

RAPORT

VJETOR 2024



RAPORT 2024

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN
E SHËRBIMIT CIVIL

MARS 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

MESAZHI I TITULLARIT	5
REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT	7
KAPITULLI I	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2024	
KAPITULLI II	16
MENAXHIMI I INFORMACIONIT, KËRKESAVE OSE SINJALIZIMEVE DHE ADRESIMI I PROBLEMEVE	
1. Analiza e informacioneve, sinjalizimeve ose kërkesave të ardhura nga burime të ndryshme dhe mënyra e trajtimit të tyre	16
2. Klasifikimi i informacioneve të verifikuara për vitin 2024, sipas objektit të tyre	22
KAPITULLI III	37
MBIKËQYRJE TË PËRGJITHSHME DHE ORIENTUESE TË PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA NË INSTITUCIONE TË SHËRBIMIT CIVIL	
1. Mbikëqyrje të realizuara në kategorinë e institucioneve të pavarura	39
2. Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me realizimin e procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, mobilitetin, zhvillimin e sistemit të karrierës, si dhe aplikimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil, në institucionet e administratës vendore	42
3. Mbikëqyrje të filluara në vitin 2023 dhe të përfunduara në vitin 2024	49
KAPITULLI IV	56
MONITORIMI I ECURISË SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL, NË INSTITUCIONET E SISTEMIT TË SHËRBIMIT CIVIL: INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES VENDORE NË NIVEL QARKU DHE INSTITUCIONET E PAVARURA	
1. Hartimi dhe miratimi i planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.....	58
2. Situata lidhur me plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës së institucionit	60
3. Rekrutimi në shërbimin civil gjatë vitit 2024 dhe procedura e aplikuar për plotësimin e vendit të lirë	63
4. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.....	65
5. Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil.....	68
6. Disiplina në shërbimin civil në raport me llojin e masave të aplikuar.....	69
7. Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësit civil, sipas përcaktimit në ligj.....	71
8. Disa statistika në lidhje me përkatësinë gjinore dhe institucionet ku e kanë kryer arsimin e lartë nëpunësit civilë	71
KAPITULLI V	75
MBI VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË SKEMËS SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NDËRTIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS VENDORE	
1. Niveli i bashkëpunimit të komisionerit me institucionet e mbikëqyrura dhe ecuria e procesit përgjatë periudhës 2021-2023	77
2. Niveli i bashkëpunimit të komisionerit me institucionet e mbikëqyrura dhe ecuria e procesit përgjatë vitit 2024; situata e evidentuar	80
3. Konkluzione dhe rekomandime.....	89

KAPITULLI VI	91
MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË DAP GJATË PROCESIT TË PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS	
1. Aspekte të përgjithshme dhe statistika në lidhje me procesin e rekrutimit	92
2. Ecuria e konkurrenive të mbikëqyrura në kohë reale përgjatë vitit 2024	93
3. Pranimi i drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND)	105
4. Trajtimi i informacioneve të administruara pranë Komisionerit, në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar për verifikimin e ligshmërisë së procedurave të konkurrenive të zhvilluara nga DAP, për vitin 2024.	107
KAPITULLI VII	122
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË NGA INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETËRORE	
1. Situata e përgjithshme në lidhje me nivelin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë nga ana e institucioneve të mbikëqyrura	124
2. Plotësimi i pozicioneve të shërbimit civil në institucionet e administratës shetërore	131
3. Konkluzione dhe rekomandime	137
KAPITULLI VIII	139
MBIKËQYRJJA NË VAZHDIM DHE ECURIA E ZBATIMIT TË VENDIMEVE PARALAJMËRUESE TË KOMISIONERIT	
1. Niveli i zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit	139
2. Pjesëmarrja e Komisionerit në procese gjyqësore, në të gjitha rastet kur është thirrur nga gjykata si palë në pozita të ndryshme procedurale	146
KAPITULLI IX	147
BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL	
KAPITULLI X	154
BURIMET NJERËZORE DHE MENAXHIMI FINANCIAR GJATË VITIT 2024	
1. Struktura organizative dhe organizimi i brendshëm	154
1.1 Zhvillimi i burimeve njerëzore	155
2. Menaxhimi financiar	157
2.1 Realizimi i treguesve ekonomiko-financiar	157
KAPITULLI XI	162
NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT	
KAPITULLI XII	168
PRIORITETET E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2025	
ANEKSI NR. 1	171
INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË MBIKËQYRJEN E ORIENTUAR ME OBJEKT MONITORIMIN E ECURISË SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2024	
ANEKSI NR. 2	177
TË DHËNA NË LIDHJE ME RASTET E NËPUNËSVE CIVILË GJYQFITUES TË CILËT AKTUALISHT JANË NË LISTË PRITJE	
ANEKSI NR. 3	206
TË DHËNA NË LIDHJE ME RASTET E NËPUNËSVE CIVIL GJYQFITUES, TË RIKTHYER NË NJË POZICION TË RREGULLT TË SHËRBIMIT CIVIL	

MESAZHI I TITULLARIT

E nderuar Zonja Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar Zonja e Zotërinj Deputetë,

Shërbimi civil është një sistem i organizuar i punonjësve të shtetit, brenda të cilit ata kryejnë detyrat e tyre funksionale dhe marrëdhënia juridike midis shtetit dhe nëpunësit civil, disiplinohet nëpërmjet ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili garanton zbatimin e parimeve të shërbimit civil, ku përfshihet: qëndrueshmëria, profesionalizmi, merita, integriteti moral dhe paaensia politike dhe njëkohësisht vendos edhe rregullat e administrimit të shërbimit civil.

Pikërisht, mbikëqyrja e zbatimit të parimeve dhe rregullave të administrimit të shërbimit civil, të vendosura në këtë ligj, nga ana e subjekteve të tij është edhe thelbi i veprimtarisë së Komisionerit.

Mbikëqyrja e shërbimit civil shfaqet si një proces kompleks dhe shoqërohet me sfida të natyrave të ndryshme, ndër të cilat, ajo që spikat është sigurimi i një shërbimi civil të depolitizuar dhe profesional. Me qëllim që të arrihen rezultate konkrete në këtë drejtim, kërkohet një sistem i fortë rekrutimi dhe promovimi, i bazuar në meritokraci dhe transparencë.

Për këtë arsye gjatë vitit që po raportojmë, puna e Komisionerit është përqendruar në kontrollin e procesit të rekrutimit, duke përfshirë institucione nga të gjitha tipologjitë e sistemit të shërbimit civil. Nisur nga problemet e evidentuara gjatë aplikimit të këtij instituti të ligjit, Komisioneri është kujdesur, ndër të tjera, edhe për të unifikuar procesin nëpërmjet aplikimit të praktikave më të mira.

Një sfidë tjetër, që duhet adresuar për zgjidhje është edhe përshtatshmëria e shërbimit civil me ndryshimet e shpejta teknologjike dhe sociale. Përballja me këtë sfidë kërkon investime në sisteme elektronike, si dhe trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të punonjësve, çka do të jetë në vëmendje të Komisionerit përgjatë vitit 2025.

Rritja e nivelit të zbatimit të ligjit është objektivi i vazhdueshëm në punën e Komisionerit dhe ruajtja e këtij trendi nga viti në vit, do të realizohet, së pari, nëpërmjet forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes, në drejtim të sigurimit të pavarësisë institucionale, efektivitetit dhe pajisjes me burimet e nevojshme. Këtu përfshihet edhe përdorimi i teknologjisë për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e shërbimit civil. Së dyti, nëpërmjet aplikimit të parimit të llogaridhënies dhe transparencës, duke inkurajuar denoncimin e parregullsive dhe duke siguruar që shkeljet të ndëshkohen në mënyrë të drejtë. Së treti, do të kërkohet nga Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, si mekanizma të rëndësishëm të administrimit të shërbimit civil, të investohen në zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit civil, duke ofruar trajnime të vazhdueshme dhe mundësi për zhvillim profesional.

Për të arritur këto prioritete, nevojitet një bashkëpunim i ngushtë midis institucioneve të shtetit, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, sidomos në kuadër të integrimit të vendit në BE.

Vetëm duke punuar së bashku, mund të ndërtojmë një shërbim civil të fortë, të besueshëm dhe të aftë për t’u shërbyer qytetarëve tanë.

Duke Ju falënderuar paraprakisht për mirëkuptimin,

Me respekt,

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA

REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT

Hartimi i këtij raporti bazohet në analizën e veprimtarisë institucionale për vitin 2024 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (*KMSHC*), lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili është edhe akti ligjor që rregullon funksionimin dhe kompetencat e këtij institucioni.

- Ligji për nëpunësin civil, ka dalë i bazuar në nenin 107 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet:

1. *Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.*
2. *Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.*
3. *Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj.*

- Veprimtaria e Komisionerit mbështetet në zbatimin e legjislacionit shqiptar; rekomandimeve të Rezolutës vjetore të Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, si edhe detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar.
- Kompetencat e Komisionerit lidhur me mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil parashikohen në dispozitat e neneve 14, 15 dhe 16 të ligjit për nëpunësin civil dhe renditen si më poshtë:

Neni 14

Kompetencat e Komisionerit

1. *Komisioneri mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.*
2. *Në ushtrimin e kompetencave, Komisioneri:*
 - a) *kryen hetim të plotë administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative;*
 - b) *kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;*
 - c) *inspekton dosjet dhe çdo dokument, lidhur me administrimin e shërbimit civil;*
 - ç) *kërkon, kryesisht apo me kërkesë, dëshmi të çdo nëpunësi apo funksionari të institucionit;*
 - d) *këqyr dhe inspekton çdo praktikë administrimi në çdo institucion që punëson nëpunës civilë.*
3. *Institucionet që punësojnë nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që kanë kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo kanë informacion në këtë fushë, kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Komisionerin.*

Neni 15

Mbikëqyrja

1. Nëse gjatë mbikëqyrjes, Komisioneri çmon se ka shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil, me vendim me shkrim, paralajmëron institucionin përkatës, duke i lënë detyrat për përmirësimin e situatës dhe duke përcaktuar një afat të arsyeshëm për zbatimin e tyre.
2. Në rast të moszbatimit të vendimit të dhënë, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioneri mund të gjobisë nëpunësin përgjegjës për moszbatimin e masave. Masa e gjobës është nga 20 për qind deri në 30 për qind të pagës mujore të nëpunësit përgjegjës. Në rast të moszbatimit të mëtejshëm të vendimit, Komisioneri mund të vendosë një gjobë tjetër deri në 50 për qind të pagës mujore të personit përgjegjës.
3. Vendimi për dhënien e gjobës mund të ankimohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative.

Neni 16

Mbledhja e gjobave

1. Vendimi i gjobës ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.
 - Rregullore e brendshme “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17 datë 18.03.2015, ndryshuar me vendimin nr.158 datë 30.12.2022, të Komisionerit.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2024

Gjatë vitit 2024, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vijuar veprimtarinë e tij në zbatim të kompetencave që ka përcaktuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenet 11, 14 dhe 15 të tij, të cilat kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, duke përfshirë në prioritetet e veprimtarisë së tij objektivat e përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2023, të cilat janë zbatuar plotësisht.

Në vijim, në këtë kapitull, do të paraqesim në mënyrë të përmbledhur, punët e Komisionerit të realizuara për periudhën e raportimit dhe një përshkrim të shkurtër të situatës së konstatuar për secilin aspekt të raportuar.

Statistikat e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e të dhënave që Komisioneri ka siguruar gjatë mbikëqyrjeve në subjekt, po ashtu edhe të siguruara nga raportimet periodike të njësive përgjegjëse të institucioneve në kuadër të mbikëqyrjeve të orientuara që janë zhvilluar gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2024, janë trajtuar të gjitha informacionet/kërkesat/sinjalizimet që kanë ardhur për shqyrtim në drejtim të Komisionerit

Numri total i kërkesave / informacioneve / denoncimeve, që është marrë në analizë për këtë vit është **145** raste. Procesi ka përfunduar në **138** raste, duke mbartur për t`u trajtuar në vitin pasardhës, vetëm **7** raste. Në momentin e raportimit, ka përfunduar shqyrtimi për të gjitha rastet.

Bazuar në këto të dhëna, rezulton se për këtë vit, numri i informacioneve të ardhura në adresë të Komisionerit është në trend rritës, krahasuar me një vit më parë, ku u regjistruan **120** kërkesa/informacione/denoncime, ç`ka tregon për vlerësimin e punës së Komisionerit dhe rritjen e besimit nga ana e qytetarëve dhe institucioneve që i drejtohen për të marrë një përgjigje për probleme që kërkojnë zgjidhje.

Vihet re se vendin kryesor e zënë informacionet individuale, që kanë lidhje me marrëdhënien personale të punës të nëpunësve të ndryshëm civilë, të cilat kanë shërbyer si indicie për Komisionerin, për të verifikuar paraprakisht dhe në vijim, sipas rastit për të nisur kryesisht, procesin e inspektimit. Këto raste përfaqësojnë mbi **95 %** të çështjeve të trajtuara dhe kanë të bëjnë kryesisht, me shqetësime të qytetarëve apo të nëpunësve ekzistues, që pretendojnë se u janë bërë padrejtësi apo janë lejuar shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar ato të drejta që garantohen nga legjislacioni i shërbimit civil, duke kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për vlerësimin dhe zgjidhjen e rastit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ndonëse nuk ka për kompetencë direkte zgjidhjen e ankesave të nëpunësve civilë, bazuar në kompetencën e tij të parashikuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, për të ushtruar mbikëqyrje kryesisht, ose me kërkesë të institucioneve, ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e gjithë informacioneve/kërkesave apo denoncimeve të ndryshme, të ardhura në adresë të tij, duke i dhënë përgjigje konkrete shqetësimeve të ngritura nga subjektet e ligjit si edhe qytetarët, apo

nëpërmjet vendimeve paralajmëruese drejtuar subjekteve të mbikëqyrura, për rregullimin e situatës ligjore.

Evidentimi dhe verifikimi i informacioneve të ardhura në drejtim të Komisionerit, është një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së tij, pasi ndër të tjera, shërben edhe si një indikator për të orientuar saktë, procesin e mbikëqyrjes dhe inspektimit, drejt subjekteve që shfaqin probleme, të cilat dalin në pah nga hetimi i thelluar administrativ i rasteve të denoncuar.

Janë përfshirë në procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme dhe tematike 34 subjekte me tipologji të ndryshme të institucioneve në shërbimin civil, të planifikuar për t’u kontrolluar në planin vjetor

Gjatë këtij viti, Komisioneri ka përfshirë në mbikëqyrje tematike apo të përgjithshme 34 institucione. Referuar tipologjisë dhe objektit të mbikëqyrjes, rezulton se në këtë proces janë përfshirë:

5 institucione të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj të posaçëm, ku objekti i mbikëqyrjes ka qenë verifikimi i zbatimit të ligjit gjatë procesit të plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil.

2 institucione varësie të administratës shtetërore.

27 njësi të vetëqeverisjes vendore, të cilat i janë nënshtruar procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me realizimin e procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, mobilitetin, zhvillimin e sistemit të karrierës, si dhe aplikimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Rezulton se gjatë procesit të mbikëqyrjes janë verifikuar **1506** pozicione të shërbimit civil, ku **190** pozicione ose **12,6%** e numrit të përgjithshëm të tyre i përkasin institucioneve të pavarura dhe **1316** pozicione ose **87,4%** të pozicioneve të verifikuara i përkasin institucioneve të qeverisjes vendore.

Nisur nga mënyra e plotësimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, ka rezultuar se, nga **1506** pozicione të shërbimit civil të mbikëqyrura, **151** pozicione ose rreth **10%** e numrit të përgjithshëm, janë vende të lira; **901** pozicione ose rreth **60%**, janë të zëna në përputhje me ligjin dhe **454** pozicione ose rreth **30%**, janë të zëna nga punonjës të emëruar me akte në kundërshtim me ligjin.

Është realizuar mbikëqyrje e orientuar për të siguruar të dhëna dhe për të monitoruar ecurinë e administrimit të shërbimit civil, në të gjithë sistemin e shërbimit civil në kohë reale, ku përfshihen: institucionet e administratës shtetërore, institucionet e vetëqeverisjes vendore në nivel qarku dhe institucionet e pavarura

Komisioneri, gjatë vitit 2024, ka patur në fokus të veprimtarisë së tij, monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së administrimit të shërbimit civil, në të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil. Për këtë arsye, nëpërmjet Urdhrit nr. 28 (168 prot.), datë 15.2.2024, ka nisur mbikëqyrjen e orientuar për njohjen e situatës për të gjitha institutet e ligjit në të gjitha këto institucione. Ky proces është realizuar përgjatë gjithë vitit kalendarik dhe në të janë përfshirë 203 institucione të sistemit të shërbimit civil, të grupuara sipas kësaj tipologjie: institucionet e administratës shtetërore (112), institucionet e pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj të posaçëm (18), si dhe njësitë e qeverisjes vendore (73).

Proceset që janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme janë kryesisht: publikimi i planit të rekrutimit dhe pozicioneve të lira, nëpërmjet verifikimit të vazhdueshëm në portalin e AKPA-së; publikimi i procedurës së konkurrimit për çdo pozicion apo grup pozicionesh; publikimi i listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta

të përcaktuara në shpalljen për konkurrim për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil/ngritje në detyrë; publikimi i shpalljes së fituesit apo përfundimin e konkurrimit pa asnjë fitues.

Rezulton se gjatë gjithë vitit, janë monitoruar nga Komisioneri 16095 pozicione pune në total.

Në përfundim të këtij procesi, i cili trajtohet gjerësisht në vijim të këtij raporti, Komisioneri vlerëson se është bërë një punë e mirë në drejtim të arritjes së qëllimit të tij, pasi tashmë janë siguruar statistika dhe të dhëna të mjaftueshme për të analizuar ecurinë e administrimit të shërbimit civil dhe për të nxjerrë përfundime të vlefshme, të cilat do të orientojnë ecurinë e procesit të mbikëqyrjes në vijim.

Mbikëqyrja ka nxjerrë në pah punën e mirë që është bërë nga subjektet e ngarkuara prej ligjit me administrimin e shërbimit civil në disa drejtime, si edhe nevojat që ata kanë për asistencë gjatë veprimtarisë së tyre.

Ka vijuar procesi i mbikëqyrjes për të sjellë në standardet ligjore strukturën organizative të njësive të vetëqeverisjes vendore

Edhe përgjatë vitit 2024, Komisioneri ka vijuar mbikëqyrjen e orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (*bashki*). Gjatë këtij procesi, Komisioneri i ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme këto institucione

nga pikëpamja teknike. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj asistence është edhe miratimi i një udhëzuesi të posaçëm, i cili iu është dërguar menjëherë të gjitha subjekteve vendore, me qëllim adresimin e problemeve të evidentuara ndër vite, si dhe duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur nëpërmjet disa akteve

nënligjore, në lidhje me kufijtë e pagave dhe kategorizimin e pozicioneve në administratën vendore.

Përpos sa më sipër, në datat 22-24 tetor 2024, Komisioneri organizoi në selinë e tij disa takime pune me Sekretarët e Përgjithshëm dhe përfaqësues të njëjseve përgjegjëse të organeve të qeverisjes vendore ku u përfshinë 61 bashki të vendit, për të diskutuar më tej në lidhje me aplikimin e skemës së shërbimit civil në këtë tipologji institucionesh, ku morën pjesë edhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Administratës Vendore, nga ana e së cilës janë hartuar disa

manuale orientuese *“Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore”*. sipas grupimit të bashkive, bazuar në numrin e popullsisë, me synimin për të kontribuar në përmirësimin e situatës në administratën vendore, për të ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të burimeve njerëzore, si dhe për të unifikuar strukturat bazuar në aktivitetet që kryejnë këto institucione.

Ky proces do të vijojë edhe përgjatë vitit 2025, sikurse është evidentuar edhe në kapitullin ku janë trajtuar prioritetet e punës së Komisionerit për vitin në vijim.

Është realizuar mbikëqyrja e orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore

Me Vendimin nr. 31, datë 25.04.2024, Komisioneri ka filluar mbikëqyrjen e orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Në këtë mbikëqyrje të orientuar janë administruar të dhëna nga Kryeministria dhe institucionet në varësi të saj, **11** ministri të linjës dhe **104** institucione në varësi të tyre, nga ku rezultoi se, numri i përgjithshëm i vendimeve gjyqësore të formës së prerë të mbartura deri në fund të vitit 2024 është **189 raste**. Rezulton se, për periudhën 03.01.2023 deri në 31.12.2024, institucionet e administratës shtetërore kanë mundur të ekzekutojnë vetëm **55** vendime ose **29.1 %** të rasteve, ndërsa janë ende të pa ekzekutuara **134** vendime gjyqësore të formës së prerë ose **70.9 %** për të cilët, nëpunësit gjyqfitues aktualisht janë të regjistruar në listë pritje.

Rezulton se, gjatë periudhës 2023-2024, nga **116** institucione të administratës shtetërore të mbikëqyrura, kanë pasur detyrimin për të ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë **18** prej tyre, ku bëjnë pjesë **10** ministri dhe **8** institucione varësie, ndërsa **98** institucionet e tjera, kanë raportuar se nuk kanë vendime gjyqësore për ekzekutim.

Pasi u verifikua niveli i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë rezultoi se, nga institucionet të cilat kishin detyrimin për të ekzekutuar vendime gjyqësore **18** institucione, **3** institucione nuk kishin mundur të ekzekutonin asnjë vendim gjatë dy viteve, ndërsa **15** institucione (**7 ministri dhe 8 institucione varësie**) kanë ekzekutuar **55** vendime gjyqësore.

Njëkohësisht, ky proces është ndjekur edhe përmes punës konkrete të grupit të përbashkët të punës me përfaqësues të

Komisionerit dhe DAP, duke marrë pjesë në Komisionet e Posaçme të ngritura nga institucionet qendrore për emërimin në detyrë të nëpunësve gjyqftues.

Ky proces është mbyllur me Raportin e vlerësimit nr. 77 prot., miratuar me Vendimin nr. 88, datë 20.12.2024 të Komisionerit.

Është realizuar mbikëqyrja e orientuar, nëpërmjet monitorimit "on line" dhe në subjekt, në lidhje me rekrutimet e realizuara nga Departamenti i Administratës Publike

Ky proces është realizuar pranë DAP, përmes monitorimit të procedurave të konkurrimit për pranim në shërbim civil, në nivelin ekzekutiv, të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, duke administruar informacion të vazhdueshëm në faqen zyrtare “online” të Departamentit të Administratës Publike; nëpërmjet informacionit të marrë nga përfaqësues të DAP, të autorizuar për komunikim me Komisionerin; si dhe të dhënave të mbledhura gjatë fazës së testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, në disa prej procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, për të gjitha nivelet e nëpunësisë, në të cilat grupi i punës ka qenë prezent.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri ka rritur prezencën e tij gjatë procesit të zhvillimit të procedurave të konkurrimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike, përgjatë gjithë vitit kalendarik, duke i mbikëqyrur ato në vend, në kohë reale, në të gjitha fazat, për disa raste (8 raste) të përzgjedhura sipas tipologjisë së pozicioneve të shpallura për t'u plotësuar, të klasifikuara sipas kategorisë së pozicioneve në hierarkinë e shërbimit civil (*niveli ekzekutiv, niveli i ulët, i mesëm ose i lartë drejtues*), si edhe sipas tipologjisë së procedurës së aplikuar (*pranim në nivelin ekzekutiv; lëvizje paralele, apo ngritje në detyrë*).

Monitorimi i këtij procesi ka si synim të parandalohen shkeljet ligjore në pikëpanjen procedurale, si dhe të sigurohet një proces i drejtë dhe transparent konkurrimi.

Në kuadër të mbikëqyrjes së administrimit të procesit të konkurremeve, Komisioneri ka trajtuar edhe 10 ankesat e ardhura në adresë të tij, nga nëpunës apo kandidatë që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit të organizuara nga njësia përgjegjëse (DAP), për vitin 2024, për të cilat janë pretenduar se janë kryer apo lejuar parregullsi gjatë zhvillimit të tyre.

Po kështu, janë përfshirë në proces të hetimit të thelluar administrativ të gjitha procedurat e konkurrimit për të cilat ka pasur indicie për parregullsi të procesit dhe në përgjithësi, ka rezultuar se Departamenti i Administratës Publike ka vepruar në përputhje me procedurat ligjore.

Komisioneri vlerëson se, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të këtij procesi të vështirë dhe kompleks, duhet të vijojë punën e tij drejt rritjes së cilësisë së trupës së nëpunësve civilë të rekrutuar, nëpërmjet ndërveprimit me qytetarët, me qëllim rritjen e numrit të konkurrentëve, duke publikuar në portalin “online” të aplikimit, informacionet që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit dhe për t'i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e

rritjes së nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura.

Në këtë kontekst, në punën e Departamentit të Administratës Publike, vijon të mbetet një sfidë e vërtetë rritja e besimit tek qytetarët e interesuar për të marrë pjesë në këto procedura, për punësim në bazë të meritës, dhe suksesi në këtë rast arrihet nëpërmjet garantimit dhe zhvillimit të një procesi transparent dhe të drejtë konkurrimi, si dhe nëpërmjet krijimit të mekanizmave të posaçëm që realizojnë këtë proces (*komisionet përkatëse të rekrutimit*) me pjesëmarrës me aftësi të larta

profesionale, të paanshëm dhe me integritet të figurës së tyre.

Nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike duhet të tregoj nivel më të lartë bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore, sidomos në drejtim të planifikimit të nevojave të tyre për rekrutim, kjo me qëllim rritjen e efektivitetit në realizimin e procedurave të rekrutimit në përputhje me dispozitat ligjore me qëllim plotësimin e pozicioneve të lira, pasi rezultojnë një numër i lartë i pozicioneve të lira që nuk janë plotësuar gjatë vitit 2024.

Ka vijuar procesi i verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit pas përfundimit të afatit të paralajmërimit

Për periudhën që po raportohet, pas përfundimit të afatit të lënë në vendimet paralajmëruese, procesi i verifikimit të zbatimit të tyre nga institucionet është realizuar për 38 vendime paralajmëruese të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, inspektimit apo hetimit administrativ (*ku përfshihen edhe vendime të dala përpara periudhës së raportimit*). Referuar tipologjisë së tyre, këto vendime i përkasin grupit të institucioneve si vijon: 18 vendime institucioneve të administratës shtetërore (*nga të cilat 11 ministrive, 7 institucioneve të varësisë*) ose 47% e numrit të përgjithshëm; 19 vendime njëjësive të qeverisjes vendore (*nga të cilat 18 bashkive dhe 1 këshilli qarku*) ose 50% e numrit të përgjithshëm; dhe 1 vendim institucioneve të pavarura ose 3% e numrit të përgjithshëm.

Referuar ecures së tij, rezultojnë se procesi i mbikëqyrjes në vazhdim është

përmbyllur për 27 vendime paralajmëruese, nga të cilat: për 22 vendime janë zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri, për 3 vendime është bërë objektivist e pamundur ndjekja e zbatimit të vendimit për shkak se ka rënë objekti, apo për shkak të ndryshimit të rrethanave (*siç është rasti kur institucioni ka dalë nga fusha e veprimit të ligjit për nëpunësin civil*) dhe për 2 vendime, procesi është përmbyllur për shkak se çështja është duke u shqyrtuar gjyqësisht dhe do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata.

Nisur nga përpjekjet serioze të institucioneve të mbikëqyrura për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në përputhje me detyrat e lëna nga Komisioneri në vendimet paralajmëruese, nuk ka qenë e nevojshme të aplikohen masa detyruese për gjatë tërësisë së nëpunësve që administrojnë shërbimin civil.

Ka vijuar pjesëmarrja e Komisionerit në procese gjyqësore, në të gjitha rastet kur është thirrur nga gjykata si palë në pozita të ndryshme procedurale

Gjatë vitit 2024, një nga veprimtaritë e Komisionerit përgjatë vitit 2024, ka qenë pjesëmarrja në seancat e zhvilluara nga gjykatat administrative për **19 procese gjyqësore**, ku Komisioneri është thirrur si palë e paditur apo palë e tretë nga nëpunësit civilë apo nga institucionet e administratës publike.

Në të gjitha rastet gjykimi ka pasur për objekt mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me institute të ndryshme të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pavarësisht nëse ka pasur ose jo një vendimmarrje nga ana e KMSHC-së. Pranë gjykatave më të larta janë për gjykim **56 procese administrative** për të cilat është realizuar kontroll i vazhdueshëm i ecurisë së tyre.

MENAXHIMI I INFORMACIONIT, KËRKESAVE OSE SINJALIZIMEVE DHE ADRESIMI I PROBLEMEVE

1. Analiza e informacioneve, sinjalizimeve ose kërkesave të ardhura nga burime të ndryshme dhe mënyra e trajtimit të tyre

16

Trajtimi i informacioneve apo kërkesave, marrë nga burime të ndryshme që janë kryesisht nëpunësit civilë, institucionet apo palë të treta, edhe për vitin 2024, ka qenë përparësi e punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si në drejtim të evidentimit të problemeve konkrete dhe marrjes së masave për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në raste të veçanta, ashtu dhe evidentimin e problemeve, mbi bazën e të cilave janë planifikuar e më pas kryer mbikëqyrje/inspekte, të përgjithshme apo tematike.

Në vitin 2024, institucionet e administratës publike, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kanë kërkuar bashkëpunim me Komisionerin për çështje të ndryshme, interpretim apo sqarime të dispozitave, për raste të ndryshme, me të cilat ata janë ndeshur gjatë veprimtarisë së përditshme.

Me qëllim rritjen e shpejtësisë së reagimit, për të afruar sa më shumë kohën nga ndodhja e shkeljes së pretenduar të të drejtave të nëpunësit, me momentin e reagimit për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, ka vijuar të përdoret metoda e verifikimit paraprak të informacionit, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore, e sidomos rrugët të cilat i mundëson zhvillimi i teknologjisë, duke siguruar informacion të shpejtë dhe zgjidhjen e situatës në kohën e duhur.

Në rastet kur janë konstatuar shkelje të përsëritura të ligjit është kaluar në hetim të thelluar administrativ, duke u trajtuar si procese inspektimi, të cilat janë përmbyllur me një vendim konkret paralajmërimi, ose me përfundim të procesit dhe arkivim të çështjes, në ato raste kur është vërejtur se njësia përgjegjëse, apo subjektet e posaçme të ngarkuara me detyra specifike për administrimin e aspekteve të ndryshme të shërbimit civil, kanë vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit, si nga pikpanja materiale ashtu edhe procedurale.

Në disa raste informacionet e paraqitura kanë shërbyer për fillimin e procesit të mbikëqyrjes, dhe janë bashkuar me këtë proces, duke marrë zgjidhje me përfundimin e tij, ashtu si do të analizohet konkretisht në vijim të kësaj rubrike të raportit.

Situata e paraqitur më sipër, është materializuar me të dhënat e kësaj tablele:

Tabela nr.2.1 Arsyt e fillimit të proceseve të verifikimit/hetimit administrativ/asistencës tekniko-ligjore, për vitin 2024

Arsyt e fillimit të procesit të verifikimit/hetimit administrativ /asistencës tekniko-ligjore	Rastet e regjistruara në vitin 2024
Me kërkesë të institucioneve	45
Kryesisht nga Komisioneri, nisur nga informacione prej nëpunësve dhe të tretëve	100
TOTALI	145

17

Referuar vlerave numerike në tabelën e mësipërme, gjatë vitit 2024, janë verifikuar **145** informacione, prej të cilave procesi ka përfunduar në **138** raste dhe **7** raste janë mbartur për t`u trajtuar në vijim, në vitin 2025, të cilat tashmë kanë përfunduar të gjitha.

Vlen të theksohet se çështjet e trajtuara kryesisht nga Komisioneri, të filluara mbi bazë informacionesh të marra nga palë të treta, të cilat kanë ngritur pretendimin për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, janë përfunduar me përparësi, në respektim të afateve procedurale dhe me një reagim efektiv, duke bërë ndërhyrje konkrete për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, për çdo praktikë kur janë evidentuar probleme të mosrespektimit të legjislacionit të shërbimit civil.

NË LIDHJE ME ECURINË E PROCESIT TË INSPEKTIMEVE, gjendja paraqitet më hollësisht, si më poshtë:

Tabela nr.2.2 Ecuria e procesit të verifikimit/hetimit administrativ/asistencës tekniko-ligjore, gjatë vitit 2024

Ecuria e procesit të verifikimit/hetimit administrativ/asistencës tekniko-ligjore	Rastet e filluara kryesisht, mbi bazë të informacioneve të nëpunësve	Raste të filluara me kërkesë të institucioneve	TOTALI
Numri i rasteve të përfunduara gjatë vitit 2024	94	44	138
Numri i rasteve në proces (mbartur dhe përfunduar, në fillim të vitit 2025)	6	1	7
TOTALI	100	45	145

NË LIDHJE ME TIPOLOGJINË E INSTITUCIONEVE për të cilat kanë ardhur informacionet, paraqitet kjo situatë:

Tabela nr.2.3 Tipologjia e institucioneve të përfshira në procese të verifikimit/hetimit administrativ/asistencës tekniko-ligjore, me çështje të përfunduara gjatë vitit 2024

Tipologjia e institucioneve të përfshira në procese të verifikimit/hetimit administrativ/	Raste të filluara kryesisht nisur nga	Raste të filluara me kërkesë të	TOTALI
---	---------------------------------------	---------------------------------	---------------

asistencës tekniko-ligjore me çështje të përfunduara		kërkesa e nëpunësve	institucioneve	
A.	<i>Institucione të administratës shtetërore</i>	<u>48</u>	<u>30</u>	78
	Ministri	12	10	22
	Institucione varësie	36	20	56
B.	<i>Institucione të administratës vendore</i>	<u>40</u>	<u>8</u>	48
	Këshill Qarku	5	3	8
	Bashki	35	5	40
C.	<i>Institucione të pavarura</i>	<u>12</u>	<u>7</u>	19
TOTALI (A + B + C)		100	45	145

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se nga **145** informacione të regjistruara pranë Komisionerit, **100** prej tyre janë paraqitur nga nëpunës civilë dhe **45** kërkesa kanë ardhur nga institucionet.

Nga **100** informacione të depozituara nga nëpunës civilë, rezulton se :

- nga administrata shtetërore (ku përfshihen institucionet e administratës qendrore dhe ato të varësisë) janë regjistruar **48** raste ose **48%** e rasteve;
- nga administrata vendore (ku përfshihen institucionet bashkitë dhe këshillat e qarkut) janë regjistruar **40** raste ose **40%** e rasteve;
- nga organe të pavarura vetëm **12** raste ose **12%** e rasteve.

Nga tabela e mësipërme, vërehet se në numrin e përgjithshëm të rasteve të trajtuara që i përkasin administratës shtetërore, numrin më të lartë e zënë kërkesat e adresuara nga institucione të varësisë, në administratën shtetërore. Kjo lidhet me faktin se kjo kategori institucioneesh kanë qenë në proces ndryshimi e riorganizimi të vazhdueshëm, si dhe kanë objekt më të kufizuar në veprimtarinë e tyre. Këto shkaqe sjellin si pasojë një dinamikë më të madhe në veprimtarinë e nëpunësve duke ndikuar si në lëvizjen në pozicionet e punës, ashtu edhe në marrëdhënien me drejtuesit e tyre, të cilët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me ta, në lidhje me realizimin e detyrave të përditshme.

Po kështu, kjo situatë vjen edhe për faktin se në një pjesë të mirë të këtyre institucioneve mungojnë pozicionet e punës që duhet të merren drejtpërdrejtë me menaxhimin e burimeve njerëzore e, për pasojë, administrimi i shërbimit civil kryhet shpesh nga specialistë, që kanë detyra të tjera sipas strukturës në zbatim, të cilëve u ngarkohet edhe detyra për menaxhimin e burimeve njerëzore. Nga ana tjetër, njësitë e burimeve njerëzore në ministrinë e linjës e kanë të vështirë të administrojnë shërbimin civil në këto institucione, në koherencë të plotë me momentin e kryerjes së veprimeve administrative që kanë të bëjnë me shërbimin civil.

Në këto rrethana, krijohen kushte që mundësojnë gabime gjatë administrimit të shërbimit civil, apo për lindjen e mosmarrëveshjeve, gjë që justifikon përqendrimin e rasteve të shqyrtuara tek

kjo kategori institucionesh.


Nga rastet e shqyrtuara, mbi bazën e informacioneve të marra nga nëpunës të pushtetit vendor, pjesa më e madhe e tyre i përket bashkive, pasi ato kanë numrin më të lartë të nëpunësve civilë, që ushtrojnë veprimtari ekzekutive të përditshme dhe kanë një dinamikë më të lartë në drejtim të detyrave të ngarkuara.

Krahasuar me katër vitet e fundit, trendi i ecurisë së këtij procesi, sipas tipologjisë së institucioneve në shërbimin civil paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.2.4 Informacionet sipas nivelit të administratës nga e cila kanë ardhur dhe një krahasim me gjendjen e viteve 2021, 2022, 2023 dhe 2024

TOTALI i rasteve të shqyrtuara sipas viteve	Administrata Shtetërore	Administrata vendore	Institucione të pavarura
Viti 2024 - 145 raste	78	48	19
Viti 2023 - 120 raste	61	46	13
Viti 2022 - 94 raste	57	30	7
Viti 2021 - 118 raste	55	40	23

Grafik nr.2.1 Krahasimi i numrit të informacioneve të ardhura në adresë të Komisionerit për periudhën 2021 - 2024



Nisur nga vlerat e paraqitura në tabelë, prurja e informacioneve dhe kërkesave ka pasur një rritje për vitin objekt raportimi. Vlerësojmë se, ndër të tjera, kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të njohjes nga ana e nëpunësve civilë, me të drejtat e tyre të sanksionuara në legjislacionin e shërbimit civil. Nga ana tjetër, roli i Komisionerit në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga ana e njësive të administrimit të burimeve njerëzore, në institucionet që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil, si dhe e subjekteve të tjera që ligji i ngarkon me detyra specifike, duke dalë me vendime paralajmëruese, në ato raste ku janë konstatuar paligjshmëri në administrimin e shërbimit civil, ka ndikuar në rritjen e besimit tek punonjësit e administratës publike, si dhe palëve të treta, tek ky institucion, ç` ka vërtetohet me numrin në rritje të rasteve

të trajtuara nga Komisioneri për vitin 2024.

Nëse do të raportoni në mënyrë të përmblodhur mënyrën e përfundimit të trajtimit të informacioneve të ardhura apo të mbledhura nga ana e Komisionerit, situata do të paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.2.5 Mënyra e trajtimit të informacioneve të ardhura gjatë vitit 2024

Mënyra e përfundimit të procedurës administrative	Filluar me kërkesë të institucioneve	Filluar kryesisht nga informacionet e ardhura gjatë vitit 2024	TOTALI
Vendim për përmirësimin e situatës së paligjshmërisë	1	8	9
Vendim/Relacion për mbylljen e procedurës për shkaqe të ligjshme dhe arkivimin e çështjes, pasi nuk janë konstatuar shkelje të legjislacionit të shërbimit civil	1	10	11
Bashkuar dhe zgjidhur në mbikëqyrjen e ushtruar në subjekt	0	13	13
Interpretim/kthim përgjigje kërkuar në rrugë administrative/ arkivuar pa veprime	42	63	105
Mbartur për vitin 2025	1	6	7
TOTALI	45	100	145

Sipas kësaj pasqyre, Komisioneri ka kryer hetime paraprake dhe hetime të thelluara administrative, duke i dhënë zgjidhje të gjitha informacioneve që kanë ardhur në adresë të tij, duke u shprehur dhe vlerësuar në çdo rast për nivelin e zbatimit të rregullave që përmban legjislacioni i shërbimit civil.

Duke vlerësuar mënyrën si kanë përfunduar çështjet e shqyrtuara, gjendja paraqitet si më poshtë:

- në 9 raste janë konstatuar parregullsi dhe Komisioneri ka dalë me vendim paralajmërues për të rregulluar ligjshmërinë, ose është vendosur përfundimi i hetimit administrativ në rastet kur nuk janë evidentuar veprime në kundërshtim me ligjin nga ana e njëjësive përgjegjëse apo eprorët;
- në 11 raste, ka pasur dyshime të arsyeshme për mosrespektim të ligjit, e mbi këtë bazë është urdhëruar inspektimi i çështjes, por gjatë hetimit administrativ nuk janë evidentuar veprime në kundërshtim me ligjin dhe,

për këtë arsye, është vendosur përfundimi i hetimit administrativ dhe është arkivuar çështja, duke njoftuar palët në proces;

- në 13 prej informacioneve të ardhura janë bashkuar dhe trajtuar me vendim në kuadër të mbikëqyrjes së institucionit (në ato raste kur grupet e punës, janë ngritur me urdhër të veçantë të Komisionerit);
- në 105 raste, për arsye të ekzistencës së kushteve që janë parashikuar në nenet 66, 67, 68, "Çështjet paraprake", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave

Administrative i RSH” dhe në nenin 16, të Rregullores së Komisionerit, “*Mbi Procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit*”, i është

kthyer përgjigje palëve në rrugë administrative, duke i sqaruar hollësisht për mënyrën dhe organin që duhet të vijojë trajtimin e rastit.

DUKE MARRË SI REFERENCË TIPOLOGJINË E KËRKESËS/INFORMACIONIT, nisur nga subjekti që ka iniciuar informacionin, situata paraqitet në këta tregues:

Vendin kryesor e zënë hetimet administrative, të cilat kanë marrë indicie nga informacionet e nëpunësve civilë, që denoncojnë raste konkrete që kanë lidhje me aspekte të ndryshme të zbatimit të ligjit, të cilat përfaqësojnë mbi **68.1 %** të rasteve të trajtuara. Në fakt, këto lloj kërkesash kanë të bëjnë me shqetësime të parashtruara prej nëpunësve të ndryshëm apo që pretendojnë se u janë bërë padrejtësi në shkelje të ligjit, duke kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për vlerësimin dhe zgjidhjen e rastit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk ka për kompetencë direkte zgjidhjen e ankesave të nëpunësve apo shtetasve të ndryshëm, por në kuadër të të drejtës së tij, të parashikuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për të ushtruar mbikëqyrje kryesisht, ose me kërkesë të institucioneve, për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, të gjitha informacionet apo kërkesat e ardhura nga nëpunës apo shtetas të ndryshëm, për prekje të interesave në aspekte të ndryshme gjatë veprimtarisë së tyre, kanë shërbyer si indicie për të nisur hetim administrativ kryesisht dhe verifikimin ligjor të çështjes, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në zgjidhjen e problemit të ngritur prej nëpunësit, ose në sqarimin e tij, në rastet kur pretendimi i ngritur nuk qëndron nga pikëpamja e menaxhimit të shërbimit civil.

Por, nuk kanë munguar edhe rastet kur, shtetas apo nëpunës të ndryshëm të administratës shtetërore, për motive të cilat nuk kanë ndonjë rëndësi për nisjen ose jo të procesit të verifikimit, kanë denoncuar raste të ndryshme, me pretendime të keqmenaxhimit të proceseve administrative të shërbimit civil, me qëllim favorizimi të personave të caktuar, pjesëmarrës në këto procese.

Tabela nr.2.6 Tipologjia e kërkesës/informacionit ardhur në adresë të Komisionerit, nisur nga subjekti që e ka iniciuar

Tipologjia sipas kërkesës/informacionit ardhur në adresë të Komisionerit, e përfunduar në 2024	Numri i kërkesave
Kërkesë/informacion për mosmarrëveshje administrative të ngritura nga nëpunës të ndryshëm (<i>personale</i>)	93
Kërkesë/informacion për mosmarrëveshje administrative nga palë të treta	7
Kërkesë nga institucionet apo kryesisht	45
TOTALI	145

Vlen të theksohet se në të gjitha rastet, kur janë paraqitur kërkesa/denoncime për të tretë, objekti i kërkesës, apo parashtrimi i paraqitur se në këtë ose atë rast janë kryer veprime me qëllim favorizimi për një nëpunës apo konkurrent të caktuar, fakti nuk është vërtetuar dhe çështjet kanë përfunduar, sipas rastit, ose me arkivim ose me kthim përgjigje palës denoncuese.

2. Klasifikimi i informacioneve të verifikuara për vitin 2024, sipas objektit të tyre

Duke bërë një klasifikim mbi llojet e mosmarrëveshjeve administrative, të trajtuara kryesisht, rast pas rasti për vitin 2024, gjendja paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2.7 Mosmarrëveshjet administrative, të klasifikuara sipas objektit të tyre

Instituti ku pretendohet parregullsia sipas kërkesës/informacionit	Rastet
Procedurë disiplinore	11
Procedurë transferimi ose lirim nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi	13
Procedurë transferimi i përkohshëm	7
Procedurë konfirmimi në fund të periudhës së provës apo vlerësime pune	7
Procedurë konkurrimi	15
Pezullim nga shërbimi civil	5
Interpretim të nenit 65/c për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, për shkak të ligjit	23
Të tjera (<i>sqarim për kuptim/zbatim të drejtë ligji; parashkrimi i masës disiplinore; transferimi të përkohshëm për nevoja pune; mbi zbatimin e vendimit të gjykatës së formës së prerë dhe të drejtën e nëpunësit për rikthim në shërbimin civil, etj.</i>)	64
TOTALI	145

Nisur nga objekti i çështjeve të shqyrtuara për periudhën e raportimit, rezulton se numrin më të madh mes tyre e zënë procedurat disiplinore, konkurrimet, transferimet e përkohshme, transferimet apo lirimet nga detyra për shkak ristrukturimi, etj.

SA I TAKON INSTITUTIT TË PËRSHKRIMIT TË PUNËS, gjatë vitit 2024, Komisioneri në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, si dhe neneve 2 dhe 14, germa a), neneve 16 dhe 19, pika 1 dhe 21 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, në zbatim të kërkesave të rezolutës “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2023*”, (pika 2), ka urdhëruar kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, për hartimin dhe miratimin e formularit të përshkrimit të punës, në pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, në institucionin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe në institucionin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Objekti i inspektimit është fokusuar në verifikimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me procedurën e hartimit dhe miratimit të akteve të përshkrimit të punës, për pozicionet e shërbimit civil, në këto institucione. Inspektimi sipas objektit, ka përfshirë veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet/mekanizmat e tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë hartimit të përshkrimeve të punës; verifikimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, të një kategorie veprimesh administrative në këtë institucion, në lidhje me procedurat e ndjekura në implementimin e institutit të ligjit për shërbimin civil siç janë: analiza e përmbajtjes së formularit të përshkrimit të punës dhe verifikimi i zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin e tij, sipas fazave dhe formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, e të tjera.

Gjatë këtij procesi u verifikua zbatimi i akteve ligjore e nënligjore që e rregullojnë atë, duke pasur parasysh faktin se në nënin 7, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”* dhe ligjin nr. 90/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, ku parashikohet se ministratë janë pjesë e institucioneve të administratës shtetërore dhe struktura (*pozicionet e punës*) dhe organika e tyre (*harmonizimi i pozicioneve të punës sipas funksioneve të tyre*) përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

Ndërkohë, në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, lidhja nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, në ndarjen 2, parashikohet në mënyrë të shprehur se: *“aparetet e ministrave”*, përfshihen në shërbimin civil si pjesë e institucioneve të administratës shtetërore.

Mbi bazën e këtyre rregulimeve me akte ligjore e nënligjore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucione shtetërore, kanë hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, i shfuqizuar dhe kanë ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore.

Evidentojmë faktin se, Departamenti i Administratës Publike, sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 1, germa f), të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, paraqitet si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil të institucioneve të mbikëqyrura, ndërsa rolin e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion e luan Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e për këtë arsye është përfshirë si subjekt i këtij inspektimi.

Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij i ngarkon nëpunësit e punësuar në kategoritë drejtuese të shërbimit civil shëf/përgjegjës sektori, drejtor drejtorie, drejtor drejtorie të përgjithshme/ sekretar i përgjithshëm dhe titullarin e institucionit me detyra specifike në administrimin e shërbimit civil, sipas instituteve të ligjit, ndër të cilët edhe për aspektet e institutit të hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës.

Në momentin e inspektimit, institucioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural funksiononte mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me urdhërin nr. 61, datë 18.4.2024, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*”, ndërsa institucioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka funksionuar mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me urdhërin nr. 14, datë 25.1.2024 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së pozicioneve të punës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*”, të Kryeministrit.

Ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 19, pika 1, parashikon se, përshkrimi i punës është dokumenti bazë për klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive, klasave dhe natyrës së çdo pozicioni pune.

Në zbatim të kësaj dispozite, ka dalë Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, me vendimin nr.305/2017, ku në kreun I “*Dispozita të përgjithshme*”, pika 2, parashikohet se, përcaktimet e këtij vendimi janë të zbatueshme për të gjitha institucionet që janë pjesë e shërbimit civil.

Ky akt nënligjor, në kreun IV “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*”, pika 14, përcakton se:

“*Përshkrimet e punës hartohen a) kur krijohen institucione të reja, b) kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo c) kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni*”.

Pra, legjislacioni i shërbimit civil, i ka parashikuar në mënyrë shteruese rastet kur hartohen përshkrimet e punës me qëllim që të mos abuzohet në drejtim të shkeljes së të drejtave të nëpunësit civil dhe të mos veprohet në dëm të institucionit për arsye subjektive.

Në këto raste, janë përcaktuar edhe subjektet e ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit, miratimit e administrimit të përshkrimeve të punës, që janë: analisti i punës, eprori direkt i pozicionit respektiv të punës, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe Sekretari i Përgjithshëm, të cilët duhet ti hartojnë këto akte për çdo pozicion të shërbimit civil, duke respektuar procedurën dhe rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Sipas kreut IV “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*”, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, përcaktohet edhe përkufizimi i këtij procesi që është : “*Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit respektiv të punës. Ai shërben për:*

- a) të njohur nëpunësin civil me punën që duhet të kryejë;
- b) vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës;
- c) vlerësimin e rezultateve në punë;
- ç) përcaktimin e kërkesave të veçanta për çdo pozicion pune në shërbimin civil”.

Më tej procesi specifikohet në udhëzimin nr. 01, datë 31.05.2017, të DAP “*Për hartimin dhe përshkrimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, pasi përshkrimi i punës shërben për ta njohur nëpunësin me punën konkrete që do të kryejë, detyrat dhe përgjegjësitë që do të ketë

gjatë ushtrimit të funksionit. Në bazë të këtyre elementeve, realizohet edhe vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil. Vlerësimi i rezultateve të nëpunësit do të ishte i pamundur nëse nuk do të përcaktoheshin më parë detyrat dhe objektivat për t'u përmbushur për një afat kohor të përcaktuar.

Gjatë inspektimit në këto institucione, u konstatua se janë respektuar procedurat që duhet të ndiqen nga zyrtarët e ngarkuar me këtë proces.

a) Procedura paraprake e ndjekur gjatë hartimit të përshkrimit të punës

Rezultoi se hartimi i përshkrimit të punës është kryer në përputhje me ligjin duke u paraprirë nga një analizë konkrete e analistit të punës, i cili është edhe personi përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionin e punës dhe analizën e këtij informacioni me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësiave e kërkesave të veçanta të pozicionit dhe hartimin e përshkrimit të punës. Në institucionet e inspektuara, detyra e analistit të punës është e konkretizuar në pozicione pune të përcaktuara, respektivisht: në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ndërsa në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në pozicionin e punës Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Sa i takon etapave procedurale që duhet të ndiqen gjatë procesit të hartimit të përshkrimit të punës, Komisioneri ka konstatuar se ato njihen nga subjektet që duhet ti aplikojnë dhe janë respektuar prej tyre në të gjitha rastet, sipas radhës që paraqitet në diagramën në vijim:

Veprimet procedurale që duhet të kryhen paraprakisht gjatë procesit të shkrimit të formularit të përshkrimit të punës



Nga analiza e detajuar e dosjeve individuale të punonjësve të emëruar në pozicione të shërbimit civil, në ministritë përkatëse u konstatua përputhshmëri e kriterëve të posaçme që plotëson secili punonjës, me përshkrimin e punës të vendosur në dosjen individuale të tyre.

b) Ndërtimi i formularit sipas elementëve të tij

Nëpërmjet procesit të inspektimit u konstatua se gjatë hartimit të përshkrimeve të punës, nga ana e analistit të punës dhe eprorit direkt të pozicionit respektiv, janë respektuar elementët e nevojshëm gjatë ndërtimit të këtij akti, të cilët rregullohen nëpërmjet bazës ligjore përkatëse, sipas diagramës në vijim:

Elementët e nevojshëm gjatë hartimit të përshkrimit të punës

Kategoria e I Nëpunës civil të nivelit të lartë	• Menaxhon institucionin • Formulon politika dhe këshillon rreth tyre • Përcakton objektiva, formulon programet, standartet • Planifikon dhe drejton veprimtarinë e institucionit • Përfaqëson institucionin
Kategoria e II Nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues	• Menaxhon një fushë të veçantë veprimtarie • Planifikon, drejton dhe koordinon veprimtarinë e një njësie organizative • Identifikon nevojat e zhvillimit të politikave • Rekomandon komponentë të planifikimit strategjik brenda fushës
Kategoria e III Nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues	• Mbikëqyr dhe koordinon veprimtarinë e njësisë përkatëse • Udhëzon, këshillon dhe ndjek zbatimin e detyrave • Analizon dhe zgjidh probleme brenda kuadrit të politikave • Jep kontribut në procesin e vendimmarjes
Kategoria e IV Nëpunës civil të kategorisë ekzekutive	• Zbaton detyrat në përputhje me udhëzimet • Ofron mbështetje burokratike • Zotëron njohuri të përgjithshme/posaçme

SA I TAKON INSTITUTIT TË DISIPLINËS NË SHËRBIMIN CIVIL, janë regjistruar gjithsej **11** informacione dhe vlen të theksohet fakti se në pjesën më të madhe të rasteve të aplikimit të tij, është konstatuar që procedurat kanë qenë të rregullta e janë bërë përpjekje për të zbatuar kërkesat e nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore. Megjithatë, janë trajtuar edhe disa raste, kur pas shqyrtimit të procedurës së ndjekur nga organet disiplinore, janë konstatuar shkelje të legjislacionit, prandaj për rregullimin e situatës se paligjshmërie Komisioneri ka dalë me vendim paralajmërues.

Një numër i konsiderueshëm informacionesh, **15** raste, janë paraqitur nga nëpunës civilë apo shtetas të ndryshëm, të cilët kanë marrë pjesë në konkurrimet e organizuara nga DAP, duke pretenduar se janë lejuar parregullsi nga subjektet që kanë zhvilluar procedurat e konkurrimit.

Objekti i denoncimeve ka pasur lidhje me aspekte të ndryshme të administrimit të këtij procesi, si mënyra e llogaritjes së pikëve, apo e vlerësimit të tezave nga ana e Komiteteve të Përhershme të Pranimit, apo atyre të Ngritjes në Detyrë, etj. Në këto raste, nga shqyrtimi i çështjeve ka rezultuar se në gjithë rastet e trajtuara, puna e njësisë përgjegjëse (*DAP*) dhe e komiteteve përkatëse, ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Në përgjithësi, është konstatuar se denoncuesit kanë pasur përshtypje të gabuara për ligjin; njohuri jo të plota në lidhje me proceset dhe procedurat e kërkuara, ose pretendimet e tyre nuk kanë qenë të mbështetura në prova dhe në fakte, por janë ngritur thjesht mbi supozime.

Nga ana e institucioneve të administratës vendore dhe institucionet e pavarura nuk është rregjistruar asnjë informacion me këtë objekt.

Nisur nga përmbajtja e tabelës nr. 2.7, konstatohet se një numër të konsiderueshëm të rasteve të shqyrtuara, e përbëjnë ato me objekte specifike si: kërkesa për sqarim/interpretim dhe zbatim të unifikuar të ligjit; transferimi i përkohshëm për nevoja pune; transferimi i përhershëm në kuadër të ristrukturimit të institucionit; vlerësimi i rezultateve në punë. Po kështu, në këtë kategori futen edhe rastet e paqartësive të institucioneve të ndryshme, e për pasojë, paraqitja e kërkesave për sqarime të aspekteve të veçanta të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil.

Në disa raste është bashkëpunuar me institucionet, për çështje të kuptimit dhe zbatimit të ligjit material, duke dhënë zgjidhje konkrete dhe të unifikuara, si në rastin e administrimit të marrëdhënies së punësimit, në kushtet kur është vendosur me ligj ndryshimi juridik i saj, për pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil

Sjellim në vëmendje qëndrimin e Komisionerit në rastin e kërkesës për asistencë teknike në lidhje me disa aspekte të administrimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, në institucionin e AKEP, në kushtet kur është vendosur me ligj ndryshimi juridik i marrëdhënies së punësimit për pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil, duke e rregulluar këtë aspekt të administrimit të burimeve njerëzore, sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Ndodhur përpara këtij fakti, institucioni i AKEP, ka kërkuar vlerësimin e Komisionerit, për mënyrën se si duhet të veprojë në lidhje me marrëdhënien e punësimit, për nëpunësit civil të pezulluar me afat (2 vjeçar) dhe ata të pezulluar pa afat për shkak të ligjit, dhe si duhet të trajtohen nëpunësit civil gjyqftues me vendim të formës së prerë, të cilët janë në listë pritjeje.

Ndërkohë, është udhëzuar institucioni se si duhet të veprohet, ç`ka shërben edhe si një moment i unifikimit të zbatimit të ligjit për institucionet e administratës publike, në raste të ngjashme.

Në raportin përfundimtar të Komisionerit për rastin në fjalë është mbajtur ky qëndrim:

“...Në përmbajtjen e nenit 66, pika 1, shkronja ë), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, ku referon ligji organik i institucionit, parashikohet: a) shkak i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, si edhe b) organi administrativ që e deklaron këtë fakt.

Kjo do të thotë se, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, në datën 20.12.2024, njësisia e burimeve njerëzore në institucionin e AKEP-it, është e detyruar që të deklarojë me një vendim nominal, lirim nga shërbimi civil të çdo nëpunësi që gëzon statusin e nëpunësit civil,

i cili është i rregjistruar në Rregjistrin Qendror të Personelit, që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në çdo lloj situate të administrimit të shërbimit civil ku nëpunësi ndodhet në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, duke përfshirë këtu edhe a) nëpunësit e pezulluar, si edhe b) ata që janë në listë pritjeje për shkak të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor.

Në këtë përfundim arrijmë edhe duke analizuar dispozitat konkrete që rregullojnë institutin e pezullimit nga shërbimi civil, të cilat në përmbajtjen e tyre parashikojnë se

marrëdhënia e shërbimit civil mund të ndryshojë ose përfundojë vetëm me vullnetin e nëpunësit ose kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil sipas ligjit për nëpunësin civil.

Në kreun IX “Pezullimi nga shërbimi civil”, të ligjit për nëpunësin civil, respektivisht në nenin 53/2, parashikohet se:

“... Gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me nismën e nëpunësit të pezulluar, ose kur parashikohet shprehimisht nga ky ligj.”;

dhe në nenin 56/1, parashikohet se:

“Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ...”.

Në rast se nëpunësit e pezulluar do të kërkojnë ndërprerjen e pezullimit dhe rikthimin e tyre në një pozicion pune në shërbimin civil, ende pa filluar efektet juridike të ligjit që po diskutojmë, dhe kjo kërkesë e tyre do të materializohet në një pozicion konkret të shërbimit civil, atëherë ata do të trajtohen në vijim, në përputhje me kërkesat e ligjit, sikundër edhe nëpunësit e tjerë.

Ndërsa, në rastin e një nëpunësi civil të emëruar në listë pritje për shkak të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Komisioneri vlerëson se, marrëdhënia e tij me statusin e nëpunësit civil konsiderohet si e pandërprerë ndonjëherë dhe për këtë arsye, kjo kategori nëpunësish do të trajtohet si të gjithë nëpunësit e tjerë civilë të institucionit, duke deklaruar lirimin nga shërbimi civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit.

.....”

Trajtimi i kërkesës për asistencë të ardhur pranë Komisionerit nëse vlerësimi i pjesshëm i kryer për nëpunësin, mund të konsiderohet si vlerësim i fundit, për kualifikimin e kandidatit për fazën e dytë të konkurrimit, ngritje në detyrë

Nisur nga informacionet e ardhura pranë Komisionerit, të cilat kanë pasur si objekt të tyre vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur nga njësia përgjegjëse, për kualifikimin e kandidatëve në një procedurë konkurrimi, vlen të përmendet orientimi i dhënë nga Komisioneri, për veprimet që duhen të ndiqen nga njësia përgjegjëse, lidhur me kualifikimin ose jo të një konkurrenti pjesëmarrës në një procedurë konkurrimi, në rastin kur vlerësimi i fundit, i kryer për këtë nëpunës është i pjesshëm.

Në rastin në fjalë, nëpunësi është rikthyer në shërbimin civil në kuadër të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe ka konkurruar për ngritje në detyrë në një pozicion të nivelit të ulët drejtues. Pyetja që shtrohet është nëse: vlerësimi i pjesshëm i paraqitur nga kandidati, mund të konsiderohet, si vlerësim i fundit, për kualifikimin e kandidatit për fazën e dytë të konkurrimit, ngritje në detyrë?

Në përgjigje të kësaj pyetje, Komisioneri ka mbajtur këtë qëndrim:

“...Në vijim të marrëdhënies së punësimit, në zbatim të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, e ndryshuar, për këtë nëpunës është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën 21 mars - 30 qershor 2024 dhe është vlerësuar me nivelin 3 “Mjaftueshëm”.

Referuar kërkesave të VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, e ndryshuar, ndër kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për ngritje në detyrë, është edhe vlerësimi i fundit të jetë në nivelin 2 “Mirë” ose 1 “Shumë mirë”.

Në rastin konkret, nga ana e institucionit është kërkuar mendim, nëse vlerësimi i pjesshëm që është kryer për periudhën 21 mars - 30 qershor 2024, mund të konsiderohet si vlerësim i fundit, për kualifikimin e kandidatit për fazën e dytë të konkurrencës, ngritje në detyrë.

Për të vlerësuar këtë aspekt të zbatimit të ligjit, sqarojmë fillimisht se, instituti i vlerësimit të punës në shërbimin civil, është i parashikuar në kreun XI, neni 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në referim të pikës 1/1, të nenit 62, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, nëpunësit vlerësohen periodikisht, sipas përcaktimeve me aktin nënligjor që ka dalë në zbatim të kësaj dispozite, që është Vendimi nr. 109, datë 26.2.2014, i Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Me tej, në pikën 1 dhe 2, kreu II, i këtij akti nënligjor, parashikohet se:

“1. Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë:

a) është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik.

b) shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirimin nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

2. Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik.

...”,

Pra, në kuptim të dispozitave të mësipërme, procesi i vlerësimit të rezultateve të nëpunësit, do të quhet i plotë dhe i kryer në përputhje me kërkesat e këtij akti nënligjor, kur periudha për të cilën vlerësohen arritjet/aftësitë/dobësitë e nëpunësit është 6 mujore.

...

Në të gjitha rastet kur për nëpunësin kryhet një vlerësimi i pjesshëm, për shkak të mungesës së zyrtarëve të përfshirë në këtë proces, apo rrethanave të tjera, zyrtari zëvendësues duhet të kryejë vlerësimin përfundimtar për nëpunësin, duke marrë për bazë vlerësimin e kryer nga zyrtari i mëparshëm apo vlerësimet e mëparshme. Në të gjitha rastet, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësit, duhet të jetë përfundimtar, që do të thotë të përfshijë të gjithë periudhën 6-mujore, të cilës i

referohet dhe vetëm në këtë rast, ky proces do të quhet i kryer në zbatim të dispozitave që rregullojnë këtë institut të legjislacionit të shërbimit civil.

Në rastin konkret, duke qënë se, për këtë nëpunës civil është vendosur me vendim gjyqësor të formës së prerë, rikthimi në shërbimin civil, kjo nënkupton se, marrëdhënia e tij e punësimit pranë institucionit të AMA, ka vijuar pa ndërpreje.

Në këto rrethana zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit, pas rikthimit në detyrë të nëpunësit civil, duhet të bëjnë vlerësimin përfundimtar 6-mujor, për këtë nëpunës, duke u bazuar në vlerësimet e mëparshme të nëpunësit për periudhën janar - mars, si dhe në punës që ka realizuar për periudhën mars - qershor 2024.”

Komisioneri ka administruar kërkesa nga ana e institucioneve, për qendrimin e Komisionerit, sa i takon interpretimit të nenit 37, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Si rast më tipik, po përmendimin kërkesën e një institucioni të vetëqeverisjes vendore, në lidhje me ecurinë e marrëdhënies së punësimit për nëpunësit civil të cilët janë emëruar si anëtar të organeve të qeverisjes vendore, e konkretisht, nëse një punonjës i emëruar në shërbimin civil, mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar në këshillin bashkiak.

Komisioneri, lidhur me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, për një analizë të thelluar, ka interpretuar përmbajtjen e nenit 37, “*Të drejtat politike*”, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila rregullon raportin ndërmjet statusit në cilësinë e nëpunësit civil dhe të drejtave politiko - shoqërore të nëpunësve civilë, duke vlerësuar sa më poshtë vijon:

“...Referuar përmbajtjes së pikës 3, të nenit 37, “Të drejtat politike”, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, është parashikuar e drejta e nëpunësit civil për të kandiduar dhe për tu zgjedhur, në organet e qeverisjes vendore, mirëpo kjo e drejtë e nëpunësit civil, përkon me zbatimin e kushtit ligjor që, gjatë kësaj periudhe marrëdhënia e tij e punësimit në shërbimin civil, detyrohet të jetë e pezulluar. ...

..., nëpunësi civil i zgjedhur në këtë organ përfaqësues të qeverisjes vendore, ka detyrimin ligjor për të kërkuar pezullimin nga detyra, afati i të cilit (pezullimit) rregullohet në nenin 54, “Pezullimi për shkak të ligjit”, pika 1, germa d), të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, ku theksohet se, kandidati që regjistrohet për zgjedhjet

vendore apo politike, pezullohet nga shërbimi civil, për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit.

Pra, në zbatim të parashikimeve të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton se, nëpunësi civil nga momenti i regjistrimit si kandidat për anëtar të organeve të qeverisjes vendore, që në këtë rast përkon me cilësinë si anëtar i këshillit bashkiak, duhet të kërkojë njëkohësisht edhe pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundimin e mandatit, në rastet kur arrin të zgjidhet si anëtar i këtij organi, sikurse ka ndodhur në rastin në fjalë.

Për më tepër, fakti se, një nëpunës civil krahas kryerjes se detyrës në shërbimin civil, është njëkohësisht edhe anëtar i këshillit bashkiak, si përfaqësues i një force politike, nënkupton se, gjatë ushtrimit të veprimtarisë si anëtar i këtij organi të qeverisjes vendore, ky nëpunës do të mbajë qëndrim krah forcës politike që përfaqëson, sipas natyrës së problemit që diskutohet, duke shprehur në këtë mënyrë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, të cilat janë të hapura për publikun qoftë prezent, ashtu edhe nëpërmjet medias. Ky fakt bie ndesh me parashikimin e pikës 1, të nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, e cila në mënyrë taksative ndalon çdo nëpunës civil, pjesë e administratës publike, të veprojë në mënyrë të tillë.

Ky qëndrim i ligjvënësit është i lidhur me parimin e paanësisë politike në

administrimin e shërbimit civil, i cili parashikohet në nenin 5, “Parimet e shërbimit civil”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar: “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”.

Në konkluzion të analizës së përmbajtjes së dispozitave ligjore që normojnë këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, konstatohet se, nëpunësi civil i emëruar si anëtar në organin përfaqësues të qeverisjes vendore, që është këshilli bashkiak, ka detyrimin ligjor që gjatë kohës së emërimit si anëtar në këtë organ, të kërkojë pezullimin nga shërbimi civil për atë kohë sa vijon mandatin.”

Një qëndrim tjetër ka qenë i nevojshëm të mbahet nga ana e Komisionerit, në lidhje me procedurën e konfirmimit dhe deklarimit të statusit të shërbimit civil, për rastet kur nëpunësit e kategorisë ekzekutive, kanë plotësuar afatin 1 (një) vjeçar të periudhës së provës dhe ende nuk janë konfirmuar si nëpunës civilë

Në kushtet kur Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për administrimin e shërbimit civil, nga ana e një institucioni të administratës vendore (Bashki) janë kërkuar udhëzime se si duhet të veprohet për finalizimin e periudhës së provës, për arsye se, në përfundim të kësaj periudhe, formulari i vlerësimit të rezultateve individuale në punë është plotësuar nga eprori direkt (*zyrtari raportues*), por nuk është nënshkruar nga zyrtari autorizues. Si rrjedhojë, formulari i vlerësimit të rezultateve individuale në punë, bazuar në VKM-në nr.109, datë 26.02.2014, ka qenë i papërfunduar.

Në lidhje me këtë rast, Komisioneri ka vlerësuar se situata ka lidhje me aplikimin e bazës ligjore që përfshin nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”, e për këtë arsye ka orientuar njësinë përgjegjëse se:

“...Pas përfundimit të procesit të hartimit të vlerësimeve të punës në fund të periudhës së

provës nga ana e eprorit direkt, procesi duhet të vijonte me nënshkrimin dhe

komentet e zyrtarëve të përcaktuar nga ligji (Zyrtari Kundërfirmues dhe ai Autorizues) e pas kësaj, nëse vlerësimi do të ishte pozitiv (të paktën “kënaqshëm”), eprori direkt duhet të hartonte vendimin për konfirmimin e nëpunësit civil, të arsyetuar, i cili sipas pikës 12, të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiv” dhe ti njoftojë nëpunësit dhe njësisë përgjegjëse”, brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit.

Njësia përgjegjëse, sipas pikës 13, të vendimit të përmendur më sipër, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të eprorit

direkt, duhet të nxirrte aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit.

....

Afatet e vendosura në aktet ligjore dhe nënligjore në këtë rast, për të kryer procese të caktuara në lidhje me vlerësimin e punës dhe konfirmimin e nëpunësit civil, janë përcaktuar për të disiplinuar aktorët e procesit, me qëllim që të mos zvarritet procesi dhe për këtë arsye, mos realizimi në kohë i tyre, përbën shkak për marrjen e masave disiplinore. Mosveprimi i aktorëve të procesit, në këtë rast, nuk duhet të penalizojë nëpunësin civil, për të përmbyllur procesin e konfirmimit të tij në shërbimin civil.”

Një sërë çështjesh të trajtuara këtë vit, kanë pasur objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ecursë disiplinore të nisur në ngarkim të nëpunësve civil, në institucionet e vetëqeverisjes vendore

Për ilustrim, më poshtë po parashtrojmë pjesë nga arsyetimi i një vendimi të Komisionerit me anë të të cilit është konstatuar paligjshmëri në veprimet e eprorit direkt, pranë njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Tiranë, e për rrjedhojë janë lënë detyra për rregullimin e ligjshmërisë:

“...Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar rezulton se, nëpunësi G. D, me aktin nr.24091 prot., datë 29.06.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burimeve Njerëzore, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës Sektori, Sektori i Menaxhimit të Mjedisit, Ekonomisë Qarkulluese dhe Burimeve të Energjisë”, në Drejtorinë e Politikave Mjedisore Inovacionit dhe Zgjidhjeve Inteligjente, Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qendrueshëm, Bashkia Tiranë, kategoria e pagës III-a.

Në vijim, të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicion pune, me aktin nr. 45422 prot., datë 29.12.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Mjedisit dhe Zhvillimit të Qendrueshëm, në mbështetje të germës c),

pika 1, të nenit 57 dhe germës a), të nenit 58, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, e ndryshuar, ndaj nëpunësit G. D, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.

...

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit direkt, pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, i ndryshuar, parashikojnë të gjitha hapat e kërkuar për nisjen e ecursë disiplinore nga eprori direkt, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë: njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i

dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi, eprori direkt në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

...

Në lidhje me kompetencat e zyrtarit, i cili ka dhënë masën disiplinore, konstatohet se, referuar përshkrimit të punës për pozicionin “Përgjegjës Sektori, Sektori i Menaxhimit të Mjedisit, Ekonomisë Qarkulluese dhe Burimeve të Energjisë”, eprori direkt i nëpunësit G. D, është nëpunësja E. L, që kryen detyrën e “Drejtorit të Politikave Mjedisore, Inovacionit dhe Zgjidhjeve Inteligjente”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, kjo nëpunëse ka tagrin ligjor për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunësve në varësi të saj, të parashikuar në germën a), të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Mirëpo, konstatohet se, akti nr. 45422 prot., datë 29.12.2023, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunësit G. D, është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në Bashkinë Tiranë, duke tejkaluar kompetencat ligjore dhe procedurale për të nxjerrë një akt të tillë. Për këtë arsye, ky akt, në zbatim të germës a), pika 1, të nenit 108, “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Më tej, referuar nenit 110 dhe nenit 111, të ligjit nr. 44/2015, parashikohet se, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, e në këto kushte, vetë organi publik, që në këtë rast përkon me Drejtorin e Përgjithshëm të Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në Bashkinë Tiranë, duhet të konstatohet pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 45422 prot., datë 29.12.2023, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, nëpunësit G. D dhe të rregullojë pasojat, duke e hequr nga dosja e personelit dhe Rregjistri Qendror i Personelit”

Për periudhën objekt raportimi, Komisioneri është shprehur në lidhje me mënyrën sesi duhet të veprojë institucioni, në rastet kur me vendim gjyqësor të formës së prerë është vendosur rikthimi i një gjyqfituesi, i cili rezulton i regjistruar në një procedim penal

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka ofruar asistencë në lidhje me një aspekt të administrimit të shërbimit civil, e konkretisht, me mënyrën sesi duhet të veprojë institucioni në rastin e zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, për rikthimin në detyrë të gjyqfituesit, i cili njëkohësisht rezulton se është në procedim penal për kryerjen e një vepre penale pranë Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e çështjes, Komisioneri vlerësoi se, gjendemi përpara një rasti ku ndërthuret juridiksioni penal dhe ai administrative, më poshtë pasqyrohet qëndrimi i mbajtur nga ky i fundit.

“...në rastin që po shqyrtojmë, përveçse ndodhemi në kushtet e juridiksionit administrativ, kemi të bëjmë edhe me juridiksionin gjyqësor penal, pasi çështja e re në ngarkim të nëpunësit në fjalë, do të shqyrtohet sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, e për këtë arsye, asnjë institucion tjetër i administratës nuk mund të veprojë deri në zgjidhjen përfundimtare të saj.

Nga ana tjetër, sa i takon zbatimin gjyqësor të formës së prerë me nr. 940, datë 23.11.2023, i nxjerrë nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, ligjvënësi ka parashikuar se, ky vendim është titull ekzekutiv, dhe si i tillë, në zbatim të nenit 510, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ekzekutimi i tij është i detyrueshëm për palët të cilëve ju drejtohet.

Ky qëndrim i ligjvënësit është pasqyruar edhe në nenin 66/1, pika 1, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në të cilat parashikohet se:

“1. Vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse.”

Në rastin në shqyrtim, ndodhemi përpara faktit nëse, njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin gjyqësor për rikthimin e gjyqfituesit apo duhet të presë vendimin e nxjerrë nga GJKKO, në ngarkim të tij?

Komisioneri vlerëson se, në zbatim të dispozitave ligjore për rikthimin e

gjyqfituesit, të parashikuar në legjislacionin e shërbimit civil, njësia përgjegjëse, duhet të marrë masat për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësit civil në një pozicion të shërbimit civil, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Nga ana tjetër, duke qenë se tashmë në ngarkim të këtij gjyqfituesi është nisur një proces penal, i cili nuk ka lidhje me vendimin gjyqësor të mëparshëm, institucioni duhet të vlerësojë nëse, në pozicionin ku është emëruar ky punonjës, mund të pengojë hetimin penal apo mund të cënojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij.

Nëse provohet një fakt i tillë, atëherë, ndodhemi në kushtet e zbatimit të nenit 54, "Pezullimi për shkak të ligjit", germa ë), të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, që parashikon pezullimin e nëpunësit civil për shkak të ligjit edhe: "në raste të tjera të parashikuara nga ligji".

Nëse ndodhemi në këto kushte, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, në përputhje me kërkesat e nenit 54, pika 3, germa a), të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, duhet të konstatojë pezullimin e marrëdhëniës në shërbimin civil, për këtë punonjës.

Në vijim, zgjidhja përfundimtare për vijimësinë e marrëdhëniës së punës për të, do të jetë e e lidhur me vendimin e formës së prerë të gjykatës penale, që do ta zgjidhë çështjen në themel.”

Në këtë periudhë raportimi, nuk janë përjashtuar edhe rastet e kërkesës së suportit nga ana e nëpunësve civilë gjyqësorë, të cilët kanë kërkuar interpretim nga ana e Komisionerit, në lidhje me zbatimin në praktikë të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionet e pushtetit gjyqësor

Është fjala këtu, për rastin e punonjësës Xh. K., mbi mënyrën e trajtimit të pozicionit të saj të punës “Koordinator për Marrëdhëniet me Median”, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, që konsiston në mosveprimin nga ana e njësisë përgjegjëse të këtij institucioni, për konfirmimin e saj si nëpunëse civile në pozicionin ku është e emëruar.

Ky rast u trajtua me kujdes nga ana e Komisionerit, i cili trajtoi informacionin e ardhur dhe dha përgjigje shteruese, duke arsyetuar:

“...Në informacionin e paraqitur ngrihet pretendimi se, megjithëse ka kaluar më shumë se dy vjet nga emërimi, njësia përgjegjëse e institucionit pa të drejtë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për konfirmimin si nëpunëse civile, gjë e cila vjen në kundërshtim me përcaktimin e germës f), të nenit 70, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se, janë nëpunës civilë të prokurorisë: “Nëpunësit e tjerë... të burimeve njerëzore, teknologjise... dhe marrëdhënieve me publikun e median”.

Për nisjen e verifikimit të informacionit, është vënë në dijeni institucioni i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, duke kërkuar në të njëjtën kohë dokumentacioni e nevojshëm, si dhe një sqarim lidhur me rastin në fjalë. Në vijim të sa më sipër rezultoi se:

Pretendimi i parashtruar nuk qëndron, pasi vjen në kundërshtim me pikën 2, të dispozitës së sipërcituar (të nenit 70, të ligjit nr. 97/2016), ku përcaktohet se, statusi i nëpunësve civilë të Prokurorisë së Posaçme rregullohet nga ky ligj, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

Në vijim të këtij përcaktimi sqarojmë se,

dispozita e nenit 24, të ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” i ndryshuar, ka përkufizuar dhe përcaktuar pozicionin “Koordinator për marrëdhëniet me mediat”, si pozicion më vehte, me nivel page Ib, me lidhje hierarkike dhe detyra rigorozisht të përcaktuara nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme (konkretisht, në pikat 1 dhe 2, të nenit të mësipërm thuhet: Koordinator për Marrëdhëniet me Mediat në Prokurorinë e Posaçme kryen ndërlidhjen mes prokurorisë dhe mediave kombëtare e ndërkombëtare; Koordinatori i Marrëdhënieve me Mediat është i vetmi person i autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për të komunikuar me mediat në emër të Prokurorisë së Posaçme).

Funksioni i mësipërm nuk ka lidhje me pozicionin e shërbimit civil, pretenduar prej kërkueses, parashikuar në nenin 70, pika d, të ligjit në fjalë: “nëpunësit e tjerë që punojnë në fushat e... arkivit dhe marrëdhënieve me publikun e median”, qoftë për nga rëndësia e pozicionimit të tij në strukturën e institucionit, ashtu dhe nga pikëpamja e detyrave që duhet të plotësojë, prandaj në këtë aspekt, pretendimi i ngritur konsiderohet i pabazuar dhe njësia e burimeve njerëzore të

institucionit, me të drejtë atë pozicion e ka konsideruar pjesë të kabinetit të titullarit.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerësoi se, duke u nisur nga pikëpamja organizative, po ashtu edhe nga mënyra e punësimit, punonjësit e institucionit të Prokurorisë së Posaçme, janë pjesë e shërbimit civil të prokurorisë dhe marrëdhëniet e tyre të punës rregullohen në bazë të ligjit të posaçëm, mbikëqyrja e të cilit nuk është në fushën e veprimtarisë mbikëqyrëse të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

...

Të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil të prokurorisë, parashikohen në ligjin nr.

97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, ku përcaktohet se rregullat mbi përmbajtjen e procedurave administrative në marrëdhënien me punonjësit.

Nëpunësit civilë të prokurorisë kanë të drejtë të ankimojnë vendimet procedurale (pranimi/lirimi, apo çdo procedure tjetër) në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo gjykatë shqyrton gabimet faktike dhe procedurale dhe është vendim i formës së prerë, kundër tij nuk lejohet rekurs.”

Këto ishin disa nga aspektet e veprimtarisë së Komisionerit në drejtim të trajtimit të informacioneve/denoncimeve /kërkesave, të cilat i janë adresuar institucionit gjatë vitit 2024.

MBIKËQYRJE TË PËRGJITHSHME DHE ORIENTUESE TË PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA NË INSTITUCIONE TË SHËRBIMIT CIVIL

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore dhe në zbatim të planit vjetor të punës së institucionit, të miratuar me vendimin nr. 106, datë 15.12.2023, të Komisionerit, “*Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024*”, ka patur në fokus të veprimtarisë së tij mbikëqyrjen/inspektimin kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, në drejtim të zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

37

Gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri ka përfshirë në procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme **34** institucione pjesë e shërbimit civil, dhe ka nisur **9** procese të mbikëqyrjes së orientuar. Këto procese, janë finalizuar me vendimet përkatëse, apo janë mbartur për vitin pasardhës, ashtu si do të analizohet në vijim.

Duke e klasifikuar procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme sipas tipologjisë së institucioneve, paraqitet kjo situatë:

Në 27 bashki (nga të cilat **8** janë të mbartura nga viti 2023 dhe problematika e evidentuar është trajtuar në raportin vjetor të vitit 2023), procesi i mbikëqyrjes është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil. Sipas mënyrës se si kanë përfunduar këto procese, rezulton se:

- Për **19** institucione procesi është përfunduar me Raport Përfundimtar dhe Vendim Paralajmërues.
- Për **8** institucione procesi është mbartur për t’u përfunduar gjatë vitit 2025.

Në 5 institucione të pavarura (nga të cilat **2** janë të mbartura nga viti 2023 dhe janë trajtuar në raportin vjetor të vitit 2023) procesi është përfunduar me Raport Përfundimtar dhe Vendim Paralajmërues.

Në 2 institucione varësie të administratës shtetërore (të mbartura nga viti 2023 dhe të trajtuara në raportin vjetor të vitit 2023), procesi është përfunduar me Raport Përfundimtar dhe Vendim Paralajmërues.

Tabela nr.3.1 Proceset e finalizuara në vitin 2024 dhe ato të mbartura për vitin 2025

Tipologjia e Institucioneve		Numri i institucioneve	Të mbartura për vitin 2024, pa trajtuar në raportin e 2023	Filluar në 2023 & përfunduar në 2024 (<i>trajtuar në raportin e 2023</i>)	Të mbartura për vitin 2025
1	Të pavarura	3	0	2	0
2	Administrata shtetërore	0	0	2	0
3	Administrata vendore	11	4	4	8
TOTALI		14	4	8	8


Ndërsa, për sa i përket **9** rasteve të mbikëqyrjes së orientuar, në të përfshihen të gjitha tipologjitë e institucioneve.

Analiza që do të zhvillohet në vijim të kësaj rubrike të raportit bazohet në të dhënat dhe problematikat që janë evidentuar në **14** institucionet e mbikëqyrura gjatë vitit 2024, për të cilat procesi ka përfunduar brenda vitit, si edhe për **4** institucione që janë të mbartura për vitin 2024 nga një vit më parë, por që nuk janë trajtuar në raportin e vitit 2023, pasi procesi ishte në një fazë ku nuk mund të dilnin konkluzione përfundimtare. Bëhet fjalë për **3** institucione të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj të posaçëm dhe **15** njësi të vetëqeverisjes vendore.

Po kështu, do të analizohen **6** rastet e mbikëqyrjes së orientuar që kanë përfunduar përgjatë vitit 2024, pasi **3** raste janë mbartur për vitin pasardhës.


Gjatë këtij procesi janë verifikuar **1506** pozicione të shërbimit civil, ku **190** pozicione ose **12,6%** e numrit të përgjithshëm të tyre i përkasin institucioneve të pavarura dhe **1316** pozicione ose **87,4%** të pozicioneve të verifikuara i përkasin institucioneve të qeverisjes vendore.

Grafiku nr.3.1 Pozicionet e shërbimit civil të verifikuara gjatë vitit 2024, sipas tipologjisë së institucioneve të mbikëqyrura



Sipas mënyrës se si janë plotësuar pozicionet e shërbimit civil, rezulton se, nga **1506** pozicione të shërbimit civil të mbikëqyrura, **151** pozicione ose **10%** e numrit të përgjithshëm janë vende të lira; **901** pozicione ose rreth **60%** e tyre janë të zëna në përputhje me ligjin dhe **454** pozicione ose rreth **30%** janë të zëna nga punonjës të emëruar me akte në kundërshtim me ligjin.

Grafiku nr.3.2 Mënyra e plotësimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, sipas tipologjisë së institucioneve



Të kategorizuara sipas tipologjisë së institucioneve të mbikëqyrura, në vijim po paraqesim gjendjen e evidentuar në këto subjekte dhe detyrat që janë lënë me qëllim përmirësimin e situatës.

1. Mbikëqyrje të realizuara në kategorinë e institucioneve të pavarura

Ky proces është ushtruar në 3 institucione të pavarura, ku përfshihen:

- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Këto institucione, janë përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, (i shfuqizuar) dhe kanë ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Tabela në vijim pasqyron mënyrën e plotësimit të pozicioneve të punës në institucionet e pavarura.

Tabela nr.3.2 Mënyra e plotësimit të pozicioneve të punës në institucionet e pavarura të mbikëqyrura

Nr.	Institucione të pavarura	Pozicione të shërbimit civil	Vende të lira	Pozicione të zëna në përputhje me ligjin	Pozicione të emëruar me akte në kundërshtim me ligjin
1	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	53	16	37	0
2	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	75	8	67	0
3	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit	62	9	53	0
TOTALI		190	33 (17%)	157 (83%)	0

Sa më sipër, nëpërmjet mbikëqyrjes janë verifikuar **190** pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, nga të cilat **33** pozicione ose 17% e tyre, kanë qenë të lira. Ndërkohë, nuk është evidentuar asnjë rast i emërimeve në kundërshtim me ligjin.

Objekti i mbikëqyrjes së realizuar në këto institucione ka qenë verifikimi i zbatimit të ligjit gjatë procesit të plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në këto institucione dhe situata paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr.3.3 Procedura e kryer për plotësimin e pozicioneve të punës në shërbimi civil në institucionet e pavarura

Nr.	Institucione të Pavarura	Numri i procedurave të kontrolluara (pozicione pune)	Niveli ekzekutiv				Niveli i mesëm dhe i ulët drejtues				Niveli i lartë drejtues	
			Lëvizje paralele	Pranim në shc	Lista e prirjes	Pa fitues	Lëvizje paralele	Ngritje në detyrë	Ngritje nw detyrë/Pranim nga jashtë shc	Pa fitues	Ngritje në detyrë	Ngritje nw detyrë/Pranim nga jashtë shc
1	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	34	-	4	-	-	5	12	11	-	2	-
2	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	56	4	32	-	-	4	12	3	-	-	1
3	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit	54	6	26	3	-	2	14	2	-	1	-
TOTALI		144	10	62	3	-	11	38	16	-	3	1

Në këto institucione janë kontrolluar **144** raste, të punonjësve që janë emëruar në shërbimin civil sipas procedurave përkatëse të parashikuara në ligj dhe rezulton se **75** raste, janë në nivelin ekzekutiv, **65** raste në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues dhe **4** raste në nivelin e lartë drejtues.

Sipas statistikave të evidentuara më sipër, është konstatuar se në **21** raste është aplikuar procedura e lëvizjes paralele dhe në **58** raste është aplikuar procedura e ngritjes në detyrë, nga të cilat në **41** raste me kandidatë nga sistemi i shërbimit civil dhe **17** raste me kandidatë që nuk janë pjesë e sistemit.

Vihet re se lista e pritjes, e krijuar pas përfundimit të procedurës së pranimit në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, me konkurentët që kanë marrë nivelin e nevojshëm të pikëve, por që nuk mund të emërohen pasi nuk ka pozicion pune, është aplikuar vetëm në **3** raste.

Komisioneri vlerëson se në këtë tipologji institucionesh, njësia e burimeve njerëzore e ushtron funksionin e saj në përputhje me rregullat e vendosura në ligj, në drejtim të zhvillimit të proceseve të administrimit të shërbimit civil, si hartimi i përshkrimeve të punës; procedurat e konkurrimit për plotësimin e vendeve të lira në të gjitha nivelet, apo procedurat e ristrukturimit.

Nga ana tjetër, janë konstatuar disa probleme të aspektit të përgjithshëm të zbatimit të ligjit që, nisur nga natyra e tyre, nuk sjellin pavlefshmëri të proceseve të realizuara. Këto raste që janë hasur pothuajse në të gjitha institucionet e pavarura janë evidentuar dhe janë sjellë në vëmendje të njësisë përgjegjëse, si dhe të subjekteve të tjera të zbatimit të ligjit, me qëllim që të parandalohen parregullsitë dhe të mos përsëriten në të ardhmen. Për të krijuar një përshtypje në lidhje me to, po i rendisim në vijim:

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, nuk ka funksionuar si një i vetëm, për të gjitha procedurat e kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit, ndërkohë që duhet të jetë vetëm një organizëm i tillë, i cili ngrihet në fillim të vitit në çdo institucion.

Në procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, miratimi nga titullari i institucionit jepet në rrugë elektronike (email) dhe jo me vendim me shkrim dhe të arsyetuar, ashtu si e kërkon ligji.

Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë nga pikëpanja formale, është kryer sipas përcaktimeve të akteve rregullatore, por fakti që në institucionin e AIDSH-së, mbi 75,7% e nëpunësve janë vlerësuar në nivelin 1, “*shumë mirë*”, që është niveli më i lartë i vlerësimit, e po kështu është vepruar

edhe nga ana e KQZ-së, duke ceduar në objektivitetin e procesit, që është edhe qëllimi i realizimit të tij.

Zyrtarët vlerësues, *Zyrtartari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues*, si dhe njësia e burimeve njerëzore, si njësia përgjegjëse që mbikëqyr procesin e vlerësimit, për të shmangur vlerësimet subjektive, duhet të zbatojnë hap pas hapi të gjitha kërkesat që përcakton Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, duke respektuar të gjitha fazat e vlerësimit dhe dokumentimin e tyre në mënyrë shkresore, si nëpërmjet akteve të veçanta, apo të evidentimit të tyre në përmbajtjen e formularit të vlerësimit të punës.

Komisioneri në këto raste ka vlerësuar si shkak mungesën e njohurive për këtë

proces nga ana e zyrtarëve vlerësues dhe ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që të analizohen nevojat për trajnimin e tyre, të cilat duhet të materializohen më tej në kërkesa specifike për trajnim, drejtuar Shkollës së Administratës Publike, me qëllim që të rritet niveli i dijeve të tyre në lidhje me këtë institut të ligjit dhe që procedura e vlerësimit të realizohet në përputhje me standardet e kërkuara nga aktet rregullatore që aplikohen në këtë rast.

Ndërkohë që, në këtë moment duhet të përmendim si shembull pozitiv, institucionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku është konstatuar se nga ana e

zyrtarëve vlerësues është përdorur në mënyrë proporcionale i gjithë spektri ligjor i vlerësimeve të performancës së nëpunësit civil.

Mungesa e përcaktimit të nëpunësit civil më të vjetër në detyrë, e për pasojë, mungesa e mendimit me shkrim të tij, pas përfundimit të periudhës së provës. Ky është një aspekt që shpesh konstatohet në institucionet e mbikëqyrura, pasi anashkalohet si detyrim dhe nuk i jepet rëndësia e duhur që duhet të ketë ky faktor në përgatitjen e nëpunësit civil në periudhë i prove, i cili ka hyrë rishtas në sistem dhe ka nevojë për ndihmë të specializuar.

Problematikat e evidentuara më sipër nuk cenojnë në thelb veprimet administrative që janë kryer rast pas rasti e, për këtë arsye, Komisioneri e ka përmbyllur procesin pa vendim paralajmërues, por sqarimi me burimet njerëzore e, më tej, ndjekja e zbatimit të ligjit në proceset me natyrë të ngjashme që do të kryhen në të ardhmen, kanë karakter parandalues dhe janë në vëmendje të vazhdueshme të Komisionerit.

2. Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me realizimin e procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, mobilitetin, zhvillimin e sistemit të karrierës, si dhe aplikimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil, në institucionet e administratës vendore

Mbikëqyrja e përgjithshme, në kuptim të rregullores së procedurave të Komisionerit, është procesi i cili zhvillohet për një procedurë të ligjit, tek të gjitha apo tek një numër përfaqësues i institucioneve të administratës shtetërore, institucioneve të pavarura dhe njësive të qeverisjes vendore.

Përgjatë vitit 2024, ky proces është ushtruar në 15 institucione të vetëqeverisjes vendore/bashki (4 nga të cilat janë të mbartura nga viti 2023, por që nuk janë trajtuar në raportin e mëparshëm), ku përfshihen:

Bashkia **Elbasan**
Bashkia **Librazhd**
Bashkia **Prrenjas**
Bashkia **Belsh**
Bashkia **Gramsh**

Bashkia **Kurbin**
Bashkia **Divjakë**
Bashkia **Peqin**
Bashkia **Vlorë**
Bashkia **Memaliaj**

Bashkia **Cërrik**
Bashkia **Kuçovë**
Bashkia **Rrogozhinë**
Bashkia **Vau Dejës**
Bashkia **Bulqizë**

Në mënyrë të detajuar, tabela në vijim paraqet mënyrën e plotësimit të pozicioneve të punës në institucionet e mbikëqyrura:

Tabela nr.3.4 Plotësimi i pozicioneve të punës në institucionet e mbikëqyrura në administratën vendore përgjatë vitit 2024

Nr.	Institucione të administratës vendore	Pozicione të Shërbimit Civil	Vende të lira	Pozicione të zëna në përputhje me ligjin	Pozicione të emëruar me akte në kundërshtim me ligjin
1	Bashkia Elbasan <i>(Të mbartura për vitin 2024, pa trajtuar në raportin e 2023)</i>	222	20	202	0
2	Bashkia Librazhd <i>(Të mbartura për vitin 2024, pa trajtuar në raportin e 2023)</i>	89	0	21	68
3	Bashkia Prrenjas <i>(Të mbartura për vitin 2024, pa trajtuar në raportin e 2023)</i>	59	7	15	37
4	Bashkia Belsh <i>(Të mbartura për vitin 2024, pa trajtuar në raportin e 2023)</i>	61	0	25	36
5	Bashkia Gramsh	48	3	26	19
6	Bashkia Kurbin	114	28	50	36
7	Bashkia Divjakë	63	2	38	23
8	Bashkia Peqin	53	2	32	19
9	Bashkia Vlorë	147	22	125	0
10	Bashkia Memaliaj	39	8	21	10
11	Bashkia Cërrik	56	6	31	19
12	Bashkia Kuçovë	67	0	63	4
13	Bashkia Rrogozhinë	87	10	15	62
14	Bashkia Vau Dejës	135	3	49	83
15	Bashkia Bulqizë	76	7	31	38
TOTALI		1316 <i>(100%)</i>	118 <i>(9%)</i>	744 <i>(57%)</i>	454 <i>(34%)</i>

Gjatë realizimit të procesit të mbikëqyrjes në këto institucione, janë kontrolluar **1316** pozicione pune pjesë e shërbimit civil nga të cilat, rezulton se:

118 prej tyre, ose 9%

rezultojnë të lira në momentin e mbikëqyrjes;

744 prej tyre, ose 57%

rezultojnë të zëna në përputhje me ligjin;

454 prej tyre, ose 34%

rezultojnë të zëna në kundërshtim me ligjin.

Mbikëqyrja e përgjithshme në këtë rast është kryer në një numër domethënës institucionesh me fokus kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të

plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej tij me detyra specifike në administrimin e këtij procesi.

Procedurat e aplikuara për plotësimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, gjatë vitit 2024 në administratën vendore, paraqiten sipas tabelës në vijim:

Tabela nr.3.5 Procedura e kryer për plotësimin e pozicioneve të punës në shërbimi civil në institucionet e administratës vendore

Nr.	Institucione të Administratës Vendore	Pozicione pune të plotësuar/ procedura e aplikuar	Niveli ekzekutiv				Niveli i mesëm dhe i ulët drejtues				Niveli i lartë drejtues	
			Lëvizje paralele	Pranim në shc	Lista e pritjes	Pa fitues	Lëvizje paralele	Ngritje në detyrë	Ngritje në detyrë/Pranim nga jashtë shc	Pa fitues	Ngritje në detyrë	Ngritje në detyrë/Pranim nga jashtë shc
1	Bashkia Elbasan (Të mbartura për vitin 2024, pa u trajtuar në raportin e 2023)	63	-	37	-	2	-	2	18	3	-	1
2	Bashkia Librazhd (Të mbartura për vitin 2024, pa u trajtuar në raportin e 2023)	26	-	26	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Bashkia Prenjas (Të mbartura për vitin 2024, pa u trajtuar në raportin e 2023)	8	-	3	-	2	-	1	2	-	-	-
4	Bashkia Belsh (Të mbartura për vitin 2024, pa u trajtuar në raportin e 2023)	40	-	15	-	25	-	-	-	-	-	-
5	Bashkia Gramsh	22	5	8	-	-	-	5	4	-	-	-
6	Bashkia Kurbin	13	-	9	-	-	-	4	-	-	-	-
7	Bashkia Divjakë	15	5	7	-	-	-	3	-	-	-	-
8	Bashkia Peqin	20	-	10	-	-	1	4	5	-	-	-
9	Bashkia Vlorë	33	1	17	6	3	1	4	1	-	-	-
10	Bashkia Memaliaj	5	-	4	-	-	-	1	-	-	-	-
11	Bashkia Cërrik	24	6	7	-	8	-	2	1	-	-	-
12	Bashkia Kuçovë	30	2	17	-	1	-	3	7	-	-	-
13	Bashkia Rrogozhinë	2	-	-	-	-	-	-	2	-	-	-
14	Bashkia Vau Dejës	17	1	2	-	1	-	8	1	4	-	-
15	Bashkia Bulqizë	20	-	9	-	-	-	10	-	1	-	-
TOTALI		338	20	171	6	42	2	47	41	8	-	1

Në këto institucione janë kontrolluar **338** raste të punonjësve që janë emëruar në shërbimin

civil sipas procedurave përkatëse të parashikuara në ligj dhe rezulton se **239** prej tyre, janë në nivelin ekzekutiv, **98** raste në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues dhe **1** rast në nivelin e lartë drejtues.

Sipas statistikave të evidentuara më sipër, është konstatuar se në **22** raste është aplikuar procedura e lëvizjes paralele dhe në **89** raste është aplikuar procedura e ngritjes në detyrë, nga të cilat në **47** raste me kandidatë nga sistemi i shërbimit civil dhe në **42** raste me kandidatë të tjerë, që nuk janë pjesë e sistemit.

Vihet re se lista e pritjes, e krijuar pas përfundimit të procedurës së pranimit në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, me konkurentët që kanë marrë nivelin e nevojshëm të pikëve, por që nuk mund të emërohen pasi nuk ka pozicion pune, është aplikuar vetëm në **6** raste.

Sa i takon procedurës së ndjekur gjatë rekrutimit, në këtë rast janë konstatuar parregullsi që kanë lidhje me:

Mangësi në dokumentacionin që duhet të dorëzojë kandidati gjatë aplikimit për të marrë pjesë në konkurrim.

Mangësi në dokumentacionin që provon realizimin e fazave të konkurrimit.

Mangësi në dokumentacionin që materializon veprimtarinë e organeve që realizojnë procesin e rekrutimit.

Probleme gjatë ndërtimit dhe funksionimit të organeve kolegjiale që kryejnë procesin e konkurrimit, si Komitetet e pranimit, ose Komisionet e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Këto organizma paraqesin probleme në ndërtimin dhe funksionimin e tyre.

Konstatohet në disa raste, se në caktimin e anëtarëve të tyre, nuk respektohet ligji, edhe pse është i përcaktuar në mënyrë të shprehur pozicioni i punës që duhet të ketë një anëtar i organit kolegjial. Po kështu, nuk vlerësohet me rëndësinë e duhur zbatimi i detyrimit për të caktuar ekspertin në përshtatje me fushën e njohurive të tyre, në konkurrimin ku marrin pjesë. Ndodh, që të njëjtët ekspertë vlerësojnë kandidatë edhe në fusha ku ata nuk i kanë njohuritë e duhura.

Pothuajse në të gjitha rastet, pranimi në shërbimin civil është realizuar për një pozicion pune dhe me një kandidat pjesëmarrës, i cili, më tej, shpallet edhe si fitues i procesit.

Një aspekt tjetër i kontrollit të ligjshmërisë pas përfundimit të procedurës së konkurrimit ka qenë edhe zbatimi i ligjit gjatë periudhës së provës, për punonjësit e emëruar rishtas në pozicione të nivelit ekzekutiv.

Janë konstatuar mangësi gjatë aplikimit të këtij instituti të ligjit, të cilat kanë të bëjnë, ndër të tjera, edhe me mosveprimin e eprorit direkt për të caktuar punonjësin më të vjetër të njësisë, që të kujdeset për nëpunësin e emëruar rishtas në shërbimin civil. Po kështu, në disa raste, është konstatuar fakti se procesi i vlerësimit të punës për nëpunësin në periudhë prove nuk është

kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nga zyrtarët vlerësues, si dhe raste kur eprori direkt nuk ka finalizuar procesin e konfirmimit të nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës, edhe pse ka kaluar afati 1-vjeçar.

Në këto raste, për rregullimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në vendimin paralajmërues është kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të veprojnë si më poshtë:

Të plotësohet akti i emërimit me punonjësin e ngarkuar për të mbështetur nëpunësin civil në periudhë prove.

brenda 10 (*dhjetë*) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit të vendimit të konfirmimit nga eprori direkt.

Eprori direkt të finalizojë me aktin përkatës mënyrën e përfundimit të periudhës së provës, në një nga mënyrat e parashikuara në ligj, nëpërmjet konfirmimit si nëpunës civil; shtyrjes së periudhës së provës, apo mos konfirmimit në detyrë, si një detyrim ligjor i tij. Vendimin e konfirmimit të nëpunësit civil duhet t'ia njoftojë njësisë përgjegjëse (*njësisë së burimeve njerëzore të institucionit*), e cila në zbatim të pikës 13, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit

Zyrtarët vlerësues, në rolin e Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues, Zyrtarit Autorizues, të plotësojnë formularin e vlerësimit të punës në të gjitha rubrikat e tij, sidomos rubrikën e komenteve, duke pasqyruar në këtë akt të gjithë procedurën e kërkuar nga ligji dhe zbatimin e fazave të këtij procesi; duke u kujdesur që të ketë objektivitet në vlerësim, si dhe duke përdorur të gjithë spektrin ligjor të nivelit të vlerësimeve.

Të administrohen në dosjen e personelit, aktet me vlerësimet e rezultateve individuale në punë.

Duhet të evidentojmë në këtë rubrikë të raportit edhe një shqetësim që ngrihet nga njësitë përgjegjëse pothuajse në të gjitha këto institucione, e sidomos në bashkitë me numër më të ulët të popullsisë, që është mungesa e kandidaturave të interesuara për të marrë pjesë në konkurrim. Kjo problematike evidentohet edhe nga të dhënat e konstatuara gjatë mbikëqyrjes, ku në 50 raste, procedurat kanë përfunduar pa fitues.

Kjo situatë vjen për disa arsye, ndër të cilat: **a)** lëvizja e popullsisë drejt rajoneve më të populluara dhe me aftësi më të larta paguese, **b)** pagat relativisht të ulëta, edhe pse janë bërë përpjekje për rritjen e tyre dhe tashmë është një realitet më pozitiv në këtë drejtim. Nga ana tjetër, është evidente edhe mungesa e besimit, kjo për faktin se, publikimi i pozicionit të lirë, për t'u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, kryhet në kushtet kur, shpeshherë, pozicionet janë të zëna nëpërmjet emërimeve të përkohshme.

Në vijim do të analizojmë dy problematikat thelbësore që janë konstatuar gjatë mbikëqyrjes në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat qëndrojnë *së pari* në mungesën e një procesi ligjor për vlerësimin/rivlerësimin e pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil dhe *së dyti* në

ekzistencën e fenomenit të emërimeve në kudërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Nevoja për të përfshirë në një proces të thellë vlerësimi/rivlerësimi, të gjitha pozicionet e punës në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të përcaktohet qartë se ku qëndron secili prej tyre në raport me shërbimin civil, është evidentuar prej disa vitesh nga Komisioneri. Aktualisht, ky problem është duke u ndjekur me prioritet edhe nëpërmjet mbikëqyrjes në subjekt, duke kërkuar nga ana e institucioneve që të veprojnë me shpejtësi dhe me përgjegjshmëri për të finalizuar këtë proces, duke përcaktuar edhe momentet se ku duhet të përqendrohen:

47

Të përcaktojë nëpunësin civil/grup pune, i cili është përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës në strukturën aktuale që janë pjesë e shërbimit civil dhe analizimin e këtij informacioni, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësi e kërkesave të veçanta të çdo pozicioni (*përcaktimin e saktë të kërkesave lidhur me nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve dhe përvojën në punë*).

Ky material t'u përcillet zyrtarisht nëpunësve përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës (*epropri direkt i pozicionit respektiv të punës dhe Sekretari i Përgjithshëm*), siç përcaktohet në kreun IV, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*, i ndryshuar.

Pasi të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të përgatitë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës.

Ky dokumentacion, nëpërmjet Zyrës së Arkiv-Protokollit, t'i përcillet Komitetit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të

shërbimit civil, i cili duhet të konfirmojë me shkrim marrjen e tij.

Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, në zbatim të përcaktimeve të pikës 29/ç, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*, i ndryshuar, të krijojë Komitetin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, i cili do të përbëhet nga tre anëtarë: njëri nga anëtarët është i ngarkuari me detyrën e analistit të punës, ose ndonjë funksion tjetër të menaxhimit të burimeve njerëzore, kurse dy anëtarët e tjerë janë nëpunës civilë me përvojë në institucion.

Komiteti i vlerësimit, pas administrimit të dokumentacionit të domosdoshëm, të identifikojë me saktësi vendet e punës që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit. Më tej, do të vijoje punën me vlerësimin e tyre duke u bazuar në përshkrimet e punës dhe në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në lidhjen nr. 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*, i ndryshuar. Në përfundim të procesit të vlerësimit të hartohet një listë përmbledhëse ku të pasqyrohen pozicionet

e punës pjesë e shërbimit civil, të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse sipas klasave të zbatueshme për secilën kategori të përcaktuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe pikën 5, të vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Lista përmbledhëse e klasifikimit racional në kategorinë dhe klasën përkatëse për gjithë pozicionet e shërbimit civil të strukturës që është në fuqi t’i përcillet nëpërmjet Zyrës së Arkiv-Protokollit, Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit dhe njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

Për realizimin e kësaj detyre në përputhje me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, Komiteti i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil të bashkëpunojë dhe këshillohet me Departamentin e Administratës Publike, siç

përcaktohet në pikën 37, kreu V, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të hartohet dhe miratohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil ku të shpallen për konkurrim të gjitha vendet vakante të shërbimit civil. Në këtë akt të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuar në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, duke miratuar një planifikim të qartë të këtij procesi, ku të përfshihet pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi.

Ndërsa sa i takon problemit tjetër, që ka lidhje me emërimet në kundërshtim me ligjin, në bashkitë e mbikëqyrura janë konstatuar **454** raste të tilla, kur titullari i institucionit ka emëruar punonjës në pozicione të shërbimit civil, duke mos kryer procedurat e konkurrimit, ashtu si e kërkon ligji. Ndër institucionet me nivelin më të lartë të këtij fenomeni janë:

Bashkia Librazhd me **68**
raste

Bashkia Rrogozhinë me
62 raste

Bashkia Vau Dejës me **83**
raste

e të tjera sipas tabelës së paraqitur më sipër.

Në këto raste, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetarët e Bashkisë që të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit në pozicione pune të kategorisë ekzekutive, të kategorisë së ulët, të mesme e të lartë drejtuese dhe të rregullojnë pasojat, me qëllim që në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për t’u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e rekrutimit dhe mobilitetit në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do

të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Ndërsa nga ana e njësisë përgjegjëse është kërkuar që të publikohen pozicionet e lira, për t’u plotësuar sipas kërkesave të ligjit dhe, njëkohësisht, të kujdeset që në momentin e konkurrimit, pozicionet të jenë efektivisht të lira.

 Mbikëqyrje e përgjithshme, e nisur gjatë vitit 2024 dhe e mbartur për vitin 2025

Ndërkohë, për institucionet e vetëqeverisjes vendore/bashki:

Bashkia Lezhë	Bashkia Dimal	Bashkia Fushë-Arrëz
Bashkia Mirditë	Bashkia Berat	Bashkia Kukës
Bashkia Finiq	Bashkia Përmet	

mbikëqyrja ka nisur në muajin dhjetor të vitit 2024 dhe ende nuk ka përfunduar afati për realizimin e saj. Për këtë arsye, këto procese janë mbartur për t’u finalizuar në vitin pasardhës.

Edhe për këto institucione, fokusi i mbikëqyrjes është kontrolli i ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, me qëllim që të krijojmë një perceptim të saktë për situatën e zbatimit të ligjit në këto institute të tij, në këtë tipologji institucionesh.

3. Mbikëqyrje të filluara në vitin 2023 dhe të përfunduara në vitin 2024

Gjatë vitit 2024, Komisioneri ka përfunduar edhe procesin e disa mbikëqyrjeve të mbartura nga viti 2023. Situata e konstatuar në këto institucione është evidentuar në raportin vjetor të vitit paraardhës, pasi procesi ka qenë në fazën përfundimtare të miratimit të raportit përfundimtar, pas observacioneve të ardhura nga institucionet, ndërkohë që rregullimi i situatës së ligjshmërisë, pas përfundimit të afatit të paralajmërimit, do të analizohet në një rubrikë të posaçme në vijim të raportit, ku do të pasqyrohet niveli i zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit.

Bëhet fjalë për institucionet e paraqitura në tabelën në vijim, ku është evidentuar edhe vendimi paralajmërues i Komisionerit, i cil përmbyll procesin:

Tabela nr.3.6 Institucionet e mbikëqyrura në vitin 2023, për të cilat vendimi përmbyllës ka dalë në vitin 2024

Kontrolli i Lartë i Shtetit	
1	Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në procedurat e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “<i>Për nëpunësin civil</i>”, i ndryshuar e në vijim Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 47, datë 26.7.2024

2	Institucioni i Presidentit të Republikës Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në procedurat e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “<i>Për nëpunësin civil</i>”, i ndryshuar e në vijim Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 15, datë 9.2.2024
3	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në procedurat e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “<i>Për nëpunësin civil</i>”, i ndryshuar e në vijim Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 12, datë 5.2.2024
4	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në procedurat e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “<i>Për nëpunësin civil</i>”, i ndryshuar e në vijim Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 35, datë 31.5.2024
5	Bashkia Has Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, “<i>Për nëpunësin civil</i>”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 22, datë 12.2.2024
6	Bashkia Patos Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, “<i>Për nëpunësin civil</i>”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 19, datë 15.2.2024
7	Bashkia Pogradec Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, “<i>Për nëpunësin civil</i>”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi

	Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 13, datë 6.2.2024
8	Bashkia Korçë Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi Përfunduar me vendim të Komisionerit nr. 20, datë 26.2.2024

Tabela nr.3.7 Institucionet e mbikëqyrura gjatë vitit 2024

INSTITUCIONE TË PAVARURA	
	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
1	Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, e në vijim.
	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
2	Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, e në vijim.
	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit
3	Mbikëqyrje e përgjithshme në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, e në vijim.
INSTITUCIONE TË QEVERISJES VENDORE/BASHKI	
	Bashkia Elbasan
4	Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi.
	Bashkia Librazhd
5	Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi.

6	Bashkia Prrerjas Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi.
7	Bashkia Belsh Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi.
8	Bashkia Gramsh Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
9	Bashkia Kurbin Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
10	Bashkia Divjakë Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
11	Bashkia Peqin Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i> ", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

12	Bashkia Vlorë Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
13	Bashkia Memaliaj Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
14	Bashkia Cërrik Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
15	Bashkia Kuçovë Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
16	Bashkia Rrogozhinë Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
17	Bashkia Vau Dejës Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, " <i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

18	Bashkia Bulqizë Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, "<i>Për nëpunësin civil</i>", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjitme detyra specifike të administrimit të këtij procesi, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.
TOTALI: 18 INSTITUCIONE (3 INSTITUCIONE TË PAVARURA DHE 15 BASHKI)	

Në rregulloren e procedurave, mbi të cilën ushtron veprimtarinë Komisioneri, si një nga llojet e mbikëqyrjeve është e përkufizuar edhe mbikëqyrja e orientuar/inspektim i orientuar/përgatitor, e cila synon mbledhjen e informacionit për fusha të panjohura tërësisht ose pjesërisht nga mbikëqyrjet / inspektimet e mëparshme.

Duke nisur nga dy vitet e fundit, Komisioneri e ka rritur numrin e mbikëqyrjeve të kësaj tipologjie dhe në vitin 2024 kanë nisur 9 procese të tilla, nga të cilat 6 kanë përfunduar gjatë këtij viti kalendarik dhe 3 prej tyre, janë mbartur në vitin 2025, të specifikuara sipas tabelës në vijim:

Tabela nr.3.8 Mbikëqyrjet e orientuara të zhvilluara gjatë vitit 2024, sipas institucioneve të përfshira në këtë proces

1	Departamenti i Administratës Publike Mbikëqyrje e orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në konkurrimet e planifikuara për t'u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2024, për procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND) Përfunduar me vendimin për miratimin e Raportit të Vlerësimit, nr. 84, datë 20.12.2024 të Komisionerit
2	Institucione të Administratës Shtetërore Mbikëqyrje e orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore Përfunduar me vendimin për miratimin e Raportit të Vlerësimit nr. 88, datë 20.12.2024 të Komisionerit
3	Bashkia Tiranë Mbikëqyrje e orientuar mbi zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e pranimit në nivel ekzekutiv, lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranimin në kategorinë e lartë drejtuese në shërbimin civil, të planifikuara për t'u zhvilluar nga Bashkia Tiranë gjatë vitit 2024 Përfunduar me vendimin për miratimin e Raportit të Vlerësimit nr. 85, datë 20.12.2024 të Komisionerit
4	Institucione të Pavarura, Institucione të Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Vetëqeverisjes Vendore

	Mbikëqyrje e orientuar me objekt monitorimin e ecurisë së administrimit të shërbimit civil, në institucionet e sistemit të shërbimit civil: institucionet e administratës shtetërore; institucionet e vetëqeverisjes vendore në nivel qarku dhe institucionet e pavarura për vitin 2024 Përfunduar me vendimin për miratimin e Raportit të Vlerësimit nr. 90, datë 20.12.2024 të Komisionerit
5	Institucionet e Administratës Vendore (bashki) Mbikëqyrje e orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2024 dhe ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces”; Udhëzuesin nr. 654 prot., datë 02.10.2024, të Komisionerit, “Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit të institucionit Përfunduar me vendimin për miratimin e Raportit të Vlerësimit nr. 83, datë 20.12.2024 të Komisionerit
6	Institucione të Pavarura, Institucione të Administratës Shtetërore dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore Mbikëqyrje e orientuar mbi verifikimit të rasteve të nëpunësve që mbahen në punë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil pas plotësimit të moshës së pensionit të pleqërisë, për vitin 2023 Përfunduar me vendimin për miratimin e Raportit të Vlerësimit nr. 7, datë 24.1.2024 të Komisionerit (Përfshirë në Raportin Vjetor 2023)
7	Institucione të Pavarura, Institucione të Administratës Publike dhe Institucionet e Vetëqeverisjes Vendore Mbikëqyrje e orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me realizimin në kohë të trajnimeve të detyrueshme dhe trajnime të tjera që synojnë rritjen profesionale të nëpunësve civilë në administratën publike Ky proces është mbartur për t’u përmbyllur përgjatë vitit 2025
8	Institucione të Pavarura, Institucione të Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Administratës Vendore Mbikëqyrje e orientuar për njohjen e situatës në lidhje me numrin e institucioneve që bëjnë pjesë në shërbimin civil, numrin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, numrin e nëpunësve civilë të emëruar në këto pozicione dhe të dhëna të tjera statistikore. Ky proces është mbartur për t’u përmbyllur përgjatë vitit 2025
9	Institucione të Administratës Shtetërore Mbikëqyrje e orientuar me objekt monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me zbatimin e detyrimit ligjor, të organeve disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo audit, në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024 Ky proces është mbartur për t’u përmbyllur përgjatë vitit 2025

Proceset e evidentuara në këtë tabelë, do të analizohen në vijim të raportit, si kapituj të veçantë.

MONITORIMI I ECURISË SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL, NË INSTITUCIONET E SISTEMIT TË SHËRBIMIT CIVIL: INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETETËRORE, INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES VENDORE NË NIVEL QARKU DHE INSTITUCIONET E PAVARURA

56

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës së institucionit, të miratuar me vendimin nr.106, datë 15.12.2023, *“Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024”*, të Komisionerit, gjatë vitit 2024, ka patur në fokus të veprimtarisë së tij, monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së administrimit të shërbimit civil, në të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil.

Ky proces, i cili ka nisur nëpërmjet Urdhrit nr. 28 (168 prot.), datë 15.2.2024, të Komisionerit, *“Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar me objekt monitorimin e ecurisë së administrimit të shërbimit civil, në institucionet e sistemit të shërbimit civil: institucionet e administratës shtetërore; institucionet e vetëqeverisjes vendore në nivel qarku dhe institucionet e pavarura për vitin 2024”*, të Komisionerit, është realizuar përgjatë gjithë vitit kalendarik dhe në të janë përfshirë

203 institucione të sistemit të shërbimit civil, të grupuara sipas kësaj tipologjie:

- **112** institucione të administratës shtetërore (12 institucione qendrore: Kryeministria dhe 11 Ministrinë e linjës; 88 institucione në varësi të Kryeministrit/ministrive të linjës dhe 12 prefektura).
- **73** institucione të vetëqeverisjes vendore (12 këshilla qarku dhe 61 bashki).
- **18** institucione të pavarura.

Institucionet e sistemit të shërbimit civil, të cilat janë përfshirë në procesin e mbikëqyrjes së orientuar për të gjitha institutet e ligjit për shërbimin civil, për vitin 2024, siç janë institucionet e administratës shtetërore (112), institucionet e pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj të posaçëm (18), si dhe njësitë e qeverisjes vendore (73), janë evidentuar në **Aneksin nr.1:** *“Institucionet e përfshira në mbikëqyrjen e orientuar me objekt monitorimin e ecurisë së administrimit të shërbimit civil për vitin 2024”*.

Mbikëqyrja është orientuar drejt monitorimit të ecurisë së administrimit të shërbimit civil për të gjitha institutet e rregulluara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar:

Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, për vitin 2024.

Gjendja aktuale e pozicioneve të shërbimit civil, duke evidentuar në vijimësi numrin e pozicioneve pjesë e shërbimit civil, pozicionet e plotësuara në zbatim të procedurave të përcaktuara nga ligji dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin.

Rekrutimi në shërbimin civil, duke u fokusuar drejt llojit të procedurës së zbatuar.

Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, nëpërmjet lirimit nga shërbimi civil;

largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore; si dhe, për shkak të ligjit.

Vlerësimi i rezultateve në punë i nëpunësve civilë në institucionet e qeverisjes vendore.

Masat disiplinore të aplikuar ndaj nëpunësve civilë.

Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Statistika në lidhje me arsimin e nëpunësve civilë dhe raportin e nëpunësve sipas gjinisë (*raporti gra/burra*).

Procesi është realizuar nëpërmjet një metodologjie që aktivizon bashkëpunimin e Komisionerit me njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve, nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve në rrugët e komunikimit të përcaktuara në ligj, e sidomos nëpërmjet postës elektronike, duke pasur parasysh parashikimin e nenit 10, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, që i ngarkon njësitë përgjegjëse me administrimin e nëpunësve civilë të institucionit dhe raportimin e situatës.

Në nisje të mbikëqyrjes, subjektet janë njohur me të dhënat apo grupin e të dhënave që do të raportohen prej tyre, si dhe kanë caktuar personat e kontaktit, të cilët kanë vijuar me raportime përgjatë gjithë vitit 2024. Të dhënat e dërguara prej tyre, të shoqëruara edhe me dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes, janë analizuar më tej nga ana e Komisionerit dhe qëndrojnë në bazën e statistikave dhe konkluzioneve që kanë dalë nga monitorimi.

Proceset që janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme janë kryesisht: publikimi i planit të rekrutimit dhe pozicioneve të lira, nëpërmjet verifikimit të vazhdueshëm në portalin e AKPA-së; publikimi i procedurës së konkurrimit për çdo pozicion apo grup pozicionesh; publikimi i listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil/ngritje në detyrë; publikimi i shpalljes së fituesit apo përfundimin e konkurrimit pa asnjë fitues.

Për institucionet e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura është verifikuar edhe faqja e internetit të institucionit, për të verifikuar nëse ato e përdorin publikimin në faqen e tyre zyrtare, ashtu si parashikohet nga akti nënligjor përkatës, si një mënyrë alternative të publikimit.

Njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore i është kërkuar informacion në lidhje me ngritjen e organizmave ligjorë që realizojnë procedurat për rekrutimin e nëpunësve civilë, si komiteti i përhershëm i pranimit në kategorinë ekzekutive; komisioni i brendshëm për lëvizje paralele dhe komiteti i pranimit për ngritje në detyrë. Në vijim, institucionet kanë raportuar emërimet e kryera në shërbimin civil për periudhën janar - dhjetor 2024, duke evidentuar llojin e procedurës së zbatuar për emërimin në shërbimin civil, numrin e kandidatëve pjesëmarrës, si edhe ecurinë e

procesit. Gjithashtu, janë raportuar rastet e nëpunësve ndaj të cilëve janë aplikuar masa disiplinore; rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, duke evidentuar shkakun për çdo rast; rastet e pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil; të dhëna lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë; si dhe të dhëna lidhur me arsimin e punonjësve dhe raportin e të punësuarve sipas gjinisë (*burra/gra*).

Duhet të theksojmë se ky proces ka paraqitur vështirësi në realizimin e tij, sidomos për të sjellë në standardet e duhura raportimin e proceseve nga njësitë përgjegjëse dhe subjektet e ngarkuara me detyra të përcaktuara në institute të ndryshme të ligjit, si dhe ka nxjerrë në pah problemet që ka aktualisht trupa e administrimit të shërbimit civil, si me njohjen dhe kuptimin e ligjit dhe bazës ligjore në tërësi, që rregullon menaxhimin e shërbimit civil, ashtu edhe me zbatimin e procedurave gjatë aplikimit të ligjit në praktikë; me përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e tyre në raportimin e të dhënave të sakta dhe në kohë; e aspekte të tjera që do të trajtohen në vijim. Kjo situatë paraqitet më e rënduar sidomos në institucionet e administratës vendore.

Sipas të dhënave të administruara, si dhe referuar akteve shkresore që janë vënë në dispozicion të këtij procesi nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në rubrikat pasardhëse do të paraqesim situatën në lidhje me ecurinë e administrimit të shërbimit civil, në sistemin e shërbimit civil, gjatë periudhës janar - dhjetor 2024.

1. Hartimi dhe miratimi i planit vjetor të pranimit në shërbimin civil

Neni 18 i ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar dhe VKM nr. 108, datë 26.2.2014, rregullojnë me hollësi procesin e hartimit dhe miratimit të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

Plani vjetor i pranimit për administratën shtetërore, si pjesë e shërbimit civil, hartohet nga Departamenti i Administratës Publike dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura i miratojnë në mënyrë të pavarur planet e tyre për pranimet vjetore në pozicione të shërbimit civil.

Në bazën ligjore që rregullon këtë institut të ligjit parashikohet se planet vjetore miratohen jo më vonë se fundi i muajit shkurt dhe publikohen në portalin e AKPA-së dhe në rastin e institucioneve të qeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura publikohet edhe në faqen e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftimet publike.

Situatën e konstatuar lidhur me hartimin dhe miratimin e planit vjetor të pranimit për vitin 2024 e kemi paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.4.1 Situata e materializimit dhe publikimit të planit të rekrutimit

Tipologjia e institucioneve të mbikëqyrura	Numri i institucioneve, në të cilat është hartuar plani në përputhje me ligjin	Numri i institucioneve, në të cilat nuk është hartuar plani në përputhje me ligjin
--	--	--

Institucione të Administratës Vendore	68	5
Institucione të Administratës Shtetërore	112	0
Institucione të pavarura	17	1
TOTALI	197	6

Rezulton se **112** institucione të administratës shtetërore, ose **100%** e tyre, kanë hartuar planin e rekrutimit dhe e kanë dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike. Mbi bazën e të dhënave të dërguara, në zbatim të detyrimit ligjor, është hartuar dhe miratuar vendimi nr. 62, datë 7.2.2024, i Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2024, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil”*, ku pasqyrohet plani vjetor i pranimit për institucionet e administratës shtetërore, për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil (për Kryeministrinë, 11 ministri dhe institucionet në varësi të tyre, të cilët janë të përfshirë në Listën e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vende vakante gjatë vitit 2024”, lidhja nr. 1, bashkëlidhur). Në përmbajtjen e VKM-së është përcaktuar numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2024, të ndara: a) Për Trupën e nëpunësve civilë të Nivelit të Lartë Drejtues; b) Për kategorinë e mesme drejtuese; c) Për kategorinë e ulët drejtuese; ç) Për kategorinë ekzekutive, duke përcaktuar grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm për këtë kategori.

Ndërsa në lidhje me institucionet e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura, është konstatuar se, **68** institucione të qeverisjes vendore (që zënë **93%** të tyre) dhe **17** institucione të pavarura të monitoruara (që zënë **94%** të tyre), i kanë hartuar brenda afatit planet e pranimit për vitin 2024 dhe i kanë publikuar vendimet për miratimin e tyre. Ndërkohë, **5** institucione të qeverisjes vendore (që zënë **7%** të tyre) dhe **1** institucion i pavarur (që zë **6%** të tyre) nuk i kanë hartuar planet vjetore të rekrutimit.

Nga të dhënat e administruara vihet re se, në rastin e institucioneve të qeverisjes vendore ka rritje në numrin e institucioneve që në vitin 2024 e kanë respektuar detyrimin ligjor për përgatitjen e planit të nevojave për rekrutim, si edhe për publikimin pranë AKPA-së dhe në faqen e tyre zyrtare. Por, pavarësisht këtyre përpjekjeve, në disa raste, gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të planit të rekrutimit nuk janë marrë në konsideratë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*. Problemet që kemi hasur në lidhje me këtë institut të ligjit, janë evidentuar kryesisht në disa aspekte:

njësia përgjegjëse e institucionit, nuk ka marrë masa për reflektimin e vakancës nëpërmjet ndryshimit të planit vjetor sipas kërkesave të akteve përkatëse nënligjore, në rastet e krijimit rishtas të pozicioneve të pa planifikuara në planin vjetor të rekrutimit, si rrjedhojë e ndryshimit të strukturës organizative të institucionit; të dorëheqjes;

kalimit në një pozicion tjetër pune të punonjësit apo lirimit nga shërbimi civil, sipas shkaqeve të parashikuara në ligj.

në momentin e hartimit dhe miratimit të planit të nevojave për rekrutim në pozicionet e shërbimit civil, njësiti përgjegjëse të institucioneve përkatëse, për vitin respektiv, nuk kanë përcaktuar edhe numrin e

pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, si dhe të nivelit të lartë drejtues, të cilat do të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke respektuar kufijtë ligjor numerik të lejuar

(respektivisht 20% dhe 15%), të parashikuar në nenin 26 dhe nenin 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

60

Komisioneri i ka orientuar njësitë përgjegjëse që të përfshijnë në planin e rekrutimit, jo vetëm vendet vakante të institucionit, por edhe ato vende të lira që mund të krijohen gjatë vitit pasardhës, pasi plani i rekrutimeve shërben si bazë për shpalljen e procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve të lira, si dhe realizimin në kohë të tyre.

2. Situata lidhur me plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës së institucionit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, referuar strukturës organizative të secilit institucion, është evidentuar numri i përgjithshëm i pozicioneve të shërbimit civil për administratën shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura në monitorim; numri i pozicioneve të shërbimit civil të plotësuara me konkurrim; numri i pozicioneve të shërbimit civil të plotësuara me kontratë, në kundërshtim me ligjin; si dhe, numri i pozicioneve të shërbimit civil të lira.

Situata e administrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil në momentin e verifikimit të ligjshmërisë, paraqitet sipas kësaj tablele:

Tabela nr.4.2 Gjendja e pozicioneve të punës në shërbimin civil në përfundim të procesit të monitorimit për vitin 2024, sipas raportimit të institucioneve

	Numri i pozicioneve
Pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në administratën shtetërore	8529
1. Pozicione pune të plotësuara	6769
a. Me kontratë, në kundërshtim me ligjin	243
b. Me konkurrim	6526
2. Pozicione pune të lira	1760
Pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në administratën vendore	6154
1. Pozicione pune të plotësuara	5464
a. Me kontratë, në kundërshtim me ligjin	1007
b. Me konkurrim	4457
2. Pozicione pune të lira	690
Pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në institucionet e pavarura	1412
1. Pozicione pune të plotësuara	1254
a. Me kontratë, në kundërshtim me ligjin	0

b. Me konkurrim	1254
2. Pozicione pune të lira	158
POZICIONE PUNE NË TOTAL	16095

Sa më sipër, gjatë vitit 2024, janë monitoruar nga Komisioneri **16095** pozicione pune që përfshijnë të gjitha tipologjitë e institucioneve që përbëjnë sistemin e shërbimit civil.

Paraqitja e situatës së administrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil në përfundim të procesit të monitorimit është realizuar duke i kategorizuar të dhënat sipas procedurave që janë ndjekur, në lidhje me plotësimin e pozicioneve të punës, nëpërmjet: **i) emërimit në përputhje me kërkesat e ligjit**, (duke marrë parasysh në këtë kategori: a) pranimin nga jashtë shërbimit civil me konkurrim për nivelin ekzekutiv; b) lëvizjen paralele; c) ngritjen në detyrë; d) emërimin në zbatim të vendimeve gjyqësore, apo nga lista e fituesve në përfundim të procedurës së konkurrit për kategorinë ekzekutive dhe e) pezullimit); **ii) emërimet në kundërshtim me ligjin**, duke mos respektuar procedurat ligjore, si dhe **iii) pozicionet e lira**.

Referuar të dhënave numerike të pasqyruara në tabelën si më sipër, si dhe procedurave që janë ndjekur në lidhje me plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil, rezulton se:

Në strukturën e **institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil**, evidentohen **8529** pozicione të shërbimit civil, nga të cilat:

- **6526** pozicione janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit (rreth **77%** e pozicioneve të shërbimit civil);
- **243** pozicione janë plotësuar nëpërmjet akteve të emërimit pa respektuar procedurat ligjore (rreth **2%** të pozicioneve të shërbimit civil);
- **1760** pozicione janë pozicione pune të lira (rreth **21%** e pozicioneve të shërbimit civil).

Në strukturën e **institucioneve të administratës vendore** evidentohen **6154** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- **4457** pozicione, janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit, (rreth **73%** e pozicioneve të shërbimit civil);
- **1007** pozicione, janë plotësuar nëpërmjet emërimeve të përkohëshme, pa respektuar procedurat ligjore (rreth **16%** të pozicioneve të shërbimit civil);
- **690** pozicione, janë pozicione pune të lira, (rreth **11%** e pozicioneve të shërbimit civil).

Në strukturën e institucioneve të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj të posaçëm, subjekt i mbikëqyrjes, evidentohej 1412 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- 1254 pozicione janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit (rreth 89% e pozicioneve të shërbimit civil);
- 158 pozicione janë pozicione pune të lira (rreth 11% e pozicioneve të shërbimit civil).
- Në institucionet e pavarura nuk evidentohej raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin.

62

✓ Nga të dhënat e paraqitura si më sipër, në një vështrim të parë, evidentohej se numri i pozicioneve të lira në shërbimin civil është më i lartë në administratën shtetërore - 1760 pozicione, ose 21% e pozicioneve të punës në shërbimin civil të këtyre institucioneve - që përbën një shifër të konsiderueshme, duke sjellë në mënyrë të pashmangshme rritjen e ngarkesës së nëpunësve ekzistues të institucionit, e për pasojë ndikon negativisht në performancën e tyre.

Por, nëse e vlerësojmë situatën, duke i konsideruar pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin si pozicione të lira në kuptim të ligjit, pasi aktet administrative që emërojnë nëpunës civilë në këtë rast janë absolutisht të pavlefshme, situata paraqitet edhe më problematike në administratën vendore, *pasi janë 1007 pozicione të zëna në këtë mënyrë dhe 697 pozicione aktualisht të lira, gjithsej 1704 pozicione të lira, ose 28% e pozicioneve të punës në shërbimin civil të këtyre institucioneve.*

Nëse do të vlerësojmë fenomenin e pozicioneve të lira në kuptim të ligjit në të gjithë sistemin e shërbimit civil, evidentohej se *janë gjithsej 3858 pozicione të lira, që zënë 24% të pozicioneve të punës*, ku përfshihen të gjitha tipologjitë e institucioneve.

Duke pasur parasysh situatën e evidentuar më sipër, me qëllim normalizimin e gjendjes në lidhje me pozicionet e lira në administratën shtetërore, do të orientohet procesi i monitorimit nga Komisioneri, nëpërmjet grupit të mbikëqyrjes, që ndjek posaçërisht rekrutimin pranë Departamentit të Administratës Publike, jo vetëm tek realizimi i konkurrimeve, por edhe drejt evidentimit më të plotë dhe pasqyrimit real të tyre në planet e rekrutimit.

Po kështu, në këtë drejtim, duhet të punojë edhe Departamenti i Administratës Publike dhe grupet e administrimit të burimeve njerëzore pranë ministrive dhe institucioneve të varësisë, me qëllim rritjen e efikasitetit të strukturës organizative të institucionit, duke vlerësuar nëse këto pozicione janë realisht të nevojshme për veprimtarinë e tyre, për sa kohë që kjo problematikë është evidentuar edhe në vitet e mëparshme.

Ndërkohë, sa i takon këtij procesi në administratën vendore, ai është duke u ndjekur nga afër nga Komisioneri, nëpërmjet një mbikëqyrjeje tjetër orientuese, që ka si objekt administrimin e skemës së shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet këtij procesi, Komisioneri vlerëson ndërtimin e strukturës organizative, si edhe vendosjen e pozicioneve të

shërbimit civil në hierarkinë e duhur administrative, në momentin e miratimit të saj nga titullari i institucionit, duke u bazuar në kërkesat e ligjit dhe në praktikat më të mira administrative, që kanë vendosur standardet e duhura. Ky proces është duke dhënë rezultate konkrete në përmirësimin e ligjshmërisë në drejtim të respektimit të standardeve numerike dhe organizative gjatë ndërtimit të strukturës në NJQV.

✍ Përsa i përket zbatimit të ligjit gjatë procesit të plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil, sipas raportimeve nga institucionet e administratës vendore, konstatohet se ky problem është më i dukshëm në këtë tipologji institucionesh. Disa nga bashkitë e vendit paraqiten aktualisht me pozicione pune të zëna me punonjës të emëruar në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil (1007 raste të cilët zënë rreth **16%** pozicioneve të shërbimit civil në këto institucione), nëpërmjet emërimeve të përkohshme, duke mos zhvilluar procedurat e konkurrencës.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, për të rregulluar këtë moment të paligjshmërisë, i cili ka qenë problematik dhe është evidentuar edhe më parë nga Komisioneri, këto subjekte do të përfshihen në procese të thelluara mbikëqyrjeje dhe inspektimi dhe nga ana tjetër do të vijojë procesi i monitorimit në kohë reale edhe përgjatë vitit 2025, me qëllim që të përdoren të gjitha mjetet e komunikimit, duke përfshirë sidomos titullarët e institucioneve, që janë Kryetarët e Bashkive, për t'i sqaruar ligjin dhe për të theksuar paligjshmërinë që ata kanë lejuar.

Nëpërmjet këtij procesi do të vijojë mbështetja e njësisë përgjegjëse për të përcjellë tek titullari i institucionit, procedurën ligjore që duhet të ndiqet në këtë rast për rregullimin e ligjshmërisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, që janë nënshkruar prej tyre, për të emëruar punonjës në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në ligj dhe të rregullojnë pasojat e ardhura në këtë rast, me qëllim që pozicioni i shpallur për konkurrencë të jetë efektivisht i lirë në momentin e publikimit pranë AKPA, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimit në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit.

3. Rekrutimi në shërbimin civil gjatë vitit 2024 dhe procedura e aplikuar për plotësimin e vendit të lirë

Duke vlerësuar rëndësinë e madhe të procesit të rekrutimit në krijimin e një administrate profesionale dhe efikase, si dhe të një shërbimi civil të qëndrueshëm, të bazuar në meritë, përgjatë gjithë vitit 2024 janë administruar në kohë reale informacionet në lidhje me proceset e rekrutimit në shërbimin civil të zhvilluara nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore në sistemin e shërbimit civil.

Gjatë këtij procesi, janë evidentuar pozicionet për të cilat është organizuar konkurrimi; numri i pjesëmarrësve në konkurrencë; lloji i procedurës së aplikuar për plotësimin e pozicionit të lirë; janë evidentuar në mënyrë të vazhdueshme paqartësitë që kanë njësitë e rekrutimit, duke i orientuar ato për respektimin e të gjithë hapave të domosdoshëm proceduralë që parashikon legjislacioni i shërbimit civil gjatë realizimit të një procedure konkurrencë, si dhe janë mbështetur

organet e rekrutimit me praktika konkrete konkurrimi, duke hartuar modele të akteve administrative që e materializojnë procesin.

Përgjatë gjithë vitit, janë monitoruar procedurat e konkurrimit për lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive; për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese; si dhe procedurat për pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, të planifikuara për t'u zhvilluar nga institucionet e sistemit të shërbimit civil. Ky proces është shoqëruar me administrimin e informacionit lidhur me publikimet e detyrueshme në faqen e institucionit dhe në portalin e AKPA –së të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil; shpalljen e procedurës së konkurrimit për çdo kategori dhe klasë të shërbimit civil; shpalljen e listës së kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim; datën e përcaktuar për testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë, si dhe listën e kandidatëve fitues, duke bashkëpunuar ngushtë me nëpunësit përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e konkurrenive në institucionet përkatëse.

Rezultatet që kanë dalë nga përpunimi i të dhënave, po i paraqesim në tabelën e mëposhtme duke evidentuar numrin e pozicioneve të shërbimit civil të plotësuara gjatë vitit 2024, të ndarë sipas tipologjisë së institucioneve, si dhe procedurën e zbatuar nga njësia përgjegjëse përkatëse.

Tabela nr.4.3 Të dhëna në lidhje me procedurën e zbatuar për plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil

Procedura e zbatuar	Numri i punonjësve të emëruar nëpërmjet këtyre procedurave për Institucione të Administratën Shtetërore	Numri i punonjësve të emëruar nëpërmjet këtyre procedurave për Institucione të Administratës Vendore	Numri i punonjësve të emëruar nëpërmjet këtyre procedurave për Institucionet e Paravrra	TOTALI
Lëvizje paralele	184	56	27	267
Ngritje në detyrë	167	131	67	365
Pranim nga jashtë	22	84	9	115
Pranim në shërbimin civil, në nivelin ekzekutiv	630	325	100	1055
Emërim, rikthim me vendim Gjykate	3	2	2	7
Emërim pas përfundimit të periudhës së pezullimit	20	0	1	21
Emërim nga lista e pritjes së fituesve	0	145	1	146
TOTALI	1026	743	207	1976

Nga të dhënat e evidentuara më sipër, rezulton se në institucionet e sistemit të shërbimit civil, gjatë vitit 2024 janë emëruar në përputhje me procedurat e ligjit për nëpunësin civil **1976** nëpunës, nga të cilët **1026** emërimet i përkasin institucioneve të administratës shtetërore, **743**

emërimet i përkasin institucioneve të qeverisjes vendore dhe 207 emërimet institucioneve të pavarura.

Referuar procedurës ligjore të zbatuar për emërim në një pozicion të shërbimit civil, vërehet se:

- 267 emërimet janë kryer nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.
- 365 emërimet janë kryer nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë me nëpunës civilë të një kategorie paraardhëse.
- 115 emërimet janë kryer në zbatim të procedurës së ngritjes në detyrë me kandidatë nga jashtë shërbimit civil.
- 1055 emërimet janë kryer me procedurën e pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.
- 7 emërimet janë kryer në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë për rikthimin e nëpunësit civil në detyrë.
- 21 emërimet janë kryer nëpërmjet rikthimit të nëpunësit civil në pozicionin e mëparshëm/në një pozicion të së njëjtës kategori në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit.
- 146 emërimet janë kryer nga lista e fituesve në konkurrimin për pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive (*145 emërimet i përkasin Listës së fituesve që administrohet nga njësisia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, 1 rast institucionit të pavarur INSTAT*).

65

Sa më sipër, evidentohen 267 raste të aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele dhe 365 raste të konkurrimin për ngritje në detyrë, që tregojnë për respektimin e parimit të mobilitetit dhe zhvillimit të sistemit të karrierës brenda shërbimit civil.

Të dhënat e administruara në këtë rast përcaktojnë institucionet që kanë realizuar më shumë procese konkurrimi, si edhe problematikat përkatëse, të cilat shërbejnë për planifikimin e procesit të mbikëqyrjes për vitin pasardhës, si në drejtim të objektit, ashtu edhe të subjekteve që do të përfshihen në të.

Aspektet konkrete që përbëjnë shkak për nisjen e mbikëqyrjes verifikohen, analizohen dhe trajtohen më tej, më gjerësisht, në procesin konkret që realizohet në këtë rast.

Me qëllim unifikimin e praktikave të konkurrimin dhe rritjen e numrit të pozicioneve që duhet të plotësohen në zbatim të planit të rekrutimit, Komisioneri është në lidhje të vazhdueshme me institucionet, duke i orientuar, nisur edhe nga nevojat dhe kërkesat e tyre, për të siguruar kryerjen e procedurave të rekrutimit sipas përcaktimeve ligjore.

4. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil

Në procesin e monitorimit të vazhdueshëm të ecurisë së administrimit të shërbimit civil përgjatë gjithë vitit 2024, Komisioneri ka përfshirë edhe institutin e përfundimit të marrëdhënies në

shërbimin civil nëpërmjet: a) lirimit nga shërbimi civil; b) përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit; si dhe c) largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore.

Nga të dhënat e administruara, në lidhje me zbatimin e këtij instituti të ligjit, është konstatuar situata e paraqitur në vijim në formë tabelore:

Tabela nr. 4.4 Përfundimi i marrëdhënies me shërbimin civil në sisemin e shërbimit civil *(institucionet e pushtetit vendor, ministrinë dhe institucionet e pavarura)*

GG

Arsyet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil	Numri i rasteve për Institucione të Administratës Shtetërore	Numri i rasteve për Institucione të Administratës Vendore	Numri i rasteve për Institucionet e Paravrura	TOTALI
Lirimi nga shërbimi civil	189	262	78	529 (68%)
Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit	129	102	7	238 (30%)
Largimi nga shërbimi civil, si masë disiplinore	15	10	1	26 (2%)
TOTALI	333	374	86	793 (100%)

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër vërehet se, rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet lirimit nga shërbimi civil, parashikuar në nenin 66 të ligjit për nëpunësin civil, përbëjnë numrin më të madh të rasteve të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Vihet re se, gjatë vitit 2024, kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil **793** nëpunës civilë, nga të cilët në **529** raste (ose **68%**), nëpunësit e kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil nëpërmjet lirimit nga shërbimi civil; **238** raste (ose **30%**), përfundimi i marrëdhënies ka ndodhur për shkak të ligjit, dhe vetëm në **26** raste (ose **2%**), janë liruar nga shërbimi civil për shkak të masës disiplinore, largim nga shërbimi civil.

Përgjatë gjithë procesit të mbikëqyrjes janë evidentuar edhe shkaqet apo arsyet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të përmendura në vendimin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku nëpunësi ka ushtruar detyrën, deri në momentin e deklarimit të lirimit nga shërbimi civil. Të dhënat e specifikuar paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.4.5 Përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil, e specifikuar sipas neneve 63-66 të ligjit për nëpunësin civil

Arsyeja e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil	Numri i rasteve në institucionet e administratës shtetërore	Numri i rasteve në institucionet e administratës vendore	Numri i rasteve në institucionet e pavarura	TOTALI
--	---	--	---	--------

a. Lirimi nga shërbimi civil, për shkak të:	Refuzimit të pozicionit të ofruar nga ristrukturimi	-	-	-	-
	Mbylljes ose ristrukturimit	102	27	2	131
	Paaftësi për punë, vlerësuar nga komisioni mjekësor	-	1	-	1
	Dy vlerësimeve jo kënaqshëm	1	-	5	6
	Konfliktit të vazhdueshëm të interesit	-	-	-	-
	Dorëheqjes	77	231	66	374
	Për arsye të tjera	9	3	5	17
b. Përfundimi marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, për arsye:	Daljes në pension	116	46	7	169
	Pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit	-	39	-	39
	Për arsye të tjera	13	17	-	30
c. Largimi nga shërbimi civil, si masë disiplinore	Për kryerjen e një shkelje shumë të rëndë disiplinore	15	10	1	26
TOTALI		338 (42%)	374 (47%)	86 (11%)	793

Për sa evidentohet më sipër, rastet e lirimit nga shërbimi civil, sipas arsyes së përfundimit të marrëdhënies së shërbimit civil janë:

- **131** raste, si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit.
- **1** rast, për arsye se nëpunësi është deklaruar i paaftë për punë, nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit.
- **6** raste, pas dy vlerësimeve “*jokënaqshëm*” të rezultateve në punë.
- **374** raste, nëpunësit kanë dhënë dorëheqjen nga detyra.
- **169** raste, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë.
- **39** raste, për shkak të konstatimit të pavlefshmërisë së aktit të emërimit.
- **26** raste, nëpërmjet largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore.
- **47** raste, për arsye të tjera. Rastet e përfundimit të marrëdhënies së punës me institucionin për shkak të emërimit në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë.

Referuar dispozitës ligjore në të cilën është mbështetur njësia e burimeve njerëzore për të deklaruar vendimin për lirim nga shërbimi civil, vihet re se, numrin më të madh të rasteve e zënë lirimet nga detyra nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim nga nëpunësi.

Nga të dhënat rezulton se në **374** raste përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil ka ardhur për shkak të dorëheqjes. Këto raste zënë **47%** të shumës totale të rasteve të largimit nga shërbimi civil.

68

Vihet re se numri më i lartë i dorëheqjeve është në administratën vendore, me **231** raste, ose **62%** e rasteve të ndërprerjes së marrëdhënieve me shërbimin civil, çka vlerësojmë se ka lidhje, ndër të tjera, edhe me nivelin e ulët të pagave dhe me mangësi në kushtet e punës në këto institucione, krahasuar me dy tipologjitë e tjera të institucioneve, ato të administratës shtetërore dhe ato të pavarura, që kanë **38%** të rasteve.

Ndërsa, në raport me numrin e pozicioneve të punës në administratën vendore, përfundimi i marrëdhënies me shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes zë **6%** dhe në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës në sistemin e shërbimit civil, zë rreth **3%**.

Largimi i nëpunësve nëpërmjet dorëheqjes, krijon vështirësi në planifikimin e vendeve të lira në shërbimin civil, si dhe në ecurinë e plotësimit të tyre nëpërmjet procedurave ligjore.

5. Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil

Në lidhje me këtë institut të ligjit, janë administruar të dhëna për të gjithë nëpunësit që kanë pezulluar marrëdhënien në shërbimin civil gjatë vitit 2024, duke evidentuar arsyen e pezullimit sipas rasteve të parashikuara në nenin 53 të ligjit për nëpunësin civil. Rastet e pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela nr.4.6 Raste të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil

Institucionet	Pezulluar për shkak të ligjit	Pezulluar me kërkesë të nëpunësit	TOTALI
Institucione të Administratës Shtetërore	12	48	60
Institucione të Pushtetit Vendor	4	64	68
Institucione të Pavarura	3	8	11
TOTALI	19 (14%)	120 (86%)	139 (100%)

Nga të dhënat ka rezultuar se, instituti i pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil është aplikuar në **139** raste që, në raport me numrin e pozicioneve në sistemin e shërbimit civil, zënë rreth **1%** të tyre, që është një shifër e ulët, e cila tregon se ky institut i ligjit nuk përdoret gjerësisht nga nëpunësit civilë.

Referuar shkakut të pezullimit, vihet re se, pezullimi me kërkesë të nëpunësit, i parashikuar nga neni 55 i ligjit për nëpunësin civil është aplikuar në **120** raste (që zënë **86%** të rasteve), krahasuar me pezullimin për shkak të ligjit i parashikuar nga neni 54 i ligjit, që është aplikuar vetëm në **19** raste (që zënë **14%** të rasteve).

6. Disiplina në shërbimin civil në raport me llojin e masave të aplikuara

Në objektin e mbikëqyrjes së vazhdueshme që është kryer përgjatë gjithë vitit 2024 është përfshirë edhe instituti i disiplinës në shërbimin civil, që rregullohet në mënyrë të hollësishme në kreun X *“Disiplina në shërbimin civil”* dhe përfshin nenet 57 deri 61, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Të dhënat e administruara gjatë procesit të monitorimit, në mënyrë të specifikuar paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.4.7 Disiplina në shërbimin civil në raport me llojin e masave të aplikuara

Loji i shkeljeve disiplinore/masave disiplinore	Masat disiplinore të aplikuara në institucionet e administratës shtetërore	Masat disiplinore të aplikuara në institucionet e administratës vendore	Masat disiplinore të aplikuara në institucionet e pavarura	TOTALI
Shkelje shumë të rënda, <i>“largim nga shërbimi civil”</i>	16	9	2	27
Shkelje të rënda <i>(mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj)</i>	3	7	7	17
Shkelje të rënda <i>(pezullimi nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në 2 vjet) për 1 vit</i>	7	7	0	14
Shkelje të lehta <i>(vërejtje)</i>	29	40	10	79
TOTALI	55	63	19	137

Gjatë vitit 2024, në institucionet e mbikëqyrura, Komisioneri ka konstatuar se, masa disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për rastet kur janë evidentuar shkelje shumë të rënda të disiplinës në punë nga ana e nëpunësve civilë, është aplikuar në **27** raste.

Konkretisht, kjo masë, sipas tipologjisë së institucioneve, rezulton se është zbatuar si vijon: në institucionet e administratës shtetërore në **16** raste; në njësitë e vetëqeverisjes vendore në **9** raste dhe në institucionet e pavarura në **2** raste.

Është konstatuar se në **31** raste janë zbatuar masa disiplinore për shkelje të rënda të disiplinës në punë, nga të cilat në **17** raste, masa disiplinore “Mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” dhe në **14** raste “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”. Këto raste janë konstatuar në institucionet e administratës shtetërore (**10 raste**), institucionet e pushtetit vendor (**14 raste**) dhe institucionet e pavarura (**7 raste**).

Ndërkohë, evidentohet se masa disiplinore më frekvente është dhënë në **79** raste, kur janë konstatuar *shkelje të lehta* të disiplinës në punë dhe për nëpunësit është aplikuar masa disiplinore “Vërejtje”.

7. Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësit civil, sipas përcaktimit në ligj

Në lidhje me vlerësimet periodike të nëpunësve civilë për rezultatet në punë, duke patur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë” (1); “mirë” (2); “kënaqshëm” (3) dhe “jokënaqshëm” (4), nga raportimet e institucioneve, situata paraqitet sipas tabelës në vijim:

Tabela nr.4.8 Klasifikimi i vlerësimeve të punës sipas niveleve të përcaktuara në ligj

Institucione	Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel				TOTALI
	Shumë mirë(1)	Mirë(2)	Kënaqshëm(3)	Jokënaqshëm(4)	
Institucione të Administratës Shtetërore	2353	3293	48	4	5698
Institucione të Administratës Vendore	2246	1372	68	2	3688
Institucione të Pavarura	394	531	85	1	1011
TOTALI	4993 (48%)	5196 (50%)	201 (1.9%)	7 (0.1%)	10397 (100%)

Nga të dhënat e administruara me këtë objekt, rezulton se nga **10397** raste të vlerësuara, pjesa më e madhe e tyre, **4993 raste, që zënë 48% të nëpunësve të vlerësuar**, paraqiten në nivelin 1 “shumë mirë”, që është edhe niveli më i lartë i vlerësimit, ndërsa në **5196 raste, që përbëjnë 50% të nëpunësve të vlerësuar**, paraqiten në nivelin 2, “mirë”, që është nivel i lartë vlerësimi. Vërehet se nivelet e tjera të vlerësimit, “kënaqshëm” dhe “jokënaqshëm”, janë aplikuar respektivisht në **201** dhe **7 raste**, çka përbën vetën **2%** të rasteve të vlerësuara.

Për sa mund të evidentohet lehtësisht nga të dhënat më sipër, tabloja e vlerësimit të punës, në ato institucione ku është kryer, paraqet nivele të larta subjektivizmi, që është një fenomen i cili sjell mundësinë e humbjes së interesit dhe motivimit të nëpunësve për të kryer punën me një nivel gjithnjë e më të lartë cilësie, në kushtet kur vlerësimin e lartë e marrin pothuajse të gjithë nëpunësit civilë të institucionit.

Me qëllim që në vlerësimin e nëpunësit civil të përdoret i gjithë spektri i vlerësimit, për të pasqyruar realitetin e performancës së çdo nëpunësi civil dhe për të rritur frymën e konkurueshmërisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së punës, duhet të ndërgjegjësohen

aktorët e procesit, që janë zyrtarët vlerësues, të cilët duhet të zhvillojnë njohuritë e tyre në lidhje me aplikimin e tij, me qëllim që ai të mos kthehet në një proces formal, por të ketë ndikim real në rritjen e performancës së nëpunësit civil.

Për këtë arsye, duke e vlerësuar si kompleks dhe të vështirë këtë proces, nga ana e Komisionerit janë asistuar dhe ndihmuar eprorët direkt për ta kryer atë në përputhje me ligjin gjatë zbatimit në praktikë.

Nga ana tjetër, në administratën vendore problematika është edhe më e thellë, pasi rezulton se disa prej institucioneve, **nuk e kanë realizuar këtë proces për vitin që po raportohet.**

Këto rrethana, përbëjnë shkak që të përfshihen në mbikëqyrje tematike me këtë problematikë, institucione të administratës vendore, gjatë vitit pasardhës.

Shkaku kryesor i kësaj situate qëndron tek mungesa e njohurive nga ana e zyrtarëve vlerësues, për mënyrën e plotësimit të formularit të vlerësimit të punës, sidomos në rubrikën e komenteve. Nga ana e tyre, kërkohet që të pasqyrohet në aktin e vlerësimit të punës, realizimi i të gjithë procedurës ligjore që aplikohet për zbatimin e fazave të këtij procesi; duke u kujdesur që të ketë objektivitet në vlerësim; duke përdorur të gjithë spektrin ligjor të nivelit të vlerësimeve, si dhe duke administruar në dosjen e personelit, të gjithë dokumentacionin mbështetës të vlerësimit të kryer.

Në lidhje me këtë aspekt, Komisioneri do të vijojë të evidentojë dhe shpjegojë bazën ligjore të këtij procesi, si në përmbajtje të akteve që materializojnë mbikëqyrjen, ashtu edhe nëpërmjet ndihmës në kohë reale, që tashmë është e përhershme dhe ofrohet nga inspektorët përkatës që monitorojnë çdo institucion të sistemit të shërbimit civil.

Plotësimi dhe administrimi në dosjen e personelit, i akteve që kanë të bëjnë me vlerësimet e rezultateve individuale në punë të nëpunësve civilë, është një proces i vështirë dhe Zyrtarët vlerësues, në rolin e Zyrtarit Raportues, Zyrtarit Kundërfirmues, Zyrtarit Autorizues, duhet të ndihmohen nëpërmjet trajnimeve specifike që duhet të realizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Për këtë arsye, nga ana e njësisë përgjegjëse, duhet të dërgohen pranë këtij institucioni, kërkesa për trajnime specifike të zyrtarëve vlerësues në këtë fushë.

8. Disa statistika në lidhje me përkatësinë gjinore dhe institucionet ku e kanë kryer arsimin e lartë nëpunësit civilë

Tabela nr.4.9 Të dhëna për përkatësinë gjinore të nëpunësve civilë

Institucionet	Burra	Gra	TOTAL
Institucione të Administratës Shtetërore	3063	3706	6769
Institucione të Administratës Vendore	2108	3356	5464
Institucione të Pavarura	427	827	1254
TOTAL	5598	7889	13487

	(42%)	(58%)	(100%)
--	-------	-------	--------

Shënim: Nëpunësit sipas gjinisë burra/gra janë raportuar për të gjitha pozicionet e plotësuara aktualisht (si për emërim sipas ligjit, ashtu edhe në kundërshtim me ligjin).

Nga të dhënat e evidentuara në këtë tabelë, të cilat materializojnë raportimet e institucioneve në lidhje me ndarjen e të punësuarve sipas gjinisë së tyre, rezulton se:

- Në institucionet e administratës shtetërore, në pozicione të shërbimit civil, aktualisht janë punësuar gjithsej 6769 punonjës, nga të cilët 3063, ose **45%** janë burra dhe 3706, ose **55%** janë gra.
- Në institucionet e administratës vendore, në pozicione të shërbimit civil, aktualisht janë punësuar gjithsej 5464 punonjës, nga të cilët 2108, ose **39%** janë burra dhe 3356, ose **61%** janë gra.
- Në institucionet e pavarura, aktualisht janë punësuar 1254 nëpunës civilë, nga të cilët 427, ose **34%** janë burra dhe 827, ose **66%** janë gra.

Sa më sipër, raporti midis grave dhe burrave në sistemin e shërbimit civil paraqitet në përgjithësi i balancuar, me një trend të lehtë rritës drejt kategorisë së grave, pasi aktualisht **58%** e punonjësve janë gra dhe **42%** e tyre janë burra.

Tabela nr.4.10 Të dhëna në lidhje me institucionet ku e kanë kryer arsimin e lartë nëpunësit civilë

Institucionet	Arsimuar në institucione arsimore publike	Arsimuar në institucione arsimore private	Arsimuar në institucione arsimore jashtë vendit	TOTALI
Institucione të Administratën Shtetërore	5712	859	198	6769
Institucione të Administratës Vendore	3645	522	19	4186
Institucione të Pavarura	1004	200	50	1254
TOTALI	10361 (85%)	1581 (13%)	267 (2%)	12209 (100%)

Shënim: Të dhënat në lidhje me institucionin ku është kryer arsimi i lartë janë raportuar për të gjithë punonjësit e emëruar në një pozicion të shërbimit civil (për emërim sipas ligjit dhe në kundërshtim me ligjin). Kjo e dhënë nuk është raportuar ende nga Bashkia Tiranë për shkak të numrit të lartë të punonjësve, të punësuar në Bashkinë Qendër + 24 njësi administrative + 3 lagje (gjithsej 1278 pozicione të plotësuara).

Sipas të dhënave të evidentuara në tabelë, në lidhje me arsimin e punonjësve të punësuar në pozicione të shërbimit civil rezulton se:

- Në institucionet e administratës shtetërore, janë punësuar në pozicione të shërbimit civil 6769 punonjës, nga të cilët: 5712 prej tyre, ose **84%**, janë arsimuar në institucionet publike; 859 të punësuar ose **13%** e të punësuarve, janë të arsimuar në institucionet private; 198 të punësuar ose **3%** janë arsimuar jashtë vendit.

- Në institucionet e administratës vendore, janë punësuar në pozicione të shërbimit civil 4186 punonjës, nga të cilët: **3645** prej tyre, ose **87%**, janë arsimuar në institucionet publike; **522** të punësuar ose **12%** e të punësuarve, janë të arsimuar në institucionet private; **19** të punësuar ose **1%** janë arsimuar jashtë vendit.

- Në institucionet e pavarura, janë punësuar në pozicione të shërbimit civil 1254 punonjës, ku: **1004** prej tyre, ose **80%**, janë arsimuar në institucionet publike; **200** të punësuar ose **16%** e tyre, janë të arsimuar në institucionet private; **50** të punësuar ose **4%** janë arsimuar jashtë vendit.

Konkluzione, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së orientuar, me fokus njohjen e situatës së administrimit të shërbimit civil në kohë reale, në institucionet që përfshihen në këtë sistem.

Nga sa pasqyruam dhe analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se është bërë një punë e mirë në drejtim të arritjes së qëllimit të këtij procesi, pasi tashmë janë siguruar statistika dhe të dhëna të mjaftueshme për të analizuar ecurinë e administrimit të shërbimit civil dhe për të nxjerrë përfundime të vlefshme, të cilat do të orientojnë ecurinë e procesit të mbikëqyrjes në vijim.

Mbikëqyrja ka nxjerrë në pah punën e mirë që është bërë nga subjektet e ngarkuara prej ligjit me administrimin e shërbimit civil në disa drejtime, si edhe nevojat që ata kanë për asistencë gjatë veprimtarisë së tyre.

Në vijim do të evidentojmë konkretisht aspektet ku ka pasur impakt ky proces dhe çfarë duhet përmirësuar në të ardhmen:

- **Ky** proces ka pasur një impakt pozitiv në drejtim të disiplinimit të njësisë përgjegjëse dhe organeve të tjera, të cilat krijohen gjatë administrimit të shërbimit civil, si Komisione apo Komitete “*ad hoc*”, për të respektuar procedurat ligjore që duhet të ndiqen gjatë një procesi administrativ.
- **Nëpërmjet** këtij procesi, Komisioneri dhe gjithë subjektet e interesuara kanë në dispozicion statistika të plota për të vlerësuar situatën e administrimit të shërbimit civil në të gjithë sistemin e shërbimit civil.
- **Mbikëqyrja** në këtë rast ka shërbyer për rritjen e nivelit të njohurive të subjekteve që ligji i ngarkon me administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institutet e tij.
- **Vlerësohet** se ka ndikuar në rritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë gjatë procesit të raportimit të të dhënave nga ana e personave të ngarkuar me këtë detyrë.
- **Ka** shërbyer si një trajnim specifik për të gjitha institutet e ligjit, për të gjithë aktorët e procesit të administrimit të shërbimit civil.

- **Ka** ndihmuar në unifikimin e praktikës dokumentare, sidomos në drejtim të akteve administrative që aplikohen gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe që materializojnë procedurën e ndjekur.
- **Raporti** i vlerësimit në këtë rast, është një nga mjetet thelbësore që shërben për analizë risku, me qëllim që të përcaktohen saktë subjektet dhe objekti i mbikëqyrjeve në planin vjetor të punës së Komisionerit.
- **Ka** ndikuar në rritjen e numrit të publikimeve të pozicioneve të lira dhe për pasojë edhe të transparencës gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit, duke monitoruar në kohë reale informacionin e publikuar në mënyrë elektronike në portalin e AKPA-së, faqen e internetit të DAP, institucioneve të pavarura dhe bashkive.
- **Janë** evidentuar praktikat më të mira të menaxhimit të proceseve të shërbimit civil dhe institucionet përkatëse, si dhe rastet e institucioneve që hasin vështirësi për të ndërhyrë në kohën e duhur dhe për të siguruar zbatimin e ligjshmërisë dhe parandalimin e çdo veprimi administrativ që kryhet në kundërshtim me parimet e saksionuara në ligjin nr.152/2013.
- **Është** monitoruar në kohë reale respektimi i parimeve të ligjit për nëpunësin civil dhe i të drejtave të kësaj kategorie, si: emërimi në një pozicion të shërbimit civil pas konkurrimit, konfirmimi si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës dhe vlerësimi i rezultateve në punë për secilën periudhë vlerësimi brenda afateve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore, zbatimi i procedurës gjatë një ecurie disiplinore, e të tjera.

Në këtë këndvështrim, monitorimi në kohë reale i zbatimit të ligjit për nëpunësin civil është një proces që duhet të vijojë dhe të përmirësohet në të ardhmen, duke rritur institutet e ligjit që mbikëqyren, si edhe cilësinë e të dhënave që administrohen.

MBI VLERËSIMIN E ZBATIMIT TË SKEMËS SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NDËRTIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS VENDORE

Në zbatim të kompetencës ligjore të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, përcaktuar në nenet 11, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka ushtruar në vazhdimësi procesin e mbikëqyrjes për institucionet që përfshihen në fushën e veprimtimit të këtij ligji, duke përfshirë edhe institucionet e qeverisjes vendore, sipas planit të punës të miratuar për çdo vit.

75

Sipas përcaktimeve ligjore, të parashikuara në nenin 4, nën titullin *“Përkufizime”* (pika 1, *germa”I”*), si dhe në nenin 10, *“Njësitë e burimeve njerëzore të institucionit”*, të ligjit për nëpunësin civil, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet njësive të burimeve njerëzore të krijuara pranë çdo institucioni. Në këto rrethana, nuk ka një institucion të veçantë, të ngarkuar nga ligji për të menaxhuar administrimin e shërbimit civil në këto institucione, qëndrim ky i mbajtur nga ligjvënësi në kuadrin e ruajtjes së pavarësisë së tyre, ndërkohë që, për institucionet e administratës shtetërore, këtë rol e kryen Departamenti i Administratës Publike.

Për këtë arsye, KMSHC është kujdesur që të qëndrojë pranë këtyre institucioneve, duke i ofruar asistencë teknike të vazhdueshme, e cila ndër vite është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit me personat e kontaktit të autorizuar prej tyre, me qëllim që të parandalohen shkeljet ligjore, si dhe të sigurohet një administrim sa më efikas i shërbimit civil.

Në lidhje me sigurimin e një strukture të qëndrueshme dhe efektive, gjatë procesit të hartimit të saj, Komisioneri vazhdimisht i ka orientuar institucionet në fjalë në disa drejtime:

Përcaktimi i funksioneve kryesore nëpërmjet riformulimit dhe racionalizimit të roleve, misionëve, objektivave strategjike, strukturave organizative dhe rezultateve të pritshme të njësive përbërëse të sistemit të institucionit konkret që përfshihet në këtë proces.

Identifikimi i funksioneve të tepërta dhe i mbivendosjeve në institucionin subjekt

ristrukturimi.

Fuqizimi i kapaciteteve në njësinë e personelit, me qëllim që të bëhet e mundur kryerja e analizave funksionale në institucionin konkret që do të përfshihet në ristrukturim.

Standardizimi i strukturave në aspektin numerik të ndërtimit të njësive organizative të strukturës.

Për të konkretizuar ndihmën në këtë drejtim, Komisioneri ka hartuar herë pas here udhëzues në lidhje me strukturimin e shërbimit civil dhe klasifikimin e pozicioneve të punës (*të përcaktuar në nenin 19 të ligjit për nëpunësin civil*), në strukturën organizative të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, me qëllim krijimin e një strukture sa më efikase në shërbim të arritjes së objektivave të institucionit dhe në shërbim të qytetarëve. Akti me nr. 1082 prot., datë 14.12.2021, i Komisionerit, “*Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022*”, i është dërguar për veprim të gjitha njërive të vetëqeverisjes vendore (*bashki*). Për njohje, me qëllim mbështetjen e bashkive në këtë proces, ky udhëzues i është dërguar edhe Prefektit të Qarkut, Ministrisë së Brendshme (*Sekretarit të Përgjithshëm*), Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Departamentit të Administratës Publike.

Ky akt ka qenë dokumenti fillestar mbi të cilin Komisioneri ka filluar këtë proces, nëpërmjet të cilit është synuar fillimisht sjellja e strukturave në standardet numerike, sa më afër standardeve të vendosura në institucionet e administratës shtetërore.

Ndërkohë, duke qenë se faza e parë e procesit tashmë ka përfunduar, pasi standardet numerike janë vendosur dhe respektohen nga institucionet e administratës vendore, gjatë ndërtimit të strukturës, Komisioneri e ka vijuar këtë proces në një fazë tjetër, që synon të përmirësojë përmbajtjen e tij, duke u fokusuar në dy drejtime kryesore, që janë: **a)** përcaktimi i listës së saktë të pozicioneve të punës që përfshihen në shërbimin civil, çka do të arrihet nëpërmjet **b)** përmirësimit të dokumentit të përshkrimit të punës, i cili materializohet në formularin përkatës.

Për këtë qëllim, nëpërmjet aktit me nr. 654 prot. datë 02.10.2024, të Komisionerit, “*Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të rristurimit të institucionit*”, i janë dërguar udhëzimet përkatëse institucioneve dhe po veprohet prej tyre në përputhje me detyrat e lëna, ashtu si do të raportohet në vijim të këtij materiali.

Duke i dhënë rëndësinë e duhur këtij procesi, nëpërmjet Vendimit nr. 01 (09 prot.), datë 05.01.2022, të Komisionerit, është ngritur një grup i posaçëm pune, i cili, përveç fokusit në standardizimin e strukturave, ka pasur për detyrë edhe asistencën teknike të institucioneve, kryesisht ose sipas kërkesave të tyre. Ky mekanizëm ka vijuar të funksionojë përgjatë periudhës 2022-2024 dhe do të vijojë punën edhe përgjatë vitit 2025.

Referuar vitit 2024, vlen të theksohet se është rritur niveli i bashkëpunimit me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), e cila është materializuar në takime të përbashkëta pune, me pjesëmarrjen e institucioneve të administratës vendore, për të prezantuar dhe sqaruar manualet e përgatitura nga ky institucion, në ndihmë të organizmave që hartojnë dhe miratojnë strukturën organizative në këtë tipologji

institucionesh. Ky bashkëpunim është programuar që të zhvillohet edhe përgjatë vitit 2025, me takime konkrete.

Komisioneri ka kërkuar bashkëpunimin e disa institucioneve të rëndësishme që kanë një rol të posaçëm për të ndihmuar në zhvillimin e këtij procesi, ashtu si janë evidentuar edhe në rastin e udhëzimit të mëparshëm, ndër të cilat tashmë është edhe institucioni i Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor. Ky bashkëpunim tashmë është vendosur dhe funksionon më së miri, për të arritur qëllime të përbashkëta në drejtim të fuqizimit të institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

1. Niveli i bashkëpunimit të komisionerit me institucionet e mbikëqyrura dhe ecuria e procesit përgjatë periudhës 2021-2023

Në vijim të analizës së ecurisë së këtij aspekti që ka nisur me aktin nr. 1082 prot., datë 14.12.2021, të Komisionerit, do të parashtrojmë edhe një historik të zhvillimit të tij për të gjithë periudhën në të cilin ai ka kaluar.

Gjatë vitit 2022, Komisioneri ka komunikuar me **61** bashkitë e vendit për të organizuar mbikëqyrjen e këtij procesi dhe institucionet janë përgjigjur në kohë, me seriozitet dhe me përgjegjshmëri, çka materializohet në faktin se **52 institucione**, për atë periudhë, e kanë dërguar strukturën për vlerësim pranë Komisionerit (**25 institucione** e kanë dërguar paraprakisht projektstrukturën për vlerësim pranë Komisionerit, i cili ka dhënë qëndrimin e tij në lidhje me këtë akt dhe ka orientuar aktorët që kanë detyra specifike gjatë procesit të miratimit të strukturës, duke përcaktuar edhe drejtimet konkrete ku duhej ndërhyrë, dhe bëhet fjalë për bashkitë: Selenicë, Himarë, Sarandë, Delvinë, Finiq, Prrenjas, Tiranë, Mirditë, Mat, Has, Shijak, Tepelenë, Vorë, Rrogozhinë, Fier, Lushnjë, Divjakë, Belsh, Kukës, Tropojë, Krujë, Gjirokastrë, Kamëz, Patos dhe Libohovë; ndërsa **27 institucione** nuk kanë kaluar në një proces paraprak të vlerësimit të projektstrukturës nga grupi i posaçëm, për arsye objektive, pasi strukturat ishin miratuar përpara daljes së udhëzuesit të Komisionerit dhe bëhet fjalë për bashkitë: Kuçovë, Vlorë, Konispol, Gramsh, Cërrik, Lezhë, Dibër, Shkodër, Korçë, Maliq, Devoll, Kolonjë (Ersekë), Pogradec, Dropull, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Mallakastër, Roskovec, Elbasan, Peqin, Kurbini, Berat, Poliçan, Skrapar, Dimal dhe Fushë Arrëz; ndërkohë që procesi i vlerësimit ka vijuar edhe në këtë fazë), ndërsa për **9 institucione** nuk u arrit që të kalonin këtë proces, pasi nuk kanë komunikuar me Komisionerin (bëhet fjalë për bashkitë: Librazhd, Klos, Bulqizë, Vau Dejës, Pukë, Malësi e Madhe, Pustec, Durrës dhe Kavajë).

Për këtë arsye, Komisioneri ka ndërhyrë nëpërmjet urdhrit të brendshëm nr. 80 (707 prot.), datë 08.11.2022, "Për miratimin e planit të veprimit, për verifikimin e të dhënave që pasqyrojnë mënyrën e plotësimit të pozicioneve të punës që i përkasin shërbimit civil, në administratën vendore", i cili ka dalë si masë organizative për të përsheptuar procesin e nisur.

Pas këtij veprimi, strukturat organizative të të gjitha institucioneve të administratës vendore janë administruar nga Komisioneri, nëpërmjet grupeve të punës në terren dhe janë analizuar në drejtim të vendosjes së standardeve numerike.

Ndërkohë, gjatë vitit 2023, procesi vijoi nëpërmjet grupit të posaçëm, të ngritur me vendimin nr. 12, datë 10.02.2023, të Komisionerit, “*Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (Bashki) për vitin 2023 dhe ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces*”, (akt i cili ka dalë në vijim të vendimit nr. 01 (09 prot.), datë 05.01.2022), i cili ka ndjekur procesin e zbatimit të udhëzimit të Komisionerit, duke lënë detyra konkrete në lidhje me strukturimin e shërbimit civil dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në strukturën organizative të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, si dhe për vijimësinë e procesit të rekrutimit të nëpunësve civilë.

Procesi në fjalë, i cili gjatë vitit 2022 ka ecur me ritme të kënaqshme, duke kaluar në disa faza, ku shumë nga subjektet e përfshira në të (*bashkitë*) kanë përparuar më mirë në krahasim me disa të tjera, përgjatë vitit 2023 është ngadalësuar për shkak të procesit zgjedhor, i cili ishte një moment i rëndësishëm në veprimtarinë e administratës vendore.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh praktikën në këtë rast, e cila ka treguar se përfundimet e proceseve zgjedhore shoqërohen edhe me ndryshime në riorganizimin e institucioneve:

me qëllim që të sigurojmë struktura organizative të qëndrueshme (*sidomos sa i takon skemës së shërbimit civil*), e për pasojë edhe qëndrueshmërinë e nëpunësve civilë në detyrë;

nga ana tjetër, për të unifikuar praktikën në drejtim të zhvillimit të procesit me të njëjtin ritëm nga të gjitha subjektet;

Komisioneri e vlerësoi të nevojshëm komunikimin me drejtuesit e njëjësive të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës vendore, për të orientuar vijimësinë e procesit, si dhe për të ndarë bashkërisht shqetësimet për mënyrën se si është vepruar, duke i orientuar njëkohësisht për mënyrën se si duhet të vijnë punën në të ardhmen, nëpërmjet një e-maili dërguar të gjithë subjekteve të administratës vendore, menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve, në muajin qershor 2023, ku janë evidentuar edhe veprimet konkrete që duhet të realizohen:

1. Të fillojë menjëherë procesi i dërgimit të projekt strukturave për vlerësim paraprak nga Komisioneri, përpara se të dërgohen për miratim tek Kryetari i Bashkisë, për vitin në fjalë, nga të gjitha subjektet që ende nuk e kanë kaluar këtë fazë, me qëllim që ato të analizohen si në aspektin funksional, ashtu dhe të organizimit të burimeve njerëzore, duke përcaktuar konkretisht pozicionet e punës, që kryejnë funksione të shërbimit civil.

2. Të përfshihen institucionet në një proces të thellë **rivlerësimi të pozicioneve të punës**, sidomos në drejtim të atyre pozicioneve që ende trajtohen me statusin e nëpunësit civil në njësitë administrative, apo pozicionet që kanë lidhje me dhënien e asistencës sociale, shërbimet e ndryshme, arsimin, kulturën, e të tjera aspekte, me qëllim që të saktësohen përfundimisht pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil dhe të mundësohet një përcaktim i qartë dhe i saktë i numrit të pozicioneve të punës që i nevojiten institucionit për të realizuar kompetencat e tij.

Ky proces diktohet edhe nga ndryshimet që kanë ndodhur në bazën ligjore mbi të cilën rregullohet struktura dhe nivelet e pagave në shërbimin civil. Rivlerësimi i pozicioneve të punës është një proces që **kërkon një procedurë të posaçme**, e cila rregullohet me akt nënligjor e, për këtë arsye, kërkon një kujdes të shtuar në mënyrën se si do të aplikohet në praktikë, duke nisur që nga momenti i ngritjes së **Komisionit të Rivlerësimit**. Ky proces mund të zhvillohet edhe njëkohësisht me procesin e ristrukturimit.

3.

Të dërgohet menjëherë pranë Komisionerit **Plani i Rekrutimit**, pasi do të mbikëqyret në kohë reale nga inspektori përgjegjës për çdo qark, procesi i rekrutimeve të reja që do të kryhen në këto institucione.

4.

Përpara se të shpallet procedura e konkurrimit për secilin pozicion pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, duhet të dërgohet pranë Komisionerit **përshkrimi i punës**, i miratuar në përputhje me kërkesat e ligjit, prej nëpunësve që e kanë detyrë ligjore, me qëllim që të analizohet me kujdes përmbajtja e aktit dhe të krijohen kushtet që Komisioneri të shprehet për vijimin e procesit.

5.

Të njoftohet menjëherë Komisioneri për çdo proces ristrukturimi, që prek nëpunësit civilë, që në momentin përgatitor të tij, i cili nis me fazën e përgatitjes së relacionit shpjegues për nevojën e ristrukturimit, duke dërguar edhe aktet që e materializojnë atë, pasi do të mbikëqyren në kohë reale nga Komisioneri, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, por edhe dhënien e asistencës së nevojshme ligjore për këtë aspekt të rëndësishëm të administrimit të shërbimit civil.

Në këtë periudhë (*në 6-mujorin e dytë të vitit 2023, kjo për shkak të zhvillimit të procesit zgjedhor*) u arrit vlerësimi i strukturave të disa prej bashkive të cilat nuk e kishim marrë paraprakisht vlerësimin e Komisionerit, konkretisht: *Bashkia Elbasan, Bashkia Korçë, Bashkia Kolonjë, Bashkia Devoll dhe Bashkia Maliq*, si dhe u dërguan në kohë nga institucionet edhe planet e rekrutimit së bashku me përshkrimet e punës, për t'u vlerësuar përpara se të publikoheshin si vende të lira.

Për shkak të kompleksitetit të procesit të organizimit të burimeve njerëzore në institucionet e administratës vendore, si dhe të nevojës që kanë shprehur institucionet për asistencë gjatë proceseve të mësipërme, është vlerësuar si e nevojshme zhvillimi i takimeve të punës ndërmjet grupit të posaçëm të ngritur për këto aspekte të administrimit të shërbimit civil nga Komisioneri dhe grupit të punës që është ngarkuar nga institucionet përkatëse për të zhvilluar procesin e hartimit të strukturës për vitin 2023, kryesisht në institucionet të cilat nuk kanë reaguar me shpejtësinë e duhur dhe nuk kanë bashkëpunuar në një nivel të përshtatshëm me Komisionerin, gjatë këtij procesi.

Në këto takime janë evidentuar problematikat e hasura nga njësia përgjegjëse përsa i përket aspektit funksional dhe organizativ të ndërtimit të strukturës, si dhe përcaktimit konkretisht të pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; gjithashtu, u kërkuar ndihma e Komisionerit për të vlerësuar situatën aktuale, nëpërmjet strukturave të administruara nga

grupet e inspektimit. Praktika e krijuar gjatë kësaj periudhe ka shërbyer për të vijuar procesin edhe përgjatë vitit 2024.

2. Niveli i bashkëpunimit të komisionerit me institucionet e mbikëqyrura dhe ecuria e procesit përgjatë vitit 2024; situata e evidentuar

Duke vlerësuar:

situatën e identifikuar për një periudhë 3 vjeçare 2021-2023, për këtë moment të zbatimit të ligjit;

ndryshimet që kanë pësuar në vite strukturat e institucioneve të administratës vendore; përparimin e teknologjisë;

kuadrin e ri ligjor për një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve;

si dhe, referuar situatës faktike ku vlerësimi dhe klasifikimi fillestar i pozicioneve të punës në këtë tipologji institucionesh nuk është kryer sipas metodologjisë përkatëse;

gjatë vitit 2024, ka lindur nevoja për të kryer disa veprime të mëtejshme administrative për të qartësuar raportin e pozicioneve të punës me shërbimin civil, si dhe vlerën që ka çdo pozicion pune në shërbimin civil, në strukturën e institucionit.

Gjatë kësaj periudhe, është komunikuar disa herë me çdo institucion të administratës vendore nëpërmjet shkresave zyrtare, në rrugë elektronike, apo nëpërmjet takimeve në subjekt, për të mbikëqyrur zbatimin e orientimeve të dhëna nga Komisioneri, nëpërmjet udhëzuesit të mëparshëm, që ka dalë në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit për nëpunësin civil (*viti 2021*), si dhe duke ndjekur hap pas hapi problematikat e hasura në drejtim të standardizimit të strukturave dhe unifikimit të tyre në të gjitha institucionet e administratës vendore.

Kjo ishte edhe strategjia që ndoqi Komisioneri gjatë mbikëqyrjes që realizoi në 6-mujorin e parë të vitit 2024, në institucionet e administratës vendore, në zbatim të vendimit nr. 9, datë 30.01.2024, të Komisionerit, *“Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2024 dhe ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces”*.

Gjatë periudhës së zbatimit të këtij vendimi, Komisioneri ka dhënë vlerësimin e tij për **21** struktura organizative, të cilat u paraqitën përpara miratimit të tyre, në këto bashki (*me bashkitë Lushnjë, Prrenjas, Mat, Vorë, Korçë dhe Fier, është komunikuar disa herë për faza të ndryshme të procesit*):

Bashkia **Lushnjë**
Bashkia **Prrenjas**
Bashkia **Mat**
Bashkia **Vorë**

Bashkia **Korçë**
Bashkia **Fier**
Bashkia **Mirditë**
Bashkia **Pogradec**

Bashkia **Kavajë**
Bashkia **Rrogozhinë**
Bashkia **Cërrik**
Bashkia **Patos**

Bashkia **Lezhë**
Bashkia **Kuçovë**
Bashkia **Himarë**

Bashkia **Vlorë**
Bashkia **Roskovec**
Bashkia **Librazhd**

Bashkia **Kurbin**
Bashkia **Gramsh**
Bashkia **Peqin**

Në këto rrethana, duke e vlerësuar procesin si përgjatë periudhës 2021-2024, ashtu dhe në fund të kësaj periudhe, konstatohet se:

është arritur një rezultat i mirë në drejtim të standardizimit të strukturave dhe unifikimit të tyre në **40** institucione të administratës vendore, duke theksuar edhe faktin që bashkëpunimi midis këtyre institucioneve dhe Komisionerit ka qenë në nivelet e duhura;

vijon puna për vlerësimin përfundimtar të ndërtimit të skemës së administrimit të shërbimit civil për **21** institucione, për shkak se struktura është paraqitur për vlerësim pas miratimit të tyre dhe jo paraprakisht, edhe pse në këto raste, përsëri është dhënë asistencë e duhur, por ende nuk është finalizuar procesi *(bëhet fjalë për bashkitë: Shkodër, Poliçan, Klos, Bulqizë, Vau Dejës, Fushë-Arrëz, Pukë, Malësi e Madhe, Pustec, Dropull, Kukës, Dibër, Dimal, Durrës, Përmet, Këlcyrë, Konispol, Mallakastër, Tiranë, Memaliaj dhe Skrapar)*;

kanë ndodhur ndryshime nëpërmjet vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, *“Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page*

dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe vendimit nr. 503, datë 01.8.2024, të Këshillit të Ministrave, *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, në lidhje me kufijtë e pagave dhe kategorizimin e pozicioneve në administratën vendore;*

janë hartuar manuale orientuese *“Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore”*, sipas grupimit të tyre, bazuar në numrin e popullsisë, nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat i janë njoftuar Komisionerit me shkresën nr. 517, datë 04.09.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm, të AMVV-së, për standardizimin e strukturës në administratën vendore.

Në këto rrethana të reja, si dhe me qëllim përditësimin e udhëzimeve të mëparshme që kanë dalë në këtë fushë, Komisioneri e vlerësoi si të nevojshme **hartimin e një udhëzuesi të ri** në lidhje me ndërtimin dhe funksionimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke sjellë edhe njëherë në vëmendje të subjekteve të mbikëqyrura, procesin e transferimit të nëpunësve civilë në rastin e ristrukturimit të institucionit.

Udhëzimet u materializuan në aktin nr. 654 prot., datë 02.10.2024, të Komisionerit, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të*

ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civil për shkak të rristurimit të institucionit”, i cili i është dërguar për zbatim të gjitha njësitë të vetëqeverisjes vendore (bashki). Njëkohësisht, për njohje, me qëllim mbështetjen e bashkive në këtë proces, ky udhëzues i është dërguar edhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, Departamentit të Administratës Publike dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

Gjatë periudhës 2023 -2024, nëpërmjet disa ndryshimeve të aktit nënligjor (VKM nr. 328/2023), kanë ndryshuar edhe kufijtë maksimalë dhe minimalë të pagave me tendencë në rritje, për pozicionet e punës në shërbimin civil, si dhe është unifikuar kategoria e pagave në këto institucione me të gjithë sistemin e shërbimit civil. Këto dy momente do të ndikojnë pozitivisht në drejtim të zbutjes së problematikave në lidhje me pagat e ulëta, si dhe me mungesën e interesit për të punuar në këto institucione, (konstatuar në vijimësi deri në këtë moment, në këtë tipologji institucionesh). Po kështu, nëpërmjet këtyre ndryshimeve do të shkojë drejt zgjidhjes edhe një problem tjetër që ka qenë gjithmonë evident dhe që ka të bëjë me unifikimin e kategorizimit të pozicioneve të punës dhe pagave në sistemin e shërbimit civil.

Për sa më sipër, implementimi i këtyre akteve kërkon një proces të thellë riorganizimi dhe, për këtë arsye, Komisioneri i ka udhëzuar NJQV-të, që t’i paraprijnë këtij momenti me një tjetër proces, me objekt **vlerësimin e saktë të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil dhe vendosjen e qartë të tyre në vendin që i takon në hierarkinë administrative të strukturës së institucionit dhe skemës së administrimit të shërbimit civil.**

Në këtë këndvështrim, në mbështetje të këtij procesi, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe të gjithë aktorët e tjerë që ligji i përfshin në këtë veprim administrativ, që të fillojnë menjëherë me realizimin e detyrave të tyre që kanë lidhje me **rivlerësimin dhe riklasifikimin e pozicioneve të punës**, për të gjithë sistemin e shërbimit civil në këto institucione. Për të arritur rezultate më të mira në këtë drejtim, është kërkuar që të zhvillohet një punë përgatitore në drejtim të **a) hartimit të përshkrimeve të punës** në ato institucione që ende nuk janë hartuar dhe të **b) rishikimit të përshkrimeve të punës**, për ato raste që i kanë hartuar këto akte.

Në formularin e përshkrimit të punës duhet të përcaktohet qartë funksioni që kryen pozicioni, detyrat konkrete, kërkesat specifike të punës sipas ligjit dhe akteve nënligjore, kategorizimi i pozicionit në shërbimin civil, etj.

Aktet nënligjore që rregullojnë këtë moment të administrimit të shërbimit civil janë: vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar dhe vendimi nr. 328, datë 31.5.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësitë të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësitë të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar. Ndërkohë

duhet të vlerësohen edhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e administratës vendore, të cilat ndikojnë në detyrat që përmbush një pozicion pune në shërbimin civil.

Pasi të vlerësohen me përgjegjësi tiparet e çdo pozicioni pune në raport me shërbimin civil, nëse vlerësohet se pozicioni ka tiparet e shërbimit civil, atëherë ai duhet të trajtohet si pozicion i kësaj kategorie, në të kundërt, duhet të ndryshojë regjimi juridik i rregullimit të marrëdhënies së punësimit, duke respektuar procedurën e parashikuar në ligj, si dhe orientimet e dhëna në udhëzimin e Komisionerit.

Për të unifikuar veprimtarinë e institucioneve gjatë procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës, Komisioneri ka kërkuar nga institucionet që të veprojnë sipas kësaj skeme:

1. Të përcaktohet nëpunësi civil ose një grup pune, i cili është përgjegjës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës në strukturën aktuale që janë pjesë e shërbimit civil dhe analizimin e këtij informacioni, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrave, përgjegjësiave e kërkesave të veçanta të çdo pozicioni (*përcaktimin e saktë të kërkesave lidhur me nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve dhe përvojën në punë*).

2. Ky material t'u përcillet zyrtarisht nëpunësve përgjegjës për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës (*eprori direkt i pozicionit respektiv të punës dhe Sekretari i Përgjithshëm*), siç përcaktohet në kreun IV, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", i ndryshuar.

3. Pasi të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, njëسيا e burimeve njerëzore e institucionit të përgatitë dokumentacionin e domosdoshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës (*struktura dhe organika e hollësishme e institucionit që është në fuqi në momentin e ristrukturimit dhe përshkrimet e punës për vendet e punës pjesë e shërbimit civil*).

4. Ky dokumentacion, nëpërmjet Zyrës së Arkiv-Protokollit, t'i përcillet Komitetit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, i cili duhet të konfirmojë me shkrim marrjen e tij.

5. Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, në zbatim të përcaktimeve të pikës 29/ç, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", i ndryshuar, të krijojë Komitetin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, i cili do të përbëhet nga tre anëtarë: njëri nga anëtarët është i ngarkuari me detyrën e analistit të punës, ose ndonjë funksion tjetër të menaxhimit të burimeve njerëzore, kurse dy anëtarët e tjerë janë nëpunës civilë me përvojë në institucion.

6. Komiteti i vlerësimit pas administrimit të dokumentacionit të domosdoshëm të identifikojë me saktësi vendet e punës që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit. Më tej, do të vijojë punën me vlerësimin e tyre, duke u bazuar në përshkrimet e punës dhe në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në lidhjen nr. 5, të vendimit nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

7. Në përfundim të procesit të vlerësimit të hartohet një listë përmbledhëse, ku të pasqyrohen pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse sipas klasave të zbatueshme për secilën kategori të përcaktuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe pikën 5, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

8. Lista përmbledhëse e klasifikimit racional në kategorinë dhe klasën përkatëse për gjithë pozicionet e shërbimit civil të strukturës që është në fuqi në momentin e riorganizimit të institucionit t'i përcillet nëpërmjet Zyrës së Arkiv-Protokollit, Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit dhe njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

Për realizimin e kësaj detyre në përputhje me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, Komiteti i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, mund të bashkëpunojë dhe këshillohet me Departamentin e Administratës Publike, siç përcaktohet në pikën 37, kreu V, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Gjatë këtij procesi, kërkohet që **të mbahet në vëmendje pika 39**, nën kreun *“Parashikime të tjera”*, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, e cila parashikon në mënyrë të shprehur se: *“Në rastet e ndryshimit të përshkrimit të punës, ndryshimit të klasifikimit apo kërkesave të vendit të punës, nëpunësit civilë trajtohen sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil.”*, që parashikon ndër të tjera edhe dëmshpërblimin e nëpunësit sipas vjetërsisë në shërbimin civil.

Procesi i vlerësimit të pozicioneve të punës i finalizuar, duhet t'i paraprijë procesit të miratimit të strukturës së institucionit, i cili shoqërohet më tej, me riorganizim të pozicioneve të punës dhe burimeve njerëzore, materializuar në aktet administrative që realizon njësi përgjegjëse gjatë implementimit të tij, ndër të cilat: **a)** akti i krijimit dhe aktet që tregojnë veprimtarinë e Komisionit të ristrukturimit; **b)** aktet e transferimit të punonjësve që do të sistemohen përsëri në shërbimin civil; **c)** aktet e lirimit nga shërbimi civil të nëpunësve, për të cilët pozicioni i mëparshëm në shërbimin civil nuk ekziston më; **d)** aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, si dhe akte të tjera me këtë natyrë.

Ristrukturimi drejtohet nga njësi përgjegjëse, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; vendimin nr. 125,

datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, Kreu II, *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*; vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*; si dhe udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të DAP, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*, i ndryshuar, i cili mund të përdoret si analogji në këtë rast.

Këto akte ligjore, nënligjore e rregullatore, e kanë vendosur njësinë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në krye të procesit të ristrukturimit të institucionit për t’u kujdesur në drejtim të respektimit të anës procedurale e ligjore të tij.

Sipas këtyre akteve, njësia përgjegjëse është struktura që krijon komisionin e ristrukturimit, dhe, pas propozimeve të këtij mekanizmi, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për emërimin e punonjësve që do të vijnë të jenë pjesë e shërbimit civil.

Po kështu, kjo njësi do të jetë përgjegjëse edhe për punonjësit që do të lirohen nga shërbimi civil, për arsye se pozicioni i mëparshëm i punës në shërbimin civil nuk ekziston më, ose i ka ndryshuar përshkrimin i punës, ose i ndryshon regjimi juridik i marrëdhënies së punës, pas rivlerësimit të pozicioneve, duke nxjerrë aktin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, si dhe për të gjitha aspektet që kanë lidhje me dëmshpërblimin (*neni 66, pika 4/a, i ligjit; edhe ky proces është sqaruar në mënyrë të hollësishme në Udhëzimin e Komisionerit shoqëruar me aktet model ndihmëse në aneksin nr.1 si pjesë plotësuese e udhëzimit, ashtu si u evidentua edhe më sipër*).

Në kuadër të këtij procesi, si dhe duke marrë shkas nga nevoja që kanë institucionet për asistencë, lidhur me standardizimin e strukturës organizative në zbatim të akteve nënligjore që janë duke u aplikuar, në ambjentet e Komisionerit u realizuan takime pune në periudhën 22-24 tetor 2024 me pjesëmarrjen e Sekretarëve të Përgjithshëm dhe përfaqësuesve të njësive përgjegjëse të 61 bashkive të vendit.

Në këto takime janë lënë detyra konkrete në lidhje me proceset që analizuam më sipër dhe sidomos për përcaktimin përfundimtar të listës së pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil, si dhe hartimin e përshkrimeve të punës për pozicionet që do të vlerësohen se janë pjesë e shërbimit civil.

Për shkak të kompleksitetit të mënyrës së organizimit të burimeve njerëzore në institucionet e administratës vendore, si dhe të nevojës që kanë shprehur në vazhdimësi institucionet për asistencë gjatë hartimit të strukturës organizative, por edhe për të verifikuar ecurinë e realizimit të detyrave të lëna gjatë takimeve të sipërpërmendura, Komisioneri e ka vlerësuar si të nevojshëm vizitën në subjekt, sipas planit të veprimit nr.815 prot., datë 04.11.2024, duke i mbikëqyrur nga afër disa aspekte të zhvillimit të procesit, të tilla si:

nëse ka dalë akti për ngritjen e Komitetit të Vlerësimit, në kuadër të vlerësimit dhe

klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil të Bashkisë dhe nëse

përbërja është në përputhje me aktin nënligjor që rregullon këtë proces; nëse janë njoftuar subjektet e ngarkuara nga ligji dhe akti nënligjor që rregullon

procesin e hartimit të përshkrimeve të punës për fillimin e këtij procesi.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelore aktet e administruara nga grupet e punës të ngritura nga Komisioneri për të monitoruar këtë proces:

Tabela nr.5.1 Situata e zbatimit të detyrave nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, në lidhje me vlerësimin e pozicioneve të punës në NJQV

Qarku	Bashkitë	Aktet administrative që provojnë nisjen e procesit të vlerësimit dhe ngritjen e Komitetit të vlerësimit	Akti administrativ që vërteton njoftimin e subjekteve për rishikimin e përshkrimit të punës
Berat	Bashkia Berat	Urdhër nr. 767 (5935 Prot.,) datë 05.11.2024	Akti nr. 5930 prot., datë 05.11.2024
	Bashkia Kuçovë	Urdhër nr. 346 (3786 Prot.,) datë 06.11.2024	Akti nr. 3654 prot., datë 28.10.2024
	Bashkia Poliçan	Vendim nr. 115 (2692 prot.,) datë 01.11.2024	Akti nr. 2692/1 datë 01.11.2024
	Bashkia Skrapar	Urdhër nr. 491 (3682 Prot.,) datë 28.10.2024 (me 4 anëtarë)	Akti nr. 491/1 datë 29.10.2024
	Bashkia Dimal	Urdhër nr. 824 (3127 Prot.,) datë 04.11.2024	Akti nr. 3142 prot., datë 05.11.2024
Dibër	Bashkia Bulqizë	Urdhër nr. 5308 (5308 Prot.,) datë 28.10.2024	Urdhër i brendshëm nr. 5372 datë 30.10.2024
	Bashkia Dibër	Urdhër nr. 398 datë 31.10.2024	Kanë përdorur e mailin zyrtar për njoftim(email i datës 31.10.2024)
	Bashkia Klos	Urdhër nr. 162 (2752 Prot.,) datë 23.10.2024	e-maili i datës 06.10.2024
	Bashkia Mat	Urdhër nr. 657 (4193 Prot.,) datë 31.10.2024	Akti nr. 4193/1 datë 01.11.2024
Durrës	Bashkia Durrës	Nuk e ka finalizuar procesin	Nuk e ka finalizuar procesin
	Bashkia Krujë	Nuk e ka finalizuar procesin	Nuk e ka finalizuar procesin
	Bashkia Shijak	Urdhër nr. 449 (4850 prot.,) datë 11.11.2024	Akti nr. 4851 prot., datë 11.11.2024
Elbasan	Bashkia Belsh	Urdhër nr. 210 (3736 Prot.,) datë 28.10.2024	Akti nr. 3879 prot., datë 04.11.2024
	Bashkia Cërrik	Urdhër nr. 321 (2573 Prot.,) datë 04.11.2024	Akti nr. 2573/1 datë 04.11.2024
	Bashkia Elbasan	Urdhër nr. 986 (5389 Prot.,) datë 08.11.2024	Akti nr. 5390 prot., datë 08.11.2024

	Bashkia Gramsh	Urdhër nr. 393 (4395/1 Prot.) datë 08.11.2024	Akti nr. 4395/2 datë 11.11.2024
	Bashkia Librazhd	Urdhër nr. 1038 (5479 Prot.) datë 06.11.2024	Akti nr. 5512 prot., datë 08.11.2024
	Bashkia Peqin	Urdhër nr. 327 (2150 Prot.) datë 05.11.2024	Akti nr. 2155 prot., datë 05.11.2024
	Bashkia Prrrenjas	Urdhër nr. 458 (2629 Prot.) datë 26.10.2024	Akti nr. 2629/1 prot., datë 26.10.2024
Fier	Bashkia Divjakë	Urdhër nr. 393 (7329 Prot.) datë 03.10.2024	Akti nr. 7942 prot., datë 30.10.2024
	Bashkia Fier	Urdhër nr. 9170 Prot., datë 12.09.2024 (me 25 anëtarë)	Relacion (njoftim) nr. 9170/1 prot., datë 25.09.2024
	Bashkia Lushnjë	Urdhër nr. 290/1 (8876/1 Prot.) datë 30.10.2024	Akti nr. 9042 prot., datë 04.11.2024
	Bashkia Mallakastër	Urdhër nr. 373 (5515 Prot.) datë 04.11.2024	e-maili i datës 05.11.2024
	Bashkia Patos	Urdhër nr. 269 (4049 Prot.) datë 05.11.2024	Akti nr. 4055 prot., datë 06.11.2024
	Bashkia Roskovec	Urdhër nr. 245 (8664 Prot.) datë 06.11.2024	Akti nr. 8698 prot., datë 06.11.2024
Gjirokastrë	Bashkia Dropull	Urdhër nr. 194 (1495 Prot.) datë 07.11.2024	Akti nr. 1495/2 prot., datë 07.11.2024
	Bashkia Gjirokastrë	Urdhër nr. 319 (9896 Prot.) datë 24.09.2024	Akti nr. 8976 prot., datë 30.09.2024
	Bashkia Këlcyrë	Nuk e ka finalizuar procesin	Nuk e ka finalizuar procesin
	Bashkia Përmet	Urdhër nr. 194/1 (1479/1 Prot.) datë 20.09.2024	Akti nr. 2422 prot., datë 23.09.2024
	Bashkia Libohovë	Urdhër nr. 165/1 (1973/1 Prot.) datë 15.11.2024	Akti nr. 1973/2 prot., datë 25.11.2024
	Bashkia Tepelenë	Urdhër nr. 169 (1850/2 Prot.) datë 11.11.2024	Akti nr. 1850/3-8 prot., datë 21.11.2024
	Bashkia Memaliaj	Urdhër nr. extra (2170/1 Prot.) datë 14.10.2024	Akti nr. 2170/2 datë 13.11.2024
Korçë	Bashkia Devoll	Urdhër nr. 612 (3727 Prot.) datë 14.11.2024	e-maili i datës 14.11.2024
	Bashkia Kolonjë	Urdhër nr. 613 (5364 Prot.) datë 13.11.2024	Akti nr. 5366 prot., datë 13.11.2024
	Bashkia Korçë	Urdhër nr. 1097 (1049 Prot.) datë 28.10.2024	Urdhër nr. 1122 (10280 Prot.) datë 04.11.2024
	Bashkia Maliq	Urdhër nr. 1 (4247/1 Prot.) datë 19.09.2024	e-maili i datës 19.09.2024
	Bashkia Pogradec	Urdhër nr. 530 (4191/3 Prot.) datë 11.11.2024	e-maili i datës 11.11.2024
	Bashkia Pustec	Urdhër nr. 14 (1548 Prot.) datë 25.11.2024	e-maili i datës 25.11.2024

Kukës	Bashkia Has	Urdhër nr. 455/1 (3286 Prot.,) datë 15.10.2024	Akti nr. 3698 prot., datë 18.11.2024
	Bashkia Kukës	Urdhër nr. 584 (____ Prot.,) datë 05.11.2024	Akti nr. 1633 prot., datë 08.11.2024
	Bashkia Tropojë	Urdhër nr. 385 (____ Prot.,) datë 27.11.2024	e-maili i datës 18.11.2024
Lezhë	Bashkia Kurbin	Urdhër nr. 135/1 (3695/4 Prot.,) datë 22.08.2024	Akti nr. 5539/1 prot., datë 07.11.2024
	Bashkia Lezhë	Urdhër nr. 600 (18063/1 Prot.,) datë 07.11.2024	Akti nr. 17930 prot., datë 06.11.2024
	Bashkia Mirditë	Urdhër nr. 515 (nr.4285 prot.), datë 12.11.2024	e-maili i datës 05.11.2024
Shkodër	Bashkia Fushë-Arrëz	Urdhër nr. 693 (43769 Prot.,) datë 19.11.2024	e-maili i datës 19.11.2024
	Bashkia Malësi e Madhe	Urdhër nr. 131 (2918 Prot.,) datë 12.11.2024	Akti nr. 2918/1 datë 12.11.2024
	Bashkia Pukë	Urdhër nr. 449 (2118 Prot.,) datë 18.11.2024	Akti nr. 2182 prot., datë 27.11.2024
	Bashkia Shkodër	Urdhër nr. 1669 (26810 Prot.,) datë 19.11.2024	e-maili i datës 19.11.2024
	Bashkia Vau i Dejës	Urdhër nr. 703 (6998 Prot.,) datë 19.11.2024	Akti nr. 150 prot., datë 28.10.2024
Tiranë	Bashkia Tiranë	Proces i përmbyllur	Proces i përmbyllur
	Bashkia Kamëz	Urdhër nr. 442/1 (442/1 Prot.,) datë 17.11.2024	Emaili (njoftim) datë 19.11.2024
	Bashkia Kavajë	Nuk e ka finalizuar procesin	Nuk e ka finalizuar procesin
	Bashkia Rrogozhinë	Urdhër nr. 572 (4946 Prot.,) datë 25.11.2024	E-maili (njoftim) datë 13.11.2024
	Bashkia Vorë	Urdhër nr. 05 (208 Prot.,) datë 13.01.2025	Akti nr. 03 prot., datë 13.01.2025
Vlorë	Bashkia Vlorë	Urdhër nr. 473 (17856 Prot.,) datë 04.11.2024	Akti nr. 17856/1 datë 04.11.2024
	Bashkia Sarandë	Urdhër nr. 241 (6340 Prot.,) datë 08.11.2024	Akti nr. 6299 datë 07.11.2024
	Bashkia Selenicë	Urdhër nr. 126 (2535 Prot.,) datë 10.12.2024	Akti nr. 2535/1 datë 10.12.2024
	Bashkia Himarë	Urdhër nr. 507 (6605 Prot.,) datë 05.11.2024	Akti nr. 6737 datë 08.11.2024
	Bashkia Delvinë	Urdhër nr. 2450, datë 06.11.2024	E-maili (njoftim) datë 13.11.2024
	Bashkia Konispol	Nuk e ka finalizuar procesin	Nuk e ka finalizuar procesin
	Bashkia Finiq	Urdhër nr. 113 (2774 Prot.,) datë 11.11.2024	Akti nr. 2774/1 datë 11.11.2024

TOTALI	61 BASHKI
---------------	------------------

Sa më sipër, evidentohet se ka pasur një nivel të lartë bashkëpunimi dhe rreth **91%** e institucioneve (*56 bashki*), i kanë zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri, duke ngritur dhe bërë funksionale mekanizmat që do të zhvillojnë këtë proces, të cilat duhet ta finalizojnë atë me aktet përkatëse, çka do të monitorohet në kohë reale nga Komisioneri edhe përgjatë vitit 2025.

Procesi i verifikimit vijon me bashkitë **Durrës, Krujë, Këlcyrë, Konispol dhe Kavajë**, që përbëjnë rreth **9%** të NJQV-ve (*5 bashki*), të cilat kanë paraqitur problematika të ndryshme në drejtim të bashkëpunimit me Komisionerin në lidhje me këtë proces. Për këtë grup subjektsh, puna vijon me intensitet për të zgjidhur këtë problem.

Komisioneri ka kërkuar përgjegjshmëri të lartë nga grupet e punës që janë ngritur në këtë rast, me qëllim që të mos pengojnë ecurinë e procesit të miratimit e strukturës së institucionit dhe të mos zvarritet më tej procesi i rekrutimit.

Duke marrë parasysh faktin se viti 2025 është një vit zgjedhor dhe ka kufizime për sa i përket veprimeve administrative që kanë lidhje me lëvizjen e burimeve njerëzore dhe riorganizimin e institucionit, për një afat të caktuar kohor, që lidhet me datën e zgjedhjeve, atëherë është kërkuar që procesi i ristrukturimit të institucionit të përfundojë brenda periudhës **dhjetor 2024 - janar 2025**, periudhë e cila përkon edhe me miratimin e buxhetit të bashkive, në kuadër të numrit të përgjithshëm të punonjësve, nga ana e Këshillit Bashkiak.

3. Konkluzione dhe rekomandime

Nga të gjitha sa analizuam në përmbajtje të këtij kapitulli, me gjithë përpjekjet serioze të institucioneve në kuadër të respektimit të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të cilat Komisioneri i vlerëson si një vullnet pozitiv në drejtim të përmirësimit të situatës ligjore të administrimit të shërbimit civil, ende shtrohen për zgjidhje çështje specifike që kanë lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në administratën vendore.

Përpara burimeve njerëzore dhe organeve që i menaxhojnë ato në njësitë e qeverisjes vendore shfaqen sfida të vështira në administrimin dhe menaxhimin e shërbimit civil, krahasuar me tipologjitë e tjera të shërbimit civil, si administrata shtetërore apo administrata vendore, për shkak të mjedisit ku kryejnë veprimtarinë e tyre, rrethanave në të cilat e kryejnë veprimtarinë, si edhe mungesës së theksuar të burimeve njerëzore që plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil.

Për këtë arsye, Komisioneri do të vijojë me procesin e monitorimit të administrimit të shërbimit civil në këto institucione, me qëllim: **a)** identifikimin dhe vërtetimin e mangësive kryesore gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, me fokus të veçantë në organizimin e administratave të tyre dhe përgatitjen e përshtatshme të mirëpërcaktuar të vendeve të punës;

b) për të kuptuar më mirë problemet aktuale që lidhen me strukturat organizative dhe përshkrimin standard të punës, me të cilat njësitë e qeverisjes vendore përballen në situatën aktuale; **c)** për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të menaxherëve të menaxhimit të burimeve njerëzore mbi rëndësinë dhe sfidat e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil; **ç)** për të rritur nivelin e njohurive të menaxherëve të burimeve njerëzore për legjislacionin e shërbimit civil dhe mbi mjetet në dispozicion të zbatimit të zhvilluara me vite për zbatimin e tij; **d)** për të identifikuar nevojat për të përshtatur mjetet e zbatimit të burimeve njerëzore të përgatitur nga DAP me tipare të identifikuara në nivel lokal; **e)** për të konfirmuar nevojat e zhvillimit të mëtejshëm të mjeteve dhe procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, të përshtatura sipas nevojave të njësisë së qeverisjes vendore dhe për të identifikuar/nxitur dhe ndarë praktikatat e mira midis NJQV-ve.

Nisur nga rrethanat e paraqitura në këtë kapitull, Komisioneri do të vijojë procesin e mbikëqyrjes së orientuar në drejtim të unifikimit të strukturave në administratën vendore edhe përgjatë vitit 2025, dhe nga ana tjetër do të përfshijë në planin vjetor të punës për vitin 2025, për mbikëqyrjeje tematike disa institucione të administratës vendore, që janë evidentuar problematike, me objekt të përcaktuar:

Procesi i vlerësimit/rivlerësimit dhe riklasifikimit të pozicioneve të punës, që përfshihen në shërbimin civil;

ligjit për të përcaktuar qartë funksionet që kryen pozicioni, detyrat konkrete, kërkesat specifike të punës sipas ligjit dhe akteve nënligjore, kategorizimi i pozicionit në shërbimin civil, e aspekte të tjera të kërkuara nga ligji.

Hartimi/rishikimi i përshkrimit të punës, me fokus në respektimin e kërkesave të

Subjektet që do të përfshihen në mbikëqyrje do të jenë sidomos bashkitë, të cilat ende nuk kanë raportuar mbi zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri në lidhje me proceset e evidentuara si objekt mbikëqyrjeje më sipër.

Institucionet duhet të vijojnë punën nëpërmjet grupeve të ngritura për hartimin/ndryshimin e përshkrimit të punës dhe për vlerësimin/rivlerësimin e pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil, të cilat janë procese që do të monitorohen nga Komisioneri në të gjitha NJQV-të.

Komisioneri do të vijojë bashkëpunimin me institucionet që kanë role të caktuara në drejtim të zgjidhjes së çështjeve që kërkojnë një trajtim të veçantë në këtë fushë të administrimit të shërbimit civil, si: Ministria për Mbështetjen e Administratës Vendore; Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, e sidomos Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, për të mbështetur me trajnime administratën vendore në këtë aspekt specifik të standardizimit të organizimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore.

Po kështu, edhe nga ana e Komisionerit do të vijojë ndihma për këto institucione, nëpërmjet asistencës së vazhdueshme ligjore, si edhe nëpërmjet takimeve të posaçme me këtë tematikë, për t'i dhënë drejtim problemeve që dalin në praktikë gjatë zhvillimit të procesit.

MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË DAP GJATË PROCESIT TË PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke vlerësuar rëndësinë e madhe të procesit të rekrutimit në krijimin e një administrate profesionale dhe efikase, si dhe të një shërbimi civil të qëndrueshëm, të bazuar në meritë, në lidhje me përsosjen më tej të sistemit të rekrutimit me qëllim rritjen e objektivitetit dhe transparencës, me urdhrin nr.8, datë 24.1.2024, urdhëroi fillimin e mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesit të rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore, përgjatë vitit 2024.

Në zbatim të mbikëqyrjes në fjalë, Komisioneri ka monitoruar përgjatë gjithë vitit 2024 disa prej procedurave të konkurrimit të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për plotësimin e pozicioneve vakante në kategorinë ekzekutive, në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, për të gjitha kategoritë.

Në këtë drejtim, për të arritur objektivin e mbikëqyrjes, janë monitoruar procedurat e konkurrimit për pranim në shërbim civil, në nivelin ekzekutiv, të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, duke administruar informacion të vazhdueshëm në faqen zyrtare “online” të Departamentit të Administratës Publike; nëpërmjet informacionit të marrë nga përfaqësues të DAP, të autorizuar për komunikim me Komisionerin; si dhe të dhënave të mbledhura gjatë fazës së testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, në disa prej procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, për të gjitha nivelet e nëpunësisë, në të cilat grupi i punës ka qenë prezent.

Procesi është zhvilluar me këqyrjen e të gjitha akteve të publikuara gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, duke i pasqyruar të dhënat e nxjerra nga këto akte, në formë tabelore (excel) me qëllim përpunimin e tyre.

Gjithashtu, grupi i punës i ngarkuar me këtë proces ka ndjekur disa nga procedurat e konkurrimit, duke e evidentuar këtë proces përmes administrimit të akteve të hartuara gjatë zhvillimit të fazave të procedurës së konkurrimit, si dhe procesverbalin e këqyrjes të mbajtur nga grupi i punës për këtë qëllim, sipas objektit në Programin e Mbikëqyrjes, nr.73/1 prot., datë 24.1.2024, të miratuar nga Komisioneri, i cili i është njoftuar Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr. 73/2 prot., datë 24.1.2024, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në konkurrimet e planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike gjatë vitit 2024”*. Bazuar në metodologjinë e miratuar për procedurën se si do të kryhet procesi i mbikëqyrjes, gjatë vitit 2024, grupi i

punës është paraqitur në disa konkurse dhe ka ndjekur disa prej tyre, përgjatë të gjitha fazave të zhvillimit të tyre.

1. Aspekte të përgjithshme dhe statistika në lidhje me procesin e rekrutimit

Në zbatim të detyrimeve të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 62, datë 7.2.2024, *“Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2024, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”*, i ndryshuar me Vendimin nr. 528, datë 1.8.2024, *“Për disa ndryshime në vendimin nr. 62, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2024, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”*, në bazë të të cilit administrohet i gjithë procesi i rekrutimit.

Ky plan është ndërtuar mbi nevojat e dërguara nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore në Kryeministri dhe çdo ministrie të linjës, të cilat, më parë kanë hartuar planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim, për të gjithë sistemin përkatës që përfshin aparatin e administratës qendrore të institucionit, si dhe institucionet e varësisë.

Sipas këtij akti nënligjor, janë planifikuar **1187** pozicione të lira për rekrutim, gjatë vitit 2024, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- Për trupën e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues (TND): **10** pozicione;
- Për kategorinë e mesme drejtuese: **92** pozicione;
- Për kategorinë e ulët drejtuese: **217** pozicione;
- Për kategorinë ekzekutive: **868** pozicione.

Më tej, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 255, datë 24.4.2024, *“Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2024”*, ka vendosur që procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira, duke përcaktuar edhe numrin maksimal të pozicioneve, për të cilat do të përdoret kjo procedurë, si dhe pozicionet, në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil të përcaktuara në lidhjen nr .1, që i bashkëlidhet vendimit për miratimin e planit të rekrutimit dhe është pjesë përbërëse e tij. Bëhet fjalë për **62** (gjashtëdhjetë e dy) pozicione, të ndara si më poshtë:

- **23** pozicione të nivelit të mesëm drejtues dhe të barasvlershëm;
- **39** pozicione të nivelit i ulët drejtues dhe të barasvlershëm.

Në vijim të procesit të plotësimit të pozicioneve të punës, Departamenti i Administratës Publike *(në vazhdim, njësia përgjegjëse)*, ka organizuar konkurrimet për plotësimin e pozicioneve të lira të nivelit ekzekutiv, të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtuese *(TND)*, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, pranimit në shërbimin civil dhe ngritjes në

detyrë, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil (pika 4 e VKM nr. 62/2024).

Përgatitja e planit të nevojave për rekrutim në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, përbën një garanci për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv në mënyrë efektive, në grupe të përgjithshme dhe të posaçme të administrimit.

Në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë në realizimin e procedurave të konkurrimit, gjatë vitit 2024 janë ndjekur 8 procese të plotësimit të pozicioneve të ndryshme pune dhe niveleve të ndryshme të nëpunësisë civile.

Ndërkohë, në kuadër të këtij procesi, janë shqyrtuar edhe 10 informacione të ardhura në adresë të Komisionerit, nga nëpunës apo kandidatë që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit të organizuara nga njësia përgjegjëse (DAP), për vitin 2024, për të cilat janë pretenduar se janë kryer apo lejuar parregullsi gjatë zhvillimit të tyre.

2. Ecuria e konkurremeve të mbikëqyrura në kohë reale përgjatë vitit 2024

Bazuar në kreun IV e V, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, plotësohen vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit. Me qëllim që të vlerësojë nga afër këtë proces, Komisioneri ka vendosur që mbikëqyrja për vitin 2024 të zhvillohet me prezencën e grupit të punës gjatë zhvillimit të procesit në ambjentet ku ato janë kryer, nëpërmjet përzgjedhjes së pozicioneve sipas riskut për të pasur paligjshmëri, për 8 procedura konkurrimi të mbikëqyrura në kohë reale, janë administruar të dhënat si më poshtë:

Tabela nr.6.1 Të dhëna përmblledhëse për konkurrimet e ndjekura për vitin 2024

Nr. konkurremeve të zhvilluara	Nr. pozicioneve për t'u plotësuar në këto konkurreme	Nr. kandidatëve fitues nga faza e parë “Lëvizja Paralele”	Nr. kandidatëve fitues nga faza e dytë “Pranim në Kategorinë Ekzekutive dhe Ngritje në Detyrë”	Nr. pozicioneve të mbetura të lira
(a)	(b)	(c)	(ç)	(d)
8	21	2	23(*)	1

(*) Shënim: Sqarojmë se: a) numri i kandidatëve të pasqyruar në kolonën (ç), është i lartë pasi në procedurat e pranimi nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, ka rezultuar se numri i kandidatëve që kanë marrë mbi 70 pikë është më i lartë se numri i pozicioneve të publikuara në shpallje, fakt që përcakton regjistrimin e tyre në listën e pritjes.

Shuma e kolonave (c), (ç) dhe (d) nuk jep në total shumën e kolonë (b), pasi nuk është zbritur numri i fituesve nga lista e pritjes, (4 fitues).

Në vijim të realcionit do të trajtohen ato procedura të cilat grupi i punës ka ndjekur në subjekt. Për efekt të analizës së procesit, konkurrimet i grupojmë në këtë mënyrë: **A.** Lëvizja paralele dhe pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive dhe **B.** Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë për nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues.

A. Lëvizja paralele dhe pranimi në shërbimin civil për pozicionet e kategorisë ekzekutive

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, rregullohet nga ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (Kreu IV, *“Pranimi në shërbimin civil”*, nenet 20, 21, 22, 23 e 25); Vendimi nr.243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*.

Sipas dispozitave të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Në varësi, nëse pozicionet e lira në një procedurë konkurrimi në kategorinë ekzekutive plotësohen me anën e procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse (DAP) shpall konkursin e mbyllur. Ndërsa, në rast se, mbeten pozicione të lira pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, atëherë njësia përgjegjëse i plotëson ato me anën e procedurave për pranimin në kategorinë ekzekutive.

Në zbatim të urdhrit nr. 8, datë 24.1.2024, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*; si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 7, datë 11.03.2015, e ndryshuar, Komisioneri ka filluar mbikëqyrjen e orientuar me objekt zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në konkurrimet e planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2024.

Në kuadër të këtij procesi, në zbatim të programit të mbikëqyrjes miratuar me nr. 73/1 prot., datë 24.1.2024, anëtarë të grupit të mbikëqyrjes, kanë qenë të pranishëm (në fazën e intervistës së strukturuar me gojë si dhe fazën e testimit me shkrim), në 4 procedura konkurrimi në fazën e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil, për plotësimin e 16 pozicioneve të punës, evidentuar si më poshtë:

1. *“Specialist”*, në Sektorin e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, në Ministrinë e Brendshme - kategoria e pagës III-b, publikuar në shpalljen me kod #6068.
2. *“Specialist”*, në Sektorin e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe Çështjet Vendore, në Ministrinë e Brendshme - kategoria e pagës III-b, publikuar në shpalljen me kod #6068.

3. *"Specialist"*, në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Aparatit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, klasa e pagës IV-1 (shkenca shoqërore), publikuar në shpalljen me kod #6196.
4. *"Specialist"*, në Sektorin e Burimeve Njerëzore për Sistemin, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, klasa e pagës IV-1 (shkenca shoqërore), publikuar në shpalljen me kod #6196.
5. *"Specialist"*, në Sektorin e Burimeve Njerëzore për Sistemin, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, klasa e pagës IV-1 (shkenca shoqërore), publikuar në shpalljen me kod #6196.
6. *"Specialist"*, në Sektorin e Koordinimit të Planifikimit të Burimeve Njerëzore, Rekrutimit dhe Procedurave për Sistemin Ministror, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave, klasa e pagës IV-1 (shkenca shoqërore), publikuar në shpalljen me kod #6196.
7. *"Specialist"*, në Sektorin e Politikave të Zhvillimit për Institucionet, Pagat dhe

Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike, klasa e pagës IV-1 (shkenca Juridike), publikuar në shpalljen me kod #6196.

8. *"Specialist"*, në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, në Departamentin e Administratës Publike - klasa e pagës IV-1 (shkenca shoqërore), publikuar në shpalljen me kod #6196.
9. *"Specialist"*, (për shërbimet e brendshme), në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Qendrën Kombëtare të Biznesit- klasa e pagës IV-2 (shkenca shoqërore), publikuar në shpalljen me kod #6196.
10. *"Specialist"*, (burime njerëzore) në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas-klasa e pagës IV-2 (shkenca shoqërore), publikuar në shpalljen me kod #6196.
11. *"Specialist Jurist/Borxhi"*, në Zyrën e Administratës, në Degën Doganore Fier - kategoria e pagës III-b, publikuar në shpalljen me kod #6046.
12. *"Specialist Jurist/Borxhi"*, në Zyrën e Administratës, në Degën Doganore Sarandë - kategoria e pagës III-b, publikuar në shpalljen me kod #6046.
13. *"Specialist"*, në Sektorin e Vendburimeve Minerale, në

Drejtorinë e Burimeve Minerale, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar- klasa e pagës IV-2, publikuar në shpalljen me kod #6051.

14. *“Specialist”*, në Sektorin e Vendburimeve Minerale, në Drejtorinë e Burimeve Minerale, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar- klasa e pagës IV-2, publikuar në shpalljen me kod #6051.

15. *“Specialist”*, në Sektorin e Vendburimeve Minerale, në Drejtorinë e Burimeve Minerale, në

Shërbimin Gjeologjik Shqiptar- klasa e pagës IV-2, publikuar në shpalljen me kod #6051.

16. *“Specialist”*, në Sektorin e Monitorimit të Lejeve të Kërkim - Zbulimit, në Drejtorinë e Burimeve Minerale, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar- klasa e pagës IV-2, publikuar në shpalljen me kod #6051.

Nga analiza e të dhënave të mbledhura, për këto procedura konkurrimi, rezulton se, nga **16** pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive *“Specialist”*, të cilat janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit të hapur, **2** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet fazës së *lëvizjes paralele*, **1** pozicion pune është plotësuar nëpërmjet institutit të transferimit të përhershëm në përfundim të periudhës së pezullimit, në zbatim të nenit 56, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreut II, të VKM -së nr. 124, datë 17.2.2016, *“Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, i ndryshuar dhe **12** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet fazës së *pranimit në shërbimin civil*. Ndërkohë, **1** pozicion pune ka mbetur i pa plotësuar në përfundim të këtyre proceseve.

Tabela nr.6.2 Të dhënat numerike për kandidatët pjesëmarrës në dy fazat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive

Lëvizja paralele				Pranim në shërbimin civil				Nr. i fituesve në listë prirje
Pozicione të lira	Kandidatë			Pozicione të lira nga faza e parë	Kandidatë			
	Të kualifikuar gjatë verifikimit paraprak	Të kualifikuar nga verifikimi përfundimtar	Fitues		Të kualifikuar gjatë verifikimit paraprak	Të kualifikuar nga verifikimi përfundimtar	Fitues	
2	1	1	0	2	39	42	3	1
8	8	11	1	7	74	82	8	2
2	0	0	0	2	21	24	3	1
4	1	1	1	3	7	8	2	0

Grupi i punës, verifikoi në mënyrë të hollësishme të gjithë hapat proceduralë që ka ndjekur institucioni i mbikëqyrur, për menaxhimin e procesit të konkurrimit, ndër të cilat:

Shpalljen e konkurrimit për vendin e lirë në portalin e Departamentit të Administratës Publike;

Verifikimin paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse kandidatët i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme sipas shpalljes së konkurrimit;

Vlerësimin e kandidatëve nga Komiteti i Brendshëm për Lëvizjen Paralele dhe Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i cili përfshin vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, testimin me shkrim dhe vlerësimin e intervistës së strukturuar me gojë;

Nga verifikimi i akteve, të cilat materializojnë porcedurat e konkurrimit të shpallura nga DAP, për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, konstatohet se, është vepruar si më poshtë:

Në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike është publikuar pozicioni vakant, në përputhje me kërkesat e pikës 5, kreu II, të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar.

Në shpalljen e pozicionit, njësia përgjegjëse (DAP), **ka vepruar** në përputhje me rregullimet e pikës 1 dhe 2, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, duke parashikuar se, plotësimi i vendit të lirë në kategorinë ekzekutive do të bëhet *së pari*, nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëherë procedura do të vijojë me fazën e pranimit në shërbimin civil.

Në shpalljen e publikuar konstatohet që **është specifikuar** fusha e njohurive që do të testohet; fazat në të cilën do të kalojë konkurrimi; numri i vendeve të planifikuara për të cilat do të bëhet pranimi; kërkesat e përgjithshme sipas

Shpalljen e listës së fituesve, administrimin e kësaj liste nga njësia përgjegjëse dhe nxjerrjen e aktit të emërimit në shërbimin civil për kandidatët fitues.

nenit 21, të ligjit për nëpunësin civil dhe kërkesat e veçanta për pozicionin e punës; dokumentet që duhet të dorëzohen dhe afati për dorëzimin; datën e daljes së rezultateve për verifikimin paraprak, vlerësimin e kandidatëve dhe mënyrën e njoftimit/komunikimit me kandidatët, sipas kërkesave të pikës 9, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, e ndryshuar.

Në të gjitha rastet e shpalljes së vendeve të lira, rezultoi se, **janë respektuar afatet e parashikuara** në pikën 8 e 10, të Kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranim në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

✓ Procedura e ndjekur gjatë fazës së konkurrimit “Lëvizje paralele”, për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive

Rezulton se, nëpërmjet fazës së lëvizjes paralele, në procedurat e konkurrimit të evidentuara më lart, janë plotësuar vetëm **2 pozicione pune**, me emërtesën “*Specialist*”, duke ndjekur këto hapa:

- **Njësia** përgjegjëse (DAP), ka vepruar në përputhje me rregullimet e pikës 1 dhe 2, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet *së pari*, nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëherë njësia përgjegjëse organizon procedurën e pranimi në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur.
- **Në** të gjitha rastet është bërë verifikimin paraprak nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit që ka vendin vakant, nëse kandidatët i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme sipas shpalljes së konkurrimit dhe janë shpallur në faqen zyrtare të DAP-it (“*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizje paralele*” dhe “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për lëvizje paralele*”).
- **Sipas** dokumentacionit të administruar, “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizje paralele*” janë kualifikuar **10** kandidatë, ndërsa sipas aktit “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për lëvizje paralele*”, janë kualifikuar **13** kandidatë për të vijuar konkurrimin, duke përcaktuar edhe datën dhe orën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.
- **Sa** i takon fazës së intervistës së strukturuar me gojë, kandidatëve pjesëmarrës i është vënë në dispozicion “*Deklarata për regjistrimin e intervistës së strukturuar me gojë*”, të cilën e kanë nënshkruar duke zgjedhur alternativën nuk pranon ose pranon të regjistrohet intervista. Gjithashtu, rezulton se, teza me pyetjet për intervistën e strukturuar është brenda fushës së përcaktuar në shpallje, si dhe gjatë zhvillimit të konkurrimit nuk janë kostatuar problematika.
- **Vlerësimi** i kandidatëve është kryer nga Komisioni i Brendshëm, në bazë të përcaktimeve të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pikave 12 - 18/1, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.
- **Komisioni** i Brendshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore, ka pasur në përbërje të tij 3 anëtarë:
 - a. 1 përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, kur është e mundur, i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet;

- b. eprorin direkt;
- c. 1 përfaqësues nga DAP-i.

- Në përfundim të procedurës së konkurrimit, Komisioni i Brendshëm ka bërë vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin e

dorëzuar dhe intervistën e strukturuar me gojë, për secilën procedurë, duke publikuar *emrin e fituesit*, në faqen e internetit të DAP. Më pas, njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e emërimit për secilin fitues.

✓ Procedura e ndjekur gjatë fazës së konkurrimit “Pranimi në shërbimin civil” për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive

Nga analiza e të dhënave të mbledhura, rezulton se, **12** pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive, me emërtesën “*Specialist*”, janë plotësuar në fazën e *pranimit në shërbimin civil*, nëpërmjet **4** procedurave të konkurrimit.

- Në të gjitha rastet është bërë verifikimi paraprak nga DAP, nëse kandidatët i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit, duke u publikuar në faqen zyrtare të DAP-it.

Sipas dokumentacionit të administruar, “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për pranim në shërbimin civil*” rezulton se, janë

kualifikuar **141** kandidatë, ndërsa sipas aktit “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për pranim në shërbimin civil*”, rezulton se, janë kualifikuar **156** kandidatë për të vijuar konkurrimin. Në këtë akt është përcaktuar data dhe ora e zhvillimit të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Grupi i punës ka qenë prezent në të dyja fazat e testimit, të zhvilluara për këto procedura konkurrimi, në të cilat nuk janë kostatuar problematika.

Nga verifikimi i veprimeve të kryera nga njësia përgjegjëse DAP, gjatë zhvillimit të këtyre procedurave, rezultoi si më poshtë:

- Në të gjitha rastet, ka bërë shpalljen e procedurës së pranimit në Faqen Zyrtare të DAP, duke përcaktuar pozicionet e lira të punës, për të cilët do të zhvillohet konkurrimi; përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit në shërbimin civil (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet; datën për paraqitjen

e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim.

- DAP, ka krijuar Komitetin e Përhershëm të Pranimit në kategorinë ekzekutive (KPP). Në të gjitha rastet ky organ ka në përbërjen

e vet 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson KPP-në, 2 (dy) anëtarë nga nëpunësit civilë të institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e kategorisë së mesme drejtuese, i përcaktuar sipas specifikës së Komitetit, të përzgjedhur nga DAP dhe 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.

- **Pas** verifikimit paraprak dhe më pas verifikimit përfundimtar nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar **është shpallur** në Faqen Zyrtare të DAP.
- **Kandidatët** e kualifikuar, **i janë nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë**. Rezulton që nga konkurrentët, **është nënshkruar** deklarata e pranimit ose jo, të regjistrimit me zë të intervistës me gojë.

Grupi i punës konstatoi se, përsa i përket intervistës së strukturuar me gojë në procedurën e konkurrimit, të shpallur me kod #6196, e cila ishte parashikuar që të zhvillohej në datën 2.7.2024, ora 10:00, sipas “*Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për pranim në shërbimin civil*”, në fund të faqes, në këtë rubrikë është njoftuar se, për arsye objektive intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet më datë 5.7.2024, ora 10:00, në ambientet e Departamentit të Administratës Publike, Bulevardi "Zogu I", Tiranë.

Në lidhje me sa më sipër, njësia përgjegjëse, duhet të ketë në vëmendje që, njoftimet të cilat lidhen me procedurën e konkurrimit, të publikohen në vend sa më të dukshëm, me qëllim që të gjithë konkurrentët, të kenë mundësi të njihen me përmbajtjen e tyre, për të mos humbur afatet e publikuara në fazat e konkurrimit.

- **Anëtarët** e KPP, në të gjitha rastet, **kanë nënshkruar** deklaratën e paanësisë, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.
- **Në** përfundim të vlerësimit, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, **ka hartuar raportin** për rezultatin e procedurës pranim në shërbimin civil duke renditur kandidatët pjesmarrës në konkurrim (*në rastet kur ka patur më tepër se 1 konkurrent*) sipas pikëve të grumbulluara, duke filluar nga kandidati me rezultate më të larta.
- **KPP ka përmbyllur** procedurën e konkurrimit me vendimin për shpalljen e fituesit, duke njoftuar njësinë përgjegjëse për këtë rezultat.
- **Pasi** është shpallur lista e fituesve, në Faqen Zyrtare të DAP, njësia përgjegjëse, **ka nxjerrë aktin e emërimit**, duke i deklaruar “*nëpunës civilë në periudhë prove*”, në pozicionet e zgjedhura në përfundim të procedurës së konkurrimit.

🔗 Menaxhimi i listës së kandidatëve fitues, nga njësia përgjegjëse

Ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka përcaktuar që në rastet kur, për një konkurrim janë shpallur më shumë fitues se sa pozicionet vakante për të cilat është

zhvilluar procedura e hapur e konkurrimit, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 23, pika 3, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe pikës 18, të kreut IV, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i rendit kandidatët fitues, të cilët nuk janë emëruar për shkak të mungesës së vendeve vakante, në një listë me vlefshmëri 2- vjeçare. Nëse gjatë kësaj periudhe njësia përgjegjëse zhvillon një procedurë konkurrimi për të njëjtin grup pozicionesh, kandidatët fitues, të paemëruar ende, rirenditen në listën fituese të konkurrimit përkatës sipas rezultatit përfundimtar.

Grupi i punës, konstatoi se, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të kategorisë ekzekutive, kanë rezultuar fitues **4** konkurrentë më tepër se pozicione vakante, të cilët, njësia përgjegjëse DAP, i ka regjistruar në listën e pritjes, duke vepruar në përputhje me ligjin në këtë rast.

B. Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë për pozicionet e kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, (*lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*), janë të parashikuara në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, edhe për këtë procedurë plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, e nëse me anën e kësaj procedure pozicionet e lira nuk plotësohen, atëherë vijon procedura për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, me procedurën konkurruese ngritje në detyrë.

Në kuadër të këtij procesi, në zbatim të programit të mbikëqyrjes miratuar me nr. 73/1 prot., datë 24.1.2024, anëtarë të grupit të mbikëqyrjes, kanë qenë të pranishëm (*në fazën e intervistës së strukturuar me gojë si dhe fazën e testimit me shkrim*), në **4** procedura konkurrimi lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, për plotësimin e **5** pozicioneve të punës, në këtë këtë kategori, evidentuar si më poshtë:

1. “*Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit*”, në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit - klasa e pagës III-1, publikuar në shpalljen me kod #6182.
2. “*Përgjegjës i Sektorit të Dinamikës Detare*”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare, në Shërbimin
3. “*Inspektor (KSHF)*”, në Sektorin e Kontrollit Shtetëror të Flamurit, në Drejtorinë (Autoriteti Shtetëror) e Sigurisë Detare dhe Administrimit & Kontrollit të Flamurit, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare -
- Gjeologjik Shqiptar- Klasa e pagës III-2, publikuar në shpalljen me kod #6040.

- Kategoria: III-b, publikuar në shpalljen me kod #6084.
4. *“Inspektor (KSHP Vlorë)”*, në Sektorin e Kontrollit Shtetëror Portual, në Kapiteneritë e Porteve & Kontrollit Shtetëror Portual, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare-kategoria: III-b, publikuar në shpalljen me kod #6084.
5. *“Drejtore i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe*

Harmonizimit të Kuadrit Rregullator”, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - Klasa e pagës II-1, publikuar në shpalljen me kod #6323.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara, për këto procedura konkurrimi, rezulton se, këto 5 pozicione pune që i përkasin kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesme drejtuese, janë plotësuar nëpërmjet procedurës “*Ngritje në Detyrë*”.

Tabela nr.6.3 Të dhënat numerike për kandidatët pjesëmarrës në dy fazat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues

Lëvizja paralele				Ngritje në detyrë/Pranim në shërbimin civil			
Pozicione të lira	Kandidatë			Pozicione të lira nga faza e parë	Kandidatë		
	Të kualifikuar gjatë verifikimit paraprak	Të kualifikuar nga verifikimi përfundimtar	Fites		Të kualifikuar gjatë verifikimit paraprak	Të kualifikuar nga verifikimi përfundimtar	Fites
1	1	1	0	1	4	4	1
1	0	0	0	1	5	5	1
2	0	0	0	2	6	7	4
1	1	1	0	1	1	1	1

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, për këto pozicione, njësia përgjegjëse, është kujdesur për të përmbushur rregullat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese*”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, duke vepruar si më poshtë:

- Njësia përgjegjëse, ka publikuar shpalljen e procedurës për vendet vakante, fillimisht nëpërmjet lëvizjes paralele dhe më pas, nëpërmjet ngritjes në detyrë, në faqen zyrtare të

DAP-it, duke përcaktuar pozicionet e lira të punës, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi; përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës, si dhe kushtet dhe kriteret e veçanta

që duhet të plotësojë kandidati për ngritjen në detyrë;

Gjithashtu, në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, në të gjitha rastet, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 5, të kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, siç janë:

- a. pozicioni i punës që është vakant (*emërtesa e pozicionit sipas strukturës dhe organikës në fuqi*);
 - b. përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
 - c. kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët;
 - d. dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
 - e. afati i dorëzimit që është i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
 - f. data e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së ngritjes në detyrë dhe të përmbushjes së kriterëve të veçanta të vendit të punës;
 - g. fushën e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen;
 - h. mënyra e vlerësimit të kandidatëve;
 - i. mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.
- **Njësia** përgjegjëse ka krijuar Komitetin e Pranimit për Lëvizje Paralele dhe Komitetin e Pranimit për Ngritjen në Detyrë, sipas viteve që është zhvilluar procedura, në përbërje të të cilit janë: për KPLP - përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore, eprori direkt i pozicionit të shpallur dhe një anëtar i DAP-it,
 - ndërsa për KPND - 2 punonjës të institucionit, një anëtar i DAP-it; dy ekspertë, të jashtëm sipas fushës së vlerësimit;
 - **Pas** verifikimit paraprak dhe më pas verifikimit përfundimtar, nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar (*për secilën fazë më vete*), **është shpallur** në faqen zyrtare të DAP-it;
 - **Konkurrimi** për procedurën e ngritjes në detyrë, sipas pikës 21, të kreut III, ka kaluar në dy faza:
 - a. Verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, sipas përcaktimeve të pikës 22 dhe 26, të Kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, nga njësia përgjegjëse;
 - b. Vlerësimin e kandidatëve, nga Komiteti përkatës.
 - **Kandidatët** e kualifikuar, **i janë nënshtruar intervistës së strukturuar me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit** (dosjes personale), në lëvizjen paralele dhe në procedurën ngritje në detyrë, testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.
- Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, për këto pozicione të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, konstatohet se **janë përmbushur rregullat** e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Më tej, u verifikua respektimi i afateve ligjore të parashikuara në pikën 4 dhe 6, të kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015. Në këto dispozita është përcaktuar se, shpallja e procedurës për ngritjen në detyrë, publikohet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e vlerësimit dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit nuk duhet të jetë

më i vogël se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes. Në lidhje me sa më sipër, grupi i punës konstatoi se **këto afate janë respektuar**.

- Në përfundim të vlerësimit, Komiteti i **ka komunikuar** vendimin e përzgjedhjes njësisë përgjegjëse, e cila, **e ka shpallur fituesin** në portalin *e DAP-it* dhe më pas, **ka nxjerrë aktin e emërimit**, në pozicionin përkatës.

Sa i takon **fazës së lëvizjes paralele**, sipas dokumentacionit të administruar, *“Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraparak për lëvizje paralele”* dhe *“Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për lëvizje paralele”*, rezulton se, janë kualifikuar **2** kandidatë për të vijuar konkurrimin, duke përcaktuar edhe datën dhe orën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

Në përfundim, KPLP, **ka hartuar** raportin përfundimtar dhe **ka njoftuar** njësinë përgjegjëse për rezultatin. Në rastin konkret, konkurrentët **janë njoftuar** për rezultatin e arritur. Njësia Përgjegjëse, pas mbarimit të afatit 5 ditor, të ankimit nga kandidatët për rezultatin e vlerësimit (*pika 22, Kreu IV, e VKM nr.243, datë 18.3.2015*), **ka publikuar** shpalljen se kjo **fazë ka përfunduar pa fitues**.

Në lidhje me **fazën e ngritjes në detyrë**, nga analiza e të dhënave të administruara, rezulton se, këto pozicione pune që i përkasin kategorisë të ulët dhe të mesme drejtuese, (**5** pozicione) janë plotësuar nëpërmjet procedurës ngritje në detyrë.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, kandidatët që kanë aplikuar për procedurën e ngritjes në detyrë, **i plotësojnë kushtet** minimale dhe kërkesat e veçanta sipas shpalljes për konkurrim, të përcaktuara në pikën 2, të Kreut III, të aktit nënligjor, si më poshtë:

- **Janë** nëpunës civilë të konfirmuar, me kategori page sipas përcaktimit në shpallje, e vërtetuar në të gjitha rastet me aktet përkatëse të konfirmimit të statusit nga institucionet ku ata kryenin detyrën.
- **Nuk** kanë masë disiplinore në fuqi, të vërtetuar me akt zyrtar nga institucioni ku kryejnë detyrën.
- **Vlerësimet** e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim, janë në nivelin *“Mirë”* ose *“Shumë mirë”*.
- **Plotësojnë** kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, siç janë lloji dhe niveli i diplomës, eksperiencia në vite në fushën përkatëse.
- **Nga** verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se, për procedurat e konkurimit për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët, e të

mesme drejtuese, KPND është ngritur konform ligjit.

- **Për** procedurat e realizuara, rezulton se, lista me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës **është shpallur** në faqen zyrtare të DAP.
- **Sipas** dokumentacionit të administruar, akti *“Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për ngritje në detyrë”* janë kualifikuar **16** kandidatë dhe më pas sipas aktit

“Njoftim mbi rezultatet e verifikimit për ngritje në detyrë”, janë kualifikuar **17** kandidatë për të vijuar konkurrimin, duke përcaktuar datën dhe orën e zhvillimit të testimit me shkrim dhe të intervistës së strukturuar me gojë.

- **Grupi** i punës, ka marrë pjesë gjatë kryerjes së fazës së testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, në të cilat nuk janë konstatuar problematika.

Në lidhje me vlerësimin e kandidatëve nga KPND, nga verifikimi rezulton se është vepruar në këtë mënyrë:

- Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPND, **kanë përgatitur** testet përkatëse;
- Për intervistën e strukturuar me gojë, **janë hartuar** pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët.
- KPND, **ka zhvilluar intervistën me gojë** me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, sipas udhëzimit të DAP.
- Në të gjitha rastet, kandidatët **kanë nënshkruar** deklaratat e pranimit ose mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.
- Anëtarët e KPND, në të gjitha rastet, **kanë nënshkruar** deklaratën e paanësisë, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.
- Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPND **ka hartuar** raportin përfundimtar për rezultatin e konkurrimit.
- Njësia e burimeve njerëzore, duke respektuar afatet që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, **ka shpallur** fituesit në faqen zyrtare të DAP.
- Në përfundim të procedurave të konkurrimit për ngritje në detyrë për të plotësuar pozicionet e lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, njësia përgjegjëse **ka nxjerrë** aktet e emërimit për kandidatët fitues.

3. Pranimi i drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND)

Në nenin 28, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar përcaktohet se, pranimi në trupën e nivelit të lartë drejtues (TND) mund të bëhet vetëm nga personat të cilët kanë përfunduar formimin e thelluar në Shkollën Shqiptare të Administratës

Publike. Përzgjedhja e nëpunësve në programin e formimit të thelluar për TND, bëhet nëpërmjet një konkursi kombëtar, të organizuar nga njësi përgjegjëse, ku kanë të drejtën të marrin pjesë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, si dhe çdo individ tjetër, që nuk është pjesë e shërbimit civil, por plotëson kërkesat specifike për pranimin në TND.

Më tej, në nenin 29, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se, pranimi në trupën e nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një konkursi kombëtar, e cila në zbatim të pikës 2, kreu V, të vendimit 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”*, i ndryshuar, mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

Rezulton se, bazuar në vendimin nr. 63, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave *“Për hapjen e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2024”*, Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurën e pranimi të drejtpërdrejtë në TND për plotësimin përmes procedurave të konkurrimit 4 pozicione të nivelit të lartë drejtues (TND), për vitin 2024, procedurë e cila është shpallur në muajin gusht, të vitit 2024.

Më vendimin nr. 527, datë 1.8.2024, të Këshillit të Ministrave, *“Për një ndryshim në vendimin nr. 63, datë 7.2.2024, të këshillit të ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimi të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2024”*”, ka ndryshuar numri i pozicioneve të punës që do të plotësohen nëpërmjet pranimi të nëpunësve në trupën e nivelit të lartë drejtues, nga **6** në **10** pozicione.

Nëpërmjet këtij akti nënligjor është vendosur se, procedura e pranimi në trupën e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues (TND), do të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe se kjo procedurë do të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kërkesat specifike për pranim në TND. Njëkohësisht, në përmbajtje të këtij akti përcaktohet se, procedura e drejtpërdrejtë e pranimi do të përdoret për **10** pozicione pune TND.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka publikuar shpalljen për të organizuar procesin e konkurrimit për plotësimin e **4** pozicioneve në trupën e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues (TND), nëpërmjet procedurës së konkurrimit kombëtar, të shpallur në gusht të vitit 2024, në përfundim të të cilit, janë arritur rezultatet si më poshtë:

Tabela nr.6.4 Të dhëna për procedurën e konkurrimit për TND

Pozicione që duhet të plotësohen në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND)	Pozicione të shpallura për plotësimin e trupës së nivelit të lartë drejtues (TND)	Kandidatë të kualifikuar nga verifikimi paraprak	Kandidatë të kualifikuar nga lista përfundimtare (pas ankesës)	Kandidatë të shpallur fitues nga KKP (me mbi 70 pikë)	Vende të TND të mbetur pa plotësuar, sipas planit të rekrutimit 2024
10	4	8	8	4	6

Nga monitorimi i procedurës së konkurrimit të shpallur në portalin e Departamentit të Administratës Publike, konstatohet se, njësia përgjegjëse ka zbatuar procedurat e përcaktuara në nenin 27, 29, 30 dhe 31, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në vendimin nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”*, i ndryshuar, në lidhje me:

- publikimin e aktit të shpalljes për plotësimin e pozicioneve të nivelit të lartë drejtues, duke pasqyruar në të elementët dhe të dhënat e nevojshme në lidhje me përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës, kriteret e përgjithshme, kërkesat specifike të pranimin, si dhe kushtet dhe kërkesat e veçanta, aftësitë, njohuritë e cilësitë, që kandidatët duhet të zotërojnë për të aplikuar në konkursin për pranim në trupën e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues (TND);
- publikimin e listës paraprake dhe listës përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar për të vijuar më tej me fazën e dytë të konkurrimit, vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë;
- publikimin e listës paraprake dhe listës përfundimtare të kandidatëve të shpallur fitues në përfundim të procedurës së vlerësimit me pikë, duke garantuar të drejtën e ankimit, për kandidatët të cilët nuk janë shpallur fitues.

4. Trajtimi i informacioneve të administruara pranë Komisionerit, në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të konkurremeve të zhvilluara nga DAP, për vitin 2024.

Në kuadër të mbikëqyrjes së administrimit të procesit të konkurremeve, Komisioneri ka trajtuar edhe **10** informacione të ardhura në adresë të tij, nga nëpunës apo kandidatë që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit të organizuara nga njësia përgjegjëse (DAP), për vitin 2024, për të cilat janë pretenduar se janë kryer apo lejuar parregullsi gjatë zhvillimit të tyre.

Në vijim të materialit, do të trajtohen informacionet e ardhura, që janë trajtuar në kuadër të këtij procesi, si dhe qëndrimi i mbajtur nga Komisioneri në secilin rast.

✓ **Verifikimi i procedurës së skualifikimit në fazën e verifikimit paraprak të kërkuases A. A., për shkak të mungesës së dokumentacionit të dorëzuar**

Komisioneri është njohur me përmbajtjen e informacionit të dërguar nga kandidatja A. A., pjesëmarrëse në procedurën e konkurrimit të shpallur me kod #6027, *“Shpallje për lëvizje paralele, pranin nga jashtë shërbimit civil”*, në kategorinë ekzekutive, lloji i diplomës *“Arsim i lartë”*, niveli i diplomës *“Master Shkencor”*, në të cilin pretendohet se, kjo kandidate është skualifikuar nga procedura e konkurrimit për lëvizje paralele, për mungesë të dorëzimit të dokumentave:

- Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
- Faqja e parë e librezës së punës.

Në lidhje me këtë pretendim, kandidatja ka dërguar e-mail edhe pranë njësisë përgjegjëse DAP, duke ushtruar të drejtën e ankimit, për skualifikim nga procedura e konkurrimit. Në këto kushte, Komisioneri, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, e ndryshuar, ka kërkuar nga DAP, dokumentacionin e plotë provues, për verifikimin e informacionit.

Nga përmbajtja e dokumentacionit ka rezultuar se, në zbatim të pikave 6 dhe 7, të kreut VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, në përfundim të afateve të përcaktuara për verifikimin paraprak të kandidatëve, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka bërë verifikimin e kandidatëve që përmbushin kushtet për lëvizje paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrimin me kod #6027, për pozicionin e punës *“Specialist, në Sektorin CEN dhe ISO”*, në Drejtorinë e Standarteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Standartizimit, klasa e pagës IV-2.

Në përfundim të këtij procesi, A. A. është skualifikuar në fazën e verifikimit paraprak, për mungesë të dokumentacionit të evidentuar si më poshtë:

- Mungesë e aktit të deklarimit të statusit të punësimit;
- Fotokopja e librezës së punës nuk ka qenë e plotë, pasi ka munguar faqja e parë, nga e cila duhet të vërtetohen gjeneralitetet.

Gjithashtu, në sistemin *“online”* të rekrutimit, në dosjen elektronike të A. A., dokumentacioni nuk ka rezultuar i plotë.

Në përputhje me pikën 10, të kreut VII, të VKM-së nr.243 datë 18.3.2015, ku parashikohet procedura e ankimit, kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda

3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, kanë të drejtë të paraqesin ankesat me shkrim në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit që ka vendin vakant. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Nga komunikimi me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit rezulton se, kandidatja ka paraqitur ankesë dhe në përfundim të afateve të shqyrtimit të ankesës, njësia e burimeve njerëzore, ka vendosur të kualifikojë kandidaten A. A., për të vijuar procedurën e konkurrimit për fazën e lëvizjes paralele.

Në këto rrethana, rasti në fjalë është trajtuar dhe zgjidhur në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil dhe për pasojë ka rënë objekti për të vijuar më tej hetimin administrativ. Për këtë arsye, është vendosur përfundimi i hetimit administrativ dhe arkivimi i rastit.

✓ **Verifikimi i skualifikimit në fazën e verifikimit paraprak për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor, të kërkuesit M. Gj.**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nëpërmjet shkresës nr. 219 prot., datë 19.3.2024 ka administruar informacionin e dërguar nga nëpunësi M. Gj., emëruar në pozicionin *“Specialist”*, në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në të cilin ngrihen pretendime për skualifikim të padrejtë në fazën e verifikimit paraprak, nga DAP, në procedurën e konkurrimit të zhvilluar me kod #6040, *“Shpallje për lëvizje paralele, ngrije në detyrë, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”*, për plotësimin e pozicionit *“Përgjegjës i Sektorit të Dinamikës Detare”*, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare, në këtë institucion.

Sa më lart, nëpunësi pretendon se, skualifikimi nga procedura e konkurrimit me kod #6040, në fazën e verifikimit paraprak për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor, është i padrejtë, pasi referuar përshkrimit të punës për pozicionin, si kriter arsimor për plotësimin e tij, nuk kërkohet që diploma *“Bachelor”* dhe *“Master Shkencor”*, të jenë në të njëjtën fushë, por përcaktohet se, diploma e nivelit *“Master Shkencor/Profesional”* ose ajo e nivelit *“Bachelor”* duhet të jenë në njërin nga fushat Gjeologji, Gjeologji Naftë, Mjedis, Gjeomatikë ose Topo-Gjeodezi. Në këtë rast, nëpunësi pretendon se, janë shkelur parimet e shërbimit civil, të sanksionuara në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Për sqarimin e pretendimeve të mësipërme, Komisioneri, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, ku ka kërkuar të gjithë dokumentacionin shkresor për procedurën e konkurrimit të zhvilluar me kod #6040 *“Shpallje për lëvizje paralele, ngrije në detyrë në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”*, për pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Dinamikës Detare”*, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, referuar pikës 2.1 të shpalljes me kod #6040 përcaktohet se, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit “*Master Shkencor*” apo “*Master Profesional*” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Gjeologji/Gjeologji Nafte/Mjedis/Gjeomatikë/Topo-
Gjeodezi. Edhe diploma e nivelit “*Bachelor*” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b. Të kenë të paktën 2 vite përvojë pune në profesion;
- c. Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

Nga dokumentacioni i ngarkuar në dosjen elektronike të kandidatit, doëzuar pranë DAP, rezulton se, ai zotëron diplomë të nivelit “*Bachelor*” në degën “*Marrëdhënie Ndërkombëtare*” dhe diplomë të nivelit “*Master Shkencor*” në degën “*Menaxhim Mjedisor Urban*”, të cilat nuk janë në të njëjtën fushë sikurse parashikohet në shpallje.

Në vijim të procedurës, bazuar në pikën 22, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të ndryshuar, njësia përgjegjëse DAP, ka kryer verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të cilat janë të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Pas verifikimit paraprak të informacionit të dorëzuar nga kandidati M. Gj., ka vendosur skualifikimin për këtë procedurë konkurrimi, duke arsyetuar se: Diploma “*Bachelor*” dhe “*Master Shkencor*” nuk janë në të njëjtën fushë.

Për më tepër, kërkesat për përcaktimin e kriterit arsimor në shpalljen për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Dinamikës Detare*”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, janë përcjellë pranë DAP nga institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, me shkresën nr. 134 prot., datë 29.1.2024.

Sa më lart, referuar dokumentacionit të administruar për procedurën e konkurimit me kod #6040, të evidentuar në këtë rast, rezulton se, nga ana e njësisë përgjegjëse DAP janë respektuar të gjitha kërkesat ligjore dhe nënligjore të parashikuara në nenin 26, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar.

Në kushtet kur nuk janë konstatuar parregullsi në administrimin e shërbimit civil, bazuar në dispozitat e sipërpërmendura, si dhe në nenin 16, pika 6, të Rregullores “*Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, hetimi administrativ i këtij rasti ka përfunduar dhe çështja është arkivuar.

✍ **Kërkesë për verifikimin e pezullimit të konkurimit me kod #5929” dhe vendosjen e fitueses A. O. në listë pritje**

Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 263 prot., datë 16.4.2024, ka administruar informacionin e dërguar nga kandidatja A. O. në të cilën ngrihen pretendime se, DAP nuk ka vepruar drejt, në rastin kur, me akt të ndërmjetëm, ka vendosur pezullimin e

procedurës së konkurrimit për pozicionin nr. 3, “*Specialist në Sektorin e Hartimit, Harmonizimit dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore*”, në Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kategoria III-b, të shpallur më kod #5929; lloji i diplomës “*Shkenca Juridike*”; niveli minimal i diplomës “*Master Shkencor*”, duke e vendosur kandidaten fituese për këtë pozicion A. O. në listë pritje.

Për verifikimin e pretendimeve të ngritura nga kandidatja në fjalë, grupi i mbikëqyrjes, ka administruar dokumentacionin e plotë në të cilin materializohet qëndrimi i mbajtur nga njësia përgjegjëse, në rastin e pezullimit për plotësimin e pozicionit të punës në fjalë.

Referuar përmbajtjes së dokumentacionit rezulton se, pranë DAP, me shkresën nr. 902 prot., datë 15.2.2024, “*Për pezullimin e procedurës së konkurrimit për pozicionin Specialist Jurist*”, të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucioni ka kërkuar pezullimin e procesit për plotësimin e këtij pozicioni të shpallur për t’u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pasi në zbatim të Urdhrit nr. 14, datë 25.1.2024, të Kryeministrit, është miratuar struktura e re për institucionin, në të cilën ka suprimim të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.

Në vijim, mbështetur në kërkesën e paraqitur, njësia përgjegjëse DAP, me Vendimin nr. 6 (nr.1105/1 prot.), datë 22.2.2024, ka vendosur të pezullojë këtë procedurë rekrutimi, duke e njoftuar për këtë vendim me shkresën nr.1654/2 prot., datë 9.4.2024, kandidaten fituese A. O., e cila me deklaratën e nënshkruar më parë, në datën 21.3.2024, ka pranuar të qëndrojë në listë pritje.

Më tej, pas veprimeve të ndërmarra nga ana e Komisionerit rezulton se, në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe pikës 19, kreu IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, e ndryshuar, njësia përgjegjëse DAP, me shkresën nr.1864 prot., datë 4.4.2024, “*Emërim*”, e ka emëruar kandidaten fituese A. O., si “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin “*Specialist (Jurist)*”, në Drejtorinë e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në një institucion tjetër që është pjesë e shërbimit civil, e konkretisht, në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, pozicion për të cilin kandidatja A. O. ka shprehur dakordësinë.

Në këto rrethana, Komisioneri ka vlerësuar se, rasti në fjalë është trajtuar dhe zgjidhur në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil dhe në kushtet kur ka rënë objekti për të vijuar më tej hetimin administrativ, është arkivuar rasti.

✍ **Kërkesë për verifikimin e procedurës së ndjekur për vlerësimin e jetëshkrimit, nga njësia përgjegjëse, në fazën e pranimi në shërbimin civil, për kandidatin G. Xh.**

Përmes shkresës me nr. 296 prot., datë 2.5.2024, pranë Komisionerit është administruar informacioni i dërguar nga kandidati G. Xh., pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit me kod #6021, shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, lloji diplomës “*Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Natyrore/Shkenca Inxhinerike*”, niveli

minimal i diplomës “*Master Profesional*”, të shpallur nga Departamenti i Administratës Publike, në të cilën ngrihen pretendime se, njësia përgjegjëse, nuk ka vlerësuar objektivisht jetëshkrimin e kandidatit, ankesë të cilën e ka paraqitur edhe pranë DAP.

Në përmbajtjen të informacionit dhe dokumentacionit, ka rezultuar se kandidati, ka qenë pjesëmarrës në dy procedura konkurrimi, me kod #4749 dhe kod #6021, shpallur nga DAP, ku në të dy këto procedura kriteret e posaçme që duhet të plotësonin kandidatët për fazën e pranimi në shërbimin civil kanë qenë të njëjta, sa i takon arsimit dhe eksperiencës në punë. Mirëpo, rezulton se, konkurrenti është vlerësuar me nivel pikësh të ndryshëm për jetëshkrimin, pavarësisht faktit se, dokumentacioni i dorëzuar nga ai, në të dy procedurat ka qenë i njëjtë.

Për verifikimin paraprak të informacionit, Komisioneri ka kërkuar pranë njësisë përgjegjëse DAP, me shkresën nr. 296/1 prot., datë 7.6.2024, dokumentacionin e plotë të administruar në procedurën e konkurrimit me kod #6021, për kandidatin G. Xh.

Më tej, kandidati G. Xh., me e-mailin e datës 16.5.2024, ka vënë në dijeni Komisionerin, se është njoftuar nga ana e DAP, se është në listën e kandidatëve fitues për procedurën e konkurrimit me kod #6021.

Gjithashtu, DAP me e-mailin e datës 3.6.2024 ka sqaruar Komisionerin se, kandidati G. Xh. ka qenë pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit me kod #6021. Në këtë procedurë ai është shpallur fitues dhe në zbatim të pikës 17, të kreut IV, të VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, në datën 15.5.2024 është paraqitur pranë DAP për të nënshkruar deklaratat e fituesit, ku ka pranuar të qëndrojë në listë pritje për dy vite.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar, evidentuar sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se, rasti në fjalë është trajtuar dhe zgjidhur në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, e për këtë arsye çështja arkivohet.

➤ **Verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së vlerësimit të ndjekur nga KPP, në fazën e pranimi në shërbimin civil, me kërkuar M. L.**

Përmes e-mailit zyrtar, në datën 14.5.2024, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është njohur me përmbajtjen e informacionit të dërguar nga kandidati M. L., pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit të shpallur me kod #6045, “*Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil*”, në kategorinë ekzekutive, lloji i diplomës “*Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike/Shkenca Natyrore/Shkenca Inxhinierike*”, niveli i diplomës “*Bachelor*”, në të cilin pretendohet se, ky kandidat nuk është vlerësuar objektivisht nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi, në fazën e pranimi në shërbimin civil.

Në përmbajtje të dokumentacionit të plotë të administruar në dosjen e konkurrimit, shpallur me kod #6045, rezulton se, pas ankesës së kandidatit M. L., drejtuar DAP me shkresën nr. 2426 prot., datë 10.5.2024, KPP ka marrë në shqyrtim kërkesën e këtij

kandidati, duke kryer edhe një herë procesin e vlerësimit të jetëshkrimi dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Lidhur me pretendimet që kandidati ka ngritur në ankesën e tij, përsa i takon vlerësimit të jetëshkrimit dhe vlerësimit të intervistës së strukturuar me gojë, është konstatuar se:

1. Vlerësimi i jetëshkrimit: KPP e ka vlerësuar kandidatin me 3 pikë nga 15 pikë të mundshme, të ndara si më poshtë:

- a. Në lidhje me përvojën në punë, kandidati është vlerësuar 1 pikë nga 5 pikë të mundshme, për shkak të mungesës së përvojë shtesë në punë, në fushën e kërkuar.
- b. Në lidhje me trajnimet/kualifikimet, është vlerësuar 1 pikë nga 5 pikë të mundshme, për shkak se nuk ka trajnime/kualifikime shtesë të lidhura me fushën.
- c. Në lidhje me arsimin, është vlerësuar me 1 pikë nga 5 pikë të mundshme, pasi kandidati nuk ka kryer arsim shtesë të papërfunduar/përfunduar/ apo gradë arsimore. Pas vlerësimit të parë, kandidati ka shtuar në sistem, në profilin e tij, vërtetim

për ndjekjen e studimeve “*Master Shkencor*”, e Drejtë Civile, lëshuar nga fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në këto kushte, KPP pas rivlerësimit të arsimit të kandidatit, ka vendosur ta vlerësojë atë 2 pikë nga 5 pikë të mundshme.

Pas shqyrtimit të ankimit, për fazën e vlerësimit të jetëshkrimit, kandidati është vlerësuar me 4 pikë nga 15 pikë të mundshme.

2. Vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë: KPP ka vendosur që kandidati të vlerësohet me 12 pikë nga 25 pikë të mundshme.

Pas ankesës së paraqitur, nisur nga fakti se, kandidati ka zgjedhur që intervista të regjistrohet, KPP ka ridëgjuar përgjigjet e dhëna prej tij, për secilën pyetje, duke vendosur të njëjtin vlerësim, 12 pikë.

Në mbështetje të dokumentacionit të evidentuar sa më lart, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse dhe KPP, në rastin në fjalë ka vepruar në përputhje me kërkesat e pikës 7, 8 dhe 9 të kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, duke rivlerësuar procesin pas ankimit të kandidatit. Duke e vlerësuar këtë veprim në përputhje me pikën 22, të kreut IV, të aktit nënligjor të sipërpërmendur, Komisioneri ka përfunduar hetimin administrativ dhe e ka arkivuar rastin.

🔴 **Verifikimi i procedurës së vlerësimit në fazën e lëvizjes paralele, në procedurën e konkurrimit me kod #6205, për konkurrentin B. Gj.**

Nëpërmjet shkresës nr. 390 prot., datë 18.6.2024 është administruar informacioni i dërguar nga kandidatja B. G., në të cilën ngrihen pretendime për vlerësim të padrejtë në fazën e lëvizjes paralele, në procedurën e konkurrimit me kod #6205, “*Shpallje për lëvizje paralele, pranimit në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, për plotësimin

pozicioneve “*Specialist në Sektorin e Administrimit të Shërbimit Spitalor*” dhe “*Specialist në Sektorin e Politikave dhe Zhvillimit të Shërbimit Spitalor*”, Drejtoria e Politikave të Shërbimit Spitalor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Shëndetësinë, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të shpallur nga DAP.

Referuar përmbajtjes së informacionit, kandidatja parashtron se, vlerësimi nga Komiteti i Brendshëm për Lëvizje Paralele, për pjesëmarrjen në procedurën e konkurrimit me kod #6205, të shpallur nga DAP, është i padrejtë dhe jo objektiv.

Gjithashtu, pretendohet se nga ana e njësies përgjegjëse nuk është respektuar pika 18/1, e kreut VII, “*Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive*”, e parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.3.2015, pasi nuk është njoftuar kandidatja për rezultatin e konkurrimit, duke i cënauar të drejtën e ankimit.

Me qëllim verifikimin paraprak të informacionit të administruar, nëpërmjet shkresës nr.390/1 prot., datë 8.7.2024, drejtuar njësies përgjegjëse dhe shkresës nr. 309/2 prot., datë 8.7.2024, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është kërkuar nga Komisioneri praktika e plotë shkresore që materializon procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të shpallura me kod #6230, duke përfshirë edhe aktet, në të cilat është dokumentuar procedura e shqyrtimit të ankimit të kandidates B. G., për këtë procedurë konkurrimi.

Ka rezultuar se, në përfundim të procesit të rivlersimit, Komisioni i Brendshëm për Lëvizje Paralele, ka vendosur vlerësimin përfundimtar të kandidates B. G. në procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin vakant me kod: #6230, lloji i diplomës “*Shkenca Mjekësore/Shkenca*” me 67.7 pikë nga 100 pikë, (40 pikë jetëshkrimi dhe 27.7 pikë intervista e strukturuar me gojë).

Referuar dokumentacionit të administruar prej institucioneve për këtë procedurë konkurrimi, rezulton se, në datën 6.6.2024, kandidatja është njoftuar nëpërmjet e-mailit nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, për rezultatin e vlerësimit me pikë për intervistën e strukturuar me gojë. Në kushtet kur, e-maili është kthyer si adresë e parregullt, njësia e ka telefonuar në datë 14.6.2024 kandidaten, duke i ridërguar edhe një herë rezultatin e vlerësimit në adresën e re, të e-mailit.

Sa i takon pretendimeve të ngritura nga kandidatja B. G., për vlerësim jo objektiv, rezulton se pas ankesës, KBLP është mbledhur në datën 20.6.2024 për të rivlerësuar përgjigjet e dhëna nga kjo kandidate, në intervistën e strukturuar me gojë. Sipas procesverbalit të mbajtur në këtë datë, rezulton se, pas shqyrtimit të përgjigjeve, vlerësimi me pikë ka mbetur i pandryshuar me 27.7 pikë.

Lidhur me pretendimet e kandidates B. G. përse i përket vlerësimit me pikë në pyetjet e intervistës së strukturuar me gojë, sqarojmë se, Komisioni i Brendshëm për Lëvizje Paralele si organ kolegial, është i vetmi organ që vendos për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës gjatë procedurës së lëvizjes paralele, lidhur me kontrollin dhe dhënien e meritës, lidhur me aftësitë e tyre profesionale dhe veprime të tilla kanë karakter plotësisht

diskrecionar. Ky organ kolegjal është i krijuar në bazë të ligjit me përfaqësues të nivelit drejtues nga institucioni për të cilin është shpallur vendi vakant dhe prania e tyre në komision garanton cilësinë e pyetjeve dhe përgjigjeve të tyre. Po kështu, njihet edhe e drejta e ankimit në gjykatë për veprimet e tyre, në çdo fazë të konkurrimit.

Në këto kushte, vlerësohet se, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nga KBLP janë kryer të gjitha veprimet e parashikuara ligjore, për një proces të drejtë, objektiv dhe transparent, ashtu sikurse e parashikojnë dispozitat që rregullojnë këtë institut të shërbimit civil. Për këtë arsye, në kushtet kur nuk janë evidentuar parregullsi në administrimin e procesit të konkurrimit, çështja është arkivuar.

✦ **Kërkesë për verifikimin e pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë, të hartuara nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizje Paralele, me kërkues P. K.**

Nëpërmjet shkresës nr. 389 prot., datë 18.6.2024 është administruar informacioni i dërguar nga kandidati P. K., në të cilën ngrihen pretendime për vlerësim të padrejtë në fazën e lëvizjes paralele, në procedurën e konkurrimit të shpallur me kod #6230, *“Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil”*, në kategorinë ekzekutive, lloji i diplomës *“Shkenca Mjekësore/Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike”*, niveli minimal i diplomës *“Master Profesional”*, për plotësimin e pozicionit *“Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Dibër”*, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Tiranë/Durrës/Dibër, nga DAP.

Referuar përmbajtjes së informacionit, kandidati pretendon se, vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë, në fazën e lëvizjes paralele për procedurën e konkurrimit me kod #6230, nuk është i drejtë pasi pyetjet e drejtuara gjatë intervistës nuk ishin të natyrës dhe modeleve standarte, sipas udhëzimit të DAP.

Për sa më sipër, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele, Komisioneri me shkresën nr. 389 prot., datë 8.7.2024, drejtuar DAP dhe shkresën nr. 389/2 prot., datë 8.7.2024, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, i ka kërkuar dy institucioneve praktikën shkresore, si dhe dokumentacionin që materializon procedurën e konkurrimit për fazën e lëvizjes paralele, për plotësimin e pozicionit *“Specialist në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Dibër”*, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Tiranë/Durrës/Dibër.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, institucioni Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka dërguar informacionin e kërkuar duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës.

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton e provuar se, kandidati është njoftuar përmes e-mailit, rregullisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, të institucionit Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në të gjitha fazat e konkurrimit, në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP.

Sa i takon pretendimeve të konkurrentit në lidhje, me natyrën e pyetjeve të drejtuara gjatë intervistës së strukturuar me gojë, Komisioneri vlerëson se, në mbështetje të Udhëzimit nr.2, datë 27.3.2015, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, nëpërmjet konkurrimit të hapur”*, kreu III, Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele është organ kolegjal, i cili ka në diskrecion hartimin e pyetjeve të intervistës së strukturuar dhe vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit.

Përpara zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë, anëtarët e KBLP hartojnë tezën me pyetjet për intervistën e strukturuar me gojë, duke përcaktuar llojet e pyetjeve që do të drejtohen konkurrentëve gjatë kësaj faze, të cilat në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, mund të jenë të lidhura me sjelljen, me situatë hipotetike dhe me dijet (njohuritë) e konkurrentëve. Pra, janë anëtarët e KBLP të cilët vendosin se cilat pyetje do të drejtohen konkurrentëve, duke i shkruar ato në tezën e intervistës, së bashku me ndarjen në pikë për secilën prej tyre.

Në rastin konkret, KBLP ka hartuar pyetjet që lidhen me njohuritë në fushën e kërkuar të pozicionit të punës, të cilat janë përfshirë në tezën e intervistës së strukturuar me gojë.

Sa i takon ankesës së drejtuar KBLP, nga kandidati P. K., me procesverbalin e datës 20.6.2024, ky organ ka argumentuar qëndrimin e tij, duke ja dërguar për njohje përmes e-mailit edhe ankuesit P. K.

Në këto rrethana, duke qenë se nuk janë konstatuar parregullsi gjatë administrimit të procesit të konkurrimit, hetimi administrativ ka përfunduar dhe çështja është arkivuar.

✓ **Verifikimi i informacionit të dërguar nga kandidatja R. V., sa i takon përmbajtjes së pyetjeve në testimin me shkrim, të zhvilluar për shpalljen me kod #6408**

Me shkresën nr. 792 prot., datë 13.10.2024 kandidatja R. V. ka dërguar pranë Komisionerit, një informacion në të cilin ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, të shpallur me kod #6408, për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme”*, në Ministrinë e Financave.

Parregullsitë e pretenduara kanë të bëjnë me vlerësimin e padrejtë nga Komiteti i Pranimin për Ngritje në Detyrë, të testimit me shkrim dhe për këtë arsye, brenda afatit të parashikuar në pikën 35, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, konkurrentja ka paraqitur ankim pranë njësisë përgjegjëse, DAP.

Ankesa është marrë në shqyrtim nga Komiteti i Pranimin për Ngritje në Detyrë dhe në përfundim të procesit të shqyrtimit të ankimit, ky organizëm ka arritur në konkluzionin që, procedurat e zhvilluara gjatë konkurrimit dhe procesi i vlerësimit, janë kryer në përputhje me ligjin.

Në këtë rast Komisioneri sqaron se, hartimi i pyetjeve dhe vlerësimi me shkrim, janë procese në diskrecion të Komitetit të Pranimit për Ngritje në Detyrë të cilat mbështeten në pikën 9, të kreut IV, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të DAP *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”* dhe rezulton se ato janë kryer nga këto organe në zbatim të kompetencave ligjore. Në këtë rast, konkurrentit i lind e drejta e ankimit në gjykatë nëse pretendon parregullsi.

Sipas vlerësimit të Komisionerit, procedura e rekrutimit për ngritje në detyrë, me kod #6408, *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme”*, në Ministrinë e Financave, është zhvilluar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”*, të Këshillit të Ministrave, si dhe në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme e të ulët drejtuese...”* të Departamentit të Administratës Publike.

Në këtë rast, në kushtet kur ligjvënësi ka parashikuar gjykatën si organin kompetent që shqyrton ankesat e nëpunësve civilë, nëpunësi civil duhet të mbajë në vëmendje edhe nenin 41/3 *“E drejta e informimit dhe ankimit”*, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se:

“Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil”, duke u kujdesur edhe për afatet ligjore të ankimit.

Në këtë rast, në kushtet kur nuk janë konstatuar parregullsi në administrimin e procesit të konkurrimit, hetimi administrativ ka përfunduar dhe çështja është arkivuar.

✍ **Kërkesë për emërim si kandidat fitues me mbi 70 pikë, në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, në nivelin e ulët drejtues, kërkues P. H.**

Me shkresës nr. 793 prot., datë 23.10.2024, është administruar informacioni i dërguar nga kandidati P. H., me detyrë *“Specialist”*, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në cilën parashtrohet se, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë, për shpalljen #4698 –pozicioni *“Përgjegjës i Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit”*, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ai ka rezultuar fitues me 74.4 pikë. Mirëpo, njëkohësisht për këtë procedurë konkurrimi, krahas fazës së ngritjes në detyrë është zhvilluar edhe faza e pranimit nga jashtë shërbimit civil, ku në përfundim të kësaj faze, Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë ka kualifikuar si fitues, kandidatin E. A., duke e renditur të parin me 82.8 pikë.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit me kod #4698, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, pozicioni *“Përgjegjës i Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit”*, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, i është ofruar kandidatit të kualifikuar me nivelin më të lartë të pikëve. Pas emërimit në këtë pozicion, ky nëpunës ka konkurruar përmes lëvizjes paralelen në një pozicion tjetër, ku ka rezultuar fitues dhe është emëruar.

Në kushtet, kur pozicioni *“Përgjegjës i Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit”*, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ka mbetur sërish vakant, kandidati P. H., pretendon se, KPND duhet të veprojë duke e emëruar si kandidat zëvendësues.

Në lidhje me sa më sipër, konkurenti P. H., ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë DAP, por sipas tij, përgjigja e dhënë nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit për shërbimin civil, për këtë arsye, i është drejtuar Komisionerit për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e KPND dhe DAP, në këtë procedurë konkurrimi.

Komisioneri pasi është njohur informacionin e dërguar nga P. H., me shkresë zyrtare, ka kërkuar pranë DAP, dokumentacionin e administruar gjatë fazës së konkurrimit dhe ankimit, për shpalljen me kod #4698.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 793/3 prot., datë 11.11.2024 *“Mbi kërkesën për dokumentacion në lidhje me verifikimin e procedurës së konkurrimit me kod #4698 - “Përgjegjës i Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit”, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”*, ka sqaruar hollësisht për procedurën e ndjekur dhe vlerësimet e kryera gjatë procesit të konkurrimit për fazën e ngritjes në detyrë, për këtë pozicion pune, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin e nevojshëm, nga përmbajtja e të cilit ka rezultuar se:

Në bazë të planit vjetor të pranimi, si dhe të VKM-së nr. 381, datë 29.6.2023 *“Për hapjen e procedurës së pranimi në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil për vitin 2023”*, DAP ka shpallur procedurën me kod #4698, për plotësimin e pozicionit të punës *“Përgjegjës i Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit”*, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë, për plotësimin e pozicionit të punës *“Përgjegjës i Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit”*, pas përfundimit të afatit të ankimit, KPND ka përzgjedhur si fitues kandidatin që është renditur i pari, E. A. me 82.8 pikë, duke nxjerrë aktin e emërimit nr. 4823 prot., datë 25.9.2023, ndërsa kandidati P. H. është renditur pas tij, me 74.4 pikë.

Pas emërimit në këtë detyrë, E. A. ka konkurruar duke rezultuar fitues për pozicionin *“Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër”*.

Për shkak të krijimit të vakancës pas emërimit të punonjësit E. A. në pozicionin e evidentuar më sipër, me shkresën e regjistruar pranë DAP me nr. 2120 prot., datë 22.4.2024, kandidati P. H. ka kërkuar të emërohet në pozicionin e punës *“Përgjegjës i*

Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit”, si kandidat zëvendësues, kërkesë e cila nuk është pranuar me të drejtë nga DAP.

Sqarojmë se, emërimi në pozicione të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të VKM nr. 242, datë 18.3.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar. Në fund të çdo procedure konkurrimi për lëvizje paralele/ngritje në detyrë/pranim nga jashtë shpallet fitues kandidati që është renditur i pari, me të paktën 70% të pikëve. Më tej, në zbatim të pikës 36, të këtij akti nënligjor, njësia përgjegjëse, nxjerr aktin e emërimit të kandidatit fitues në pozicionin vakant. Me nxjerrjen e këtij akti, përmbillet e gjithë procedura e konkurrimit për plotësimin e pozicionit të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues. Pra, në secilën procedurë konkurrimi të shpallur për plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil, që i përkasin kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, ka vetëm një kandidat fitues dhe nuk parashikohet listë fituese.

Referuar dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, kjo listë është e parashikuar vetëm në procedurat e konkurrimit për pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive ku, sipas përcaktimit të nenin 23, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kandidatët fitues në procedurat e pranimin në shërbimin civil, kanë të drejtë të zgjedhin të emërohen në çdo pozicion të lirë të të njëjtit grup, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës (2 vjet).

Për sa më sipër, Komisioneri ka vlerësuar se, mbështetur në dispozitat ligjore të sipërcituara, njësia përgjegjëse DAP, ka zbatuar drejt të gjithë procedurën e kërkuar në fazat e konkurrimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, që rregullojnë këtë institut të ligjit. Për këtë arsye hetimi administrativ është ndërprerë dhe çështja është arkivuar.

➤ **Verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së vlerësimit, në shpalljen me kod #6407, me kërkes E. Xh.**

Me shkresën nr. 838 prot., datë 11.11.2024 është administruar informacioni i dërguar nga kandidati E. Xh. në të cilin ngrihen pretendime për vlerësim të padrejtë jo objektiv, në tre fazat e konkurrimit (*testimi me shkrim, intervista e strukturuar me gojë dhe jetëshkrimi*), në procedurën e konkurrimit me kod #6407, *“Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive”*, lloji i diplomës *“Shkenca Juridike”*, niveli minimal i diplomës *“Master Profesional”*, të shpallur nga DAP.

Për verifikimin e informacionit të administruar, me shkresën nr. 838/1, datë 25.11.2024, Komisioneri ka kërkuar pranë njësies përgjegjëse DAP, praktikën shkresore që materializon veprimet administrative të kryera gjatë zhvillimit të kësaj procedure konkurrimi.

Më tej, DAP nëpërmjet shkresës nr. 5428/7 prot, datë 2.12.2024, ka sqaruar Komisionerin se, kandidati E. Xh. ka qenë pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit me

kod #6407. Nga të dhënat e administruara nga DAP, rezulton se kandidati E. Xh., është ankuar për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e rezultateve të procedurës së konkurrimit për procedurën me kod #6407. Pas administrimit të ankesës, si dhe në kushtet kur kandidati Elton Xh. ka pranuar që intervista të regjistrohet, kandidati është paraqitur në datën 15.11.2024 për të ridëgjuar regjistrimin e intervistës së strukturuar me gojë në prani të KPP, si dhe është sqaruar nga KPP në lidhje me vlerësimin me pikë për çdo pyetje. Gjithashtu, kandidati është paraqitur në DAP, në datën 18.11.2024 për t'u sqaruar në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e tij përse i përket testimit me shkrim. Komiteti i Përhershëm i Pranimit është mbledhur në datën 18.11.2024 për të marrë në shqyrtim ankesën e kandidatit në lidhje me vlerësimin e testimit me shkrim, intervistës së strukturuar me gojë dhe të jetëshkrimit.

Procesverbali i mbajtur për shqyrtimin e ankesës nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i është përcjellë kandidatit me shkresën nr.5428/3 prot., datë 19.11.2024.

Në vijim, kandidati ka përcjellë pranë DAP, kërkesën protokolluar me nr.5428/2 prot., datë 19.11.2024 për të disponuar dokumentacionin e procedurës me kod #6407. Kërkesë e cila është trajtuar nga DAP dhe ka marrë përgjigje me shkresën nr. 5428/6 prot., datë 27.11.2024.

Procedura e konkurrimit për shpalljen me kod #6407, lloj i diplomes "*Shkenca Juridike*", niveli minimal i diplomës "*Master Profesional*", ka përfunduar me vendimin e datës 21.11.2024, të Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP), "*Për rezultatin përfundimtar të procedurës së pranimit në kategorinë ekzekutive në shërbimin civil për grupin e pozicioneve #6407*".

Në vijim, njësia përgjegjëse ka ftuar kandidatët fitues në datën 27.11.2024, duke respektuar renditjen e tyre të zgjedhin nga lista e pozicioneve ekzistuese të lira, për të cilat kanë konkurruar.

Referuar renditjes në pikë, kandidati E. Xh. ka zgjedhur pozicionin "*Specialist (jurist)*", në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Juridik dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, klasa e pagës IV-2 dhe me aktin nr. 6562 prot., datë 3.12.2024, të DAP, është emëruar në këtë pozicion pune.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar, evidentuar sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se, rasti në fjalë është trajtuar dhe zgjidhur në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

*
* *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të mbikëqyrjes së orientuar mbi mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesit të rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore, përgjatë vitit 2024.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vlerësim të rrethanave të mësipërme si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar, si edhe shqyrtimit të informacioneve që kanë ardhur nga palë të interesuara për administrimin e shërbimit civil, arrin në konkluzionin se, procesi i rekrutimit të nëpunësve civilë, të zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, është kryer në zbatim të procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit.

Duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara në përmbajtje të këtij relacioni, si dhe rastet e trajtuara në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të këtij procesi të vështirë dhe kompleks, duhet të vijojë punën e tij drejt rritjes së cilësisë së trupës së nëpunësve civilë të rekrutuar, nëpërmjet ndërveprimit me qytetarët, me qëllim rritjen e numrit të konkurrentëve, duke publikuar në portalin *“online”* të aplikimit, informacionet që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit dhe për t'i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e rritjes së nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura.

Në këtë kontekst, në punën e Departamentit të Administratës Publike, vijon të mbetet një sfidë e vërtetë rritja e besimit tek qytetarët e interesuar për të marrë pjesë në këto procedura, për punësim në bazë të meritës, çka arrihet nëpërmjet garantimit dhe zhvillimit të një procesi transparent dhe të drejtë konkurrimi, si dhe nëpërmjet krijimit të mekanizmave të posaçëm që realizojnë këtë proces (*komisionet përkatëse të rekrutimit*) me pjesëmarrës me aftësi të larta profesionale, të paanshëm dhe me integritet të figurës së tyre.

Nga ana tjetër, Departamenti i Administratës Publike duhet të tregoj nivel më të lartë bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore, sidomos në drejtim të planifikimit të nevojave të tyre për rekrutim, kjo me qëllim rritjen e efektivitetit në realizimin e procedurave të rekrutimit në përputhje me dispozitat ligjore.

ËKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË NGA INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenin 14 dhe nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të planit vjetor të punës për vitin 2024, me qëllim:

monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, të cilat rregullojnë institutin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues, (*Referuar nenit 66/1, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, çdo institucion i cili ka të punësuar nëpunës civilë, duhet të marrë masat për*

ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, si dhe t’i paguajë ata për të gjithë kohën e qëndrimit pa punë), si dhe

marrjen e informacionit të nevojshëm, i cili do të shërbejë si një indikator për të vijuar me plane konkrete mbikëqyrjeje, të materializuara në planin vjetor të vitit pasardhës, në subjektet dhe proceset që do të evidentohen me probleme,

me Vendimin nr. 31, datë 25.04.2024, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së orientuar për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore ku përfshihet Kryeministria, ministrinë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre.

Nëpërmjet kësaj mbikëqyrjeje synohet të krijohet një pasqyrë e plotë e situatës në disa drejtime, duke evidentuar disa prej tyre:

Si është kuptuar dhe zbatuar neni 66/1, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore, të cilat rregullojnë institutin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues;

Si janë zhvilluar procedurat paraprake dhe si është menaxhuar procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues nga ana e institucionit, në cilësinë e debitorit, referuar vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

A është përditësuar nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit baza e të dhënave, me informacionet e nevojshme;

A është ngritur Komisioni i Posaçëm dhe cilat janë veprimet administrative të ndërmarra nga ky organ;

A janë plotësuar vendet vakante në shërbimin civil me nëpunës të regjistruar në listë pritje. Për këtë janë verifikuar të

dhënat lidhur me: numrin e pozicioneve në shërbimin civil, mënyrën e plotësimit të tyre, numrin e pozicioneve vakante;

Evidentimi i problemeve që pengojnë veprimtarinë e institucionit dhe njësisë përgjegjëse gjatë punës për zbatimin e nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe aspekte të tjera që kanë dalë gjatë procesit.

Monitorimi në këtë rast është paraprirë nga shkresat nr. 284/2 (*e vijues*) prot., datë 24.04.2024, të Komisionerit: *“Kërkesë për informacion në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil”*, me anë të së cilave është kërkuar nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore informacion i plotë në lidhje me ekzekutimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, për periudhën 03.01.2023 – 31.12.2024

Grupi i punës i ngarkuar nga Komisioneri, që në nisje të procesit, e më tej, ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me njësitë përgjegjëse të institucioneve të përfshira në këtë mbikëqyrje, si në rrugë shkresore, nëpërmjet postës zyrtare, ashtu edhe me mjetet e komunikimit elektronik (*e-mail*), apo të shërbimit të telefonisë.

Pasi u njohën me kërkesën e Komisionerit, institucionet shtetërore kanë raportuar në lidhje me situatën e zbatimit të këtij instituti të ligjit dhe kanë dërguar nëpërmjet postës zyrtare dhe adresës elektronike (*e-mail*) të gjitha informacionin e kërkuar. Të dhënat e raportuara nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore janë pasqyruar në formë tabelore, përkatësisht në **Aneksin nr. 1:** *“Të dhëna në lidhje me rastet e nëpunësve civilë gjyqfitues të cilët aktualisht janë në listë pritje”* dhe **Aneksin nr. 2:** *“Të dhëna në lidhje me rastet e nëpunësve civil gjyqfitues, të rikthyer në një pozicion të rregullt të shërbimit civil”*, bashkëlidhur këtij raporti, si pjesë integrale e tij.

Në këtë mbikëqyrje të orientuar janë administruar të dhëna nga Kryeministria dhe institucionet në varësi të saj, **11** ministri të linjës dhe **104** institucione në varësi të tyre.

Pas administrimit të informacionit të kërkuar, grupi i punës ka verifikuar dhe analizuar veprimet administrative të realizuara nga njësitë përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara nga ligji, si pjesëmarrës në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

1. Situata e përgjithshme në lidhje me nivelin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë nga ana e institucioneve të mbikëqyrura

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është një institut i rëndësishëm i së drejtës, pasi në kuptim të neneve 42/2 dhe 142/3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6, të KEDNJ-së, ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

124

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e titullit ekzekutiv, pasi një nëpunës civil, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për të kundërshtuar aktin e lirimit/largimit nga puna, nuk mund të presë pa kufi për të vënë në vend të drejtën e tij. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se nëpunësi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi, Komisioneri e ka monitoruar atë, sipas tipologjisë së institucioneve në sistemin e shërbimit civil prej disa vitesh dhe gjatë vitit 2024 ka planifikuar dhe realizuar mbikëqyrjen e orientuar në institucionet e administratës shtetërore me qëllim konstatimin e nivelit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e tyre.

Pas analizës së hollësishme të të dhënave të raportuara për periudhën 03.01.2023 - 31.12.2024, si dhe referuar akteve shkresore që janë vënë në dispozicion nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të **Kryeministrit, 11 ministrive të linjës**, si dhe **104 institucioneve në varësi** të tyre, të cilët përfshihen në shërbimin civil, Komisioneri ka evidentuar numrin e përgjithshëm të nëpunësve civilë gjyqfitues në listë pritje, të ndarë sipas kategorive të pozicioneve të punës që zotërojnë.

Po kështu është marrë informacion lidhur me vendimet gjyqësore të formës së prerë të ekzekutuara nga këto institucione gjatë vitit 2023 dhe 2024, që konsiston në emërimin e nëpunësve në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil ose përfundimin e marrëdhënies së shërbimit për shkak të arritjes së moshës së nëpunësit për përfitimin e pensionit të pleqërisë apo pushimit të ekzekutimit me kërkesë të kreditorit.

Në vijim, këto të dhëna po i paraqesim në formën e një tablele, të kategorizuara në bazë institucioni qendror (*aparati i Kryeministrit/ministrit së bashku me institucionet e tyre të varësisë*).

Tabela nr.7.1 Të dhënat e raportuara nga institucionet e administratës shtetërore në lidhje me nivelin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues

1	2	3	4	5
Administrata shtetërore (Kryeministria, ministratë dhe institucionet në varësi të tyre)	Nëpunës civilë gjyqfitues në listëprije	Nëpunësit civil në listë prije të ndarë sipas kategorisë së pozicionit të punës	Nëpunës civilë gjyqfitues të rikthyer në një pozicion të rregullt të shërbimit civil	Numri i përgjithshëm i vendimeve gjyqësore të formës së prerë
Kryeministria	2	0 - të lartë drejtues	5	7
		0 - të mesëm drejtues		
		1 - të ulët drejtues		
		1 - ekzekutiv		
Ministria për Evropën & Punët e Jashtme	1	0 - të lartë drejtues	0	1
		0 - të mesëm drejtues		
		0 - të ulët drejtues		
		1 - ekzekutiv		
Ministria e Mbrojtjes	8	1 - të lartë drejtues	11	19
		5 - të mesëm drejtues		
		0 - të ulët drejtues		
		2 - ekzekutiv		
Ministria e Turizmit & Mjedisit	11	0 - të lartë drejtues	0	11
		3 - të mesëm drejtues		
		4 - të ulët drejtues		
		4 - ekzekutiv		
Ministria Brendshme	8	1 - të lartë drejtues	18	26
		3 - të mesëm drejtues		
		1 - të ulët drejtues		
		3 - ekzekutiv		
Ministria e Drejtësisë	5	0 - të lartë drejtues	3	8
		1 - të mesëm drejtues		
		2 - të ulët drejtues		
		2 - ekzekutiv		
Ministria e Arsimit & Sportit	1	0 - të lartë drejtues	2	3
		0 - të mesëm drejtues		
		0 - të ulët drejtues		
		1 - ekzekutiv		
Ministria e Financave	69	0 - të lartë drejtues	9	78
		12 - të mesëm drejtues		
		7 - të ulët drejtues		
		50 - ekzekutivë		
	13	1 - të lartë drejtues	1	14

Ministria e Shëndetësisë & Mbrojtjes Sociale		8 - të mesëm drejtues		
		1 - të ulët drejtues		
		3 - ekzekutiv		
Ministria e Bujqësisë & Zhvillimit Rural	4	0 - të lartë drejtues	1	5
		2 - të mesëm drejtues		
		1 - të ulët drejtues		
		1 - ekzekutivë		
Ministria e Infrastrukturës & Energjisë	12	1 - të lartë drejtues	2	14
		3 - të mesëm drejtues		
		6 - të ulët drejtues		
		2- ekzekutiv		
Ministria e Ekonomisë, Kulturës & Inovacionit	0	0- të lartë drejtues	3	3
		0 - të mesëm drejtues		
		0 - të ulët drejtues		
		0 - ekzekutiv		
TOTALI	134	4 - të lartë drejtues	55	189
		37 - të mesëm drejtues		
		23 - të ulët drejtues		
		70 - ekzekutiv		


Shënim: Në tabelat që do të jenë anekse të këtij raporti, situata do të përshkruhet më e detajuar pasi janë paraqitur të dhënat për çdo institucion, duke specifikuar në mënyrë nominale çdo nëpunës së bashku me aktet përkatëse që shoqërojnë praktikën si: aktet e emërimit të tyre në detyrë; të dhëna lidhur me pozicionin dhe kategorinë e pagës në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së shërbimit civil; numrin dhe datën e vendimit gjyqësor; të dhëna lidhur me ecurinë e procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv; vlerën monetare të pagesave të realizuara në favor të nëpunësve civilë dhe vlerën monetare të detyrimit që nuk është likuiduar ende prej institucionit.

Referuar të dhënave më sipër, rezulton se, numri i përgjithshëm i vendimeve gjyqësore të formës së prerë të mbartura deri në fund të vitit 2024 është **189 raste**. Rezulton se, për periudhën 03.01.2023 deri në 31.12.2024, institucionet e administratës shtetërore kanë mundur të ekzekutojnë vetëm **55** vendime ose **29.1 %** të rasteve, ndërsa janë ende të pa ekzekutuara **134** vendime gjyqësore të formës së prerë ose **70.9 %** për të cilët, nëpunësit gjyqfitues aktualisht janë të regjistruar në listë pritje.

Duke analizuar të dhënat e administruara, rezulton se, gjatë periudhës 2023-2024, nga **116** institucione të administratës shtetërore të mbikëqyrura, kanë pasur detyrimin për të ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë **18** prej tyre, ku bëjnë pjesë **10** ministri dhe **8** institucione varësie, ndërsa **98** institucionet e tjera, kanë raportuar se nuk kanë vendime gjyqësore për ekzekutim.

Pasi u verifikua niveli i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë rezultoi se, nga institucionet të cilat kishin detyrimin për të ekzekutuar vendime gjyqësore **18**


institucione, 3 institucione nuk kishin mundur të ekzekutonin asnjë vendim gjatë dy viteve, ndërsa 15 institucione (7 ministri dhe 8 institucione varësie) kanë ekzekutuar 55 vendime gjyqësore.



Megjithëse numri i vendime gjyqësore të pa ekzekutuara mbetet relativisht i lartë, është e rëndësishme të theksojmë faktin se nga ana e institucioneve janë bërë përpjekje serioze në drejtim të rregullimit të ligjshmërisë dhe të përmirësimit të situatës së administrimit të shërbimit civil, çka reflektohet në këto drejtime:

- Baza e të dhënave për çdo rast specifik është plotësuar me të dhënat për secilin gjyqfitues në listë pritje;
- Është konstatuar një tendencë në rritje e rasteve të gjyqfituesve, të cilët po paguhën për pjesën e pagave të prapambetura gjatë periudhës së qëndrimit në listë pritje;
- Në disa institucione, Komisionet e Posaçme kanë bërë përpjekje për sistemimin e gjyqfituesve, duke i propozuar atyre vende të cilat kanë qenë të lira në institucion dhe është arritur që të sistemohet një pjesë e tyre.

Nëse analizohen 134 rastet e nëpunësve civilë gjyqfitues që janë në listë pritje, sipas kategorisë që i përket nëpunësisë civile, do të vëmë re se janë ende të pasistemuar në punë:



Në kreun 10, nenet 399/1 e vijues, të Kodit Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë është përcaktuar vlerësimi i kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si dhe shpërblimi i drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve. Po kështu, neni 66/1, i ligjit nr.

152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në pikën 1 të tij ka sanksionuar se vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë **zbatohen menjëherë**.

Referuar akteve ligjore të sipërcituar, nga analiza e dokumentacionit të administruar në këtë mbikëqyrje orientuese, ka rezultuar se institucionet e administratës shtetërore **nuk kanë vepruar në kohë** për të realizuar detyrimet e tyre ligjore.

Në momentin e verifikimit në subjekt kanë rezultuar të pa ekzekutuara **134** vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilët janë ndarë sipas viteve paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabelë nr.7.2 Vendimet gjyqësore të pa ekzekutuara, të grupuara sipas vitit kalendarik, të ndërprerjes së marrëdhënies së punës

Viti	2006	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Raste	2	3	6	3	7	3	18	13	19	17	9	8	2	1	8	12	3

Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës.

Ligji parashikon se afati për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë është deri **në një vit** dhe llogaritja e këtij afati fillon nga momenti i komunikimit të titullit ekzekutiv, deri në zbatimin e të gjitha urdhërimeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e nëpunësit gjyqësor, si dhe të subjekteve përkatëse të ngarkuar nga ligji.

Referuar akteve të administruara rezultojnë ende të pa ekzekutuar **24** raste, të cilët janë larguar nga shërbimi civil përpara hyrjes në fuqi ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ose e shprehur ndryshe mbi 11 vjet më parë, ndërkohë që afati ligjor për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë është një vit. Aktualisht institucionet kanë shkelur afatin e ekzekutimit për **52** vendime gjyqësore të formës së prerë.

Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451, të Kodit të Procedurës Civile, ku sanksionohet se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, institucionet shtetërore, pasi ju komunikohet një vendim gjyqësor i formës së prerë, duhet të marrin masa për ekzekutimin vullnetar të tij, kjo në respektim të nenit 142, pika 3, të Kushtetutës, i cili parashikon se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”* dhe nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Vendimet*

gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse”.

Institucionet gjatë veprimtarisë së tyre duhet të kenë në vëmendje faktin se, mosekzekutimi për një kohë të gjatë i vendimit gjyqësor të formës së prerë **shoqërohet me një dëm financiar të konsiderueshëm në buxhetin e shtetit**, pasi të gjendur në këtë situatë ato po paguajnë nëpunës të cilët nuk ofrojnë shërbime. Në këtë kuptim, një realizim i plotë i detyrimit është jo vetëm në favor të kreditorit për të realizuar të drejtën e tij të fituar nga një vendim gjyqësor, por i shërben edhe administrimit sa më të mirë të buxhetit të shtetit.

129

Në këtë rast, subjektet e ngarkuara nga ligji duhet të kishin marrë të gjitha masat e nevojshme për të gjetur mjetin e përshtatshëm ligjor për kthimin sa më shpejt të nëpunësve gjyqfitues në punë në zbatim të afateve ligjore, si dhe të paguanin pagat e prapambetura, pasi janë detyrime ligjore që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Gjatë mbikëqyrjes u konstatua se një pjesë e konsiderueshme e institucioneve të administratës shtetërore janë përfshirë në proces ristrukturimi. Lidhur me këtë situatë, sqarojmë se, një nëpunës civil në listë pritje zotëron të gjitha të drejtat që gëzojnë nëpunësit e tjerë të institucionit (*madje edhe pagesën*) dhe për këtë shkak, ata duhet të bëhen pjesë e procesit të ristrukturimit.

Në një proces ku do të rivlerësohen pozicionet e punës, si dhe do të evidentohen nëpunësit që kanë kualifikimin e duhur, përvojën dhe i përshtaten më mirë pozicioneve të reja të punës të krijuara, nuk ka asnjë arsye pse Komisioni i Ristrukturimit dhe më tej njësia përgjegjëse, të mos marrin në konsideratë edhe nëpunësit në listë pritje, pasi ndër to mund të ketë gjyqfitues me kualifikimin, përvojën dhe kapacitetet teknike të cilët i përmbushin kriteret për t’u emëruar në pozicione punë të ristrukturuara apo të krijuara të reja.

Për më tepër, institucionet e administratës shtetërore ndër vite kanë pësuar ndryshime strukturore, të cilat janë shoqëruar kryesisht me rritjen e numrit të nëpunësve civilë e, për pasojë, janë realizuar një numër i konsiderueshëm procesesh për rekrutimin nga jashtë shërbimit civil, por edhe me ngritje në detyrë për të plotësuar pozicionet e lira, ndërkohë që qëndrojnë në listë pritje prej shumë vitesh nëpunës civilë për shkak të vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara.

Nga verifikimi rezultoi se përgjatë vitit 2024, sipas raportimit të njësive të burimeve njerëzore, në administratën shtetërore kanë qenë **1760 pozicione pune në shërbimin civil të lira**, ndërkohë që **numri total i vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara është 134**, e për këtë shkak, po aq është edhe numri i nëpunësve civilë në listë pritje.

Në këtë këndvështrim, vlerësohet se institucionet dhe Njësia Përgjegjëse i kanë pasur të gjitha mundësitë për të sistemuar këta nëpunës në një pozicion të rregullt të shërbimit civil.

✍ Situata e rikthimit në detyrë të nëpunësve civil gjyqfitues në administratën shtetërore gjatë periudhës janar 2023 - dhjetor 2024, e konkretizuar sipas institucioneve dhe kategorizimit të nëpunësve civilë

Gjatë procesit të mbikëqyrjes së orientuar, informacioni është detajuar edhe për rastet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues sipas institucioneve që i përkasin ato dhe sipas nivelit të nëpunësisë civile.

Ashtu si u evidentua më sipër, nga **18** institucione që kanë patur detyrimin për të ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë për periudhën objekt raportimi, **15 institucione** e kanë shtyrë më përpara procesin, duke ekzekutuar **55** vendime gjyqësore të formës së prerë.

Më konkretisht, gjatë periudhës janar 2023 – dhjetor 2024 kanë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë institucionet si më poshtë:

1 rast Kryeministria (*aktualisht ky institucion nuk ka vendime të pa ekzekutuara*);

2 raste Departamenti i Administratës Publike në varësi të Kryeministrit;

1 rast Inspektorati në varësi të Kryeministrit;

1 rast Agjencia e Menaxhimit të Mbetjeve Ujore në varësi të Kryeministrit;

11 raste Ministria e Mbrojtjes;

18 raste Ministria e Brendshme;

3 raste Ministria e Drejtësisë;

2 raste Ministria e Arsimit dhe Sportit;

1 rast Ministria e Shëndetësisë;

5 raste Ministria e Financave;

4 raste Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në varësi të M. Financave;

2 raste Ministria e Infrastrukturës;

2 raste ISHPSHSH në varësi të MEKI;

1 rast Drejtoria e Metrologjisë në varësi të MEKI;

1 rast ISUV në varësi të MBZHR.

Pas analizës së **55** rasteve të nëpunësve civilë gjyqfitues të emëruar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil rezultoi se, nisur nga kategoria e nëpunësisë civile, ato ndahen si më poshtë:

31 nëpunës civilë ose **56.3%** e tyre në kategorinë ekzekutive

10 nëpunës civilë ose **18.2%** e tyre në kategorinë e mesme drejtuese

10 nëpunës civilë ose **18.2%** e tyre në kategorinë e ulët drejtuese

4 nëpunës civilë ose **7.3%** e tyre në kategorinë e lartë drejtuese

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se **numri më i lartë i nëpunësve civilë gjyqfitues të sistemuar në punë i përket kategorisë ekzekutive.**

Duke analizuar mënyrën se si janë zbatuar këto tituj ekzekutivë rezulton se:

- në **48 raste**, vendimet gjyqësore të formës së prerë janë ekzekutuar përmes emërimit të nëpunësit në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil;
- në **6 raste**, vendimet gjyqësore të formës së prerë janë ekzekutuar përmes aktit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të plotësimit të moshës së pensionit të pleqërisë nga nëpunësi; dhe
- në **1 rast** nëpunësi ka kërkuar pushimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

2. Plotësimi i pozicioneve të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i mbikëqyrjes së orientuar, i cili do të shërbente, ndër të tjera, për të kuptuar mundësitë reale që kanë pasur subjektet e mbikëqyrura për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, u vlerësua edhe mbledhja e të dhënave të sakta lidhur me administrimin e pozicioneve të shërbimit civil në përputhje me strukturat organizative mbi bazën e të cilave kanë funksionuar institucionet e administratës shtetërore në momentin e verifikimit, pra në muajin dhjetor, 2024.

Ky informacion është përqendruar në mbledhjen e të dhënave në lidhje me numrin e përgjithshëm të punonjësve sipas strukturave në fuqi; numrin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil; numrin e nëpunësve civilë të emëruar në zbatim të ligjit; numrin e punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil dhe numrin e vendeve vakante në shërbimin civil.

Pas komunikimeve përmes postës elektronike me njësinë përgjegjëse, të dhënat e raportuara nga Kryeministria, 11 Ministri të linjës dhe 98 institucionet në varësi të tyre për lehtësi studimi janë paraqitur në formë tabelore të ndara në disa rubrika.

Tabela nr.7.3 Administrimi i pozicioneve të punës, në aparatën e administratës shtetërore sipas strukturës organizative të institucionit deri në muajin dhjetor, 2024

Nr.	Institucioni	Numri i pozicioneve në shërbimin civil sipas strukturës	Numri i pozicioneve në shërbimin civil të plotësuar sipas ligjit	Numri i pozicioneve në shërbimin civil të plotësuar në kundërshtim me ligjin	Numri i pozicioneve të lira në shërbimin civil
1.	KRYEMINISTRIA	114	84	0	30

2.	Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE	23	20	0	3
3.	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar	34	25	0	9
4.	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	81	61	0	20
5.	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	11	10	0	1
6.	Agjencia e Prokurimit Publik	45	40	0	5
7.	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	21	18	0	3
8.	Agjencia Telegrafike Shqiptare	32	26	0	6
9.	Avokatura e Shtetit	16	5	0	11
10.	Departamenti i Administratës Publike	60	50	0	10
11.	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	114	108	0	6
12.	Inspektorati Qendror	16	14	0	2
13.	Komiteti për Pakicat Kombëtare	11	8	0	3
14.	Komiteti Shtetëror për Kultet	3	3	0	0
15.	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës	62	45	0	17
16.	Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit	24	19	0	5
TOTALI		667	536	0	131
17.	MINISTRIA E FINANCAVE	330	227	0	103
18.	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1074	721	0	353
19.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1200	948	0	252
20.	DPTP	13	12	0	1
21.	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	218	191	0	27
22.	QTATD	14	8	1	5
23.	CFCU	48	36	3	9
24.	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit	25	18	0	7
TOTALI		2922	2161	4	757
25.	MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME	151	120	0	31

26.	Agjencia Kombëtare e Diasporës	16	11	0	5
TOTALI		167	131	0	36
27.	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	131	91	0	40
28.	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë	15	11	0	4
29.	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	19	15	0	4
30.	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar	58	48	0	10
TOTALI		223	165	0	58
31.	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	205	165	0	40
32.	Agjencia Kombëtare Bërthamore	7	7	0	0
33.	Agjencia e Eficencës së Energjisë	19	16	0	3
34.	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat Civile	25	18	0	7
35.	Agjencia Shtetërore për Shpronësim	25	23	0	2
36.	Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse	9	5	0	4
37.	Instituti i Transportit	14	13	0	1
38.	Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve (QGTKRR)	5	3	0	2
39.	Drejtoria e Përgjithshme Detare	66	63	0	3
40.	Arkivi Qendror Teknik	10	10	0	0
41.	Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar	108	100	0	8
42.	Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore	14	7	0	7
43.	Autoriteti Rregullator Hekurudhor	5	1	0	4
TOTALI		512	431	0	81
44.	MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT	240	107	0	133
45.	AKAFPK	30	20	0	10
46.	DPA	20	20	0	0

47.	DPPI	37	33	0	4
48.	DPS	14	14	0	0
49.	DPM	97	91	0	6
50.	ISHMT	74	72	0	2
51.	ISHPSH	154	132	0	22
52.	QKB	73	59	0	14
53.	ATRAKO	12	7	0	5
TOTALI		751	555	0	56
54.	MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	102	87	0	15
55.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe 4 Agjencitë Rajonale të Mjedisit	233	204	0	29
56.	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	65	58	0	7
57.	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	24	21	0	3
58.	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	30	28	0	2
TOTALI		454	398	0	56
59.	MINISTRIA E BUJQËSISË	154	125	0	29
60.	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - AZHBR	224	191	0	33
61.	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë - ISUV	64	62	1	1
62.	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës- DSHPA	44	36	0	8
63.	Agjencia Kombëtare e Duhan- Cigareve - AKDC	10	7	0	3
64.	Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve - ESHFF	15	13	0	2
65.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë	50	34	0	16
66.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Lushnjë	15	12	0	3
67.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Korçë	19	12	0	7
68.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Vlorë	16	7	0	9
69.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Shkodër	12	9	0	3

70.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB) Tiranë	62	48	0	14
71.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB) Lushnjë	71	55	0	16
72.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB) Korçë	68	59	0	9
73.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB) Shkodër	57	39	0	18
74.	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve	38	30	0	8
75.	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Tirane	69	59	0	10
76.	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan	83	76	0	7
77.	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Shkodër	66	56	0	10
78.	Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë	86	75	0	11
TOTALI		1223	1005	1	217
79.	MINISTRIA E DREJTËSISË	174	136	0	38
80.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	123	20	84	19
81.	Qendra e Botimeve Zyrtare	18	17	0	1
82.	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor	9	8	0	1
83.	Instituti i Mjekësisë Ligjore	28	26	0	2
84.	Qendra e Parandalimit të Krimeve për të Mitur dhe të Rinjve	16	15	0	1
85.	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	20	13	0	7
86.	Komiteti shqiptar i Birësimeve	8	8	0	0
87.	Agjensia Kombëtare e Falimentit	7	6	0	1
TOTALI		403	249	84	70
88.	MINISTRIA E MBROJTJES	104	88	0	16
89.	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	92	75	0	17
90.	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit	37	30	0	7

TOTALI		233	193	0	40
91.	MINISTRIA E BRENDSHME	136	124	0	12
92.	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	353	176	153	24
93.	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore	11	10	0	1
94.	AAPSK	13	11	1	1
95.	Prefektura Tiranë	26	26	0	0
96.	Prefektura Durrës	21	18	0	3
97.	Prefektura Kukës	20	19	0	1
98.	Prefektura Shkodër	20	17	0	3
99.	Prefektura Lezhë	20	17	0	3
100.	Prefektura Dibër	20	18	0	2
101.	Prefektura Elbasan	22	19	0	3
102.	Prefektura Berat	19	13	0	6
103.	Prefektura Vlorë	24	21	0	3
104.	Prefektura Fier	23	22	0	1
105.	Prefektura Korçë	29	28	0	1
106.	Prefektura Gjirokastrë	20	17	0	3
TOTALI		777	556	154	67
107.	MINISTRIA E SHËNDËTËSISE DHE MBROJTJES SOCIALE	132	100	0	32
108.	Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë	18	16	0	2
109.	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve	9	5	0	4
110.	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor	38	25	0	13
TOTALI		197	146	0	51
TOTALI PËR 110 INSTITUCIONE		8529	6526	243	1760

Sipas të dhënave të paraqitura më sipër, rezultojnë se numri total i pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil në ato institucione të administratës shtetërore ku janë administruar të dhënat, si: Kryeministria, **11** ministritë e linjës dhe **98** institucione në varësi të tyre është **8529** vende pune. Institucionet kanë raportuar se situata e administrimit të shërbimit civil në lidhje me plotësimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, në dhjetor, të vitit 2024, rezultojnë e tillë:

- janë plotësuar në përputhje me ligjin **6526** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ose **76.5%** e tyre;
- janë ende të paplotësuara **1760** pozicione pune, ose **20.7%** e tyre;
- Ndërkohë është raportuar se, **243** pozicione pune në shërbimin

civil, ose **2.8%** e tyre janë plotësuar në kundërshtim me ligjin, nëpërmjet kontratave të punës ose akteve të emërimit të përkohshëm, pa zhvilluar procedura konkurrimi.

Më konkretisht, **243** rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin i përkasin institucioneve si më poshtë:

- | | |
|---|-------------------------|
| ▪ 153 raste - Policia e Shtetit | ▪ 1 rast - QTATD |
| ▪ 84 raste - Dr. Përgjithshme Burgjeve | ▪ 1 rast - AAPSK |
| ▪ 3 raste - CFCU | ▪ 1 rast - ISUV |

Në kushtet kur janë konstatuar **243** raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin, ky fakt do të shërbejë si indicie për të përfshirë në mbikëqyrje tematike institucionet e evidentuara me parregullsi gjatë administrimit të shërbimit civil.



3. Konkluzione dhe rekomandime

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë procesit të mbikëqyrjes së orientuar në institucionet e administratës shtetërore, lidhur me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil dhe më konkretisht në institutet si më poshtë:

Verifikimi i nivelit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civil gjyqfitues.

Administrimi i pozicioneve të punës si pjesë e shërbimit civil dhe verifikimi i tyre nëpërmjet strukturave organizative të institucioneve, nga ku u konstatuan: emërimet në kundërshtim me ligjin dhe pozicionet e lira në shërbimin civil, për të evidentuar mundësinë e sistemit të nëpunësve civil gjyqfitues.

Pas mbledhjes dhe analizës së informacionit të nevojshëm u evidentuan problematikat në fushat e sipërcituara të administrimit në shërbimin civil, si dhe institucionet të cilat kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të Komisionerit, duke shërbyer si indicie për t'u përfshirë në planin vjetor të mbikëqyrjes të KMSHC-së për vitin 2025.

Për përmirësimin e situatës, Komisioneri vlerëson se duhet të vijojë puna e nisur me Departamentin e Administratës Publike, për të ndjekur veprimtarinë e Komisioneve të Posaçme nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e këtyre mekanizmave, me qëllim që të mbështeten subjektet të cilat kanë detyrimin ligjor për të ekzekutuar vendimet e formës së prerë për rikthimin në punë të nëpunësve civilë gjyqfitues.

Sa më sipër i është bërë e njohur Departamentit të Administratës Publike përmes Raportit të Vlerësimit për këtë aspekt, me qëllim që të udhëheqë më tej proceset e administrimit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, në rolin e njësisë përgjegjëse për këto institucione. Raporti i Vlerësimit është publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit, me qëllim që të njihen të gjitha palët e interesuara për aspektet që trajtohen në të.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes orientuese në administratën shtetërore, sipas pikave të këtij raporti janë materializuar në anekset si më poshtë:

Aneksi nr. 2: Të dhëna në lidhje me nëpunësit civil gjyqfitues për rikthimin në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, të cilët aktualisht janë në listë pritje në institucionet e administratës shtetërore

Aneksi nr. 3: Të dhëna në lidhje me nëpunësit civil gjyqfitues për rikthimin në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, për të cilët është ekzekutuar vendimi gjyqësor

MBIKËQYRJA NË VAZHDIM DHE ECURIA E ZBATIMIT TË VENDIMEVE PARALAJMËRUESE TË KOMISIONERIT

1. Niveli i zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit

139

Ky kapitull synon të paraqesë një analizë të detajuar të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit gjatë vitit 2024, duke përfshirë të dhëna të hollësishme mbi përqindjen e zbatimit të këtyre vendimeve dhe një pasqyrë të rezultateve në lidhje me totalin e vendimeve paralajmëruese të nxjerra gjatë këtij viti.

Duke filluar nga këto të fundit, rezulton se, për periudhën janar – dhjetor 2024, Komisioneri ka përfunduar me vendim **47** procese mbikëqyrje/inspektimi apo hetimi administrativ, nga të cilat: **7** vendime të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes orientuese me natyrë informative që synon njohjen e situatës; **14** vendime të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes/inspektimit apo hetimit administrativ, ku nuk janë konstatuar shkelje e, për këtë arsye, nuk janë lënë detyra, dhe **26** procese janë përmbyllur me vendime paralajmëruese për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë (nga të cilat, në 5 raste, afati për zbatimin e vendimit përfundon në vitin 2025).

47 vendime

26 me detyra

14 pa detyra

7 me karakter informativ

Sipas statistikës së paraqitur më sipër, rezulton se në 30% të rasteve të mbikëqyrura nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, ndërkohë që, 55% e numrit të përgjithshëm të vendimeve të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes janë vendime paralajmëruese, ku janë lënë detyra konkrete për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, nga të cilat


për 5 vendime (ose 19% e tyre) afati për zbatimin e vendimit përfundon brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Sa i takon procesit të mbikëqyrjes në vazhdim (*procesi i verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese pas përfundimit të afatit të paralajmërimit*), rezulton se gjatë periudhës objekt raportimi, ky proces është realizuar për **38** vendime paralajmëruese të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes, inspektimit apo hetimit administrativ (*ku përfshihen edhe vendime të dala përpara periudhës së raportimit*).

140

Referuar tipologjisë së tyre, këto vendime i përkasin grupit të institucioneve si më poshtë:

Totali - 38 vendime, që i përkasin:



Referuar ecures së tij, rezulton se procesi i mbikëqyrjes në vazhdim është përmbyllur për **27** vendime paralajmëruese, nga të cilat: për **22** vendime janë zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri, për **3** vendime është bërë objektivist e pamundur ndjekja e zbatimit të vendimit për shkak se ka rënë objekti, apo për shkak të ndryshimit të rrethanave (*siç është rasti kur institucioni ka dalë nga fusha e veprimit të ligjit për nëpunësin civil*) dhe për **2** vendime, procesi është përmbyllur për shkak se çështja është duke u shqyrtuar gjyqësisht dhe do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata.

Ndërkohë për 11 vendime, procesi i mbikëqyrjes në vazhdim u mbart për vitin 2025, për shkak të kompleksitetit të problematikave, apo përfundimit të afatit për zbatimin e tyre gjatë periudhës që përkon me fundin e vitit 2024.

Situata e zbatimit të vendimeve paralajmëruese, paraqitet në mënyrë grafike më poshtë, duke u shoqëruar me një analizë më të zgjeruar.

Përfunduar 71% **Në proces 29%**



☐ 22 zbatuar

☐ 11 mbartur për vitin 2025

☐ 2 duke u shqyrtuar nga gjykata

☐ 3 ka rënë objekti

Në përfundim të verifikimit, rezulton se:

Për 22 vendime

institucioneve si më poshtë:

15 vendime

administratës shtetërore
(11 ministri & 4 institucione
varësie)

7 vendime

njësive të qeverisjes vendore
(6 bashki & 1 këshill qarku)

Konkretisht, rezulton se janë realizuar plotësisht detyrat e lëna nga Komisioneri, si më poshtë:

Në administratën shtetërore (ministri & institucionet e varësisë):

- Anulimi i aktit të vlerësimit të rezultateve në punë (1 rast).
- Përfundimi i procesit të miratimit apo nënshkrimit të përshkrimeve të punës për nëpunësit civilë dhe

depozitimi i akteve pranë DAP-it (2 institucione).

- Përsëritja e procesit të vlerësimit për nëpunësin për periudhën e provës dhe anulimi i aktit të lirimit të tij (1 rast).

- Anullimi i aktit të vlerësimit dhe përsëritja e procesit të vlerësimit (1 rast).
- Kryerja e procesit të vlerësimit të rezultave në punë të nëpunësve civilë, përfshi TND (9 institucione).

Në njësitë e qeverisjes vendore (bashki dhe këshilla qarku):

- Nxjerrja e aktit të emërimit (1 rast).
- Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit për largimin e nëpunësit dhe rikthimi i tij në pozicionin që ka patur (1 rast).
- Anulimi i masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësin dhe ndjekja e ecurisë së procesit administrativ, duke hequr nga dosja e personelit dhe Rregjistri Qendror i Personelit, masën disiplinore në ngarkim të nëpunësit (1 rast).
- Lirimi nga shërbimi civil për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë (3 raste).
- Anulimi i Vendimit për transferimin e përhershëm të nëpunësit dhe lirimi i tij nga shërbimi civil (1 rast).
- Anullimi i aktit të transferimit të nëpunësit dhe kthimi në pozicionin e mëparshëm (1 rast).

Për 2 vendime

procesi është përmbyllur për shkak se çështja është duke u ndjekur gjyqësisht (bëhet fjalë për 2 vendime që i përkasin institucioneve të varësisë së administratës shtetërore).

Në këtë rast, rezulton se Komisioneri ka kërkuar:

- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionit Disiplinor dhe e aktit të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare të titullarit të institucionit, duke kërkuar vijimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit (1 rast).
- Anulimin e aktit të lirimit nga shërbimi civil (1 rast).

Për 3 vendime

procesi është përmbyllur për shkak të pamundësisë në objekt për ndjekjen e zbatimit të vendimit paralajmërues (bëhet fjalë për 1 vendim që i përket institucioneve të varësisë së administratës shtetërore dhe 2 vendime që i përkasin njësive të qeverisjes vendore - bashki).

Në këto raste, rezulton se Komisioneri ka kërkuar:

Në administratën shtetërore (institucion varësie):

- Përshkrimet e punës duhet të jenë të detajuara, në përputhje me legjislacionin dhe të specifikojnë qartë funksionet e secilit pozicion.
- DAP të rivlerësojë rastin dhe, nëse konstaton parregullsi në punësim, të ndërmarrë veprimet ligjore për shfuqizimin e aktit të emërimit në shërbimin civil (1 rast).
- Të merren masat për të siguruar zbatimin e plotë të kërkesave procedurale gjatë vlerësimit të punës, siç parashikohet nga ligji

143

Në njësitë e qeverisjes vendore (bashki):

- Të konstatohet pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit (1 rast).
- Të rishikohen përshkrimet e punës dhe të saktësohen kriteret e posaçme në përmbajtjen e përshkrimit të punës, lidhur me përvojën në punë, ashtu si e parashikon ligji, me qëllim që të mos ketë subjektivitet në zbatimin e këtij kriteri sipas preferencave (1 institucion).
- Të anulohet akti administrativ i riemërimit si një akt i paligjshëm (1 rast).

Për 11 vendime

procesi u mbart për vitin 2025 (10 vendime që i përkasin bashkive dhe 1 vendim që i përket 1 institucioni të pavarur).

Në një këndvështrim krahasues me një vit më parë të vendimeve të cilat i janë nënshtruar procesit të verifikimit për zbatimin e tyre, rezulton se:

Në vitin 2023:

- janë zbatuar plotësisht 60% e vendimeve;
- janë përmbyllur gjatë procesit të verifikimit për arsyet e parashikuara në ligj apo rregulloren e procedurave të mbikëqyrjes/inspektimit 23% e vendimeve (pasi janë duke u shqyrtuar nga gjykata, ka rënë objekti, etj);
- janë mbartur për vitin pasardhës 17% e vendimeve.

Në vitin 2024

- janë zbatuar plotësisht 58% e vendimeve;

- janë përmbyllur gjatë procesit të verifikimit për arsyet e parashikuara në ligj apo rregulloren e procedurave të mbikëqyrjes/inspektimit **13%** e vendimeve *(pasi janë duke u shqyrtuar nga gjykata, ka rënë objekti, etj)*, janë mbartur për vitin pasardhës **29%** e vendimeve.

Pra, sikundër vërehet, ka një rënie të lehtë të proceseve të përfunduara dhe një rritje të lehtë të proceseve që janë mbartur për vitin pasardhës në vitin 2024. Kjo ka ardhur si pasojë e kompleksitetit të problematikave apo përfundimit të afatit për zbatimin e vendimeve paralajmëruese gjatë periudhës, që përkon me fundin e vitit 2024.

Në përfundim të analizës mbi ecurinë e procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, vlen të theksohet se nisur nga përpjekjet serioze të institucioneve të mbikëqyrura për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në përputhje me detyrat e lëna nga Komisioneri në vendimet paralajmëruese, nuk ka qenë e nevojshme të aplikohen masa detyruese për gjobitjen e nëpunësve që administrojnë shërbimin civil. Bashkëpunimi nga ana e tyre ka qenë në nivel të lartë dhe efikas, e nga ana tjetër edhe ndihma e Komisionerit ka qenë e vazhdueshme, me qëllim që subjektet të kuptojnë detyrat e lëna dhe njëkohësisht të njohin edhe rrugët se si duhet të zbatohen ato.

Roli i Komisionerit është rritur ndjeshëm nga viti në vit, në drejtim të asistencës ndaj institucioneve dhe lehtësimit të punës së njërive të burimeve njerëzore nëpërmjet sqarimit të aspekteve të ndryshme ligjore në përmbajtjen e vendimeve paralajmëruese, por edhe nëpërmjet ndihmës së drejtpërdrejtë në subjekt në rastet kur është kërkuar prej tyre.

Kjo situatë na motivon për të vazhduar gjithmonë e më shumë përpjekjet dhe angazhimin tonë në përmbushje të qëllimit të ligjit për krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Tabela nr.8.1 Vendimet paralajmëruese për të cilat është përmbyllur procesi i mbikëqyrjes

NR.	INSTITUCIONI	VENDIMI PARALAJMËRUES
ADMINISTRATA SHETETËRORE DHE INSTITUCIONET NË VARËSI		
1.	Agjencia Kombëtare e Turizmit	Vendimi nr. 61, datë 9.5.2022
2.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Vendimi nr. 122, datë 12.10.2022
3.	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Vendimi nr. 38, datë 19.6.2024
4.	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Vendimi nr. 66, datë 12.11.2024
5.	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	Vendimi nr. 77, datë 27.9.2023

6.	Ministria e Drejtësisë	Vendimi nr. 60, datë 21.10.2024
7.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Vendimi nr. 74, datë 28.7.2023
8.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Vendimi nr. 17, datë 15.2.2023
9.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Vendimi nr. 21, datë 2.3.2023
10.	Ministria e Financave	Vendimi nr. 98, datë 30.11.2023
11.	Ministria e Drejtësisë	Vendimi nr. 18, datë 21.2.2023
12.	Ministria e Mbrojtjes	Vendimi nr. 23, datë 7.3.2023
13.	Ministria e Brendshme	Vendimi nr. 19, datë 28.2.2023
14.	Ministria e Drejtësisë	Vendimi nr. 62, datë 4.11.2024
15.	Ministria e Kulturës	Vendimi nr. 16, datë 15.2.2023
16.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Vendimi nr. 20, datë 28.2.2023
17.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Vendimi nr. 56, datë 27.9.2024
18.	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	Vendimi nr. 35, datë 31.5.2024
NJËSI TË QEVERISJES VENDORE		
19.	Bashkia Divjakë	Vendimi nr. 104, datë 7.12.2023
20.	Bashkia Vlorë	Vendimi nr. 82, datë 23.10.2023
21.	Bashkia Tiranë	Vendimi nr. 18, datë 15.2.2024
22.	Këshilli i Qarkut Dibër	Vendimi nr. 19, datë 1.3.2021
23.	Bashkia Vlorë	Vendimi nr. 99, datë 17.7.2022
24.	Bashkia Vlorë	Vendimi nr. 81, datë 13.10.2023
25.	Bashkia Patos	Vendimi nr. 19, datë 15.2.2024
26.	Bashkia Tropojë	Vendimi nr. 135, datë 11.11.2022
27.	Bashkia Elbasan	Vendimi nr. 3, datë 14.1.2022

Tabela nr.8.2 Vendimet paralajmëruese të cilat janë mbartur për vitin 2025

NR.	INSTITUCIONI	VENDIMI PARALAJMËRUES
INSTITUCIONET E PAVARURA		
1.	Presidenca	Vendimi nr. 15, datë 9.2.2024
NJËSI TË QEVERISJES VENDORE		
2.	Bashkia Peqin	Vendimi nr. 45, datë 24.7.2024
3.	Bashkia Gramsh	Vendimi nr. 40, datë 26.6.2024
4.	Bashkia Prrenjas	Vendimi nr. 23, datë 13.3.2024
5.	Bashkia Has	Vendimi nr. 22, datë 12.3.2024
6.	Bashkia Librazhd	Vendimi nr. 28, datë 9.4.2024
7.	Bashkia Belsh	Vendimi nr. 37, datë 19.6.2024
8.	Bashkia Kurbin	Vendimi nr. 42, datë 16.7.2024
9.	Bashkia Divjakë	Vendimi nr. 44, datë 24.7.2024
10.	Bashkia Kavajë	Vendimi nr. 5, datë 22.1.2024
11.	Bashkia Kuçovë	Vendimi nr. 54, datë 25.9.2024

2. Pjesëmarrja e Komisionerit në procese gjyqësore, në të gjitha rastet kur është thirrur nga gjykata si palë në pozita të ndryshme procedurale

Një nga veprimtaritë e Komisionerit përgjatë vitit 2024, ka qenë pjesëmarrja në seancat e zhvilluara nga gjykatat administrative për **19 procese gjyqësore**, ku Komisioneri është thirrur si palë e paditur apo palë e tretë nga nëpunësit civilë apo nga institucionet e administratës publike.

Në të gjitha rastet gjykimi ka pasur për objekt mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me institute të ndryshme të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pavarësisht nëse ka pasur ose jo një vendimmarrje nga ana e KMSHC-së. Pranë gjykatave më të larta janë për gjykim **56 procese administrative** për të cilat është realizuar kontroll i vazhdueshëm.

Ashtu siç e kemi theksuar edhe më parë, rekomandimet e Komisionerit, apo parashtimet e bëra prej tij përpara gjykatës kanë vijuar të vlerësohen të drejta dhe janë marrë në konsideratë nga këto të fundit, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri ka treguar një angazhim të veçantë në drejtim të forcimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet e administratës publike, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikojnë në zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil. Ky bashkëpunim nuk është kufizuar vetëm tek këto institucione, por është shtrirë edhe tek institucionet apo organizmat e tjerë vendas apo të huaj. Një pasqyrë e përmblendhur e veprimtarive të zhvilluara gjatë vitit 2024 në këtë drejtim, paraqitet në vijim të këtij kapitulli, duke evidentuar edhe aspektet e bashkëpunimit:

147

Bashkëpunimi në kuadër të zbatimit të parimit të llogaridhënies, para Kuvendit të Shqipërisë

Një nga dimensionet kryesore të veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është bashkëpunimi i vazhdueshëm me Kuvendin e Shqipërisë, si pjesë e mekanizmit të llogaridhënies dhe zbatimit të detyrimeve ligjore. Ky bashkëpunim shtrihet si në kuadrin e raportimeve të rregullta vjetore dhe periodike, ashtu edhe në kontributin e dhënë për miratimin e buxhetit, apo aspekte të tjera, të cilat do të evidentohen në vijim:

Bashkëpunimi në kuadër të llogaridhënies

Raportim i veprimtarisë për vitin 2023 përpara Kuvendit të Shqipërisë.

Raportim vjetor periodik 1-vjeçar në kuadër të zbatimit të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2023, si dhe raportim 4-mujor për detyrat e lëna në rezolutë për vitin 2024, dërguar Drejtorisë së Shërbimeve të Monitorimit.

Raportim periodik vjetor, 4-mujor dhe 6-mujor në kuadër të mekanizmit të ngritur pranë Kuvendit të Shqipërisë për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, dërguar Drejtorisë së Shërbimeve të Monitorimit.

Raportim periodik 1-vjeçar, 4-mujor dhe 6-mujor në lidhje me veprimtarinë e përgjithshme të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në zbatim të ligjit, dërguar Drejtorisë së Shërbimeve të Monitorimit

Pjesëmarrja në mbledhjet e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Gjatë vitit 2024, Komisioneri ka qenë i pranishëm në mbledhjet e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku janë diskutuar:

Kërkesat për ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014, i cili rregullon strukturën dhe organikën e Komisionerit, pas përshtatjes së tyre me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.325, datë 31.05.2023, *“Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të*

zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”;

Projektligji për buxhetin e vitit 2025, ku Komisioneri ka paraqitur mendimin e tij në lidhje me buxhetin e akorduar.

Pjesëmarrja në mbledhjet apo takimet e organizuara nga Drejtoria e Shërbimeve të Monitorimit

Komisioneri ka marrë pjesë në mbledhjen e organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve të Monitorimit, ku janë dhënë sqarime mbi metodologjinë e hartimit të raporteve vjetore dhe trajtimin e problematikave të hasura në këtë drejtim.

Komisioneri ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë me institucionet e pavarura, në lidhje me rrjetin ndërinstitutional të koordinatorëve, duke ndarë praktika dhe sfida për rritjen e efektivitetit të monitorimit dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.

Gjithashtu, stafi i Komisionerit ka pasur komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Shërbimeve të Monitorimit për çështje specifike në lidhje me veprimtarinë e Komisionerit apo mbi zbatimin e ligjit për shërbimin civil.

Ky bashkëpunim i ngushtë dhe i vazhdueshëm reflekton angazhimin e Komisionerit për forcimin e transparencës institucionale, zbatimin e parimeve të shërbimit civil dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore në raport me Kuvendin e Shqipërisë dhe reformat e administratës publike.

Bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, në zbatim të detyrave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë

Një nga drejtimit kryesore të veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka qenë dhe mbetet forcimi i bashkëpunimit me institucionet kyçe që luajnë një rol vendimtar në administrimin dhe zhvillimin e shërbimit civil në Shqipëri. Në këtë kuadër, një rëndësi të veçantë ka pasur bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike (DAP) dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), sidomos në drejtim të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2024.

Në funksion të kësaj detyre, me shkresat nr. 464 prot., datë 22.07.2024 dhe nr. 493 prot., datë 29.08.2024, Komisioneri ka kërkuar nga DAP dhe ASPA angazhimin për hartimin dhe zbatimin e kurrikulave të posaçme për trajnimin e burimeve njerëzore të njësisë të vetëqeverisjes vendore (NJQV-ve), në lidhje me popullimin me të dhëna të regjistrit të

personelit **HRMIS** dhe platformës së bashkëpunimit www.administrata.al, e cila shërben si një mjet i rëndësishëm për shkëmbimin e informacionit dhe standardizimin e praktikave administrative në të gjithë administratën publike. Njëkohësisht, Komisioneri ka kërkuar bashkëpunimin e këtyre institucioneve në lidhje me detyrat e mëposhtme:

Forcimin e zbatimit të ligjit për shërbimin civil, duke siguruar që dispozitat e tij të zbatohen në mënyrë uniforme dhe të qëndrueshme në të gjitha institucionet e administratës publike.

Përmirësimin e situatës në lidhje me përputhshmërinë e përshkrimeve të punës me kategoritë e përcaktuara në ligjin e shërbimit civil në të gjithë administratën publike.

Përmirësimin e procesit të rikthimit në punë të nëpunësve civilë.

Vlerësimin mbi impaktin që sjell ndryshimi i regjimit juridik të marrëdhënies së punës në një institucion shtetëror, nga marrëdhënia e punës e cila rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, në marrëdhënie pune e normuar sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional mbetet një shtyllë e rëndësishme për përmirësimin e administrimit të shërbimit civil në vend dhe për garantimin e një administrate publike të qëndrueshme, profesionale dhe të bazuar në meritë e integritet moral.

Bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues

Gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri ka zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Administratës Publike (DAP) për të adresuar sfidat e hasura në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet shtetërore. Ky angazhim ka pasur si qëllim kryesor sigurimin e një zbatimi të plotë dhe në kohë të këtyre vendimeve, duke eliminuar pengesat procedurale dhe institucionale që kanë vonuar ekzekutimin e tyre.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë identifikuar problematikat kryesore që kanë ndikuar në zvarritjen e procesit dhe janë propozuar zgjidhje konkrete për të përmirësuar mekanizmat e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Kjo ka përfshirë ndërhyrje në nivelin e koordinimit ndërinstitucional, harmonizimin e praktikave administrative dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve për të garantuar respektimin e të drejtave të nëpunësve civilë të përfshirë në këto procese.

Pjesëmarrja në Mbledhjet e Komisioneve të Posaçme

Përfaqësues të Komisionerit kanë marrë pjesë aktivisht në mbledhjet e Komisioneve të Posaçme të ngritura pranë institucioneve shtetërore, të cilat

analizojnë mundësitë për sistemimin e nëpunësve gjyqfitues në pozicione të rregullta brenda shërbimit civil. Kjo përfshirje ka synuar të sigurojë që procesi i rikthimit dhe sistemimit të tyre të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar parimet e meritokracisë,

barazisë dhe qëndrueshmërisë në shërbimin civil.

Pjesëmarrja e Komisionerit në këto mbledhje ka shërbyer si një mekanizëm mbikëqyrës për të garantuar që vendimet të bazohen në kritere të qarta ligjore dhe të mos ketë shmangie apo praktika të paqarta që mund të dëmtojnë parimin e

ligjshmërisë në administrimin e burimeve njerëzore. Përmes këtij angazhimi, Komisioneri ka dhënë kontributin e tij në forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në sistemin e shërbimit civil, duke nxitur një administratë publike më funksionale dhe në përputhje me standardet ligjore.

Bashkëpunimi midis Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe aktorë të tjerë me ndikim në kuadër të procesit të strukturimit të NJQV-ve

Një aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit të Komisionerit, siç është evidentuar edhe në kapitullin përkatës të këtij raporti në lidhje me mbikëqyrjen e orientuar mbi aplikimin e skemës së shërbimit civil në procesin e miratimit të strukturave të institucioneve të administratës vendore për vitin 2024, ka qenë edhe ai me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, si institucion që mbështet NJQV-të në zbatimin e politikave të vetëqeverisjes vendore, por jo vetëm.

Me qëllim adresimin e problematikave të konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të strukturimit të këtyre njësive ndër vite, përpos udhëzimeve të mëparshme dhe asistencës së vazhdueshme për shkak të kompleksitetit të një sërë instituteve të ligjit për shërbimin civil që zbatohen gjatë këtij procesi, njëkohësisht, duke pasur parasysh edhe ndryshimet e realizuara nëpërmjet vendimit nr. 328, datë 31.05.2023 dhe vendimit nr. 503, datë 01.08.2024, të Këshillit të Ministrave, në lidhje me kufijtë e pagave dhe kategorizimin e pozicioneve në administratën vendore, Komisioneri hartoi një udhëzues (*nr. 654 prot., datë 02.10.2024*), i cili i është dërguar menjëherë të gjitha subjekteve vendore.

Njëkohësisht, për shkak të rolit apo funksioneve që këto institucione kanë në zbatim të ligjit, ky udhëzues i është dërguar edhe Prefektit të Qarkut, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Departamentit të Administratës Publike.

Më tej, në kuadër të përpjekjeve për harmonizimin e strukturave të administratës vendore me aktet nënligjore përkatëse, duke vlerësuar kontributin e rëndësishëm të AMV-së edhe në hartimin e Manualeve Orientuese për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të ndara sipas madhësisë së bashkive, Komisioneri i është drejtuar AMV-së me një kërkesë për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në takimet e punës të me NJQV-të, takime të cilat u zhvilluan në datat 22-24 tetor 2024. Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e AMV-së në nivel eksperti ndihmuan në sqarimin e problematikave praktike që lidhen me zbatimin e manualeve dhe përshtatjen e strukturave vendore me aktet nënligjore në fuqi.

Diskutimet kryesore në të cilat u përqendruan këto takime ishin:

Vlerësimi i pozicioneve të punës: Përcaktimi përfundimtar i listës së pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil.

Trajtimi i punonjësve: Rregullimi i situatës për ata punonjës që do të preken nga rivlerësimi dhe ristrukturimi, duke u

siguruar që të kenë dëmshpërblim sipas vjetërsisë në punë në rastet e lirimit.

Zgjidhja e problemeve ligjore: Adresimi i situatave të punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin, të cilët nuk mund të sistemohen në pozicione të shërbimit civil pas procesit të ristrukturimit.

151

Bashkëpunimi i Komisionerit me institucione kombëtare, misione të huaja dhe institucione homologe

Në funksion të garantimit të një administrate publike të qëndrueshme, transparente dhe në përputhje me parimet e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Komisioneri ka zhvilluar një sërë aktivitete dhe ka forcuar bashkëpunimin me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky angazhim është reflektuar në takime të nivelit të lartë, konsultime teknike dhe shkëmbime ekspertize me aktorë të ndryshëm, me qëllim përmirësimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe adresimin e sfidave sistematike.

Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Në datën 4 dhjetor 2024, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, si ndërlidhës i bashkëpunimit ndërinstitucional mes Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, organizoi një takim me përfaqësues të nivelit të lartë të këtyre institucioneve dhe drejtues të Projektit PACEP për vlerësimin e ecurisë së procesit të monitorimit dhe zbatimit të rekomandimeve të nxjerra prej tyre në ushtrim të veprimtarisë në zbatim të ligjit. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Ky takim theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të rekomandimeve/vendimeve, dhe nevojën për një metodologji të standardizuar për

monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve/vendimeve.

Takim dypalësh me ekspertë të misionit të SIGMA-s

Gjatë periudhës së raportimit, në ambientet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u zhvillua një takim me përfaqësues të institucionit dhe ekspertë të misionit të SIGMA-s për fushën e monitorimit *“Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimi Publik”*.

Në fokus të këtij takimi ishte mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për shërbimin civil dhe funksionimi i Komisionerit, kuadri ligjor, të dhëna statistikore në lidhje me kërkesat/informacionet e depozituara pranë Komisionerit nga nëpunësit civilë, si dhe problemet kryesore të konstatuara dhe rekomandimet sistematike të nxjerra nga Komisioneri.

Takime të përbashkëta pune me përfaqësues të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në kuadër të Marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit

Në kuadër të zbatimit të angazhimeve të parashikuara në Marrëveshjen dypalëshe të bashkëpunimit, të nënshkruar më 3 nëntor 2022, Komisioneri ka zhvilluar katër takime të përbashkëta pune me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në fokus të këtyre takimeve ka qenë shkëmbimi i përvojave dhe përmirësimi i mekanizmave të mbikëqyrjes së shërbimit civil në të dy vendet.

Takimi i përbashkët me përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Bashkëpunimi i Komisionerit me Kryeministrinë dhe kontributi i tij institucional në lidhje me Takimin e XII-të të Nënkomitetit/Grupit të Posaçëm Bashkimi Evropian – Shqipëri

Në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe angazhimeve ndërinstitucionale për procesin e integritetit evropian, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka bashkëpunuar me Kryeministrinë në lidhje me përfaqësimin e institucionit në Takimin e XII-të të Nënkomitetit/Grupit të Posaçëm Bashkimi Evropian – Shqipëri për zbatimin e Reformës në Administratën Publike, i cili u mbajt në Bruksel më 27 qershor 2024.

Përveç pjesëmarrjes në këtë takim të rëndësishëm, Komisioneri ka kontribuar në procesin e raportimit duke përgatitur

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil zhvilloi një takim të përbashkët informues dhe ndërgjegjësues me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky aktivitet kishte për qëllim theksimin e rëndësisë së transparencës si parim themelor për besueshmërinë dhe integritetin e institucioneve publike, duke synuar rritjen e besimit dhe mbështetjes së qytetarëve ndaj administratës publike.

Gjatë takimit, u diskutua mbi rolin e transparencës në sigurimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale, e cila bazohet në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

dhe dorëzuar kontributin e përditësuar institucional në lidhje me zhvillimet dhe sfidat në fushën e reformës në administratën publike, bazuar në veprimtarinë e institucionit në zbatim të ligjit.

Sa më sipër nënvizon rolin e Komisionerit në procesin e reformës në administratën publike dhe bashkëpunimin e tij të vazhdueshëm me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në përmbytje të angazhimeve të vendit në lidhje me procesin e integritetit evropian.

Kontributi i Komisionerit në kuadër të strategjive kombëtare

Kontributi në draftimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit (SNKK) 2024-2030

Pjesëmarrje në takim me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, si dhe kontribut i Komisionerit në draftimin e tekstit të SNKK 2024 – 2030 dhe planit të veprimit të kësaj strategjie, për pjesën që i takon Komisionerit.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të Strategjisë për Integrimin në BE

Komisioneri ka bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të Strategjisë për Integrimin në Bashkimin Evropian, bashkëpunim i cili është shtrirë në drejtim të aksesimit të Platformës për Integrimin Evropian (PIEA) dhe vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave për integrimin në BE CAF.

Komente mbi Strategjinë Kombëtare për Reformën në Administratën Publike (SNRAP 2030)

Komisioneri ka dhënë komentet e veta mbi draftin e SNRAP 2030 dhe Planin e Veprimit 2024-2026, të këtij dokumenti strategjik.

Përfshirja e Komisionerit në grupet ndërinstitucionale të punës GNPIE dhe GNPRAP

Pjesëmarrje në takimin e GNPIE

Komisioneri mori pjesë në takimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), të organizuar nga Ministria e Drejtësisë, ku u diskutua për Kapitullin 23 “*Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore*” dhe kriterin politik.

Komunikimi me DAP dhe Ministrinë e Drejtësisë mbi GNPRAP – Komisioneri ka vijuar komunikimin dhe ka dhënë përgjigje ndaj kërkesave të ardhura nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë lidhur me përditësimin e listës së anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës për kriterin “*Reforma në administratën Publike*”.

BURIMET NJERËZORE DHE MENAXHIMI FINANCIAR GJATË VITIT 2024

154

Komisioneri e ka menaxhuar buxhetin vjetor nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si njësi organizative e strukturës së institucionit, e ngarkuar me zbatimin e buxhetit. Baza ligjore që orienton veprimtarinë financiare të institucionit përfshin kryesisht ligjin nr.10296, datë 8.07.2010, “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij; Rregulloren e Brendshme të Institucionit dhe Planin Vjetor të Punës, të miratuar nga Komisioneri për vitin 2024. Po kështu, është vepruar në zbatim të buxhetit të institucionit, të akorduar për periudhën Janar-Dhjetor 2024. Nëpërmjet kësaj veprimtarie, është siguruar mbarëvajtja e punëve dhe funksionimi i brendshëm i institucionit, duke mbajtur në vëmendje miradministrimin dhe përdorimin me efektivitet të burimeve ekonomike, financiare dhe materiale, në përputhje me parimet dhe rregullat e menaxhimit financiar.

Në detyrat e saj funksionale, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si çdo vit, analizon dhe realizon kërkesat për gjithshka ka të bëjë me nevojat e institucionit, duke filluar nga pajisjet bazike të punës deri në mbulimin dhe mbështetjen financiare të aktivitetit të tij.

1. Struktura organizative dhe organizimi i brendshëm

Veprimtaria e institucionit ushtrohet në përputhje me strukturën dhe organikën bazuar në Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2014 “*Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*”, ndryshuar me Vendimin nr. 37/2024, “*Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, dhe Vendimin nr. 91/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, të Kuvendit.*

Organika e miratuar e Komisionerit përbëhet prej 37 punonjësish. Bazur në planin vjetor të rekrutimit, si dhe ndryshimet e tij, përgjatë vitit 2024 janë kryer gjithsej 2 procedura rekrutimi.

Gjatë zhvillimit të këtyre procedurave, është aplikuar instituti i ngritjes në detyrë dhe nxitja për të zhvilluar shkallët e karrierës. Punonjës të institucionit kanë shfaqur interes dhe janë bërë pjesë e proceseve të konkurrimit dhe kanë fituar në disa prej tyre. Nga ana tjetër, edhe nëpunës civilë në institucione të tjera kanë marrë pjesë në konkurs dhe janë shpallur fitues. Këto procese kanë shënuar zhvillim të karrierës së nëpunësit civil si brenda institucionit, ashtu edhe brenda sistemit të shërbimit civil.

Në fund të vitit 2024, në organikën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë 34 punonjës, si rezultat i dorëheqjes nga detyra.

1.1 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, përgjatë vitit 2024 është fokusuar në disa drejtime:

Zbatimi me rigorozitet i kuadrit rregullator ligjor të fushës;

Dokumentimi dhe zbatimi i praktikave në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Sigurimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Rekrutimi i individëve me rezultate të mira të arsimit në një ose dy degë diplomimi;

Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional, zhvillimit të kapaciteteve, si dhe kryerjes së trajnimeve në mënyrë të vijueshme;

Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi objektiv të vlerësimit të stafit bazuar në performancë, në përmbushjen e objektivave individuale dhe kërkesave të kompetencave profesionale e të tjera

Referuar përmirësimit të funksionit organizativ e institucional dhe objektivave të trajnimit, të vendosura për vitin 2024, njësia përgjegjëse e institucionit, si çdo fillim viti, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ka analizuar nevojat për trajnim, e më pas ka hartuar kalendarin e trajnimeve.

Në kalendar janë detajuar nevojat specifike të çdo njësie organizative për trajnime individuale të punonjësve të tyre. Këto trajnime të parashikuara për vitin raportues u realizuan në disa forma, por, edhe këtë vit, kryesisht u zhvilluan në distancë, nëpërmjet platformave të ndryshme *online*.

Përsa i përket trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove “*Prezantimi me administratën publike*”, trajnim që mundësohet, planifikohet dhe organizohet nga ASPA, një nëpunës civil në periudhë prove i rekrutuar gjatë vitit 2023 zhvilloi trajnimin e detyrueshëm gjatë vitit 2024 sipas planifikimit të ASPA.


Nga ana tjetër, pjestarë të stafit të Komisionerit, kanë marrë pjesë si trajnerë në përbërje të trupës së ekspertëve të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, kryesisht me fokus trajnimi temat që kanë lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, duke u kujdesur që të evidentohen dhe trajtohen edhe problematikat e konstatuara gjatë mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, sidomos me target grupet me pjesëmarrës nga njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve me tipologji të ndryshme në sistemin e shërbimit civil.

Po kështu, pjesëtarë të stafit të Komisionerit, vazhdojnë të japin kontributin e tyre edhe si pjestarë të trupës mësimdhënëse në universitetet e vendit, duke u përpjekur që të rrisin dijet e tyre, t'i ndërthurin ato me praktikën institucionale dhe t'i transmetojnë me profesionalizëm tek studentët.

Në vijim të detyrimeve ligjore të njësise përgjegjëse, janë mbikëqyrur dhe administruar burimet njerëzore të institucionit në zbatim të parimeve dhe kritereve të legjislacionit në këtë fushë, si dhe janë kryer proceset e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve, në përputhje me afatet ligjore.

156

Një tregues mjaft i rëndësishëm i politikave të burimeve njerëzore është edhe përfaqësimi gjinor për Nivelin e Mesëm dhe të Lartë Drejtues, në institucion, i cili reflektohet në numrin e konsiderueshëm të grave:



Burra 24%



Gra 76%



Siç shihet edhe nga treguesit grafikë, gratë në pozicione drejtuese përfaqësohen me 6 pozicione pune, kundrejt 1 pozicioni që përfaqësohet me drejtues burrë.

Në të njëjtin trend është edhe raporti gra/burra në gjithë stafin e KMSHC-së për vitin 2024, pasi qendron 26 gra me 8 burra.

2. Menaxhimi financiar

2.1 Realizimi i treguesve ekonomiko-financiar

Me ligjin nr. 97/2023 *“Për buxhetin e shtetit të vitit 2024”*, fondet e akorduara për funksionimin normal institucional në total u miratuan në vlerën **97.966.000 Lekë**, përfshirë edhe fondin e veçantë.

Në zbatim të këtij buxheti, si dhe pas realizimit dhe finalizimit të procedurave të prokurimit u morën masa konkrete, duke rishikuar dhe orientuar shpenzimet buxhetore drejt aktiviteteve kryesore të institucionit, në respektim të parimeve dhe rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në lidhje me procedurat e prokurimit publik gjatë vitit 2024 janë realizuar:

11 (njëmbëdhjetë) procedura prokurimi nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit publik (SPE);

7 (shtatë) procedura prokurimi me *“vlerë të vogël”*,

3 (tre) procedura të realizuara nëpërmjet *“sistemit dinamik”*,

1 (një) procedurë prokurimi *“e hapur e thjeshtuar”*. Kjo e fundit është realizuar 2 herë (procedurë e anuluar pasi asnjë nga operatorët nuk përmbushte kërkesat sipas DST-së),

11 (njëmbëdhjetë) procedura blerjeje me *“vlerën nën 100 000 lekë (pa tvsh)”*.

Procedurat janë realizuar sipas legjislacionit të hartuar dhe miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si dhe nga urdhrat, manualët, udhëzimet dhe rekomandimet e publikuara në faqen zyrtare gjatë gjithë vitit 2024.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i alokuar për vitin 2024, deri në 31 Dhjetor 2024 u shpenzuan **89.738.557,32** (lekë), ose **92 %**, e planit vjetor.


Tabela me poshtë pasqyron realizimin në vlerë për çdo kategori shpenzimesh dhe në përqindje përkundrejt totalit të buxhetit të akorduar.

Tabela nr.10.1 Realizimi në vlerë i shpenzimeve në raport me buxhetin e akorduar

Llogari Ekonomike	Përshkrimi	Plani i buxhetit, viti 2024 (në mijë lekë)	Realizimi i buxhetit, viti 2024 (në mijë lekë)
600	Fond Page	67,041,000	63,281,024
601	Kontributi për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	11,650,000	10,096,293
602	Mallra dhe shërbime të tjera	16,350,000	15,566,881

605	Transferta korente jashtë vendit	200,000	86,159
606	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	725,000	718,200
230-231	Shpenzime kapitale	2,000,000	0
TOTALI		97,966,000	89,738,557
Në % kundrejt totalit			92%

Grafiku nr.10.1 Realizimi në vlerë i shpenzimeve në raport me buxhetin e akorduar



Ashtu si vihet re, janë realizuar/përdorur fondet buxhetore në masën 92%. Ky mosrealizim ka ardhur kryesisht në artikujt si më poshtë renditur:

Grupartikulli **600-601** është realizuar në vlerën 73,377,317 lekë ose 93.2%. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e vendeve vakante të krijuara gjatë vitit kalendarik, plotësimi i të cilave kërkon më tej realizimin e procedurave të rekrutimit sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Grupartikulli **602-606** është realizuar në vlerën 16,361,240.32 lekë ose 94.7%. Ky mosrealizim është diktuar kryesisht nga sjellja e tregut gjatë proceseve të prokurimit, ku në shumicën e rasteve kanë rezultuar me oferta relativisht të ulëta deri afer 50% e fondit limit përkatës. Kjo ka kushtëzuar

përsëritjen e procedurave të prokurimit në disa raste.

Grupartikulli **231**. Edhe pse puna me fazat e përgatitjes për procedurën me objekt *“Krijimi i sistemit të ruajtjes dhe menaxhimit të praktikave të punës së KMSHC”*, filloi që prej muajit Mars 2024, investimi në shumën prej 2,000,000 leke, i parashikuar për këtë zë buxheti nuk arriti të realizohej deri në fund të vitit 2024. Në përputhje të nenit 49, të ligjit nr. 160/2020, *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar si dhe nenit 55, të VKM-së 285/2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka parashkuar që kjo procedurë të kryhej nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit publik me anë të procedurës e *“hapur e thjeshtuar”*. Pas ofertimit, operatori i vetëm ekonomik *“NAOL”* shpk nuk u kualifikua për shkak të mungesës së dokumentacionit në përputhje me kërkesat në DST. Me aktin nr. 192/15 pro., datë 13.12.2024, për shkak se për procedurën me një fazë nuk u dorëzua asnjë ofertë e përshtatshme kjo procedurë u anulua.

Panvarësisht problematikave të hasura si më lart por jo vetëm, jemi munduar të punojmë dhe do të vijojmë të punojmë në drejtim të sigurimit të një procesi të pavarur dhe efikas zbatimi dhe monitorimi, me qëllim që të parandalohen shkeljet e ligjit dhe të rregulloreve në fuqi.

Si përfundim, duke vlerësuar sa evidentuam në këtë rubrikë të raportit, për vitin tjetër kalendarik do të punojmë për të arritur disa objektiva si në drejtim të mirëadministrimit të burimeve njerëzore ashtu edhe në drejtim të përdorimit të fondeve publike me efektivitet, ekonomi dhe eficensë si:

Rritjen e nivelit të zbatimit të Rregullores së Brendshme (e ndryshuar), e cila do të ndikojë drejtpërsëdrejti në zbatim të detyrave të përcaktuara, duke forcuar strukturën përgjegjëse për kontrollin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të Kodit të Etikës dhe vlerësimin e integritetit të stafit të Komisionerit.

Angazhim maksimal në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, për menaxhimin e burimeve njerëzore, duke garantuar ushtrimin e aktivitetit të institucionit dhe minimizuar riskun e evidentuar (*mungesë stafi nga lëvizjet e mundshme*).

Koordinimi i detyrave të strukturave për identifikimin e nevojave për mallra, shërbime apo punë, për hartimin në kohë nga strukturat e prokurimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe

Me aktin nr. 192/16 prot., datë 13.12.2024, u publikua në sistem edhe një herë njoftimi i shkurtuar i kontratës me numër REF 33220-12-13-2024, i cili u publikua në Buletinin e Prokurimit Publik nr. 88, datë 23.12.2024. Perseri, dy operatorët pjesmarrës nuk mund të kualifikoheshin për të vijuar më tej për shkak të mungesës së theksuar të dokumentacionit të kërkuar në DST.

fillimin dhe përfundimin në kohë të procedurave të tenderimit online me vlera të vogla ose të mëdha, duke garantuar tregues në rritje të realizimit të buxhetit.

Përfundimi në kohë i procesit të vlerësimit të punonjësve në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Rritja e profilit publik të KMSHC-së nëpërmjet rikonceptimit të faqes zyrtare.

Rritja e komunikimit të brendshëm në KMSHC dhe shkëmbimit të informacionit midis Drejtorive.

Përmirësimin e vazhdueshëm të ambientit të IT në orientimin e buxheteve të investimeve, në krijimin dhe instalimin e platformave IT në funksion të modernizimit të menaxhimit të proceseve të punës dhe atyre logjistike mbështetëse.

Zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus të veçantë, thellimin e njohurive në fushën e përparimeve dhe ndryshimeve të legjislacionit të shërbimit

civil, por jo vetëm, si detyrim specifik që buron nga legjislacioni i përmirësuar.

Në vitin 2024, është bërë rikonceptimi i faqes së KMSHC, ku përveç dizenjimit dhe strukturës janë shtuar edhe rubrika të reja të cilat lidhen me misionin, aktivitetin dhe veprimtarinë institucionale. Rubrikat dhe menutë e shtuara në faqe kanë një rol shumë të rëndësishëm në rritjen e informimit dhe transparencës. Ato mundësojnë një qasje më të lehtë dhe më të qartë për vizitorët, duke i ndihmuar ata të gjejnë shpejt informacionin që kërkojnë.



Përdorimi i rubrikave të strukturuar bën që përmbajtja të jetë e organizuar dhe e kuptueshme, duke mundësuar një akses më të shpejtë dhe të saktë të informacionit. Për më tepër, duke ofruar mundësi të ndryshme për të kërkuar dhe filtruar përmbajtjen, faqja rrit besimin e përdoruesve, pasi ata ndihen më të informuar dhe të sigurt në marrëdhënien e tyre me faqen dhe institucionin. Ndër rubrikat më me interes, mund të përmendim:

Hapësira e dedikuar për Njësitë e Qeverisjes Vendore, për orientimin e tyre në lidhje me strukturën dhe transferimin e nepunësve civil për shkak të ristrukturimit të institucioneve të tyre, sëbashku me aktet

model që materializojnë praktikën, hap pas hapi.

Kalendarin, me njoftimin në kohe reale, për takimet e zhvilluara me të gjitha

institucionet në nivel qarku, në lidhje me rolin e Komisionerit për zbatimin e ligjit për nëpunësit civil.

Shtimi i listës së të dhënave të hapura, për informimin e nëpunësve dhe çdo të interesuari në lidhje me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Rubrika për statistikat dhe inspektimet e kryera nga Komisioneri në përfundim të raportimit për veprimtarinë e vitit 2023.

Publikimi i Udhëzuesit për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me "Platformat" apo "Rrjetet sociale" që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën.

Publikimi i Udhëzuesit në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022.

Qëndrimet e Komisionerit lidhur me unifikimin e praktikës në sistemin e shërbimit civil.

Publikimi i materialeve ndërgjegjëse në lidhje të gjitha institutet e ligjit, për informimin e nëpunësve të shërbimit civil.

Rubrika për "*Pyetje dhe Përgjigje*", ku shpjegohen në mënyrë të detajuar pyetjet më të shpeshta që lidhen me sistemin e shërbimit civil.

Përditësimi i vazhdueshëm i urdhërave, vendimeve dhe raporteve përfundimtare të dala nga Komisioneri, në fillim dhe në përfundim të mbikëqyrjeve dhe në rastet e trajtimit të infomacioneve/kërkesave.

Miratimi dhe publikimi i formularit të kërkesë/informacionit me të cilin çdokush mund t'i drejtohet Komisionerit për shkeljen që pretendojnë se është kryer.

NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si institucion i pavarur, i cili i nënshtrohet detyrimit për raportimin në Kuvendin e Shqipërisë, e po kështu edhe në funksion të zbatimit të Vendimit nr. 49/2017 të Kuvendit, *“Për monitorimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj të veçantë”*, raporton për veprimtarinë e tij në bazë të kompetencave ligjore, si edhe për realizimin e detyrave specifike që janë lënë nga Kuvendi për vitin 2024, nëpërmjet rezolutës që miraton veprimtarinë e tij. Sa më sipër, në këtë rubrikë të raportit, po parashtrijmë ecurinë e realizimit të tyre, duke i përcaktuar ato në mënyrë specifike, ashtu si do të paraqiten në vijim, në raport me nivelin e zbatimit të tyre:

162

Pika 1 e rezolutës është realizuar plotësisht:

1. Komisioneri duhet të angazhohet në bashkëpunim me DAP-in për zbatimin në mënyrë të rregullt nga e gjithë administrata publike të dispozitave të ligjit për shërbimin civil.

Në përmbushje të kësaj detyre, por edhe të angazhimeve të marra përsipër nga të dy palët në Memorandumin e Bashkëpunimit midis dy institucioneve, Komisioneri i është drejtuar DAP-it me shkresën nr.464 prot., datë 22.07.2024, *“Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të realizimit të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2023”*”, përmes së cilës e ka njohur DAP me detyrat e lëna nga Kuvendi, dhe ka propozuar organizimin e një takimi pune dypalësh. Ky takim është zhvilluar në datë 25 korrik 2024, në ambientet e Komisionerit, ku u diskutuan dhe u dakordësuan aspekte konkrete të bashkëpunimit, të cilat janë ndjekur më tej gjatë gjithë vitit kalendarik.

Vlen të përmendet rasti i bashkëpunimit midis dy institucioneve tona, për unifikimin e praktikës në rastet kur nëpunësit civilë ndiqen penalisht, apo dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë.

Ky është një moment kur institucionet shpesh kanë paqartësi për mënyrën se si duhet të veprojnë me marrëdhënien e punës të nëpunësit civil që është subjekt i ndjekjes penale dhe kërkojnë interpretim nga Komisioneri.

Në kushtet kur këto raste lidhen me integritetin dhe pastërtinë e figurës së nëpunësve civilë dhe Departamenti i Administratës Publike është institucioni i ngarkuar me ligj të posaçëm për verifikimin e tyre, Komisioneri e ka vënë në dijeni për qëndrimin që ka mbajtur në të gjitha rastet dhe, njëkohësisht, i ka orientuar institucionet që kanë nevojë për asistencë, që t'i drejtohen DAP, si institucion i specializuar në këtë fushë.

Po kështu, Komisioneri është konsultuar me Departamentin e Administratës Publike, për të arritur në qendërime të unifikuara, në përgjigje të kërkesës për asistencë që ka ardhur prej institucioneve të administratës vendore, gjatë aplikimit të ndryshimeve në aktin nënligjor që rregullon kategorizimin e pozicionit të punës dhe pagës së nëpunësve civilë në këto institucione. Në këtë rast është kërkuar eksperiencia e DAP, si institucion i specializuar në këtë fushë, për t'i dhënë një zgjidhje uniforme të gjitha pyetjeve të drejtura nga kjo tipologji institucionesh.

Ndërkohë, janë shkëmbyer eksperiencia midis institucioneve tona, edhe në drejtim të unifikimit të procedurave që aplikohen për pranimin në shërbimin civil, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë. Gjatë monitorimit të këtyre proceseve pranë Departamentit të Administratës Publike, Komisioneri ka evidentuar praktikën më të mira dhe i ka paraqitur ato si model, për t'u zbatuar nga të gjithë institucionet e sistemit të shërbimit civil.

Pika 2 e rezolutës është realizuar plotësisht:

2. Komisioneri duhet të vijojë angazhimin e tij në bashkëpunim me DAP-in për përmirësimin e situatës, në lidhje me përputhshmërinë e përshkrimeve të punës me kategoritë e përcaktuara në ligjin e shërbimit civil në të gjithë administratën publike.

Në zbatim të kësaj detyre, Komisioneri ka marrë masat e mëposhtme:

Kërkesë për Bashkëpunim me DAP - Në shkresën e sipërpërmendur nr.464 prot., datë 22.07.2024, Komisioneri ka kërkuar, ndër të tjera, bashkëpunimin e DAP-it, edhe sa i takon kësaj detyre, në kushtet kur DAP është institucioni përgjegjës i ngarkuar nga ligji për hartimin e politikave dhe të akteve ligjore e nënligjore për shërbimin civil, si dhe të udhëzimeve dhe manualeve që garantojnë zbatimin e unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil.

Shtimi në Planin Vjetor të Punës të mbikëqyrjeve me objekt përshkrimet e punës - Përveç rasteve të planifikuara në Planin Vjetor të punës, ku ky aspekt ka qenë i parashikuar midis të tjerash në objektin e mbikëqyrjeve të përgjithshme, pas daljes së rezolutës së Kuvendit, për të monitoruar dhe siguruar përputhshmërinë e përshkrimeve të punës me kategoritë e përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil në të gjithë administratën publike, Komisioneri ka shtuar në Planin Vjetor të Punës procesin e mbikëqyrjes së përshkrimeve të punës si një objekt të veçantë.

Në këtë proces, i cili ka si qëllim evidentimin e situatës aktuale, identifikimin e problematikave dhe, nëse është rasti, lënien e detyrave për marrjen e masave për përmirësimin e kësaj përputhshmërie në subjektet e monitoruara, u përfshinë 2(dy) institucione të administratës shtetërore (*ministri*). Aktualisht, ky proces është përmbyllur dhe përfundimet në lidhje me të janë analizuar në mënyrë të hollësishme në rubrikën përkatëse në raportin vjetor.

Gjatë procesit të unifikimit të strukturave në administratën vendore, Komisioneri ka dërguar pranë DAP, udhëzuesin që ka nxjerrë në këtë rast, ku janë dhënë orientime edhe në lidhje me hartimin e përshkrimit të punës. Në vijim të këtij procesi bashkëpunimi, DAP ka orientuar në

disa raste institucionet e administratës vendore, për mënyrën se si duhet të veprojnë, në lidhje me kategorizimin e pozicioneve të punës, e sidomos të kategorisë së pagës për pozicione specifike pune.

Ndërkohë, plotësimi i kriterëve të vendit të punës në përputhje me përshkrimin e punës, është në një proces verifikimi të vazhdueshëm, që kryhet në të gjitha mbikëqyrjet e realizuara.

3. Komisioneri, në ndihmë të institucioneve të administratës vendore, duhet të vijoje punën në kuadër të përmirësimit të organizimit të brendshëm të burimeve njerëzore (për nëpunësit e shërbimit civil), me qëllim standardizimin e strukturës organizative të institucioneve dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Pika 3 e rezolutës është realizuar plotësisht:

Me vendimin nr.9, datë 30.01.2024, Komisioneri ka nisur mbikëqyrjen e orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (*bashki*) për vitin 2024. Gjatë këtij procesi, Komisioneri i ka asistuar në mënyrë të vazhdueshme këto institucione sa i përket aspekteve teknike, nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me personat e kontaktit të autorizuar prej tyre, me qëllim që të parandalohen shkeljet ligjore, si dhe të sigurohet një administrim sa më efikas i shërbimit civil.

Në vijim të udhëzimeve të mëparshme në këtë drejtim, Komisioneri ka hartuar një udhëzues të ri, nr. 654, datë 02.10.2024, i cili iu është dërguar menjëherë të gjitha subjekteve vendore, me qëllim adresimin e problemeve të evidentuara gjatë periudhës 2021-2024, si dhe duke marrë parasysh ndryshimet që janë realizuar nëpërmjet vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "*Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*" dhe vendimit nr. 503, datë 1.8.2024, të Këshillit të Ministrave, "*Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, në lidhje me kufijtë e pagave dhe kategorizimin e pozicioneve në administratën vendore.

Përpos sa më sipër, në datat 22-24 tetor 2024, Komisioneri organizoi në selinë e tij disa takime pune me Sekretarët e Përgjithshëm dhe përfaqësues të njësive përgjegjëse të organeve të qeverisjes vendore ku u përfshinë 61 bashki të vendit, për të diskutuar më tej në lidhje me aplikimin e skemës së shërbimit civil në këtë tipologji institucionesh.

Për shkak të rolit mbështetës, në këto takime morën pjesë edhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Administratës Vendore, nga ana e së cilës janë hartuar disa manuale orientuese "*Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore*". sipas

grupimit të bashkive, bazuar në numrin e popullsisë, me synimin për të kontribuar në përmirësimin e situatës në administratën vendore me efikasitet dhe efektivitet, si dhe për të unifikuar strukturat bazuar në aktivitetet që kryejnë këto institucione.

Nisur nga detyrat konkrete të lëna në këto takime, në lidhje me:

vlerësimin e pozicioneve të punës dhe **hartimin** e përshkrimeve të punës për përcaktimin përfundimtar të listës së pozicionet që do të vlerësohen se janë pjesë e shërbimit civil, e shërbimit civil, civil; dhe

165

me qëllim që të konkretizohet në veprime dhe akte administrative sa më parë ky proces, Komisioneri e çmoi të nevojshme të verifikonte në subjekt situatën, në të gjitha qarqet e vendit, duke hartuar Planin e Veprimit nr. 815 prot., datë 04.11.2024, *“Lidhur me verifikimin në subjekt të ecursë së procesit të zbatimit të ligjit gjatë aplikimit të skemës së administrimit të shërbimit civil në administratën vendore dhe asistencën e këtyre institucioneve për të kuptuar dhe zbatuar drejt udhëzuesin e Komisionerit në lidhje me këtë aspekt”*.

Aktualisht, procesi i monitorimit të aplikimit të skemës së administrimit të shërbimit civil në administratën vendore, për vitin 2024 është përmbyllur me Raport Vlerësimi nga ana e Komisionerit, miratuar me vendimin nr. 83, datë 20.12.2024.

Pika 4 e rezolutës është realizuar plotësisht:

4. Komisioneri duhet të monitorojë me përparësi administrimin e shërbimit civil në procesin e rekrutimit në administratën vendore për të përmirësuar situatën, me qëllim parandalimin e fenomenit të emërimeve në kundërshtim me ligjin.

Komisioneri, ka vijuar mbikëqytjen e orientuar, të nisur me urdhrin nr. 28, datë 15.02.2024. Kjo mbikëqyrje është e shtrirë gjatë gjithë vitit kalendarik 2024 dhe konsiston në monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të gjithë instituteve të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ndër të cilët edhe procesi i rekrutimit, duke siguruar të dhënat e kërkuara në kohë reale, si dhe duke analizuar dhe ndërhyrë në kohën e duhur me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjshmërisë në subjektet e mbikëqyrjes. Ky proces është shtrirë jo vetëm në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, por edhe në 73 Njësi të Qeverisjes Vendore (61 Bashki dhe 12 Këshilla Qarku).

Njëkohësisht, ka vijuar zbatimi i Planit Vjetor të punës, ku është parashikuar kryerja e mbikëqyrjes së përgjithshme në 28 subjekte të qeverisjes vendore, me objekt procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Në përfundim të mbikëqyrjes Komisioneri ka paralajmëruar institucionet për të rregulluar situatën duke zbatuar detyrat konkrete që janë përcaktuar në vendim.

Po kështu, Komisioneri, ka vijuar procesin e mbikëqyrjes së orientuar në Bashkinë Tiranë, i cili ka nisur me urdhrin nr. 10, datë 24.01.2024, me objekt zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e pranimit në nivelin ekzekutiv, të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në kategorinë e lartë drejtuese, të planifikuara për t'u zhvilluar nga ky institucion gjatë vitit 2024.

Ky proces është finalizuar me raport vlerësimi, të miratuar me vendimin nr. 85, datë 20.12.2024 të Komisionerit.

5. Duhet të angazhohet në bashkëpunim të ngushtë me DAP-in për përmirësimin e procesit të rikthimit në punë të nëpunësve civilë.

Pika 5 e rezolutës është realizuar plotësisht:

Në lidhje me ecurinë e zbatimit të kësaj detyre, Ju informojmë se Komisioneri ka realizuar mbikëqyrjen e orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, iniciuar me Vendimin nr. 31, datë 25.04.2024, *“Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore”*, të Komisionerit.

Në përfundim të këtij procesi nëpërmjet Vendimit nr. 88, datë 20.12.2024, Komisioneri ka miratuar Raportin e Vlerësimit, i cili pasqyron situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, nga ana e institucioneve të administratës shtetërore.

Njëkohësisht, ky proces është ndjekur edhe përmes punës konkrete të grupit të përbashkët të punës me përfaqësues të Komisionerit dhe DAP, duke marrë pjesë në Komisionet e Posaçme të ngritura nga institucionet qendrore për emërimin në detyrë të nëpunësve gjyqfitues.

6. Nëpërmjet angazhimit të stafit të saj, duhet të organizojë në bashkëpunim me DAP-in trajnime në kuadër të popullimit me të dhëna të regjistrit qendror të personelit HRMIS dhe të platformës administrata.al, për të gjithë nëpunësit e njëjësive të administrimit në të gjitha bashkitë e vendit.

Pika 6 e rezolutës është realizuar plotësisht:

Me shkresën nr.464 prot., datë 22.07.2024, *“Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të realizimit të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2023”*”, Komisioneri e ka njohur DAP, ndër të tjera, edhe me këtë detyrë të rezolutës së Kuvendit.

Në vijim, me shkresën nr. 493 prot., datë 29.08.2024, drejtuar Departamentit të Administratës Publike dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, Komisioneri, e ka njohur DAP me problemet e konstatuara gjatë

proceseve të mbikëqyrjes tematike me objekt zbatimin e ligjit gjatë administrimit të regjistrit të personelit dhe të platformës së bashkëpunimit www.administrata.al, të realizuara ndër vite në këtë tipologji institucionesh.

Në përmbajtjen e kësaj shkrese, Komisioneri ka kërkuar bashkëpunimin e DAP dhe ASPA-s, si dy institucione që janë pjesë e rëndësishme e skemës së administrimit të shërbimit civil, të ngarkuara me detyra të posaçme në fushën e formimit profesional të nëpunësve, të marrin masa për të trajnuar burimet njerëzore në institucionet e administrates vendore, duke krijuar kurikula specifike në drejtim të popullimit me të dhëna të këtyre platformave.

167

Përveç sa më sipër, si dhe trajnimeve dhe asistencës teknike të parashikuar në Planin Vjetor të punës dhe të realizuar në subjekt, në lidhje me:

instituti e disiplinës në shërbimin civil;
procedurat që duhet të ndiqen prej NJQV-ve gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
procedurat e ndjekura nga Komisioneri në kuadër të kontrollit për zbatimin e vendimeve paralajmëruese; si dhe

procedura të tjera të specifikuara më vonë në autorizimet e nxjerra nga Komisioneri për fillimin këtij procesi, të tilla si: procedurat e rekrutimit, pezullimit, liritimit apo vlerësimet e punës,

Komisioneri e ka përfshirë në Planin Vjetor dhe nëpërmjet Vendimit nr. 50, datë 13.09.2024, ka nisur procesin e monitorimit, duke përfshirë të gjitha institucionet e sistemit të shërbimit civil, me objekt realizimin e trajnimeve të detyrueshme dhe trajnimeve të tjera që synojnë rritjen profesionale të nëpunësve civilë në administratën publike, ku një fokus i veçantë i është kushtuar trajnimeve lidhur me regjistrin qendror të personelit (*HRMIS*) dhe platformën ëëë.administrata.al. Aktualisht, ky proces është në fazën përfundimtare dhe do të finalizohet gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Pika 7 e rezolutës është realizuar plotësisht:

7. Në rastet kur marrëdhënia mes punëdhënësit dhe punëmarrësit të një institucioni shtetëror, nga marrëdhënie e cila rregullohet në bazë të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, përmes ndryshimeve ligjore kalon në marrëdhënie që rregullohet me anë të Kodit të Punës, KMSHC-ja duhet të kryejë një vlerësim mbi impaktin që ky ndryshim sjell.

Me qëllim realizimin e këtij rekomandimi, Komisioneri, përmes shkresës nr.464 prot., datë 22.07.2024, e ka njohur DAP me këtë detyrë të lënë nga Kuvendi dhe në takimin e përbashkët të zhvilluar në datë 25 korrik 2024, ka kërkuar prej këtij institucioni që të njoftojë në lidhje me rastet e ndryshimeve ligjore që passjellin ndryshime në regjimin juridik të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil të punëmarrësve, duke bërë që kjo marrëdhënie të rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës.

Aktualisht pranë Komisionerit nuk është depozituar asnjë informacion apo kërkesë për vlerësim nga ana e DAP-it, ku të evidentohet një situatë të tillë.

PRIORITETET E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2025

Për hartimin e planit të punës për vitin 2025, Komisioneri ka analizuar me kujdes problematikat e evidentuara në këtë raport, duke identifikuar çështjet kryesore që kërkojnë vëmendje dhe ndërhyrje institucionale. Bazuar në këtë analizë, janë përcaktuar dhe integruar në veprimtarinë e institucionit procese pune që lidhen me përmbushjen e kompetencave ligjore në fushën e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, me qëllim garantimin e ligjshmërisë në të gjithë spektrin e institucioneve që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Konkretisht, gjatë këtij viti, puna e Komisionerit do të përqendrohet në mënyrë të veçantë në dy prioritet kryesore, me ndikim në drejtim të përmirësimit të funksionimit të sistemit të shërbimit civil, garantimit të standardeve/respektimit të parimeve të administrimit të shërbimit civil dhe forcimit të zbatimit të kuadrit ligjor, të cilat po i parashtrajmë në vijim:



Mbikëqyrje e orientuar përgjatë gjithë vitit lidhur me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil

Një nga prioritetet kryesore të Komisionerit për vitin 2025 do të jetë mbikëqyrja vjetore lidhur me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky proces monitorimi do të realizohet përmes mbledhjes së informacionit dhe verifikimeve të rregullta, bazuar në raportimet periodike mujore të institucioneve të përfshira. Qëllimi i këtij monitorimi është të sigurojë një pasqyrë të qartë mbi nivelin e zbatimit të legjislacionit dhe të evidentojë problematikat e mundshme, me synimin për të ndërhyrë në mënyrë të menjëhershme për të korrigjuar çdo shkelje të konstatuar.

Një aspekt thelbësor i këtij procesi është përdorimi i të dhënave të mbledhura për të orientuar planifikimin strategjik të institucionit të Komisionerit për vitin pasardhës. Këto të dhëna do të ndihmojnë në përcaktimin e nivelit të riskut dhe në identifikimin e fushave prioritare për mbikëqyrje, duke rritur efektivitetin dhe cilësinë e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil.



Mbikëqyrje e zbatimit të ligjit gjatë procesit zgjedhor

Duke pasur parasysh problematikën e evidentuar gjatë procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil në proceset zgjedhore të mëparshme, gjatë të cilave bëhen efektive njëkohësisht disa institute të ligjit për nëpunësin civil, Komisioneri vendosi si një nga prioritetet kryesore të punës së tij gjatë vitit 2025 monitorimin e këtij procesi gjatë zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Ky proces do të realizohet në të gjitha institucionet e administratës

publike të cilat përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Në fokus të këtij procesi do të jenë një sërë procedurash, të tilla si: rekrutimi në pozicione pune të shërbimit civil, pezullimi nga shërbimi civil, disiplina në punë dhe masat disiplinore; konflikti i interesit; realizimi i veprimtarive të jashtme të nëpunësve civilë që në këtë rast kërkojnë zbatimin e disa procedurave të përcaktuara ligjore (në kuadrin e pjesëmarrjes së tyre si kandidatë për t’u zgjedhur në organet e qeverisjes vendore e po ashtu, edhe për t’u emëruar në administratën zgjedhore, si anëtarë të KZAZ, KQV dhe GNV); f), të drejtat politike të nëpunësit civil, e njëkohësisht edhe kufizimet e vendosura në dispozitën që përfaqësohet nga neni 37, i ligjit në fjalë, ku ndër të tjera, ndalohej pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike, qoftë edhe në rrjetet sociale.

Përveç aspekteve të sipërpërmendura, Komisioneri do t’i kushtojë një vëmendje të veçantë edhe këtyre drejtimeve kryesore të veprimtarisë së tij:

Puna e nisur prej disa vitesh në ndihmë të institucioneve të administratës vendore, për të përmirësuar organizimin e brendshëm të burimeve njerëzore në pozicione të shërbimit civil, ka vijuar nëpërmjet grupit të posaçëm të ngritur nga Komisioneri dhe tashmë ka dhënë rezultate konkrete në drejtim të standardizimit të strukturës organizative të institucionit dhe rritjes së efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së saj. Gjatë këtij procesi është evidentuar një nivel i lartë bashkëpunimi midis institucioneve dhe Komisionerit.

Vlerësimi i situatës nga Komisioneri është mirëpritur prej tyre, duke zbatuar në mënyrë vullnetare të gjitha rekomandimet që janë dhënë, sipas rastit. Puna në këtë drejtim do të vijojë edhe përgjatë vitit 2025, me një intensitet të lartë, sidomos në drejtim të procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit të pozicioneve të punës në raport me shërbimin civil dhe në raport me detyrat që kryejnë, duke orientuar me qartësi procesin dhe duke ndjekur zhvillimin e tij sipas detyrave të lëna.

Komisioneri do të vijojë të mbikëqyrë

respektimin e parimeve dhe procedurave ligjore në proceset e administrimit të shërbimit civil, të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore. Ky proces do të përfshijë monitorimin e të gjitha procedurave të rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë në institucionet e administratës shtetërore, duke siguruar zbatimin e standardeve ligjore dhe promovimin e një sistemi meritokratik.

Njëkohësisht, Komisioneri, për të rregulluar situatën në drejtim të parandalimit të fenomenit të emërimeve në kundërshtim me ligjin, do të vijojë mbikëqyrjen/monitorimin e procedurave të plotësimit të vendeve të lira pjesë e shërbimit civil sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar në disa njësi të qeverisjes vendore: Bashkinë Tiranë, Bashkinë Tropojë, Bashkinë Malësi e Madhe, Bashkinë Roskovec, Bashkinë Maliq, Bashkinë Sarandë, Bashkinë Libohovë, Bashkinë Kolonjë, Bashkinë Himarë dhe Këshillin e Qarkut Shkodër.

Ashtu si e kemi analizuar në përmbajtjen e raportit, ka vijuar puna në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm të nivelit të zbatimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues.

Mbikëqyrja me këtë objekt, për vitin 2024 është orientuar në institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet grupit të posaçëm të krijuar me Departamentin e Administratës Publike, duke marrë pjesë aktive në mbledhjet e Komisioneve të Posaçme, nëpërmjet një plani të detajuar, me qëllim për t'i ardhur në ndihmë procesit dhe për të mbështetur Departamentin e Administratës Publike për të realizuar detyrën e tij.

Gjatë vitit 2025, ky proces do të realizohet pranë të njëjstëve të vetëqeverisjes vendore për të monitoruar zbatimin prej tyre të këtyre vendimeve, nëpërmjet administrimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe, në rastet kur vlerësohen problematika, nëpërmjet pjesëmarrjes së stafit të autorizuar prej tij në mbledhjet e Komisioneve të Posaçme, për emërimin e nëpunësve gjyqfitues.

Procesi i inspektimit dhe hetimit administrativ të informacioneve që vijnë në drejtim të Komisionerit, në lidhje me

aspekte të ndryshme të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil do të jenë gjithashtu në fokus të punës së Komisionerit.

Këshillimi dhe ndihma e institucioneve për të zbatuar drejt ligjin do të vijojë të jetë prioritet i punës së Komisionerit, si një përvojë tashmë e krijuar, e cila do të realizohet nëpërmjet asistencës teknike përmes stafit të tij, drejtuar tek njësitë përgjegjëse në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që do të shfaqin nevojë në këtë drejtim.

Një drejtim kyç i veprimtarisë së Komisionerit gjatë vitit 2025 do të jetë mbikëqyrja në vazhdim/ndjekja e ecures së zbatimit të detyrave të përcaktuara në vendimet paralajmëruese nga institucionet e administratës publike. Në përfundim të afateve të përcaktuara në këto vendime, Komisioneri do të vlerësojë nivelin e zbatimit nga institucionet përkatëse, duke e konsideruar këtë proces si një tregues thelbësor të respektimit të kuadrit ligjor dhe të efektivitetit të sistemit të shërbimit civil. Kjo mbikëqyrje do të shërbejë jo vetëm për të garantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore nga institucionet, por edhe për të nxitur standardizimin dhe përmirësimin e praktikave administrative në përputhje me parimet dhe procedurat e shërbimit civil.

Rritja e performancës institucionale të Komisionerit do të jetë në vazhdimësi në fokus të veprimtarisë së tij, pasi ajo ndikon në mënyrë direkte si në pavarësinë e institucionit, ashtu edhe në realizimin e të gjitha punëve që renditëm më sipër, duke marrë parasysh edhe shtimin e ritmit për të kryer punët që kërkohen në kuadrin e integritetit të vendit në BE. Ky aspekt sigurohet me shtimin e dijeve nëpërmjet trajnimeve specifike në ndihmë të rritjes së cilësisë së punës në aktet që materializojnë veprimtarinë e Komisionerit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të vijojë të punojë për të ndihmuar në të gjitha aspektet që kanë lidhje me ecurinë e reformës në administratën publike, duke dhënë kontributin e tij në kuadër të zhvillimit të strategjive ku ai ndërvepron së bashku me aktorët e tjerë.

Në përfundim të raportimit, Komisioneri vlerëson se respektimi i legjislacionit të shërbimit civil dhe monitorimi i tij janë aspekte thelbësore që sigurojnë suksesin e reformës në shërbimin civil, si pjesë e rëndësishme e reformës në administratën publike. Sfidat e Komisionerit mbetet që të sigurojë një proces të pavarur dhe efikas mbikëqyrjeje, me qëllim që të parandalojë shkeljen e ligjit dhe të rregullojë paligjshmërinë në rastet kur ka ndodhur, nëpërmjet mjeteve që i ka dhënë ligji.

Duke shpresuar se nëpërmjet këtij raporti, Ju kemi paraqitur një pasqyrë të plotë e gjithëpërfshirëse të veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për vitin 2024, Ju falënderojmë sinqerisht për mirëkuptimin dhe mbështetjen e vazhdueshme,

Me respekt,

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

**INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË MBIKËQYRJEN E ORIENTUAR ME
OBJEKT MONITORIMIN E ECURISË SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT
CIVIL PËR VTTIN 2024**

172

KRYEMINISTRIA	
1	Agjencia e Auditimit te Programeve te Asistences Akredituar nga BE
2	Agjencia e Prokurimit Publik
3	Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile
4	Agjencia Telegrafike Shqiptare
5	Departamenti i Administrates Publike
6	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave
7	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar
8	Inspektoriat Qendror
9	Komiteti Shtetëror I Kulteve
10	Komiteti për Pakicat Kombëtare
11	Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujrore
12	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
13	Shkolla Shqiptare e Administrates Publike
14	Avokatura e Përgjithshme e Shtetit (qender)
15	Drejtoria e Pergjithshme e Antikorrupsionit
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	
1	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
2	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
3	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	
1	Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve
2	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
3	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë
4	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnjë
5	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë
6	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër
7	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës
8	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve
9	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
10	Qendra e Trasferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë
11	Qendra e Trasferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë
12	Qendra e Trasferimit të Teknologjive Bujqësore Lushnjë
13	Qendra e Trasferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë
14	Qendra e Trasferimit të Teknologjive Bujqësore Shkodër
15	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
16	Drejtoria e Pergjithshme e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimeve
MINISTRIA E DREJTËSISË	
1	Agjencia Kombëtare e Falimentimit
2	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor

3	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
4	Instituti i Mjekësisë Ligjore
5	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
6	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
7	Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve
8	Qendra e Botimeve Zyrtare
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	
1	Agjencia Kombëtare Bërthamore
2	Agjencia për Eficencën e Energjisë
3	Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të rrezikshme
4	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
5	Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
6	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
7	Autoriteti Rregullator Hekurudhor
8	Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore
9	Drejtoria e Përgjithshme Detare
10	Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare
11	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
12	Agjencia Shtetërore për Shpronësim
MINISTRIA E FINANCAVE	
1	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit
2	Degët e Thesarit
3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore në përbërje të saj
4	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale në përbërje të saj
5	Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore
6	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-se, BB-se dhe Donatoreve të Tjerë
7	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT	
1	Agjencia Kombëtare Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
2	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
3	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
4	Agjencia e Trajtimit të Konçesioneve
5	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
6	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
7	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësive Industriale
8	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
9	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
10	Qendra Kombëtare e Biznesit
MINISTRIA E MBROJTJES	
1	Rezervat Materiale të Shtetit
2	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	
1	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
2	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
3	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
4	Agjencia Kombëtare e Bregdetit

MINISTRIA E BRENDSHME

1	Policia e Shtetit
2	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
3	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
4	Administrata e Prefektit të Qarkut Berat
5	Administrata e Prefektit të Qarkut Dibër
6	Administrata e Prefektit të Qarkut Durrës
7	Administrata e Prefektit të Qarkut Elbasan
8	Administrata e Prefektit të Qarkut Fier
9	Administrata e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë
10	Administrata e Prefektit të Qarkut Korçë
11	Administrata e Prefektit të Qarkut Kukës
12	Administrata e Prefektit të Qarkut Lezhë
13	Administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër
14	Administrata e Prefektit të Qarkut Tiranë
15	Administrata e Prefektit të Qarkut Vlorë

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

1	Agjencia Kombëtare e Diasporës
---	--------------------------------

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

1	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
2	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
3	Instituti i Integritetit për ish të Përndjekurit

KËSHILLAT E QARKUT

1	Berat
2	Dibër
3	Durrës
4	Elbasan
5	Fier
6	Gjirokastrë
7	Korçë
8	Kukës
9	Lezhë
10	Shkodër
11	Tiranë
12	Vlorë

BASHKITË

1	Berat
2	Dimal
3	Kuçovë
4	Skrapar
5	Poliçan
6	Dibër
7	Bulqizë
8	Mat
9	Klos
10	Durrës
11	Shijak
12	Krujë

13	Elbasan
14	Cërrik
15	Belsh
16	Peqin
17	Gramsh
18	Librazhd
19	Prrenjas
20	Fier
21	Patos
22	Roskovec
23	Lushnje
24	Divjakë
25	Mallakastër
26	Gjirokastër
27	Libohovë
28	Tepelenë
29	Memaliaj
30	Përmet
31	Këlcyrë
32	Dropull
33	Korçë
34	Maliq
35	Pustec
36	Kolonjë
37	Devoll
38	Pogradec
39	Kukës
40	Has
41	Tropojë
42	Lezhë
43	Mirditë
44	Kurbin
45	Malësi e Madhe
46	Shkodër
47	Vau Dejës
48	Pukë
49	Fushë-Arrëz
50	Tiranë
51	Kamëz
52	Vorë
53	Kavajë
54	Rrogozhinë
55	Vlorë
56	Selenicë
57	Himarë
58	Sarandë
59	Konispol

60	Finisq
61	Delvinë
INSTITUCIONE TË PAVARURA	
1	Kuvendi i Shqipërisë
2	Presidenca
3	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit
4	Avokati i Popullit
5	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit
6	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
7	Kontrolli i Lartë i Shtetit
8	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
9	Autoriteti i Konkurrencës
10	Autoriteti i Mediave Audiovizive
11	Shkolla e Magjistratures
12	Komisioni i Prokurimit Publik
13	Këshilli i Lartë Gjyqësor
14	Instituti i Statistikave
15	Gjykata Kushtetuese
16	Prokuroria e Përgjithshme
17	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
18	Autoriteti i Komunikimeve Elektorinike dhe Postare
TOTALI 203 institucione (Kryeministria, 11 Ministri të linjës, 88 Institucione varësie, 12 Prefektura, 12 Këshilla Qarku, 61 Bashki dhe 18 Institucione të pavarura)	

TË DHËNA NË LIDHJE ME RASTET E NËPUNËSVE CIVILË GJYQFITUES TË CILËT AKTUALISHT JANË NË LISTË PRITJE

I.KRYEMINISTRIA									
Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Kategoria e pagës	Akti i liritimit ose largimit nga shërbimi civil	Arsyeja e largimit ose liritimit nga shërbimi civil (neni)	Arsyeja e mos rikthimit në një pozicion të shërbimit civil/mos zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë (suprimim/shkurtim, ndryshim i kriterëve të veçanta /pozicion jo i lirë)	Nr./data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Vlera e pagesës së kryer nga institucioni deri në momentin e dërgimit të informacionit pranë KMSHC	Vlera monetare e papaguar deri në përmbyshjen e plotë të detyrimit
1.1 Departamenti i Administratës Publike									
1	Tonin Frroku	Inspektor	III ^a	Vendimi nr. 646, datë 25.02.2014	Riskstrukturim	Me shkresën nr. 984 prot., datë 12.02.2014, DAP-i i ka propozuar Z.Frrokut, sistemimin në një pozicion të shërbimit civil, i cili është refuzuar nga gjyqfituesi me pretendimin se është i një kategorie më të ulët. Institucioni është ngarkuar vetëm	Vendimi nr.00-2023-4060 (346), datë 19.10.2023		Nuk ka detyrime monetare

						me detyrimin për rikthim e gjyqfituesit në shërbimin civil, jo për pagimin e pagave.			
1.2 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave									
2	Indrit Boriçi	Përgjegjës	III ^b	Vendimi nr. 11, datë 6.9.2017	Masë disiplinore neni 57/2	Ristrukturim	Vendimi nr. 54, datë 16.2.2022, GJ.A.A.T	7,083,806 lekë	0
II. MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME									
3	Elsa Kosova	Specialist	Paga llogaritet sipas gradës diplomatike (Ministër Këshilltar)	Vendimi nr. 4244 prot., datë 28.3.2014, të Komisionit të Disiplinës	Masë disiplinore neni 57/2	Znj. Kosova nuk është shprehur lidhur me propozimin e KPS	Vendimi nr. 00-2015-3900(498), datë 17.9.2015, i GJ.L	14,502,012 lekë	0
III. MINISTRIA E MBROJTJES									
4	Bardha Kola	Drejtor	II ^b	Vendim i Sek. Përgj. nr. 5497, datë 16.12.2013	Masë disiplinore "Largim nga shërbimi civil" neni 25, pika 2, pika 3	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.430, datë 04.03.2016, nga Gjykata e Apelit	13,485,422 lekë	0
5	Arben Sulo	Drejtor	II ^b	Vendim i Sek. Përgj. nr.10934, datë 15.12.2013	Masë disiplinore "Largim nga shërbimi civil"	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.678, datë 25.03.2016, nga Gjykata Administrative e Apelit	11,347,013 lekë	0

6	Shkëlqim Berisha	Drejtor i Përgjithshëm	II ^a	Vendim i Sek. Përgj. nr. 10476, datë 01.11.2013	Lirim nga Shërbimi civil me motivacionin <i>"mosparaqitje e pajustificuar në detyrë"</i>	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2165, datë 14.10.2015, nga Gjykata Administrative e Apelit	16,709,016 lekë	0
7	Ilir Kurti	Drejtor	II ^b	Vendim i Sek. Përgj. nr. 94, datë 08.01.2014	Ristrukturim	Shkurtim i numrit të punonjësve, për shkak të ristrukturimit të M.M. Pozicion jo i lirë	Vendim nr. 501, datë 10.03.2016, nga Gjykata Administrative e Apelit	9,299,612 lekë	0
8	Mirela Osoja	Drejtor	II ^b	Vendimi nr. 8713/6 prot., datë 08.01.2019, të Komisionit Disiplinor	Mbështetur në shkronjat a) dhe c), të pikës 2, të nenit 57, në shkronjën ç), nenit 58, të ligjit nr.152/2013 <i>"Për nëpunësin civil"</i> , i ndryshuar	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2017, datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit	9,964,027 lekë	0
9	Rezert Bejkaj	Drejtor	II ^b	Vendim i Sek. Përgj. nr. 93, datë 08.01.2014	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr.130, datë 25.01.2017, të Gjykatës Admst. të Apelit. MM ka paraqitur Rekurs, në Gjykatan e Lartë. Kolegji i	2,454,409 lekë	0

							Lartë Administrativ, me vendimin nr.00-2022-726, datë 31.03.2022, ka vendosur mos pranimin e rekursit.		
10	Albana Spahiu (Mustafaj)	Specialist	III ^b	Vendim nr.68, datë 08.01.2014, të Sekretarit të Përgjithshëm	Kaluar në listë pritje për shkak të Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr.430, datë 14.02.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit	1,558,099 lekë	0
11	Stela Mustafaraj	Specialist	III ^b	Vendim nr.60, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr.744, datë 22.02.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit Çështja ka qenë e pezulluar në Gjykatën e Lartë deri në shqyrtimin e Rekursit të paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes dhe me vendimin e Kolegjit Administ. të Gjykatës së Lartë nr.00-	3,817,217 lekë	0

							2022-737, datë 26.04.2022, i ka dhënë të drejtë paditëses		
IV. MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT									
12	Ilirjan Qirjazi	Përgjegjës	III ^a /1	Urdhrit nr.511 prot, datë 15.02.2010	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr. 89, datë 30.09.2010	1,356,951 lekë	14,409,520 lekë
13	Shpetim Ngjeci	Specialist	III ^b	Urdhrit nr. 59, datë 01.02.2010	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr. 80, datë 21.09.2010	1,151,800 lekë	11,796,079 lekë
14	Artan Tafa	Specialist	III ^b	Urdhri nr. 63, datë 1.02.2010	Ristrukturim	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr. 83, datë 23.09.2010	73,563 lekë	4,370,946 lekë
15	Danjela Godo	Përgjegjëse	III ^a /1	Vendimi nr. 511 prot., datë 15.2.2010 <i>"Për kalim në listë pritje të MMPAU"</i>	Ristrukturim	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.335, datë 21.02.2012	1,387,331 lekë	14,598,320 lekë
16	Hasan Cani	Përgjegjës	III ^a	Vendim nr. 8120 prot., datë 12.11.2013	Ristrukturim	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.1092, datë 20.05.2015	1,553,351 lekë	11,278,200 lekë
17	Edlir Orozi	Drejtor	II ^b	Vendim nr. 1957/4, prot.,	Masë disiplinore <i>"Largim nga shërbimi civil"</i>	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.102, datë 19.01.2017	274,918 lekë	4,580,018 lekë

				datë 26.03.2012					
18	Idlir Gumbardhi	Drejtor	II ^b	Akti nr. 8151 prot, datë 12.11.2013	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr.3432, datë 26.10.2016	1,951,951 lekë	13,293,570 lekë
19	Edi Beqaraj	Specialist	IV ^a	Akti administrativ nr. 1531 prot., datë 4.03.2015	Vlerësimi i punës “jo kënaqshëm”	Suprimuar	Vendimi nr. 736 (86-2019-833) 12/03/2019	1,003,860 lekë	6,848,807 lekë
20	Juxhina Gjoni	Drejtor	II ^b	Vendimi nr.1866/1 prot., datë 09.02.2018	Ristrukturim	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2703 (86- 2019-3081), datë 15.10.2019	1,626,140 lekë	8,109,115 lekë
4.1 Agjencia Kombëtare e Mjedisit									
21	Tomor Ballabani	Specialist	IV ^a	Vendim nr.1, datë 20.07.2023	Ristrukturim	Procedura e sistemimit është në proces	Vendim nr. 653, datë 07.03.2024	479.080 lekë	893.200 lekë
4.2 Agjencia Kombëtare e Bregdetit									
22	Jonka Ceka	Përgjegjëse	III ^{a/1}	Vendimi nr.1, datë 31.05.2016	Largim nga shërbimi civil, neni 57, pika 2, gërma “a” dhe “b” të ligjit nr.152/2013	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr. 33 (86-2022-34), datë 02.02.2022	7,063,647 lekë	E papërcaktuar

V.MINISTRIA E BRENDSHME

23	Ervehe Çumani	Specialist	III ^b	Akti nr. 815 prot., datë 07.02.2008, “Për lirim nga detyra dhe kalimin në listë pritje”	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr.15, datë 29.01.2009, i Gjykatës së Apelit, Tiranë <u>Rikthim</u>	Nuk ka pagesë	-
24	Tatiana Shurbi	Specialist	III ^b	Akti nr. 816 prot., datë 01.03.2008 “Për lirim nga detyra dhe kalimin në listë pritje”	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr. 8, datë 20.01.2009, i Gjykatës e Apelit, Tiranë <u>Rikthim + page</u>	-	-
25	Bujar Murati	Drejtore i Përgjithshëm	II ^a	Shkresa nr.3914, datë 23.12.2009, “Kërkesë për pezullim nga shërbimi civil” drejtuar DAP DAP me shkresën nr. 2149/1 prot., datë 23.12.2009, ka miratuar pezullimin	Pezullim	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.837, 25.04.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë <u>Rikthim + page</u>	-	-

				nga shërbimi civil					
26	Faik Jata	Drejtor	II ^b	Akti nr. 7805 prot., datë 11.11.2013 “Për kalimin në liste pritje”	Ristrukturim	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2048, datë 22.05.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë <u>Rikthim + page</u>	-	-
27	Rukie Ahmetcenaj	Përgjegjës	III ^{a/1}	Akti nr. 7800 prot., datë 11.11.2013 “Për lirimin nga detyra dhe kalimin në listë pritje”	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr.467, datë 04.03.2016, i Gjykatës së Apelit, Tiranë <u>Rikthim + page</u>	-	-
28	Avni Nezaj	Drejtor	II ^b	Akti nr.7803 prot., datë 11.11.2013 “Për kalimin në listë pritje”	Ristrukturim	Suprimuar	Vendimi nr.2362 datë.12.06.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë <u>Rikthim + page</u>	-	-
29	Adem Kapo	Specialist	III ^b	Akti nr.6816/15 prot., datë 18.09.2014, i Komisionit të Disiplinës. Vendim nr. 7748 prot., datë 24.09.2014, i	Masë disiplinore	Suprimuar	Vendimi nr.336, datë 01.02.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë <u>Rikthim + page</u>	-	-

				Sekretarit të Përgjithshëm					
30	Qerim Hoshi	Drejtor	II ^b	Akti nr. 6011/2, datë 14.09.2016, i Sekretarit të Përgjithshëm për " <i>Lirimin nga shërbimi civil</i> "	Vlerësimi i punës " <i>jo kënaqshëm</i> "	Suprimuar	Vendimi nr.269, datë 13.07.2022, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë <u>Rikthim + page</u>	Nuk ka pagesë	-
VI. MINISTRIA E DREJTËSISË									
31	Artan Murrizi	Inspektor	III ^a	Akti nr.413/99, datë 03.12.2013	Ristrukturim neni 50/6	Suprimuar	Vendimi nr.2132, datë 14.10.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë	8,767,472 lekë	1,332,829 lekë
32	Vasilika Hysi	Përgjegjës	III ^a	Akti nr.413/112, datë 03.12.2013	Ristrukturim neni 50/6	Suprimuar	Vendim nr.144, datë 05.04.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	8,637,749 lekë	1,012,430 lekë
33	Zigur Kërma	Përgjegjës	III ^a	Akti nr.1029/1, datë 12.03.2007	Me masë disiplinore " <i>Largim nga shërbimi civil</i> " neni 57/2	Suprimuar	Vendimi nr. 61, datë 07.06.2012, i Gjykatës së Apelit <u>Rikthim</u>	-	-
34	Bledar Kabashi	Drejtor	II ^b	Akti nr.7272/1, datë 11.12.2017	Ristrukturim neni 50/6	Suprimuar	Vendim nr. 392 datë 21.10.2022, i Gjykatës	9,761,182 lekë	9,761,182 lekë

							Administrative të Apelit,Tiranë		
35	Gerhard Qafa	Inspektor	III ^a	Akti nr.7435/1, datë 11.12.2017	Ristrukturim neni 50/6	Suprimuar	Vendimi nr.628, datë 21.09.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit	8,372,882 lekë	8,372,882 lekë
VII. MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT									
36	Majlinda Laçi	Specialist (ZAB)	IV ^b	Vendimi nr.25, datë 08.05.2017	Lirim nga shërbimi civil		Vendimi nr. 416, datë 24.02.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit	151,1370 lekë	0 lekë
VIII.MINISTRIA E FINANCEVE									
37	Odetta Shkreli	Drejtor	II ^b	Akti nr.1567/14 prot., datë 28.04.2016	Ristrukturim	Pamundësi objektive për ta sistemuar	Vendimi nr. 44, datë 26.01.2023, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë	8,872,649 lekë	-
38	Azis Jata	Drejtor	II ^b	-	Ristrukturim	Diskutim në mbledhjen e K.P	Vendimi nr. 13, datë 8.02.2010, Gjykata Administrative e Apelit	15,704,107 lekë	-
39	Sotiraq Veizi	Specialist	III ^b	Vendimi nr.9522/3 prot., datë 08.08.2014	Ristrukturim	Nuk ka dorëzuar kërkesë për ekzekutim	Vendimi nr.3646, datë 2.10.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit	-	-

40	Rozana Haxhialushi	Specialist	III ^b	Akti nr.1650/3 prot., datë 26.12.2013	Ristrukturim	Nuk ka dorëzuar kërkesë për ekzekutim	Vendimi nr.1684 datë 12.05.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit	-	-
41	Fatmir Isufaj	Drejtor	II ^b	Vendim nr.3837/2 prot., datë 30.04.2013	Kaluar MEKI	-	Vendimi nr. 227 datë 18.02.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit	-	-
42	Rozë Uldedaj	Specialist	III ^b	Akti nr.16978/3, prot., datë 09.12.2013	Ristrukturim	Pamundësi objektive për ta sistemuar	Vendimi nr.2622 datë 01.07.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit	-	-
43	Gentian Kaprata	Drejtor	II ^b	-	Kaluar MEKI	Nuk ka vende vakante që i përshtatet arsimimit, praktika është dorëzuar në DAP për risistemim	Vendimi nr.2106, datë 7.7.2016	-	-
8.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve									
44	Artur Kallembi	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.1263, datë 18.08.2009	Për mosplotësim të kriterit arsimor për pozicionin e punës	Pozicion jo i lirë	Vendim nr.7386, datë 12.06.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor	11,970,143 lekë	855,017 lekë
45	Altin Allmuça	Përgjegjës	IV-2	Vendimi nr.2215, datë 28.09.2010	Moszbatim i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale (me	Pozicion jo i lirë	Vendimi i KSHC nr. 86, datë 22.02.2011, dhe i Gjykatës	8,256,000 lekë	1,032,000 lekë

					ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999)		së Apelit datë 13.07.2011		
46	Razije Llalla	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.1061, datë 23.06.2014,	Nga Komisioni Disiplines per masen disiplinore <i>"Moszbatim i dispozitave ligjore ne permbushjen e detyrave funksionale"</i>	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.856, datë 23.04.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,452,280 lekë	1,119,297 lekë
47	Sokol Vokshi	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.1251, datë 31.07.2014, i K.D	Me Komision Disipline per <i>"Moszbatim i dispozitave ligjore ne permbushjen e detyrave funksionale"</i>	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.1062 (85), datë 19.05.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,377,222 lekë	1,086,808 lekë
48	Kujtim Metaliaj	Inspektor	IV-1	Akti nr.1294/1, datë 25.08.2009		Pozicion jo i lirë	Vendim nr.1336, datë 15.07.2015, i Gjykatës së Apelit	11,161,300 lekë	1,093,972 lekë
49	Adriana Memelli	Përgjegjës	III-3	Vendimi nr.41234, datë 25.06.2014		Suprimuar	Vendimi nr.71, datë 01.02.2023, i Gjykatës Administrative së Apelit	11,764,060 lekë	1,577,304 lekë

50	Anila Thomai	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.1871, datë 07.05.2013		Pozicion jo i lirë	Vendim nr. 105, datë 03.12.2013, i Gjykatës së Apelit	8,027,400 lekë	755,520 lekë
51	Ahmet Zani	Drejtor	II-1	Vendimi nr.17, datë 05.01.2010		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.130, datë 15.12.2013, i Gjykatës së Apelit	6,150,813 lekë	
52	Artan Becka	Inspektor	IV-2	Akti nr.8736, prot., datë 22.04.2013	Nga Komisioni I Disiplinës për “Shkelje e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla”	Pozicion jo i lirë	Vendim nr. 275, datë 06.12.2006, Gjykata Administrative e Apelit	9,145,207 lekë	955,980 lekë
53	Vjollca Alinani	Inspektor	IV-3	<i>"Moszbatim i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale"</i> Vendim i Komisionit të Disiplinës	Nga Komisioni I Disiplinës, “Moszbatimi I dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale (me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999)	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.275, date 06.12.2006, i Gjykatës së Apelit	8,765,158 lekë	499,016 lekë
54	Arben Guga	Drejtor	II-1	Vendimi nr.197, datë 11.05.2013	Moskonfirmim statusi pas periudhës së provës	Pozicion jo i lirë	Vendim nr. 9, datë 29.01.2013, Gjykata e Apelit Tiranë	15,545,191 lekë	1,313,481 lekë

55	Sokol Mucò	Drejtor	III-1	Vendimi nr.300, datë 20.01.2014		Pozicion jo i lirë	Vendim nr. 268, datë 16.02.2015, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë	11,821,400 lekë	1,202,433 lekë
56	Eduart Mustafa	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.804, datë 08.11.2011	Nga Komisioni I Disiplinës, “Moszbatimi I dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale (me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999)	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr. 48, datë 03.05.2012, i Gjykatës së Apelit Tiranë	10,050,533 lekë	853,200 lekë
57	Meleq Muci	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.1257, datë 31.07.2014	Nga Komisioni I Disiplinës për “Mospërmbushja e rëndë e detyrave”	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.949, datë 01.12.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,489,511 lekë	1,126,394 lekë
58	Astrit Llubani	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.792, datë 05.05.2006	Nga Komisioni I Disiplinës për "Moskryerjes së detyrave dhe mosrespektimit të perseritur të afatëve të caktuara për kryerjen e detyrave si dhe për shprehjen dhe kryerjen e veprimtarive	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.30, datë 27.5.2010, i Gjykatës së Apelit	7,982,974 lekë	454,008 lekë

					publike me karakter partiak				
59	Marcel Hila	Drejtor	III-1	Vendimi nr.1185, datë 25.07.2014	Nga KD per "Mospërbushja e rëndë e detyrave dhe moszbatim haptazi të dispozitave ligjore në përbushje detyrave ”	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.4166, i Gjykatës Administrative të Apelit	11,837,856 lekë	1,259,209 lekë
60	Azem Xhani	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.1064, datë 23.06.2014, i K.D	Nga Komisioni i Disiplines per “Mospërbushja e rëndë e detyrave ”	Suprimuar	Vendimi nr.4530(1251), datë 15.12.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit	7,332,458 lekë	947,143 lekë
61	Fatmir Nezaj	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.695, datë 25.02.2014		Suprimuar	Vendimi nr.6426, datë 18.12.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë	10,874,883 lekë	1,098,285 lekë
62	Adrian Selimaj	Inspektor	IV-1	Vendimit nr.1159, datë 25.07.2014	Nga KD per “Mospërbushja e rëndë e detyrave dhe moszbatim haptazi të dispozitave ligjore në	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.3127, datë 10.10.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit	11,687,841 lekë	1,057,705 lekë

					përmbushje detyrave ”				
63	Artan Cengu	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.926, datë 08.05.2014		Pozicion jo i lirë	Vendim nr.1329, datë 08.06.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,017,248 lekë	907,387 lekë
64	Artian Adil	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.912, datë 02.05.2014		Suprimuar	Vendimi nr.4719, datë 27.12.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,685,394 lekë	1,082,660 lekë
65	Alma Buci (Kore)	Inspektore	IV-1	Vendimi nr.1394, datë 03.10.2014	Nga KD Shkelje e rende per mospërmbushje te detyrave funksionale	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr. 595, datë 15.02.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,995,237 lekë	1,068,843 lekë
66	Aleksander Lala	Specialist	IV-2	Vendimi nr.1362, datë 23.09.2014, i K.D	Nga KD Shkelje e rende per mospërmbushje te detyrave funksionale	Pozicion jo i lirë	Vendim nr.1502, datë 06.04.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,046,821 lekë	950,701 lekë
67	Ndriçim Çeka	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.1108, datë 16.07.2014		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.114, datë 23.01.2017, i Gjykatës	10,600,680 lekë	1,151,280 lekë

							Administrative të Apelit		
68	Islam Myteveli	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.1127, datë 25.07.2014		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.4626, datë 20.12.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,199,496 lekë	998,648 lekë
69	Ilir Mezini	Drejtor	II-1	Vendimi nr.76, datë 16.02.2015		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.530, datë 14.02.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,578,927 lekë	1,195,680 lekë
70	Petrit Sudi	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.17078, datë 23.06.2014		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.1168, datë 21.03.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,557,705 lekë	1,069,920 lekë
71	Vilma Faqekuqi	Inspektore	IV-1	Vendimi nr.75, datë 16.02.2015	Suprimuar Pozicioni	Suprimuar	Vendimi nr.2983, datë.28.06.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	8,757,812 lekë	1,016,160 lekë
72	Emiljano Cera	Specialist	IV-2	Vendimi nr.836, datë 29.10.2015		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.1907, datë. 04.05.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	6,145,945 lekë	747,600 lekë

73	Mendu Koci	Inspektor	IV-1	Vendim nr.24, datë 16.01.2015	Me Komsion disipline per "Mospërbushje e rëndë e detyrave dhe shkelja e rëndë në mënyrë të përsëritur e rregullave te etikës në marrëdhënie me eproret, koleget dhe tatimpaguesin"	Suprimuar	Vendim nr. 543, datë 16.03.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,983,506 lekë	1,082,660 lekë
74	Mehmet Lushaj	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.1086, datë 23.06.2014		Suprimuar	Vendimi nr.2689, datë 14.06.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,229,623 lekë	1,080,000 lekë
75	Aleksandër Qafa	Inspektor Hetimi	IV-2	Vendimi nr.1423, datë 09.10.2014		Suprimuar	Vendimi nr.2804, datë 20.06.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,035,824 lekë	975,774 lekë
76	Mirlinda Aliko	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.1453, datë 21.10.2014		Suprimuar	Vendimi nr.2753, datë 16.06.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	8,469,763 lekë	885,322 lekë

77	Sami Sokoli	Përgjegjës	IV-1	Vendimi nr.23, datë 16.01.2017		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2863, datë 29.09.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	10,150,346 lekë	1,110,294 lekë
78	Bashkim Methasani	Inspektor	IV-1	Vendimit nr.3202, datë 15.06.2015		Suprimuar	Vendimi nr.366, datë 12.12.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,104,673 lekë	1,112,169 lekë
79	Elisabeta Shehu	Drejtör	III-3	Vendimi nr.1602, datë 23.06.2014		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr. 540, datë 15.02.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit Vlorë	12,004,573 lekë	1,278,177 lekë
80	Gligor Kallavares	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.857, datë 03.11.2015 të K.D		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.479, datë 08.02.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit	7,537,513 lekë	885,768 lekë
81	Mirgen Dervishi	Përgjegjës	IV-1	Vendim nr.409, datë 15.05.2015		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.965, datë 07.03.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,854,915 lekë	1,056,875 lekë
82	Arber Dhana	Inspektor	IV-1	Vendim nr.128, datë 09.02.2016		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2963, datë 13.07.2018, i Gjykatës	7,709,324 lekë	903,039 lekë

							Administrative të Apelit		
83	Aleksander Paja	Inspektor i Parë	IV-1	Vendim nr.2145, datë 22.07.2013		Suprimuar	Vendim nr.210, datë 20.01.2014, i Gjykatës së Apelit Tiranë	579,600 lekë	309,500 lekë
84	Adelina Kokoshi	Specialist	IV-3	Vendimi nr.1361, datë 25.03.2013		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr. 13, datë 27.12.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit	7,933,008 lekë	735,046 lekë
85	Dervish Beqiraj	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.600, datë 24.07.2015		Suprimuar	Vendimi nr.418, datë 14.02.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	9,769,773 lekë	1,122,866 lekë
86	Osman Demirxhi	Inspektor	IV-3	Vendimi nr.1106, datë 12.12.2008		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.95, datë 21.10.2009, i Gjykatës së Apelit Tiranë	13,185,756 lekë	838,316 lekë
87	Bajram Frangu	Inspektor	IV-1	Vendimi nr.1065, datë 02.06.2014		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr. 220 datë 26.01.2017 i Gjykatës Administrative të Apelit	10,109,372 lekë	1,140,588 lekë
88	Alfons Bazelli	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.445, datë 29.05.2015		Suprimuar	Vendimi nr.469, datë 20.02.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit	8,105,604 lekë	913,402 lekë

89	Suzana Skuqi	Përgjegjës	IV-1	Vendimi nr.2018, datë 04.06.2013		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.3037, datë 11.09.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit	453,600 lekë	154,800 lekë
90	Androkli Kokthi	Drejt看 Rajonal	III-3	Pezullim nga detyra nga Gjykata e Apelit Tiranë me datë 09.03.2016		Pozicion jo i lirë	Vendim nr.1686, datë 04.05.2018	10,626,532 lekë	1,380,001 lekë
91	Arjan Halili	Inspektor	IV-2	Vendim nr. 1193, datë 25.07.2014		Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2682 , datë 21.09.2016	8,853,359 lekë	945,421 lekë
92	Naim Sina	Inspektor	IV-2	Masë disiplinore “ <i>Largim nga shërbimi civil</i> ”		Pozicion jo i lirë	Lëshim Urdhri Ekzekutimi Vendim nr. 154, datë 19.05.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë vendim i formës së prerë	12,273,641 Lekë	867,016 Lekë
93	Selaudin Vakaj	Inspektor	IV-3	Vendimi nr.876, datë 27.03.2014		Suprimuar	Vendimi nr.1719, datë 22.06.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,109,118 lekë	924,130 lekë
94	Ardjana Hila	Specialist	IV-2	Vendimi nr.6144 datë 21.03.2019		Suprimuar pozicioni	Vendimi nr.421, datë 22.05.2023, i Gjykatës	4,666,512 lekë	1,212,223 lekë

							Administrative të Apelit Tiranë		
95	Skender Murati	Inspektor	IV-2	Vendim nr.1763, datë 24.04.2013		Suprimuar	Vendimi nr.74, datë 16.09.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit	5,260,355 lekë	913,605 lekë
96	Aleks Neçaj	Inspektor	Iv-1	Vendim nr.431, datë 25.05.2015		Pozicion jo i lirë	Vendim nr.53/2256, datë 08.05.2012, i Gjykatës Administrative të Apelit	9,360,715 lekë	1,056,635 lekë
97	Haxhire Bushi	Përgjegjës	III-2	Vendimi nr.777, datë 03.11.2011		Pozicion jo i lirë	Vendim nr.53/2256, datë 08.05.2012 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	1,958,654 lekë	138,000 lekë
98	Mira Kaçorri	Drejtor	III-1	Vendimi nr.246, datë 1.4.2016		Pozicion jo i lirë	Vendim nr. 89, datë 4.3.2022, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	9,590,907 lekë	1,245,177 lekë
99	Agim Toro	Inspektor II	IV-2	Vendimi nr.165, datë 19.2.2019		Pozicion jo i lirë	Vendim nr. 36, datë 7.2.2022, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	4,857,959 lekë	998,198 lekë
100	Mirela Sadikaj	Inspektor II	IV-2	Vendimi nr.1309, datë 13.3.2013		Suprimuar	Vendim nr. 522, datë 6.3.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	215,070 lekë	-
101	Valmir Vantasi	Inspektor II	IV-2	Vendimi nr.40322, datë 07.12.2016		Praktike e re	Vendim nr. 529, datë 14.07.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit	2,190,255 lekë	1,315,136 lekë

102	Sahit Meshi	Inspektor II	IV-2	Vendimi nr.1163, datë 25.07.2014		Praktikë e re	Vendim nr. 31003-01885-00-2016, datë 02.11.2023, i Gjykatës së Lartë	7,879,185 lekë	2,318,564 lekë
103	Yllka Plaku	Inspektor I	IV-1	Vendimi nr.105, datë 23.02.2015		Praktikë e re	Vendim nr. 1053, datë 13.12.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit	6,897,092 lekë	2,440,159 lekë
104	Eftali Lito	Specialist	IV-3	Vendimi nr.437, datë 22.07.2016		Praktikë e re	Vendim nr. 126, datë 12.02.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit	5,304,387 lekë	1,772,736 lekë
8.2 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave									
105	Endri Dafa	Përgjegjës turni, Zyra Doganore Qafë Botë	IV-I	Vendim nr.26875/4, datë 09.03.2018	Masë disiplinore	Në proces rikthimi	Vendimi nr.284, date 20.04.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit	6,970,020 lekë	443,520 lekë
IX. MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE									
106	Kostandin Vako	Inspektor	III ^b	Nr.5594 prot., datë 11.12.2013	Ristrukturim	Ndryshim i kriterëve të vecanta	Vendimi nr.1778, datë 21.04.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë	726,802 lekë	671,318 lekë
107	Alketa Xhako		III ^b	Nr. 5594/1 prot., datë 11.12.2013	Ristrukturim	Ndryshim i kriterëve të vecanta	Vendimi nr.4215 datë 17.07.2014, i	746,400 lekë	688,368 lekë

							Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë		
108	Mirela Cano	Sekretar i Përgjithshëm	I ^b	Nr.913/7 prot., datë 18.02.2014	Ristrukturim	Dërguar propozimi	Vendimi nr.415, datë 03.03.2016 , i Gjykatës Administrative Apelit Tiranë	1,373,260 lekë	1,233,744 lekë
109	Sokol Frroku	Drejtor	II ^b	Nr.5594/4 prot., datë 11.12.2013	Ristrukturim	Dërguar propozimi	Vendimi nr.3725, datë 09/10/2014, i Gjykatës Administrative Apelit Tiranë	3,707,760 lekë	3,334,950 lekë
110	Romeo Zegali	Drejtor	II ^b	Nr. 316/1 prot., datë 15.01.2018	Ristrukturim i institucionit	Ndryshim i kritereve të vecanta	Vendimi nr.1357, datë 16.04.2018, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë	1,196,000 lekë	1,079,520 lekë
111	Ndrek Ismajli	Përgjegjës	III ^a	Nr. 1354/4 prot., date 21.07.2010	Lirim nga Sherbimi civil (mase disiplinore)	Ndryshim i kritereve të vecanta	Vendimi nr.201 datë 04.11.2011 i KSHC	895,225 lekë	817,846 lekë
112	Anna Xheka	Drejtor	II-b	Nr. 795 prot., date 07.04.2010	Lirim nga Sherbimi civil (mase disiplinore)	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.147, datë 02.12.2010, i KSHC	1,082,280 lekë	980,584 lekë

113	Dritan Burgija	Drejtor	II ^b	Nr. 2148/4 prot., datë 01.11.2013	Lirim nga Shërbimi civil (<i>larguar me masë disiplinore</i>)	Ndryshim i kriterëve të vecanta	Vendimi nr.360, datë 03.02.2014	1,062,600 lekë	963,462 lekë
114	Ilirjan Proko	Drejtor	II ^a	Nr. 795 prot., datë 07.04.2010	Ristrukturim i institucionit	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.863, datë 24.02.2015	5,152,000 lekë	4,638,240 lekë
115	Flora Batusha	Drejtor	II ^a	Vendimi nr.1038 datë 03.10.2013	Pezullim i ushtrimit të detyrës	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.473, datë 06.02.2015	1,269,000 lekë	1,143,030 lekë
116	Harris Murana	Drejtor	III ^a	Nr. 5594/5 prot., datë 11.12.2013	Ristrukturim i institucionit	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.958, datë 01.03.2014	-	-
117	Luiza Gjonaj	Specialiste	IV ^a	Nr.294 prot. datë 30.12.2014	Masë disiplinore	Në vazhdim të procedurës për rikthimin në pozicionin e mëparshëm	Vendimi nr.2522, datë 11.05.2015	6,326,132 lekë	1,141,548 lekë
118	Lindita Backaj	Drejtor	II ^b	Akti nr. 294 prot., datë 15.01.2018	Ristrukturim	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.2111, datë 04.06.2018	6,408,720 lekë	5,754,986 lekë
X. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL									
119	Aleksandër Klimi	Përgjegjës	III ^a	Akti nr. 15, datë 26.5.2016	Masë disiplinore	Pozicion jo i lirë	Vendimi nr.481, datë 15.11.2022	9,084,251 lekë	
120	Adelina Bistri	Specialist	III ^b	Akti nr.5141/169,	Ristrukturim	Shkurtim pozicioni	Vendimi nr.44, datë 24.01.2024		

				datë 22.11.2013					
10.1 Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve									
121	Albert Kushti	Drejtor i <i>Agjencise Kombëtare te Duhan- Cigareve (Fizike)</i>	III ^a	Nr. 428, datë 05.09.2014	Masë disiplinore <i>(Neni 57/2 të Ligjit nr. 152/2013 për Nëpunësin Civil)</i>	Pozicion jo i lirë	Nr. 167 datë 04.02.2015	11,331,345 lekë	-
122	Besnik Jakaj	Drejtor	III ^a	Urdhër Nr.5205/10 prot., datë 27.12.2017	Masë disiplinore <i>(Neni 57/2 të Ligjit nr. 152/2013 për Nëpunësin Civil)</i>	Në zbatim të Ligjit Nr. 16/2020, për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9863 Prot, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka dalë nga fusha e zbatimit të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe marredheniet e punes te punonjesve te AKU rregullohen sipas dispozitave te Kodit te Punes dhe AKU e ka të pamundur sistemimin e Z. Besnik Jakaj në një pozicion pune si nëpunës civil. Sa me siper, rasti eshte marre ne shqyrtim	Nr. 633, datë 29.12.2021	7,482,287 lekë	

						nga Institucioni Qendror, Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, i cili ka konstatuar pamundesine e sistemimit te z. Jakaj ne aparatin e saj, dhe ka kerkuar asistencen e Departamentit te Administrates Publike per rikthim ne pune te z. Jakaj			
XI. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË									
123	Arminda Qylafku	Drejtor i Pergjithshem	II ^a	Akti nr.546/1, datë 25.02.2014 i SP të ish MTI-së	Ristrukturim institucioni	Ndryshim i kriterëve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimit nr.3145, datë 10.10.2016, i Gjykatës së Apelit	14,483,100 lekë	756,400 lekë
124	Edmond Kazazi	Drejtor	II ^b	Akti nr.507, datë 25.02.2014	Ristrukturim institucioni	Ndryshim i kriterëve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimi nr.500072, datë 07.12.2023, i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë		-
125	Zyrie Gymishka	Përgjegjës	III ^{a/1}	Vendimi nr.511/1, datë 25.02.2014 i	Ristrukturim institucioni	Ndryshim i kriterëve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimi nr.4493, datë 14.12.2016, i	90,000 lekë	0

				SP te ish MTI-se			Gjykatës së Apelit		
126	Dea Shllaku	Përgjegjëse	III ^{a/1}	Vendimi nr.542/1, datë 25.02.2014 i SP te ish MTI-se	Ristrukturim institucioni	Ndryshim i kritereve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimi nr.2243, datë 14.07.2016, i Gjykatës së Apelit	9,309,022 lekë	0
127	Alma Meco (Bilali)	Përgjegjëse	III ^a	Nr. 2403, datë 16.03.2012	Largim nga shërbimi civil	Ndryshim i kritereve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendim nr.2403, datë 16.03.2012		
128	Ilirjana Murati	Specialiste	III ^b	Nr.122, datë 26.11.2013	Kalim në listë pritje	Ndryshim i kritereve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimi nr.4157, datë 05.10.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	7,897,360 lekë	388,800 lekë
129	Agron Tyli	Drejtor i ARRSH	III ^a	Shkresa Nr.5254/5, datë 03.07.2018	Refuzim i nënshkrimit të kontrates së punës		Vendim nr.3361, datë 23.12.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	7,031,875 lekë	
130	Tonin Frroku	Inspektor	III ^a	Akti nr. 646/1 prot., datë 25.2.2014	Ristrukturim	Ndryshim i kritereve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimi nr. 1708, datë 24.4.2017, GJAAT	0	0
131	Arben Xhiku	Drejtor i OKIIA	II ^b	Akti nr.330, datë 05.04.2018, i	Lirim nga detyra	Dalja e OKIIA nga Shërbimi Civil	Vendimi nr.348, datë 7.2.2019, i	9,153,800 lekë	824,800 lekë

				Ministrit te Infrastruktur ës dhe Energjisë			Gjykatës së Apelit		
132	Martin Biba	Përgjegjës sektori	Nuk është e aplikueshme	Vendimi nr.2168, datë 17.12.2018 Urdhri nr.498, datë 17.12.2018	Lirim nga shërbimi civil për shkak të ligjit	Nuk ekziston vendi në shërbimin civil	Vendimi nr.592, datë 18.09.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit	10,199,767 lekë	860,06 lekë
133	Kozeta Qehajaj	Përgjegjëse sektori	IIIa	Vendimi nr.6853/3, datë 13.06.2018, i Komisionit të Ristrukturimi t	Ristrukturim institucioni	Ndryshim I kritereve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimi nr. 112, datë 09.02.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit	0	0
134	Tefta Gina	Specialiste	III ^b	Akti nr. 831, datë 13.11.2013	Ristrukturim institucioni	Ndryshim I kritereve të vecanta të punës, në strukturën e re	Vendimi nr. 1057, datë 17.12.2020, i Gjykatës se Apelit	0	9,278,618 lekë

ANEKSI NR. 3

TË DHËNA NË LIDHJE ME RASTET E NËPUNËSVE CIVIL GJYQFITUES, TË RIKTHYER NË NJË POZICION TË RREGULLT TË SHËRBIMIT CIVIL

I. KRYEMINISTRIA									
Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Kategoria e pagës	Akti i lirimit ose largimit nga shërbimi civil	Arsyeja e largimit ose lirimit nga shërbimi civil (neni)	Nr./data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Nr./data e aktit të riemërimit në detyrë	Vlera e pagesës së kryer nga institucioni për ekzekutimin e vendimit	Vlera monetare e papaguar deri në përmbushjen e plotë të detyrimit
1	Manjola Duli	Koordinator	II ^b	Shkresë nr.4300, datë 18.12.2021, Kalim në listë pritje	Ristrukturim	Vendim nr.2126, datë 12.10.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë	Akti nr. 2487/2, datë 27.4.2023	1142891 lekë	8993669 lekë
1.1 Departamenti i Administratës Publike									
2	Valbona Shegani	Specialist	III ^b	Urdhër nr. 66/4, datë 16.1.2014	Masë disiplinore	Vendimi nr. 1911, datë 21.09.2015	Urdhër emërimi nr.6829/12, datë 4.7.2018	4,221,710 lekë	0

3	Marjel Mejdini	Koordinator	III ^a	Urdhër nr.1591/10, datë 06.11.2023	Ristrukturim	Vendimi nr. 1459, datë 13.05.2019	Urdhër emërimi nr.4359/6, datë 23.08.2019	6,218,942 lekë	0
1.2 Inspektorati Qendror									
4	Lezan Gjyla	Drejtor	II ^b	Urdhër nr.49, datë 28.04.2017	Ristrukturim	Vendimi nr. 34, datë 26.01.2023	Urdhër emërimi nr.4888/4, datë 11.10.2023	5,528,660 lekë	5,649,685 lekë
1.3 Agjencia e Menaxhimit të Mbetjeve Ujore									
5	Ast Nikolla	Specialist	IVb	Mospërbushje e rëndë e detyrave	Profili i edukimit nuk përshtatet me pozicionet vakante aktuale në këtë institucion	Vendiminr 436, datë 17.9.2021, GJ.A.A.T	Urdhër emërimi nr.4528/4, datë 20.09.2024		
II. MINISTRIA E MBROJTJES									
6	Edmod Gore	Drejtor	II ^b	Vendimi nr.5429/1, datë 03.09.2019, të Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse	Shkronjës “c”, pika 1, të nenit 66, “Lirimi nga shërbimi civil”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku thuhet: “Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet liritimit	Vendimin nr.327 (86-2021-419), datë 11.06.2021, i Gjykatës Administrative të Apelit	Akt emërimi nr.2700/3, datë 05.05.2022, i Departamentit të Administratës Publike		0

					në këto raste: c) pas dy vlerësimeve “jokënaqshëm”, të rezultateve në punë”				
7	Esmeralda Caushaj	Specialist	III ^b	Vendimi nr.78, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm të MM	Ristrukturimi I institucionit të MM, organika e drejtorisë ndryshoi totalisht është bërë riorganizimi i sektorëve, ka shkurtim të numrit të personelit	Vendimi nr. 1223, datë 18.05.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit	Akti nr.998/2, datë 02.03.2017, "Akt emërimi" i Departamenti të Administratës Publike"		0
8	Ardit Cankja	Specialist	III ^b	Vendimi nr.88, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm të MM	Ristrukturimi i institucionit të MM, organika e drejtorisë ndryshoi duke shkrirë 3 sektorë në dhe 4 zyra, shkurtim i numrit të personelit dhe ndryshim i përshkrimit të punës. <i>(neni 23, ligji nr.8549, dt. 11.11.1999)</i>	Vendimi nr.476, datë 11.03.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Akti nr.532/2, datë 27.02.2017, "Akt emërimi" i Departamentit të Administratës Publike		

9	Eda Grimci	Specialist	III ^b	Vendimi nr.69, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm, të MM	Ristrukturimi i institucionit të MM, organika e drejtorisë ndryshoi duke shkrirë 2 sektorë në një sektor, shkurtim i numrit të personelit, si dhe ndryshim i përshkrimit të punës. <i>(neni 23, ligji nr.8549, dt. 11.11.1999)</i>	Vendimi nr.611, datë 01.04.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Akti nr.1799/1, datë 27.04.2020, “Akt emërimi” të Departamentit të Administratës Publike		
10	Shemsi Stermasi	Specialist	III ^b	Vendim nr. 75, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm i MM.	Për shkak të ristrukturimit të institucionin dhe reduktim të numrit të personeli <i>(neni 23, ligji nr.8549, dt. 11.11.1999)</i>	Vendimi nr.2515, datë 14.09.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit	Aktit nr. 35/2. datë 10.01.2023, “Emërim” e Departamentit të Administratës Publike		
11	Gëzim Kodra	Përgjegjës Saktori	IIIa/1	Vendim nr. 77, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm i MM.	Ristrukturimi i institucionit të MM, organika e drejtorisë ndryshon ka shkurtim të sektorëve dhe numrit të personelit,	Vendimi nr. 2995, datë 30.09.2016, I Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Aktit nr. 4376/2. datë 01.10.2020, “Emërim” e Departamentit të Administratës Publike.		

					ndryshon përshkrimi i punës. <i>(neni 23, ligji nr.8549, dt. 11.11.1999)</i>				
12	Roland Bici	Specialist	IV ^a	Vendim nr. 61, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm i MM.	Ristrukturimi i institucionit të MM, ndryshon struktura e drejtorisë, përshkrimi i punës dhe kriteri arsimori i pozicionit. <i>(neni 23, ligji nr.8549, dt. 11.11.1999)</i>	Vendimi nr. 4471, datë 14.12.2016, I Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Aktit nr. 4375/2, datë 01.10.2020, “Emërim” e Departamentit të Administratës Publike.		
13	Elira Luli	Specialist	IV ^a	Vendim nr. 86, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm i MM.	Ristrukturimi I institucionit te MM, shkurtim i numrit të punonjësve të sektorit <i>(neni 23, ligji nr.8549, dt. 11.11.1999)</i>	Vendimi nr.2171, datë 15.10.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Aktit nr. 4373/2, datë 01.10.2020, “Emërim” e Departamentit të Administratës Publike.		
14	Artan Hasipi	Specialist	IV ^a	Sekretari i Përgjithshëm i Ministrit së Mbrotjtjes me vendimin Nr.1969/1, datë 01.07.2010, ka marrë masa	Me motivacionin “Për shkelje të përsëritur të Etikës së nëpunësit Civil, thyerje të rëndë disiplinore (kërcënim	Vendimi nr. 344, datë 07.02.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Aktit nr. 4377/2, datë 29.09.2020, “Emërim” e Departamentit të Administratës Publike.		

				disiplinore ndaj z. Artan Mersin Hasipi, “Largim nga shërbimi civil”	personi), si dhe dëmtim me qëllim të dokumentacionit zyrtar pronë shtetërore”				
15	Hristian Naumov	Specialist	IV ^a	Me anë të aktit nr. 1330/13, datë 15.08.2014, të DAP “Për revokimin e Aktit të Deklarimit të Statusit të Nëpunësit, Nr. 1330/6, datë 30.07.2014 për z. Hristian Stefan Naumov”	Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 8593, date 17.06.2014, Forcat e Armatosura kaluan në strukturën e re organizative dhe me Urdhët të Ministrit të Mbrotjtjes nr. 519, date 24.06.2014, “Për kalimin ne strukturën e re organizative dhe vendosjen në planin e përhapjes së Forcave Armatosura te Republikës së Shqipërisë”, “struktura e <i>Qendrës Kombëtare të</i>	Vendimi nr. 2278, datë 29.10.2015, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Aktit nr. 3533/2, datë 17.06.2022, “Emërim” e Departamentit të Administratës Publike		

					<i>Sigurisë dhe Mbrotjes</i> suprimohet dhe personeli i QKSM del ne dispozicion deri me date 30.09,2014				
16	Arjan Bllak	Specialist	IV ^a	Vendim nr. 63, datë 08.01.2014, i Sekretarit të Përgjithshëm i MM.	Ristrukturimi i institucionit të MM, ndryshon struktura e drejtorisë, përshkrimi i punës dhe kriteri arsimori i pozicionit. <i>(neni 23, ligji nr.8549, dt. 11.11.1999)</i>	Vendimi nr.3848, datë 20.10.2014, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Aktit nr. 4374/2, datë 29.09.2020, “Emërim” e Departamentit të Administratës Publike		
III. MINISTRIA E BRENDSHME									
17	Bajram Bistri	Përgjegjës	III ^a	Akti nr. 2748, datë 23.12.2005	Ristrukturim	Vendimi nr. 87 datë 26.01.2010, i Gjykatës së Apelit Tiranë	Akti nr. 5464/2, datë 02.11.2023, emëruar nga DAP	-	-
18	Altin Pasko	Drejtor	II ^b	Largim nga shërbimi civil	Masë disiplinore	Vendimi nr. 23, datë 23.02.2009, i Gjykatës së Apelit, Tiranë	Akti nr. 6164/3, datë 12.12.2023, emëruar nga DAP	-	-

19	Ervin Aliu	Koordinator	III ^a	Akti nr. 7806, datë 11.11.2013	Ristrukturim	Vendimi nr. 1780, datë 27.04.2017, i Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	Akti nr. 5646/5, datë 17.11.2023, emëruar nga DAP	-	-
20	Gentiana Mani	Specialist	IV ^a	Akti nr. 2737/31, datë 06.10.2014	Masë disiplinore	Vendimi nr. 1464, datë 06.04.2017, i Gjykatës së Apelit, Tiranë	Akti nr.1637/2 datë, 24.03.2023, emëruar nga DAP	-	-
21	Arjola Metaj	Specialist	III ^b	Vendim nr.7782, datë 11.11.2013	Ristrukturim	Vendim nr. 1470, datë 06.05.2014, I Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	Akti nr. 2092/2, datë 03.06.2016, emëruar nga DAP		
22	Sokol Sheti	Drejtor	II ^b	Vendim nr. 1570, datë 02.04.2013	Masë disiplinore	Vendim nr. 72, datë 26.09.2013, I Gjykatës së Apelit, Tiranë	Akti nr. 2472/2, datë 24.05.2016, emëruar nga DAP		
23	Lejda Gega	Specialist	III ^b	Vendim nr.7792, datë 11.11.2013	Ristrukturim	Vendim nr. 244, datë 11.02.2016, I Gjykatës Apelit, Tiranë	Aktin nr. 2093/4, datë 16.06.2016, emëruar nga DAP	Nuk ka pagesë	
24	Alfred Skapi	Specialist	IV ^b	Shkresa nr. 894, datë 05.03.2008	Ristrukturim	Vendim nr. 7, datë 20.01.2009, I Gjykatës Apelit, Tiranë	Emëruar nga DAP, datë 12.10.2017, në Prefekturën Tiranë	Nuk ka pagesë	

25	Luljeta Shahu	Specialist	III ^b	Vendim nr. 1776/3, datë 05.06.2007, për marrjen e masës disiplinore	Masë disiplinore	Vendimi nr. 427, datë 21.12.2007, I Gjykatës Apelit, Tiranë	Dalë në pension më datë 1.3.2019		
26	Mezan Hoxha	Inspector	III ^a	Urdhër Ministri nr.2772, datë 23.12.2005	Ristrukturim	Vendim nr. 2772, datë 23.12.2005, I Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	Akti nr. 5240/6, datë 21.10.2019, emëruar nga DAP		
27	Hetem Maili	Specialist	IV ^b	Akti nr. 1154/3 prot., datë 01.04.2008	Ristrukturim	Vendimi nr. 1, datë 13.01.2009, I Gjykatës Apelit, Tiranë	Akti nr.1614/5, datë 28.04.2020, emëruar nga DAP		
28	Kastriot Dervishi	Drejtor	II ^b	Vendimi nr.7424/16 prot.,datë 06.11.2014, i Komisionit Disiplinor	Masë disiplinore	Vendimi nr.11132, datë 16.03.2016, I Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	,Akti nr. 2139/2, datë 01.04.2022, emëruar nga DAP		
29	Erverest Muço	Specialist	III ^b	Akti nr. 7784 prot., datë 11.11.2013	Ristrukturim	Vendim nr. 1624, datë 14.04.2017, I Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	Akti nr.5925/5, datë 18.11.2021, emëruar nga DAP		
30	Ilir Haklaj	Specialist	III ^b	Akti nr. 455/11 prot., datë 18.02.2014	Ristrukturim	Vendim nr. 238, datë 11.02.2016, I Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	Akti nr. 5925/4, datë 01.12.2021, emëruar nga DAP		

31	Naim Dëra	Specialist	III ^b			Vendim nr. 53, datë 20.06.2003, I Gjykatës Apelit, Tiranë	Dale në pension më datë 06.09.2021	Nuk ka pagesë	
32	Genc Radovicka	Drejtor	II ^b	Akti nr. 683/1 prot.,datë 08.05.2007	Masë disiplinore	Vendimi nr. 77, datë 02.06.2008, I Gjykatës Apelit, Tiranë	Në vitin 2017 është pushuar ekzekutimi I vendimit me kërkesë të përmbaruesit		
33	Milaim Sadriaj	Përgjegjës Sektor	III ^a	Akti nr. 7783, datë 11.11.2013	Ristrukturim	Vendimin nr. 597, datë 07.12.2022, I Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	, Akti nr. 5757/2, datë 30.11.2023, emëruar nga DAP		
34	Isuf Kuçana (Prefektura)	inspektor	IV ^a	Urdhër nr. 39, datë 25.04.2016, I Prefektit të Qarkut Berat	Ristrukturim	Në këtë strukture nuk ka pozicion në shërbimin civil me kategori page IV ^a	Vendim nr. 945, datë 28.03.2019, I Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë	1,629,971 lekë	Në process likujdimi
IV. MINISTRIA E DREJTËSISË									
35	Juljana Hoxha	Sekretar i Përgjithshëm	I ^b	Vendimi nr.66, datë 05.10.2017	Masë disiplinore	Vendimi nr. 2911, datë 05.11.2019, Gjykatës Administrative së Apelit	Akti nr. 6090/4, datë 27.01.2023	9,896,775,36 lekë	4,933,831,68 lekë
36	Petrit Kaja	Inspektor	III ^a	Akti nr. 7434/1, datë 11.12.2017	Rikustrukturim ka dalë në listë pritje (neni 50/6)	Suprimuar	Ka mbushur moshën për pension pleqërie	6,827,009,73 lekë	1,145,002,68 lekë

37	Arben Cara	Drejtor	II ^b	Akti nr. 413/98, datë 03.12.2013	Ristrukturim	Vendim I datës 10.06.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë			
V. MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT									
38	Albano Zhapaj	Specialist	III ^b	Vendimi nr.20, datë 13.08.2014, i Komisionit të Disiplinës MAS	Masë disiplinore	Vendimi nr. 2437, datë 18.11.2015, i Gjykatës Administrative së Apelit	Vendimi nr.6317/11, datë 26.01.2023	6,382,310 lekë	726,800 lekë (janar – tetor 2022)
39	Bedrie Manjani	Përgjegjës i Zyrës Arsimore Bulqizë	IV ^a	Vendimi nr.5, datë 22.01.2018, i Komisionit të Disiplinës MAS	Masë disiplinore	Vendimi nr. 772, datë 10.09.2020, i Gjykatës Administrative së Apelit	Me aktin nr. 5408/3, date 31.10.2023	2,666,700 lekë	2,311,265 lekë
VI. MINISTRIA E SHËNDETËSISË									
40	Petrit Ponari	Drejtor	II ^b	Akti nr. 4063/1 prot., datë 13.9.2013	Masë disiplinore	Vendimi nr. 142, datë 26.12.2013			
VII. MINISTRIA E FINANCAVE									
41	Hysem Muçeku	Drejtor i Përgjithshëm	II ^a	Akti nr. 16957/1 prot., datë 09.12.2013	Riskstrukturim	Vendimi nr.4106, datë 07.11.2014	Akti nr.2877/2, datë 13.06.2023	13,773,031 lekë	-

42	Genti Minarolli	Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit	II ^a	Vendimi nr.14, datë 25.11.2013	Riskstrukturim	Vendimi nr.5413, datë 20.12.2017	Akti nr.2876/2, datë 13.06.2023	9,551,911 lekë	-
43	Durim Kraja	Drejtor i Përgjithshëm	II ^a			Vendimi nr. 71, datë 21.02.2023	Akti nr.2874/2, datë 13.06.2023	Nuk është paguar	
44	Alma Delija	Drejtor	II ^b	Vendimi nr.4922/11, datë 03.05.2016	Masë disiplinore	Gjykata Administrative e Apelit 22.10.2014	Akti nr.4129/2, datë 22.08.2023	9,615,375 lekë	-
45	Laureta Ahmeti	Specialist	III ^b	Vendimi nr.16936/2, datë 09.12.2013	Riskstrukturim	Vendimi nr.1506, datë 24.06.2015	Akti nr.3200/2, datë 23.06.2023	6,948,862 lekë	-
7.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve									
46	Servete Hasandocaj	Inspektor	IV-I	Vendimi nr. 1341, datë 15.09.2014	Suprimuar	Vendimi nr.4454, datë 14.12.2016, i Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	Shkresa nr.20591/2., prot, datë 06.12.2022 <i>(ekzekutim vendimi për shkak të moshës për pension)</i>	11,427,845 Lekë	131,760 lekë
47	Albert Berxolli	Inspektor	IV-I	Vendimi nr. 94, datë 06.02.2012	Suprimuar	Vendimi nr. 67, datë 03.07.2012, i Gjykatës Administrative së Apelit, Tiranë	Shkresa nr.20492, prot.,datë 19.12.2013 <i>(ekzekutim vendimi për</i>	1,766,982 lekë	-

							<i>shkak të moshës për pension)</i>		
48	Anila Haxhiu	Inspektor	IV-2	Vendimi nr.15, datë 29.06.2006	Suprimuar	Vendimi nr. 330, datë 12.12.2006, Gjykata Apelit	Shkresa nr.3890, prot., datë 28.02.2024	4,784,658 lekë	
49	Sami Sokoli	Përgjegjës	III-3	Vendimi nr.23, datë 16.01.2017	Suprimuar	Vendimi nr. 2863, datë 29.09.2016, i Gjykata Administrative së Apelit, Tiranë	Shkresa nr.5028, prot.. datë 18.03.2024 <i>(ekzekutim vendimi për shkak të moshës për pension)</i>	10,1150,346 lekë	258,600 lekë

VIII. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

50	Kosta Sterjopullo (AAC)	Specialist	Nuk është e aplikueshme	Akti nr. 16, datë 01.10.2018	Masë disiplinore	Vendimi nr. 227, datë 14.06.2022	Akti nr.506, datë 24.08.2023	7,747,541 lekë	-
51	Genci Dauti (Autoriteti Kombëtar për sigurinë dhe Emergjencat në Miniera)	Inspektor	III ^b	Urdhri nr.93, datë 09.05.2017	Plotësim të moshës së pensionit	Vendimi nr. 483, datë 20.12.2017		1,247,876 lekë	260,812 lekë

IX. MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

9.1 Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

52	Flamur Mera	Inspektor	IV ^b	Akti nr. 66, datë 21.03.2019	Masë disiplinore	Vendimi nr. 265, datë 06.04.2023	Akti nr.119, datë 06.07.2023	1,300,000 lekë	531,438 lekë
53	Mehdi Meçka	Inspektor	IV ^b	Akti nr.68, datë 21.03.2019	Masë disiplinore	Vendimi nr. 643, datë 25.09.2023	Akti nr.200, datë 19.12.2023	700,000 lekë	2,133,299 lekë

9.2 Drejtoria e Metrologjisë

54	Dardan Çuni	Specialist	IV ⁻²	Akti nr. 150, datë 14.06.2018	Neni 13 i ligjit nr.138/2015	Vendimi nr. 155, datë 23.03.2023	Urdhër nr.195, datë 30.06.2023	3,175,352 lekë	-
----	-------------	------------	------------------	----------------------------------	---------------------------------	-------------------------------------	-----------------------------------	----------------	---

X. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**10.1 Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë**

55	Suela Hima	Specialiste	IV ^b	Vendimi nr. 749 date 21/11/2014	Neni 57/2 Masë disiplinore	Nr. 5106 (86- 2017-5429), datë 5.12.2017	Shkresa nr.1870/3, datë 5.4.2023, e Departamentit te Administrates Publike	1, 300,000 lekë	5,093,617 lekë
----	------------	-------------	-----------------	------------------------------------	-------------------------------	--	---	-----------------	----------------



WWW.KMSHC.AL